

FJALA E GUVERNATORIT

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj anëtarë të Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

Është privilegj i veçantë, që në zbatim të detyrimit ligjor të paraqes para Jush Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2006.

Në këtë raport përmbledhet veprimtaria e Bankës së Shqipërisë në zbatim të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore. Në pjesën e parë, më lejoni të përqendrohem në ecurinë e ekonomisë kombëtare për të trajtuar më tej pjesët më specifike, që lidhen me përgjegjësitë institucionale dhe kontributet e drejtpërdrejta të Bankës së Shqipërisë në drejtim të kontrollit të inflacionit, të ruajtjes së stabilitetit financiar, të përmirësimit të infrastrukturës financiare si dhe të rolit tonë në integrimin evropian dhe atë rajonal.

1. ZHVILLIMET EKONOMIKE GJATË VITIT 2006

Zhvillimi ekonomik i vendit gjatë vitit 2006, ka qenë përgjithësisht në përputhje me programin afatmesëm të zhvillimit ekonomik të vendit. Ekonomia shqiptare ka patur ritme krahasimisht të kënaqshme rritjeje, në sajë të dinamizmit të sektorit privat, stabilitetit makroekonomik dhe fryteve të reformave të deritanishme strukturore. Sistemi bankar ka dhënë një stimul të fuqishëm në mbështetje të aktivitetit ekonomik, duke rritur kredinë për ekonominë me rreth 70 miliardë lekë ose mbi 700 milionë dollarë amerikanë.

Në bazë të treguesve të disponueshëm ekonomikë, norma e rritjes ekonomike vlerësohet të jetë rreth nivelit 5 për qind. Kjo rritje është shoqëruar me stabilitet çmimesh, të shprehur në një inflacion mesatar vjetor prej 2.4 për qind. Kushtet monetare, të karakterizuara nga norma historikisht të ulëta interesi dhe qëndrueshmëri e kursit të këmbimit, kanë favorizuar rritjen e investimeve dhe të konsumit në ekonomi. Në mënyrë të veçantë, ato janë reflektuar edhe në rritjen e shpejtë të kredisë, duke mbështetur më tej rritjen e ekonomisë. Zhvillimet fiskale kanë rezultuar brenda kufijve të programuar, duke kontribuar në konsolidimin e mëtejshëm të financave publike dhe kontrollin e deficitit buxhetor.

Gjithsesi, realizimi i shpenzimeve kapitale kërkon një vëmendje më të madhe, në drejtim të nivelit të planifikuar ashtu edhe përsa i takon ritmikës të kryerjes së këtyre shpenzimeve.

Rritja ekonomike është reflektuar edhe në tregun e punës. Numri i të punësuarve në vend ka shënuar rritje, ndonëse ajo ende nuk reflekton tërësisht

zhvillimet në sektorët e tjerë të ekonomisë. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik në vend është shoqëruar me rritjen e shkëmbimeve tregtare me jashtë. Bilanci i pagesave është mbyllur në terma pozitivë, duke mbështetur qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit.

Treguesit sasiore dhe cilësore të ecurisë ekonomike, flasin për një rritje të kënaqshme, të mbështetur kryesisht në aktivitetet e shërbimeve dhe të prodhimit industrial. Shitjet e realizuara nga ndërmarrjet ekonomike, gjatë nëntëmuajorit të parë, ishin rreth 11 për qind më të larta sesa në vitin 2005. Fakti që tremujori i parë regjistroi një rritje të lartë vjetore të shitjeve, tregon se ndërmarrjet e prodhimit dhe të shërbimeve, i tejkaluan problemet e shkaktuara nga kufizimet në furnizimin me energji elektrike, në fund të vitit 2005. Zhvillime pozitive janë regjistruar në sektorin e industrisë dhe në mënyrë të veçantë, në industrinë përpunuese. Aktiviteti tregtar në vend, vazhdon të sigurojë pjesën më të madhe të shitjeve, si edhe të shënojë ritme të konsiderueshme rritjeje vjetore.

Sektori i ndërtimit, vlerësohet të ketë patur një ecuri afërsisht të njëjtë me atë të vitit të kaluar. Tregues të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të këtij sektori, imponojnë domosdoshmërinë për një vëmendje më të madhe, veçanërisht në orientimin më të mirë të burimeve financiare, private apo publike. Zhvillimet në degën e ndërtimit gjatë viteve të fundit, veçanërisht përqendrimi i skajshëm i ndërtimeve në territore të caktuara, dëshmojnë për mungesë të eficiencës së politikave të zhvillimit urban, duke mos garantuar qëndrueshmërinë afatgjatë të degës. Për më tepër, ende dega e ndërtimit vazhdon të mbizotërohet nga ndërtimet për banesa, duke lënë shumë prapa zëra të tjerë strategjikë siç janë investimet në infrastrukturën rrugore, në ndërtime industriale, në bonifikime dhe infrastrukturë bujqësore përfshirë dhe investime të tjera, që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës në komunitetet e vogla urbane dhe rurale.

Prodhimi bujqësor gjatë vitit 2006 ka rikuperuar pjesërisht rënien e ritmit të rritjes, të vërejtur gjatë vitit 2005. Projeksioni për rritjen e sektorit në vitin 2006 qëndron në nivelin 2.5 për qind, duke qenë më i lartë se rritja në vitin 2005, por më i ulët se norma mesatare e rritjes gjatë pesë viteve të fundit. Investimet në sektorin e bujqësisë dhe financimi nga ana e sistemit bankar, do të rriten në përputhje me potencialin që ka kjo degë, vetëm nëse eliminohen pengesat e krijuara nga probleme të shumta strukturore.

Toka bujqësore nuk shfrytëzohet në maksimum, si pasojë e migrimit të jashtëm dhe të brendshëm dhe problemeve me titujt e pronësisë. Infrastruktura relativisht e pazhvilluar e zonave rurale, vështirëson daljen e produkteve në treg. Copëzimi i tokës bujqësore pengon organizimin efektiv të prodhimit, ul rendimentin dhe rrit koston e përdorimit të mekanikës bujqësore.

Përsa i përket energjisë, Banka e Shqipërisë vlerëson se ajo mbetet sfida jonë kryesore në periudhën e afërt dhe atë afatmesme.

Për rreth një dekadë e gjysmë po përballemi me kufizime të theksuara në furnizimin me energji elektrike. Përkimi në kohë i krizave aktuale me një

ambient global shumë të ndjeshëm ndaj këtij problemi, ka bërë që kostot e importimit të burimeve energjitime të jenë relativisht të larta, të cilat në terma afatgjatë do të ishin të papërballueshme. Nga vërtetimet e Bankës së Shqipërisë rezulton se pasojat negative që kjo situatë krijon, janë të shumta dhe të lidhura drejtëpërsëdrejti me aktivitetin ekonomik të sektorit prodhues si në nivel korporatash ashtu edhe në atë të biznesit të vogël apo të mesëm. Përsëritja e herëpashershme rrit rrezikun që periudhat me kufizime të ndjeshme të energjisë, të mos konsiderohen më si goditje rastësore por gjithnjë e më shumë të klasifikohen si faktorë të përhershëm, të cilët duhen faktorizuar në kostot e prodhimit dhe për rrjedhim, në politikat e formimit të çmimeve dhe në pritjet për to.

Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë vlerëson se, duke filluar që nga viti 2007, të gjithë aktorët vendimmarrës përkatës nevojitet të zbatojnë një politikë të re administrimi, konkrete, të ndryshme nga praktika 15-vjeçare. Pjesë integrale e saj nuk duhet të jetë vetëm administrimi i burimeve aktuale energjitime, por dhe hapat konkretë në rrjetin shpërndarës si masa afatshkurtra për të kaluar në veprime më afatgjata, që do të kuptonin ndërtimin e burimeve alternative të energjisë. Zgjidhja sa më e shpejtë e situatës energjitime, do të ketë ndikime pozitive për biznesin shqiptar, për shëndetin e financave publike, për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit dhe për stabilitetin makroekonomik.

Në përfundim të kësaj pjese të parë, do të doja të evidentoja disa çështje të tjera, të cilat mendoj se duhet të përfshihen në listën e prioriteteve të zhvillimit afatmesëm ekonomiko-financiar të vendit. Ekonomia shqiptare po largohet nga statusi i një ekonomie në tranzicion duke iu afruar atij të një ekonomie në zhvillim. Ky hap cilësor kërkon thellimin e mëtejshëm të reformave strukturore, rritjen e efektivitetit të politikave të zhvillimit dhe zgjerimin e kapaciteteve absorbuese të vendit, në drejtim të rritjes së konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare në kontekstin rajonal dhe më gjerë.

Si një çështje të afërt dhe të perspektivës do të evidentoja thellimin e vazhdueshëm të deficitit tregtar. Edhe pse momentalisht pozicioni i jashtëm i vendit, i materializuar në tregues të tillë si borxhi i jashtëm, niveli i rezervave valutore apo pozicioni i përgjithshëm i bilancit të pagesave nuk paraqitet problematik, vlerësoj se rritja e eksporteve nuk është e mjaftueshme, veçanërisht në kontekst të varësisë së lartë që ka ekonomia shqiptare ndaj dërgesave të emigrantëve. Deficiti korent relativisht i lartë, rreth nivelit 7.6 për qind të PBB-së, është një argument më shumë në këtë drejtim. Ky i fundit, në prani edhe të një deficiti fiskal, rrit ekspozimin e ekonomisë tonë dhe bën të domosdoshëm sigurimin e prurjeve valutore të një natyre më të qëndrueshme. Kjo, do të përkthehej në një nevojë për më shumë investime të huaja direkte cilësore, të cilat nga ana e tyre do të kontribuonin në një rritje të qëndrueshme të eksporteve.

Për këtë qëllim, duke përfituar edhe nga një ambient global, i cili në vazhdimësi është në kërkim të tregjeve të reja, do të sugjeroja një strategji kombëtare marketingu më cilësore. Në këtë strategji, duhet të evidentohen

në mënyrë profesionale dhe bashkëkohore, të gjitha nismat e fundit dhe oportunitetet e shumta që ofron Shqipëria. Gjithashtu, mendoj se ka ardhur koha që në planet tona afatgjata të zhvillimit, duhet të integrojmë edhe projekte të përbashkëta rajonale. Infrastruktura rrugore, energjia, komunikacioni, turizmi e fusha të tjera, janë ende të pazhvilluara në nivel rajoni. Për këtë arsye, vlerësoj se projektet rajonale të natyrës strategjike ngjallin një shkallë më të lartë interesimi tek investitorët vendas dhe të huaj. Ekonomitë e rajonit të marra të shkëputura, janë relativisht të vogla, por të marra të gjitha së bashku, mendoj se formojnë një treg tërheqës me shumë mundësi investimi.

Këto vitet e fundit, është vërejtur gjerësisht se shkalla e depërtimit të investimeve të huaja në rajonin tonë është relativisht e vogël dhe kryesisht, pasqyron procesin e privatizimit të pasurive të rëndësishme publike. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me ekonominë shqiptare. Më konkretisht, gjatë periudhës 2000 – 2006, investimet e huaja direkte të marra së bashku, sipas statistikave të bilancit të pagesave, llogariten rreth 1.45 miliardë usd, rreth 3.5 për qind e PPB-së së realizuar në të njëjtën periudhë.

Në qoftë se do të identifikonim arsyet pse flukset e IHD janë kaq modeste, mund të përmendnim problemet komplekse që karakterizojnë rajonin tonë, ndërkohë që edhe në plan kombëtar ekzistojnë arsye të ndryshme, të cilat ulin aftësinë thithëse të ekonomisë sonë.

Banka e Shqipërisë mendon se stadi aktual i zhvillimit të vendit, krijon mundësi të mëdha në këtë drejtim. Eksperienca e vendeve të sapoanëtarësuar, ka treguar se nënshkrimi i MSA dhe negociatat që pasojnë atë, janë ndjekur nga fluksi i lartë IHD-sh. Gjithsesi, nuk mund të pretendojmë që ky fenomen do të jetë automatikisht i pranishëm edhe në Shqipëri. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë gjykon se thellimi i mëtejshëm i reformave strukturore është i domosdoshëm dhe se ky proces, duhet të pasohet me përmirësimin e klimës së biznesit si dhe me rritjen e shkallës së zbatimit të ligjit.

Si problem të fundit, por jo më të parëndësishmin, do të doja të ekspozoja shkallën ende të ulët të mbulimit të aktivitetit ekonomik me të dhëna statistikore. Politika monetare që ne po ndjekim, është një proces sa dinamik aq dhe vizionar. Përveç ekzistencës së tregjeve eficiente ajo kërkon edhe një mbështetje të gjerë me të dhëna statistikore të freskëta dhe metodologjiksht të sakta.

Pavarësisht përpjekjeve tona të vazhdueshme dhe mirëkuptimit që kemi gjetur tek INSTAT, ne e shikojmë të domosdoshme që të apelojmë për një vëmendje më të madhe të të gjithë shoqërisë dhe institucioneve përkatëse në veçanti, në drejtim të shtimit të informacionit statistikor dhe konsolidimit të mëtejshëm të atij ekzistues. Ka ardhur koha që të gjitha institucionet monitoruese, licencuese, vendimmarrëse përfshirë dhe organizatat e shumta joqeveritare, të ndiejnë një përgjegjësi më të madhe në këtë drejtim. Është momenti që ato të zhvillojnë modele vlerësimi dhe matjesh të tërthorta, për shumë nga treguesit demografikë, ekonomikë, socialë dhe financiarë.

Më lejoni tashmë të prezantoj një çështje tjetër të rëndësishme të fjalës time, që ka të bëjë me një nga përgjegjësitë kryesore ligjore të Bankës së Shqipërisë, stabilitetin e çmimeve të konsumit.

2. ZHVILLIMET NË INFLACION DHE POLITIKA MONETARE

Inflacioni i çmimeve të mallrave të konsumit gjatë vitit 2006, është luhatur në pjesën më të madhe midis kufijve të intervalit 2 - 3 për qind. Viti u mbyll me një normë vjetore të inflacionit prej 2.5 për qind. Kjo vlerë ishte pranë inflacionit mesatar vjetor prej 2.4 për qind, duke qenë e njëjtë me atë të vitit 2005. Presionet inflacioniste ndonëse në mënyrë të moderuar, kanë ardhur në rritje gjatë vitit 2006. Norma mesatare e inflacionit vjetor u ngjiti në 2.7 për qind, gjatë gjashtëmuorit të dytë të vitit, nga 2.0 për qind që ishte në gjysmën e parë të vitit.

Në përgjithësi, stabiliteti i inflacionit mesatar vjetor gjatë viteve të fundit, flet për qëndrueshmëri të normës së inflacionit, pavarësisht nga luhatjet në kohë dhe në madhësi, të faktorëve që kanë kushtëzuar ecurinë e çmimeve të konsumit. Zhvillimet në anën e kërkesës dhe të ofertës së ekonomisë kanë qenë të balancuara, duke mos krijuar premisa për presione inflacioniste.

Politika fiskale ka respektuar treguesit e programuar në nivel vjetor, duke stabilizuar ndikimin e komponentit të sektorit publik në kërkesën agregate. Po kështu, politika monetare ka kontrolluar kushtet e likuiditetit, zhvillimin e normave të interesit dhe ka ndjekur ecurinë e kursit, duke monitoruar nëpërmjet tyre stimujt financiarë të aktivitetit ekonomik. Nga ana tjetër, nivelet e ulta të inflacionit gjatë viteve të fundit, janë reflektuar në ancorimin e pritjeve inflacioniste të ekonomisë pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ky faktor i fundit, mund të ketë kontribuar në frenimin e efekteve të raundit të dytë, që mund të shkaktonin në ekonomi disa nga goditjet e ofertës, me të cilat u përball ekonomia shqiptare, si çmimet e larta të naftës dhe rritjet e çmimeve të administruara.

- KUSHTET MONETARE DHE VENDIMET E POLITIKËS MONETARE

Vendimet e politikës monetare për normën bazë të interesit në ekonomi, janë ndërmarrë në bazë të analizave të vazhdueshme të zhvillimeve korente dhe të pritshme, të faktorëve të kërkesës dhe të ofertës, me origjinë në ambientin e brendshëm dhe të jashtëm. Në kushtet kur u evidentua një gjallërim i presioneve inflacioniste dhe në praninë e një numri faktorësh që pritej të favorizonin më tej këtë situatë, Banka e Shqipërisë vendosi për një ndryshim të kahut të politikës monetare, në fillim të tremujorit të tretë të vitit 2006. Ky ndryshim erdhi pas një periudhe neutraliteti, që zgjati rreth 1.5 vjet. Ndryshimi i kahut të politikës monetare, u materializua në dy rritje të normës bazë të interesit, gjatë gjashtëmuorit të dytë të vitit 2006. Në muajt korrik dhe nëntor 2006, norma e repove njëjavore u rrit përkatësisht me nga 0.25 pikë përqindjeje. Maturia në vendimmarrjen e politikës monetare, gjeti shprehje në distancimin në kohë të dy lëvizjeve shtrënguese në normat e interesit.

Në periudhën kohore korrik – nëntor 2006, janë bërë vlerësime të vazhdueshme mbi masën e reagimit dhe ndjeshmërinë e tregut bankar ndaj qëndrimit të politikës monetare mbi normat e interesit. Rritja totale e këtyre të fundit me 0.5 pikë përqindjeje, vlerësohet të ketë normalizuar ritmet e rritjes vjetore të ofertës së parasë, duke iu përgjigjur në mënyrë më të plotë kërkesës për mjete monetare, nga ana e sektorëve publik e atij privat. Veprimet e politikës monetare kanë ndihmuar në stabilizimin e pritjeve inflacioniste të agjentëve ekonomikë, për një periudhë afatmesme.

- POLITIKA FISKALE

Banka e Shqipërisë vlerëson se gjatë vitit 2006, politika fiskale ka mbështetur kënaqshëm zhvillimet në inflacion. Treguesit fiskalë u realizuan brenda kufijve të programit buxhetor, duke mos krijuar premisa për rritjen e presioneve inflacioniste në ekonomi. Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2006, u konstatua një përqendrim i lartë i shpenzimeve buxhetore. Realizimi i deficitit buxhetor në fund të vitit, i vlerësuar me rreth 3.2 për qind të PBB-së apo 0.7 pikë përqindjeje më i ulët se ai i një viti më parë, ka ndikuar në tkurrjen e presioneve inflacioniste dhe në kontrollin e zgjerimit monetar.

- FAKTORË TË KËRKESËS

Kërkesa e brendshme gjatë vitit 2006, ka mbështetur në një masë të konsiderueshme ritmet pozitive të rritjes ekonomike. Ecuria e mirë e kërkesës së brendshme është reflektuar nga një numër treguesish të aktivitetit ekonomik. Kështu, treguesi i shitjeve për nëntëmujorin e parë të vitit, shënoi një rritje vjetore prej 12.4 për qind. Në mënyrë të veçantë, rritja e importeve të makinerive dhe pajisjeve dhe rritja e kredive për pasuri të patundshme, janë tregues të zgjerimit të investimeve në vend. Kërkesa e brendshme ka ardhur në rritje edhe si pasojë e zgjerimit të shpejtë të aktivitetit kreditues, i cili shënoi një rritje prej 57 për qind në terma vjetorë. Krahas efekteve pozitive të zgjerimit të investimeve, rritja e kërkesës së brendshme ushtron presion për rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve.

Në mungesë të ndonjë presioni të dukshëm inflacionist nga ana e kërkesës, mund të vlerësohet se ekonomia shqiptare po shfrytëzon kapacitetet e lira pa rritur kostot dhe rrjedhimisht, çmimet përfundimtare të mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu, duhet theksuar se një pjesë e kësaj kërkesë të brendshme është plotësuar nëpërmjet rritjes së importeve dhe të deficitit tregtar, duke lehtësuar presionin mbi çmimet e konsumit.

- FAKTORË TË OFERTËS

Çmimet e importit. Ekonomia shqiptare është një ekonomi relativisht e hapur dhe, për pasojë, çmimet e importit përbëjnë një element të rëndësishëm të inflacionit në vend. Përgjithësisht, gjatë këtij viti, kushtet ekonomike të partnerëve tregtarë të Shqipërisë kanë qenë të favorshme, duke lehtësuar kontrollimin e presioneve nga ana e ofertës dhe duke mundësuar respektimin e objektivit të inflacionit.

Çmimet e naftës. Çmimet e konsumit gjatë vitit 2006 u ndikuan nga situata e tensionuar në tregun ndërkombëtar për çmimin e naftës. Ndikimi i këtij faktori, përsa i përket intensitetit të veprimit në normën e inflacionit, nuk ishte i njëtrajtshëm, duke qenë më i lartë gjatë nëntë muajve të parë të vitit dhe duke shënuar rënie, gjatë tremujorit të fundit.

Kursi i këmbimit. Gjatë vitit 2006, zhvillimet në kursin e këmbimit kanë mbështetur dobësimin e presioneve inflacioniste të kahut të ofertës. Monedha vendase është mbiçmuar ndaj dollarit amerikan dhe ka ruajtur të pandryshuar pozitën e saj në lidhje me euron. Tendencat mbiçmuese të lekut, ndonëse të dobësuar në muajt e fundit, kanë bërë që çmimi i importeve në monedhën vendase të bjerë. Në këtë mënyrë, kursi i këmbimit ka ndihmuar në frenimin e efektit të çmimit të lartë të naftës në tregjet botërore dhe në ruajtjen e një norme të ulët inflacioni.

Prodhimi bujqësor. Prodhimi bujqësor është një ndër faktorët kryesorë të brendshëm, që kushtëzojnë zhvillimet në çmimet e konsumit. Sasia e prodhimeve bujqësore vendase, ndikon në mënyrë të menjëhershme nivelin e çmimeve të mallrave ushqimorë. Gjatë vitit 2006, efekti sezonal i rritjes së prodhimit bujqësor, është shfaqur më me vonesë sesa në vitet e kaluara, duke bërë që rënia e çmimeve të mallrave ushqimorë të regjistrohej vetëm në muajt shtator dhe tetor.

Çmimet e prodhimit. Gjatë vitit 2006, çmimet e prodhimit vazhduan të ndjekin prirjen rënëse, të vërejtur që prej muajit prill 2005. Megjithatë, përqendrimi i indeksit të çmimeve të prodhimit në sektorin prodhues të industrisë, e vështirëson krahasimin e tij me indeksin e çmimeve të konsumit. Gjithashtu, vlerësohet se pjesa e prodhimit vendas nuk është ende një përbërës përcaktues i ofertës së mallrave në tregun vendas, duke mos ndikuar kështu çmimet e konsumit.

Papunësia dhe pagat. Ecuria e mirë e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2006 u reflektua dhe në treguesit e tregut të punës, dhe kryesisht në nivelin e papunësisë. Mundësi të reja punësimi u krijuan, duke bërë që norma e papunësisë të vazhdojë prirjen rënëse të vërejtur prej më shumë se dy vjetësh. Përmirësime janë vërejtur dhe në drejtim të të ardhurave. Kështu, pagat në sektorin shtetëror, paga minimale dhe pensionet kanë pësuar rritje sipas programit të buxhetit. Ecuria e deritanishme e inflacionit tregon se ekonomia shqiptare nuk vuan nga mospërputhje të ndjeshme midis rritjes së pagave dhe produktivitetit.

Pritjet inflacioniste. Pritjet e biznesit dhe të publikut në terma afatshkurtër deri afatmesëm, janë luhatur rreth niveleve të faktuara të inflacionit. Sipas vlerësimeve periodike të Bankës së Shqipërisë, pritjet e publikut kanë konverguar, në pjesën më të madhe, rreth vlerave 1 - 3 për qind. Ndërkohë, pritjet e biznesit për ecurinë e çmimeve, shfaqin një luhatshmëri më të lartë. Në ankorimin e pritjeve të publikut të gjerë drejt vlerës së inflacionit të synuar nga Banka e Shqipërisë, një rol të rëndësishëm ka luajtur politika monetare dhe konsolidimi i stabilitetit makroekonomik.

3. ZHVILLIMET NË OFERTËN E PARASË

Gjatë pjesës më të madhe të vitit 2006, treguesit monetarë kanë pasqyruar kërkesën e stabilizuar për mjete monetare. Ritmi mesatar i rritjes së M3, rezultoi 12 për qind. Kërkesa për para e sektorit publik u rrit me vetëm 3.3 për qind, gjatë vitit 2006. Kjo huamarrje, relativisht e ulët, ka balancuar ritmet e larta të kreditimit të sektorit privat, duke influencuar pozitivisht në ruajtjen e stabilitetit monetar. Në përputhje me tendencën e vënë re gjatë viteve të fundit, zhvillimet monetare janë karakterizuar nga zhvendosja drejt mjeteve monetare më afatgjata.

Ecuria e parasë jashtë bankave ka ndjekur tendencën e përgjithshme të kërkesës për para. Pesha e parasë jashtë bankave ndaj M3 në fund të vitit, shënoi 24.2 për qind ose 1.7 pikë përqindjeje më pak se një vit më parë. Në terma nominalë, paraja jashtë bankave pësoi rritje prej 13.6 miliardë lekësh ose 9.1 për qind.

Ambienti makroekonomik, gjatë vitit 2006, ka qenë i favorshëm për rritjen e qëndrueshme të depozitave në lekë të sistemit bankar. Normat pozitive të interesave realë janë shoqëruar me rritje të mëtejshme të depozitave në lekë. Depozitat në lekë janë rritur me 38 miliardë gjatë vitit 2006, duke plotësuar nevojat prej 35.9 miliardë lekësh të ekonomisë dhe të qeverisë për kredi, në monedhën kombëtare.

Në vitin 2006, depozitat në valutë janë rritur me rreth 29.4 për qind. Ritmi më i lartë i rritjes së depozitave në valutë kundrejt ritmit të rritjes së ofertës monetare, ka çuar në rreth 29 për qind raportin e depozitave në valutë ndaj M3. Pesha e depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave u rrit në 38.5 për qind, kundrejt 35.5 për qind në vitin 2005.

4. KËRKESA PËR PARA

Zgjerimi i kërkesës për para kulmoi në muajin dhjetor me një rritje vjetore prej 16.7 për qind. Kontributin kryesor në rritjen e kërkesës për para gjatë vitit e ka dhënë kredia për ekonominë. Ky kontribut shënoi maksimumin e tij në muajin qershor, duke ardhur në zbehje në muajt në vijim, si pasojë e rritjes së huamarrjes publike. Pozicioni valutor me jashtë ka ruajtur një peshë relativisht të qëndrueshme në krijimin e mjeteve monetare gjatë vitit.

- **KREDIA PËR EKONOMINË**

Zhvillimi i sistemit bankar dhe rritja e rolit të bankave si ndërmjetës financiarë, kanë sjellë zgjerim të ndjeshëm të aktivitetit kreditues gjatë viteve të fundit. Portofoli i kredisë arriti në 191.2 miliardë lekë ose 21.3 për qind të PBB-së, në fund të vitit 2006. Portofoli i kredisë për ekonominë përbënte 31.3 për qind të totalit të aktiveve të sistemit bankar dhe rreth 37.4 për qind të depozitave të sistemit bankar.

Në terma absolutë, kredia për ekonominë u rrit me 69.3 miliardë lekë në vitin 2006, krahasuar me rritjen prej 52 miliardë lekësh në vitin 2005. Gjatë dy viteve të fundit, bankat tregtare kanë plotësuar më mirë kërkesën në rritje për kredi në lekë. Në fund të vitit 2006, kredia në lekë përbënte 29 për qind të portofolit të kredisë, duke shënuar një zgjerim të moderuar në peshën e saj.

Kredia për bizneset përbën pjesën kryesore të portofolit të bankave, duke arritur në 66.5 për qind të totalit në fund të vitit 2006. Në terma vjetorë, kredia për biznese u rrit me 52 për qind. Struktura e shpërndarjes së kësaj kredie, sipas përdorimit, ka tentuar të bëhet më uniforme, krahasuar me një vit më parë. Pjesa më e madhe e kredisë për bizneset (34.5 për qind), përdoret për blerjen e pajisjeve dhe makinerive. Ndërkohë që, 23.2 për qind e portofolit të kredisë për biznese, është përdorur për financimin e investimeve të zgjerimit të sipërfaqeve të kryerjes së aktiviteteve.

Kredia për individët arriti në 7 për qind të prodhimit të brendshëm bruto, në vitin 2006 ose 33.5 për qind e totalit të portofolit të kredisë. Më shumë se gjysma e kredisë së individëve (59.3 për qind) është akorduar për financimin e blerjeve të pasurive të paluajtshme. Ndërkohë që rritje ka shënuar edhe financimi i blerjeve të mallrave të konsumit. Raporti i kredisë për konsum, në totalin e portofolit të individëve është 27.3 për qind, nga 20 për qind një vit më parë. Në veçanti, kredia konsumatore ka njohur rritje të dukshme në muajt karakteristikë të pushimeve verore si dhe gjatë muajve të fundit të vitit, në periudhën e festave.

Duke u ndalur në kreditimin e sektorëve të veçantë, duhet theksuar se sektori i tregtisë mbetet më i kredituari nga sistemi bankar, me 22.4 për qind të portofolit të kredisë. Kredia për sektorin e ndërtimit ka paraqitur frenim të ritmeve të rritjes, gjatë vitit 2006. Ky sektor paraqiti shenja të përkohshme përmirësimi gjatë muajve të verës, duke iu rikthyer më pas trendit rënës. Ndërkohë, kreditimi i ulët i sektorit të bujqësisë tregon për probleme të vazhdueshme strukturore, që pengojnë kreditimin e këtij sektori.

Në shpërndarjen gjeografike të kredisë, vihet re se 68 për qind e portofolit, është e përqendruar në Tiranë. Pas saj, renditen Durrësi dhe Vlora, me 8 dhe 4 për qind të portofolit të kredisë, përkatësisht. Kjo tregon rëndësinë e madhe ekonomike të zonës së Tiranës si dhe nevojën për përmirësimin e infrastrukturës ekonomike, në pjesën tjetër të vendit.

- MJETET VALUTORE NETO

Pozicioni valutor i sistemit bankar është përmirësuar, gjatë vitit 2006. Mjetet valutore neto të sistemit bankar arritën në nivelin 2.4 miliardë usd në fund të këtij viti, duke shënuar një rritje vjetore prej rreth 440 milionë usd.

- KËRKESA PËR PARA E QEVERISË

Llogaria e qeverisë ka paraqitur një ecuri jo të zakonshme, gjatë vitit 2006. Për pjesën më të madhe të vitit, kërkesa për para e qeverisë ka qenë negative,

duke e përqendruar huamarrjen e brendshme të planifikuar, në dy muajt e fundit të vitit. Financimi gjithsej i deficitit për vitin 2006, rezultoi rreth 22.6 miliardë lekë.

5. TREGU FINANCIAR DHE NORMAT E INTERESIT

Viti 2006 është karakterizuar nga rritja e aktivitetit në tregun e parasë dhe në tregun e kapitaleve, ndërkohë që ecuria e normave të interesit është orientuar përgjithësisht, nga politika monetare e Bankës së Shqipërisë. Në kushtet e tepricës së likuiditetit, normat e interesit kanë patur një tendencë rënëse gjatë gjysmës së parë të vitit. Pas sinjalizimit të shtrëngimit të kushteve monetare në gjashtëmuajorin e dytë, normat e interesit kanë qenë në rritje.

Tregu ndërbankar ka qenë më aktiv gjatë vitit 2006, duke siguruar një mënyrë më efektive për administrimin e fondeve të tepërta të bankave. Vëllimi mesatar ditor i transaksioneve, arriti shifrën 1.6 miliardë lekë ose 0.2 miliardë lekë më shumë se mesatarja e vitit të kaluar. Tregu ndërbankar është karakterizuar nga ngushtimi i diferencës së normave të interesit sipas maturiteteve dhe pozicionimi i tyre pranë normës bazë të interesit. *Spread*-i mesatar midis interesave njëditorë dhe shtatëditorë zbriti në 0.7 pikë përqindjeje në vitin 2006, nga 1.6 pikë përqindjeje në vitin 2005.

Në gjysmën e parë të vitit 2006, ka pasur një ulje të vazhdueshme të *yield*-eve të bonove të thesarit dhe të obligacioneve të qeverisë, si pasojë e kërkesës së ulët të qeverisë për financim. Në gjysmën e dytë të vitit 2006, pas sinjaleve shtrënguese të Bankës së Shqipërisë dhe rritjes së kërkesës për likuiditete në sistem, pati një rritje graduale të këtyre *yield*-eve. Krahasuar me një vit më parë, *yield*-et janë rritur përkatësisht me 0.83 pikë përqindjeje, 0.45 pikë përqindjeje dhe 0.98 pikë përqindjeje.

Emetimet e obligacioneve të qeverisë janë rritur krahasuar me vitin e kaluar, duke bërë që portofoli i bankave, të vetmet pjesëmarrëse në këtë treg, të rritet me 37 miliardë lekë. Pësha që zënë obligacionet kundrejt totalit të letrave me vlerë të qeverisë është rritur në 22 për qind në vitin 2006, nga 12 për qind vitin e kaluar. Struktura e maturiteteve të tyre varion nga 2 deri në 5 vjet. Obligacionet pesëvjeçare u emetuan për herë të parë, në muajin nëntor të këtij viti, për shumën 6.3 miliardë lekë. Kërkesa për to rezultoi më e lartë sesa shuma e emetuar.

Tregu i depozitave në lekë është karakterizuar nga ulja e interesave, në gjysmën e parë të vitit 2006 dhe rritja e tyre, pas sinjaleve shtrënguese të politikës monetare. Normat e interesit janë rritur më shpejt për afatet e gjata të maturimit, duke reflektuar përshtatjen e kohëzgjatjes së tyre me rritjen e borxhit afatgjatë të qeverisë.

Normat e interesit për kreditë në lekë janë ulur në të gjitha afatet, gjatë vitit 2006. Interesi mesatar i ponderuar në muajin dhjetor 2006 zbriti në 12.92 për qind, nga 13.50 për qind që ishte një vit më parë. Me gjithë uljen e kostos

së ndërmjetësimit në krahasim me vitin e kaluar, niveli i *spread*-it mbetet ende relativisht i lartë. Ai ndikohet nga konkurrenca jo e plotë në këtë treg dhe nga natyra me rrezikshmëri më të lartë e kredive të akorduara në lekë.

Në tregun e depozitave në valutë, normat e interesave në dollarë dhe në euro kanë vazhduar trendin e tyre rritës, si rezultat i shtrëngimit të politikës monetare nga Fed-i dhe Banka Qendrore Evropiane, gjatë vitit 2006. Në të njëjtën kohë, janë rritur dhe normat e interesave për kreditë e akorduara në këto monedha. Rritja më e madhe e këtyre interesave ka qenë në kreditë nga 6 muaj në një vit, në euro dhe në kreditë deri në 6 muaj, në dollarë. Në fund të vitit 2006, interesat mesatarë të ponderuar të kredive në dollarë, arritën 9.42 për qind dhe interesat e kredive në euro arritën në 8.17 për qind, nga 8.47 për qind dhe 7.95 për qind që ishin përkatësisht në fund të vitit të kaluar.

6. KURSI I KËMBIMIT

Gjatë vitit 2006, leku ka ruajtur tendencën mbiçmuese ndaj valutave kryesore, ndonëse me një intensitet më të ulët. Në terma vjetorë nominalë efektivë, leku është mbiçmuar mesatarisht me 1.1 për qind gjatë vitit 2006. Një vit më parë, ky mbiçmim ishte 2.8 për qind. Diferenca e normave të interesit lekë-valutë, edhe pse në rënie gjatë tre viteve të fundit, ka vazhduar të jetë në nivele pozitive.

Zhvillimet ekonomike gjatë vitit 2006, kanë mbështetur një monedhë vendase të qëndrueshme. Presionet mbiçmuese për lekun, janë përqendruar kryesisht në muajt korrik-gusht dhe dhjetor. Përveç hyrjes sezonale të valutës, që është faktori kryesor i forcimit të lekut në këtë periudhë, në treg janë reflektuar dhe rritjet e normës bazë të interesit.

Oferta e lartë e valutës në këtë periudhë, është thithur pjesërisht nga ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë, të cilat kanë synuar përmbushjen e objektivit të saj për rritjen e rezervës ndërkombëtare neto, në përputhje me programin e përgjithshëm makroekonomik të vendit.

7. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

Marrëveshja e riblerjes me maturim njëjavor me çmim fiks, është instrumenti kryesor i përdorur gjatë vitit 2006. Në përputhje me situatën e likuiditetit, Banka e Shqipërisë është zhvendosur nga marrëveshjet e riblerjes tek ato të anasjellta, ndërkohë që edhe afati i maturimit ka ndryshuar nga javor deri në tremujor. Ky spektër lëvizjesh, është imponuar nga faktorë sezonalë, nga sjellja e buxhetit si edhe nga nevoja për të përforcuar sinjale të caktuara, të politikës monetare.

Për të plotësuar nevojat më afatgjata të tregut me likuiditet, gjatë 4 muajve të fundit të vitit 2006, u kryen katër transaksione blerjeje me të drejta të plota të bonove të thesarit, me vlerë nominale totale prej 3.2 miliardë lekësh.

Gjatë vitit 2006, për investimin e likuiditeteve të lira, bankat e nivelit të dytë përdorën instrumentin e depozitës njëditore pranë Bankës së Shqipërisë, mesatarisht për 1.6 miliardë lekë në ditë ose 0.82 miliardë lekë më shumë se në vitin 2005.

Kredia njëditore është përdorur vetëm në shtatë raste, pavarësisht mungesës së likuiditetit gjatë tremujorit të tretë të vitit. Për të katërtin vit rradhazi, instrumenti i fundit kreditues i Bankës së Shqipërisë, kredia lombard nuk pati asnjë rast përdorimi.

Instrumenti i rezervës së detyruar, u përdor në vazhdimësi edhe gjatë vitit 2006 për të tërhequr likuiditetin e sistemit bankar. Ritmi mujor i rritjes së rezervës së detyruar në lekë gjatë vitit 2006, ishte mesatarisht më i lartë se gjatë vitit 2005, 0.92 për qind kundrejt 0.76 për qind, duke reflektuar rritjen në kategoritë respektive që përfshihen në llogaritjen e rezervës së detyruar.

8. ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

Gjatë vitit 2006 rezerva valutore bruto, e vlerësuar dhe e raportuar në usd, është rritur me 368.06 milionë usd, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor, vlerën 1,793.12 milionë usd.

Nga kjo rritje, rreth 205 milionë usd janë akumulim nga ndërhyrjet valutore të Bankës së Shqipërisë. Këto ndërhyrje, kanë synuar përmbushjen e objektivit sasior për këto mjete dhe zbutjen e luhatjeve në periudhat e pikut të ofertës valutore. Ndërkohë që efekti i kursit të këmbimit ka qenë pozitiv, në masën 106 milionë usd pjesa tjetër e rritjes është kontribut i hyrjeve nga disbursimet e huaja.

9. ECURIA E SISTEMIT BANKAR

Sistemi bankar vijoi zhvillimin e tij të qëndrueshëm edhe gjatë vitit 2006. Rezultati neto i sistemit bankar për vitin 2006 rezultoi me fitim prej 7.45 miliardë lekësh, rreth 12.9 për qind më shumë se viti 2005. Të ardhurat nga aktivitetet kryesore (të ardhurat neto nga interesi), rezultuan 31.2 për qind më shumë se një vit më parë, duke reflektuar orientimin e sistemit bankar në veprimtari me kthim më të lartë si dhe rritjen e vëllimit të aktiveve në tërësi.

Në fund të vitit 2006, e ardhura neto nga interesat ishte 92.6 për qind e të ardhurave bruto të sistemit bankar, krahasuar me 84 për qind në fund të vitit 2005. Ky tregues, ka shënuar rritje të vazhdueshme, veçanërisht në tre vitet e fundit, duke shprehur qëndrueshmërinë e të ardhurave neto në tërësi për sistemin bankar.

Gjatë vitit 2006, aktivet e sistemit bankar shënuan rritje me 127.7 miliardë lekë, rreth 57.6 miliardë lekë më shumë se rritja e aktiveve e evidentuar në vitin 2005. Kontributin kryesor në rritjen e aktiveve të sistemit bankar e dhanë bankat e mëdha, ndonëse pesha e tyre në treg, vjen në rënie. Llogaritjet

tregojnë që niveli i përqendrimit për aktivitetin e kredihënies është më i ulët, krahasuar me nivelin e përqendrimit për aktivet dhe për depozitat.

Rritja e konsiderueshme e kredihënies është shoqëruar me rritjen e madhësisë së portofolit të kredive me probleme, me rreth 3.1 miliardë lekë, krahasuar me fundin e vitit 2005. Në fund të vitit, treguesi i cilësisë së portofolit të kredisë, i shprehur si raport i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredive në terma bruto, llogaritet 3.1 për qind ndaj 2.3 për qind në fund të vitit 2005.

Aftësia e sistemit bankar për të mbuluar me kapital humbjet e rrjedhura nga kreditë, shënon rënie por mbetet në nivele të mira. Treguesi “kredi me probleme ndaj tepricës së kredisë (neto)”, i cili vlerëson madhësinë neto të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë, vazhdon të llogaritet në nivele të ulëta, prej 1.4 për qind në fundvitin 2006.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin, në fund të vitit 2006 paraqitet në nivelin 18.1 për qind, duke shënuar një rënie prej 0.5 pikë përqindjeje, krahasuar me fundin e vitit 2005. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për vitin 2006, vazhdon të ruajë prirjen rënëse të shfaqur gjatë viteve të mëparshme. Bankat e mëdha shënojnë një rritje të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, kryesisht si rezultat i rritjes së kapitalit rregullator në fund të vitit, me rreth 62.3 për qind.

Në fund të vitit 2006, raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve të sistemit bankar, shënoi vlerën 57.6 për qind, krahasuar me 62.6 për qind që ishte në fund të dhjetorit 2005.

Gjatë vitit 2006, sistemi bankar njohu zhvillime të rëndësishme sasiore dhe cilësore. Në fund të vitit, sektori bankar shqiptar përbëhej nga 17 banka prej të cilave, 3 ishin me kapital privat tërësisht shqiptar. Në fillim të vitit 2006 nisi aktivitetin e saj Banka Union. Në maj të vitit 2006, u miratua shitja e 80 për qind të aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Italo-Shqiptare, që i përkisnin Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Capitalia S.A., Itali, tek aksioneri i ri SanPaolo IMI S.p.A., Itali. Në të njëjtën periudhë, u miratua transferimi i pronësisë së 60 për qind (plus 2 aksione) të aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Kombëtare Tregtare nga Kent Bank/Bayindir Bank, tek aksioneri i ri institucional turk, Çalik-Seker Konsorsiyum Yatirim Anonim.

Në gusht të vitit 2006, u miratua transferimi i pronësisë së 11.25 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës ProCredit, nga BERZH tek ProCredit Holding AG (aksioner ekzistues). Në tetor të vitit 2006, u miratua transferimi i 71.97 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës Emporiki S.A. të Greqisë, tek aksioneri Credit Agricol S.A., Francë. Ky transferim, ndikon edhe në pjesëmarrjen indirekte të Credit Agricol S.A. te kapitali aksioner i Bankës Emporiki të Shqipërisë sh.a., në të njëjtën masë.

Gjatë vitit 2006, rrjeti i bankave u zgjerua edhe me 62 degë dhe agjenci të reja, me një shtrirje në të gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj, ku peshën më

të madhe e zë rrethi i Tiranës, me 30 degë dhe agjenci të reja të hapura. Gjithashtu, u dha miratimi për dy degë të bankave jashtë territorit të Shqipërisë dhe dy degë të tjera janë në proces miratimi.

10. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

• SISTEMI I PAGESAVE

Sistemi i pagesave në Shqipëri ka krijuar tashmë fizionominë e një sistemi të modernizuar si nga ana rregullative ashtu dhe nga ajo operationale. Numri i transaksioneve të procesuara gjatë vitit 2006 ka një rritje prej 13 për qind, krahasuar me vitin 2005. Ndërkohë, vlera e transaksioneve është rritur me 21 për qind gjatë vitit 2006, duke arritur shifrën 2,664.43 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2005, numri mesatar ditor i pagesave (në të dyja sistemet) është rritur nga 312, në 352 ose në 40 transaksione më tepër në ditë. Në vitin 2006, sistemit të pagesave iu shtua një bankë e re, duke e çuar numrin e pjesëmarrësve në 17 banka.

Në muajin mars 2006, filloi shlyerja e pagesave elektronike me kartat VISA. Aktualisht, numërohen 6 banka anëtare në këtë skemë. Numri i kartave në qarkullim është shtuar me 9 herë gjatë vitit 2006, krahasuar me vitin 2004. Shtesa e numrit të kartave, krahasuar me vitin 2005 është 127,552 copë, me gati 56 për qind. Paralelisht me rritjen e numrit të kartave, kemi edhe shtimin e numrit të ATM-ve dhe POS-ve, përkatësisht me 130 ATM dhe 404 POS.

• INTEGRIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Detyrimet që rrjedhin nga MSA për Bankën e Shqipërisë lidhen me përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit, garantimin e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime financiare për bankat dhe institucionet e tjera financiare komunitare, liberalizimin e lëvizjeve të kapitalit dhe pagesave rrjedhëse ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së si dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar (*acquis communautaire*) në këto fusha.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme gjatë vitit 2006, për sa i përket përafrimit të legjislacionit vendas me atë komunitar, ishte hartimi dhe miratimi i ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Ligji në fjalë, ka adoptuar pjesën më të madhe të dispozitave të Direktivës 2000/12/EC, në lidhje me fillimin dhe vazhdimin e veprimtarisë së institucioneve të kreditit.

Më 8 nëntor 2006, Komisioni Evropian publikoi Raportin Vjetor të Progresit për Shqipërinë. Në raport, Komisioni Evropian vlerësoi politikën e ndjekur nga Banka e Shqipërisë në drejtim të bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare si dhe mbajtjes së inflacionit nën kontroll, duke kontribuar në ruajtjen e një mjedisi të qëndrueshëm makroekonomik në vend.

Në të njëjtën kohë, Komisioni shprehu vlerësimin edhe për ndjekjen e një politike të besueshme monetare, duke theksuar veçanërisht marrjen e masave

nga ana e Bankës së Shqipërisë, në drejtim të ndryshimit gradual të strategjisë së politikës monetare drejt regjimit të shënjestrimit të shprehur të inflacionit, me qëllim forcimin e transparencës dhe besueshmërisë së politikës monetare.

Raporti evidentoi gjithashtu, zhvillimet pozitive në sektorin bankar në vend si dhe vlerësoi progresin e realizuar në drejtim të ngritjes së regjistrit të kredive, lëvizjes së lirë të shërbimeve bankare dhe financiare, lirisë së aktivitetit të bankave të huaja si dhe liberalizimit të mëtejshëm të lëvizjeve të kapitalit.

Më 27 janar 2006, Bordi Ekzekutiv i FMN-së miratoi marrëveshjen e re trevjeçare me Shqipërinë, me një vlerë prej 17.045 milionë sdr. Objektivat kryesorë të programit të ri kanë të bëjnë me ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, si një parakusht për rritjen ekonomike si dhe me përmirësimin e administrimit fiskal, të administrimit të borxhit publik dhe të mbikëqyrjes së institucioneve financiare.

Në vijim të marrëveshjes “Për administrim dhe konsulencë të investimit të rezervës valutore”, gjatë vitit 2006, Grupi i Bankës Botërore i ka ofruar asistencë teknike Bankës së Shqipërisë, në kuadër të programit Këshillues për Administrimin e Rezervës Valutore (RAMP).

Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2006, ka mbajtur kontakte të vazhdueshme edhe me BERZH-in, kryesisht në drejtim të ofrimit të informacionit dhe statistikave për zhvillimet në ekonominë shqiptare në përgjithësi, dhe për sektorin financiar në veçanti. Në Raportin e Tranzicionit 2006, BERZH vlerësoi pozitivisht mbajtjen e inflacionit brenda objektivave të Bankës së Shqipërisë si dhe konsolidimin e sistemit bankar gjatë vitit 2006.

Banka për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) është një tjetër institucion me të cilin Banka e Shqipërisë ka mbajtur marrëdhënie të ngushta, gjatë vitit 2006. BIS ka qenë veçanërisht aktive në ofrimin e asistencës teknike për Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet seminareve dhe trajnimeve të organizuara nga Instituti i Stabilitetit Financiar, i cili promovon stabilitetin financiar ndërkombëtar përmes shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes së sistemit financiar.

Gjatë vitit 2006, Banka e Shqipërisë forcoi marrëdhëniet dypalëshe me bankat qendrore të rajonit dhe më gjerë. Personalisht, kam zhvilluar vizita zyrtare në shumë prej bankave qendrore të rajonit dhe të Evropës, ku kam diskutuar mbi zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare si dhe mbi thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh dhe të asistencës teknike, që këto banka mund t’i ofrojnë Bankës së Shqipërisë. Në muajin qershor, Guvernatori i Bankës së Greqisë, z. Nicholas C. Garganas ka zhvilluar një vizitë zyrtare dyditore në Shqipëri. Kjo vizitë është zhvilluar në vazhden e marrëdhënieve dypalëshe midis dy institucioneve, me një theks të veçantë në shkëmbimin e informacionit dhe të përvojës në fushën e mbikëqyrjes bankare.

Rritja e marrëdhënieve me bankat qendrore të rajonit, kulmoi në tryezën e rrumbullakët të muajit tetor 2006, në Tiranë, ku guvernatorët e bankave

qendrore të Rumanisë, Serbisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës dhe Kosovës diskutuan në lidhje me stabilitetin financiar të rajonit.

Në kuadër të objektivit të Bankës së Shqipërisë, për të përfituar nga përvoja e bankave qendrore të Evropës Qendrore dhe Lindore, të anëtarësuar vitet e fundit në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ), gjatë vitit 2006, janë forcuar marrëdhëniet e bashkëpunimit me Bankën Kombëtare të Polonisë, Bankën Kombëtare Çeke dhe Bankën Kombëtare Bullgare.

- EMISIONI I MONEDHËS

Shtesa e monedhës në qarkullim, në vitin 2006, prej 14,7 miliardë lekësh, i është përgjigjur zhvillimit të balancuar makroekonomik të vendit. Arkëtimet e parave të bankave të nivelit të dytë nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2006, u vërtetuan në nivelin e 105 miliardë lekëve, duke mbetur pothuaj në të njëjtin nivel me vitin 2005. Përsa i përket pagesave në *cash* nga arkat e Bankës së Shqipërisë për bankat e nivelit të dytë, furnizimi është realizuar sipas kërkesave të paraqitura prej tyre, duke synuar në të njëjtën kohë mbajtjen e strukturës së monedhës në qarkullim në kufijtë e projektuar, për fundvitin 2006.

Shpejtësia e qarkullimit të parasë në vitin 2006, për ciklin e shkurtuar të qarkullimit, në total rezultoi pothuaj në të njëjtin nivel me vitin 2005. Megjithatë, shpejtësia e qarkullimit pati ndryshime për prerje të veçanta të kartëmonedhave dhe monedhave metalike. Kështu, rritje e ndjeshme e shpejtësisë së qarkullimit u vërtetua në kartëmonedhat e prerjeve 5.000 lekë, 1.000 lekë dhe 500 lekë, përkatësisht me 13,3 për qind, 38,9 për qind dhe 8,3 për qind.

- NDRYSHIME NË LEGJISLACIONIN BANKAR

Legjislacioni bankar gjatë vitit 2006, në vijim edhe të nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në datë 12.06.2006, ndryshoi dhe u përmirësua në mënyrë thelbësore me hartimin dhe miratimin nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"; ligj, i cili hyn në fuqi në 1 qershor 2007.

Ligji "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" u mundëson bankave të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian si dhe të gjitha bankave të tjera të huaja, ofrimin e shërbimeve bankare në Shqipëri nëpërmjet një dege apo filiali të tyre, pa bërë asnjë dallim ndërmjet kushteve për licencimin e këtyre degëve dhe filialeve, dhe kushteve për licencimin e bankave shqiptare. Për më tepër, në zbatim të dispozitave të MSA – së, ligji i miratuar parashikon trajtimin e tyre në ushtrimin e veprimtarive bankare dhe veprimtarive financiare pas licencimit, në të gjitha aspektet, si bankë shqiptare.

Për të siguruar dhe forcuar mbrojtjen e depozituesve dhe investitorëve, si dhe për ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar, ligji i ri parashikon rregulla më të qarta për administrimin e rreziqeve, me të cilat mund të përballen bankat,

gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Duke marrë në konsideratë kushtet aktuale të rritjes me ritme të shpejta të kredidhënies në sistemin bankar, ligji i ri trajton në mënyrë më të plotë dhe të detajuar, edhe lloje të tjera të rrezikut, të ndryshme nga rreziku i kredisë, me të cilat mund të përballen bankat si dhe ekspozimet e lejuara të këtyre të fundit, kur përballen me këto rreziqe.

Ndërmjet të tjerash, ligji parashikon për herë të parë, krijimin dhe mbajtjen nga Banka e Shqipërisë të Regjistrimit të Kredive. Qëllimi i ngritjes së këtij regjistri, në kushtet e një zhvillimi të vrullshëm të aktivitetit të kredidhënies, është të ndihmojë bankat për të marrë vendime të mirëinformuara kur u japin kredi klientëve të tyre, si dhe të forcojë mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë mbi sistemin bankar shqiptar.

Gjatë vitit 2006, Banka e Shqipërisë ka nisur studimin e parakushteve dhe kushteve të zbatimit në një periudhë afatmesme (viti 2009), të një regjimi të ri të politikës monetare. Në këtë kontekst, janë shqyrtuar mundësitë e përmirësimit të infrastrukturës ligjore për krijimin e këtyre kushteve, në përputhje me standardet ndërkombëtare në këtë fushë. Gjithashtu, është studiuar mundësia e përmirësimit të ligjit organik të Bankës së Shqipërisë, i cili përkon me parashikimin e ndryshimit të tij si prioritet afatmesëm në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA – së.

Këto ndryshime, parashikohet të përcaktojnë kompetenca dhe procedura të qarta në lidhje me procesin e vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë si dhe në lidhje me transparencën e këtij procesi, çfarë përbën dhe një nga parakushtet thelbësore për hartimin dhe zbatimin e një politike monetare efektive.

Në kuadrin e reformës ligjore, të ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë për ndryshimin dhe përmirësimin e Kodit të Procedurës Civile, Banka e Shqipërisë është angazhuar plotësisht në bashkëpunimin me sektorin bankar, për plotësimin dhe saktësimin e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, të titujve ekzekutivë.

Propozimet e Bankës së Shqipërisë, kanë patur për qëllim përmirësimin e bazës ligjore, lidhur me zbatimin e procedurave për ekzekutimin e akteve, të cilat përbëjnë tituj ekzekutivë. Qëllim kryesor, mbetet shkurtimi i kohës së ekzekutimit të këtyre akteve me qëllim rritjen e sigurisë në zhvillimin e aktivitetit të kredidhënies, duke ulur rrezikun e kredisë me të cilin përballen bankat.

Në fund të vitit 2006, Banka e Shqipërisë ka bashkëpunuar ngushtësisht me Ministrinë e Financave, gjatë procesit të hartimit të projektligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit". Banka e Shqipërisë, si autoriteti mbikëqyrës i sistemit bankar, e shikon me përparësi përmirësimin e kuadrit ligjor për parandalimin e përdorimit të sistemit bankar, për pastrimin e parave të rrjedhura nga aktivitetet kriminale dhe pasurive prej tij, në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian në këtë fushë dhe me rekomandimet e tjera ndërkombëtare.

Këtë vit u përfundua me sukses me asistencën e Bankës Botërore, hartimi dhe plotësimi i kuadrit rregullativ për administrimin e rezervës valutore, duke

rishikuar politikën e Bankës së Shqipërisë për administrimin e kësaj rezerve, kriteret dhe kushtet e administrimit si dhe decentralizimin e kompetencave vendimmarrëse, gjatë këtij procesi.

- KONTROLLI I BRENDSHËM

Në vitin 2006 janë realizuar 44 audite dhe 3 procedura verifikimi. Nga auditet e ushtruara, inspektorët paraqitën 269 gjetje dhe dhanë 197 rekomandime. Auditet u kryen në Bankën e Shqipërisë, përfshirë 5 degët e saj në rrethe si dhe njësinë e Shtypshkronjës.

11. BILANCI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Gjatë vitit 2006, totali i aktiveve të Bankës së Shqipërisë u rrit më tej, duke regjistruar nivelin 255,5 miliardë lekë, rreth 14 për qind më i lartë se ai i fundvitit 2005.

Rritje pasqyrojnë të dyja grupet përbërëse, si aktivet e huaja ashtu edhe ato vendase, ndërkohë që grupi i parë zë rreth 68 për qind të totalit të aktiveve, nivel ky i njëjtë me vitin e kaluar. Në krahun e pasiveve, detyrimet e huaja kanë një rënie të lehtë (nga 8 në 7 për qind të totalit) krahasuar me një vit më parë, ndërsa detyrimet vendase kanë pësuar rritje në masën 16 për qind. Paraja në qarkullim është treguesi që ka peshën kryesore në këtë rritje (rreth 45 për qind të rritjes), i pasuar nga zëri i “detyrimeve ndaj qeverisë” (rreth 29 për qind të rritjes) dhe zëri “detyrime ndaj bankave” (rreth 26 për qind të rritjes).

Në përgjithësi, bilanci kontabël i Bankës së Shqipërisë dhe pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, reflektojnë disa nga zhvillimet bazë që janë regjistruar në ekonomi, ku Banka e Shqipërisë ka një rol të rëndësishëm.

Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2006, tejkalojnë nivelin e para një viti, vetëm me rreth 5 për qind. Ndikimin kryesor në këtë rritje e kanë të ardhurat nga interesat në valutë (rreth 20 për qind më shumë se viti 2005). Kjo reflekton ecurinë e normave të interesit në tregjet e huaja valutore. Ky efekt absorbon rënie në zërin “të ardhura nga interesat në lekë” (rreth 7 për qind më pak se viti 2005), që pasqyron një normë mesatare të interesit poshtë asaj të vitit 2005, megjithë tendencën në rritje gjatë fundit të vitit.

Nga ana tjetër, shpenzimet për interesa tejkalojnë nivelin e para një viti me rreth 25 për qind, duke reflektuar fenomenet pozitive të rritjes së nivelit të depozitave dhe gjendjes së likuiditetit në sistemin bankar. Shpenzimet për interesat në valutë janë tejkaluara në masën rreth 64 për qind krahasuar me një vit më parë, ndërsa për interesat në lekë kemi rritje të shpenzimeve në masën rreth 14 për qind. Shpenzimet e tjera (operative dhe amortizimi) kapin një shumë pothuajse të njëjtë me atë të vitit të mëparshëm.

Në përfundim, kompensimi pothuajse i plotë mes rritjes së të ardhurave dhe rritjes së shpenzimeve financiare, bën që fitimi neto i Bankës së Shqipërisë

për vitin 2006, të paraqitet në nivel të njëjtë me vitin e kaluar, në masën rreth 5,16 miliardë lekë (ose 99.6 për qind e fitimit të realizuar gjatë vitit 2005).

Të nderuar deputetë,

Në përfundim të fjalës time, do të dëshiroja të theksoja se Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2006 ka përfshirë në axhendën e saj të gjitha rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë, në rezolutën e miratuar prej tij më datë 25 maj 2006. Po kështu, dëshiroj t'ju siguroj se e njëjta filozofi do të karakterizojë punën tonë edhe gjatë vitit 2007. Duke kuptuar drejt rolin dhe misionin e institucionit tonë, në emër të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, deklaroj se Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mbetet një institucion i përgjegjshëm, thellësisht i angazhuar në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Kushtetuta dhe Ligji.

Prioritetet tona gjatë vitit 2007 janë të shumta por më lejoni të përmend ato më të rëndësishmet:

- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve të konsumit mbetet objektivi kryesor ligjor i Bankës së Shqipërisë. Ne jemi të bindur se vendimet e marra në vitin 2006 ishin të përshtatshme dhe ato kanë shërbyer për të orientuar pritjet inflacioniste brenda intervalit të vendosur si objektivi. Ndërkohë që, bazuar në filozofinë tonë të vështimit nga e ardhmja ne do të vlerësojmë me kujdes të gjithë faktorët e rrezikut, në mënyrë që të veprojmë në momentin e përshtatshëm dhe në intensitetin e duhur.
- Stabiliteti makroekonomik është i një rëndësie parësore por pa dyshim, që i një rëndësie kaq jetike është dhe stabiliteti financiar. Për nga rëndësia dhe për nga momenti në të cilin ndodhet zhvillimi ekonomiko-financiar i vendit, ky prioritet merr një rëndësi të jashtëzakonshme. Për më tepër, shtimi i shpejtë i kredisë përbën një argument për më shumë kujdes, veçanërisht në drejtim të cilësisë së saj. Duke qenë plotësisht të ndërgjegjshëm për rolin tonë si institucion vendimmarrës dhe rregullues njëkohësisht, kemi vendosur që të rrisim vigjilencën në këtë drejtim dhe si hap të parë, do të krijojmë një njësi të specializuar, Departamentin e Stabilitetit Financiar.
- Banka e Shqipërisë, edhe një herë thekson objektivin e saj për konsolidimin e mëtejshëm të sistemit bankar. Ky proces, i cili ishte i pranishëm gjatë vitit 2006, duhet të vijojë më tej gjatë vitit në vazhdim. Ne do të synojmë që sistemi bankar të jetë bashkësi e institucioneve të shëndosha: që mbështeten nga aksionerë të fuqishëm dhe me përvojë në industrinë bankare; që zbatojnë standardet më të mira të përgjegjshmërisë në drejtim; që realizojnë një veprimtari të ekuilibruar me rreziqe të mirëadministruara; që janë në gjendje të përballojnë dhe të zhvillohen në kushtet e konkurrencës që ofron një treg i hapur dhe i integruar në tregun financiar ndërkombëtar; që mbështesin zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe që, në mënyrë transparente, i ofrojnë

publikut shërbime dhe produkte bankare cilësore dhe eficiente.

Dëshiroj të falenderoj edhe një herë Kuvendin e Shqipërisë për shkallën e mirëkuptimit dhe mbështetjen e vazhdueshme, që i ka dhënë Bankës së Shqipërisë.

Ju faleminderit për vëmendjen.



	Fq.
FJALA E GUVERNATORIT	11
KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE	1 31
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2 43
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET	3 85
KAPITULLI IV MBIKËQYRJA BANKARE	4 117
KAPITULLI V. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	5 131
KAPITULLI VI. RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2006	6 151

KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE

I.1 EKONOMIA BOTËRORE DHE TREGJET FINANCIARE

Ekonomia botërore është karakterizuar nga tendenca pozitive zhvillimi gjatë vitit 2006. Ruajtja e ritmeve të larta të rritjes dhe zgjerimi i bazës së ekonomive që kontribuojnë në të, dëshmojnë për konsolidimin e ciklit të ekspansionit. Rritja e fortë e çmimit të naftës dhe situata e rënduar gjeopolitike, kanë vënë në vështirësi qëndrueshmërinë e aktivitetit ekonomik, por pa arritur ta devijojnë atë. Politikat makroekonomike kanë vijuar të mbeten në kahun nxitës, ndonëse bankat më të mëdha qendrore kanë marrë masa për shtrëngimin e kushteve monetare, në përgjigje të lindjes së presioneve inflacioniste. Kushtet e favorshme të likuiditetit dhe normat historikisht të ulta të interesit, kanë favorizuar zhvillimin e tregjeve financiare. Dinamizmi i tyre dhe globalizimi në rritje i ekonomisë, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në transmetimin e impulseve të rritjes ekonomike përtej kufijve gjeografikë.

	2004	2005	Vlerësim	
			2006	2007
Bota	5.3	4.9	5.1	4.9
Ekonomitë e industrializuara	3.2	2.6	3.1	2.7
Eurozonë	2.1	1.3	2.4	2.0
Gjermani	1.2	0.9	2.0	1.3
Francë	2.0	1.2	2.4	2.3
Itali	1.1	-	1.5	1.3
SHBA	3.9	3.2	3.4	2.9
Evropa Juglindore	6.5	5.4	5.3	5.0

Burimi: FMN, "Eorld Economic Outlook", shtator 2006.

Tabelë 1. Rritja vjetore dhe parashikimi për vitin 2007.

Sipas vlerësimeve të FMN-së, ekonomia botërore është rritur me 5.1 për qind, gjatë vitit 2006. Rritja ekonomike për periudhën 2004 – 2006, ka shënuar nivelet më të larta që nga fillimi i viteve 70-të. Gjatë vitit 2006, është vënë re një balancim i ekonomisë globale. Aktiviteti ekonomik është moderuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Japoni por ka fituar impuls në Evropë. Zhvillimet në Kinë, Indi, Rusi si dhe në shumë nga vendet e tjera në zhvillim, vijojnë ecurinë pozitive të viteve të fundit.

	Rritja vjetor e PBB-së, T4	Norma e papunësisë, dhjetor	IÇK, dhjetor
SHBA	+3.5	4.5	2.0
Eurozonë	+3.3	7.5	1.9
Gjermani	+3.7	7.9	1.4
Francë	+1.9*	8.5	1.7
Itali	+2.9	6.7 **	2.1
Japoni	+1.7*	4.	0.3

* Tremujori i tretë; ** shtator. Burimi: Eurostat; Zyra e Kërkimeve Ekonomike; Zyra e Statistikave të Punës.

Tabelë 2. Disa tregues kryesorë ekonomikë në terma vjetorë (në përqindje).

Nga ana tjetër, rritja ekonomike e shtrirë në një periudhë të gjatë kohore ka bërë që ekonomitë e shumë vendeve të rrisin shrytëzimin e kapaciteteve të lira, duke shtuar presionet inflacioniste. Aktiviteti intensiv ekonomik, ka sjellë rritjen e kërkesës për naftë dhe të mira të tjera, duke rezultuar në shtrenjtimin e vazhdueshëm të çmimeve të tyre.

- EKONOMIA E EUROZONËS

Pas një periudhe të gjatë ngërçi, aktiviteti ekonomik në Eurozonë fitoi një ritëm të ri gjatë vitit 2006, duke kaluar edhe pritjet. Rritja ekonomike ka qenë e shpërndarë si nga ana gjeografike, ashtu edhe në komponentët e ndryshëm të kërkesës. Sipas vlerësimit më të fundit të Komisionit Evropian, prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 2.7 për qind në vitin 2006, nga 1.4 për qind në vitin 2005. Forca kryesore shtytëse e hovit ekonomik, vlerësohet të jetë e lidhur me rritjen e konsumit dhe të investimeve private. Përmirësimi i kërkesës së brendshme, ka hedhur bazat për një rritje të qëndrueshme dhe të zgjatur në kohë. Edhe evidenca nga anketimet e ndryshme të besimit, mbështet vlerësimet për rritje të fortë ekonomike dhe situatë të përmirësuar në tregjet e punës.

Politika monetare e ndjekur nga BQE-ja ka ndihmuar në ankorimin e pritjeve të inflacionit rreth objektivit 2 për qind. Inflacioni i çmimeve të konsumit u rrit gjatë pjesës së parë të vitit, duke kulmuar me 2.5 për qind, në muajin qershor. Inflacioni i kësaj periudhe buroi kryesisht nga ndikimi i drejtpërdrejtë i çmimit të lartë naftës dhe i nënprodukteve të saj. Tendenca e inflacionit të çmimeve të konsumit ndryshoi në kah të kundërt, gjatë pjesës së dytë të vitit. Efektet dytësore të çmimit të lartë të energjisë¹ kanë qenë të kufizuara, por inflacioni bazë dhe indekset e çmimit të prodhuesve kanë filluar të sinjalizojnë presione të mundshme inflacioniste për vitet 2007 dhe 2008.

Në muajin tetor, vendet anëtare të Eurozonës paraqitën para Komisionit Evropian shifrat e deficitit dhe të borxhit për vitin 2005, ecurinë gjatë vitit 2006 dhe planet për vitin 2007. Pavarësisht hapit të ngadalhtë, tendenca e përgjithshme tregon përmirësime në balancat e buxhetit. Angazhimet e marra në kuadrin e Paktit të rishikuar të Stabilitetit dhe Rritjes, janë mbajtur nga të gjitha vendet anëtare. Situata e favorshme ekonomike e Eurozonës, ka përbërë një moment të mirë për konsolidimin buxhetor në shumë vende.

- EKONOMIA E SHBA-SË

Pas një periudhe disavjeçare me norma të larta rritjeje, ekonomia e SHBA-së duket se ka filluar të hyjë në një periudhë me një normë mesatare por të qëndrueshme rritjeje. Pas një rritjeje të lartë në tremujorin e parë të vitit 2006, ritmi i rritjes së prodhimit të brendshëm bruto, u moderua gjatë pjesës në vazhdim të vitit. Arsyeja kryesore e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, është e lidhur me zhvillimet negative në tregun e banesave, të cilat kanë dhënë ndikim edhe në sektorin e ndërtimit. Megjithatë, problemet e tregut të banesave nuk janë transmetuar ndjeshëm në sektorë të tjerë

të ekonomisë. Shpenzimet konsumatore, të cilat kanë qenë baza e rritjes gjatë viteve të fundit, kanë vazhduar të jenë në nivele të larta. Sektori i biznesit vazhdon të mbetet në kushte shumë të mira financiare, me fitime dhe likuiditet të lartë. Situata e mirë financiare ka mbështetur shpenzimet kapitale të biznesit dhe ka ndikuar në një kërkesë të kënaqshme dhe të qëndrueshme për punë.

Presionet inflacioniste janë qetësuar disi gjatë muajve të fundit të vitit, pas niveleve të larta të shënuara gjatë pjesës së parë. Inflacioni ka pasur një tendencë të përgjithshme rënëse dhe, në një pjesë të madhe, kjo shpjegohet ashtu si për ekonominë e Eurozonës, me rënien e çmimit të naftës dhe të produkteve të saj. Aktualisht, shkalla e përdorimit të kapaciteteve është e lartë, ndërsa kompensimi i punonjësve ka treguar shenja të lehta rritjeje gjatë vitit 2006. Ecuria e produktivitetit dhe mënyra e kalimit të kostove të shtuara nga puna, në çmime do të ndikojnë presionet inflacioniste në ekonomi.


- **NORMAT BAZË TË INTERESIT**

Politika monetare, e ndjekur nga pjesa më e madhe e autoriteteve monetare të vendeve të industrializuara, ka pasur një tendencë të përgjithshme shtrënguese, megjithëse bankat qendrore aktualisht ndodhen në faza të ndryshme të ciklit monetar. Banka qendrore e SHBA-së (Federal Reserve), duket se po bën një pauzë pas 17 rritjesh të njëpasnjëshme të normës bazë të interesit, në pritje të materializimit të efekteve të tyre në zhvillimet ekonomike. Norma bazë e interesit në SHBA është më e larta për ekonominë e mëdha, në nivelin 5.25 për qind.

Banka Qendrore Evropiane (ECB), filloi ciklin e shtrëngimit të politikës monetare, në fund të vitit 2005. Gjatë vitit 2006, Komiteti Drejtues i BQE-së ka rritur 5 herë normën bazë të interesit, duke e çuar në 3.5 për qind, në mbledhjen e fundit të këtij viti. Duke konsideruar normat e interesit të ulta, rritjen e parasë dhe kreditimin e lartë të ekonomisë, BQE i sheh kushtet monetare në Eurozonë si mbështetëse për rritjen e aktivitetit ekonomik.

Banka e Japonisë rriti me 0.25 pikë përqindje normën bazë në muajin qershor, duke mos aplikuar lëvizje të tjera që prej kësaj periudhe. Rritja e inflacionit me norma më të ulta se sa priteshin, është arsyeja kryesore në vendimin për të mbajtur të pandryshuar normën bazë.

Grafik 1. Ecuria e normave bazë të interesit në Eurozonë, në SHBA dhe në Japoni.




Burimi: Banka Qendrore Evropiane; Federal Reserve; Banka e Japonisë.

- **KURSI I KËMBIMIT**

Pasi fitoi pikë në fillim të vitit 2005 dhe ruajti një periudhë disamujore qetësie, dollari amerikan u zhvlerësua si kundrejt euros ashtu edhe kundrejt


jenit japonez, gjatë vitit 2006. Zhvlerësimi i dollarit gjatë vitit, duket se në pjesën më të madhe, reflekton pritjet e tregjeve ndërkombëtare, se me moderimin e aktivitetit ekonomik në SHBA, diferencat pozitive të normave të interesit të usd, kundrejt monedhave të ndryshme, mund të zvogëlohen. Gjithashtu, thellimi i deficitit të llogarisë korente amerikane dhe zgjerimi i suficitit të llogarisë korente të vendeve eksportuese të naftës dhe vendeve në zhvillim të Azisë, përbëjnë një tjetër shqetësim që ndikon në tregjet valutore. Pas një periudhe ngadalësimi, gjatë vitit 2006, volatiliteti në tregjet e këmbimit është kthyer në vlerat normale, duke reflektuar faktin se vendimet e politikës monetare po përcillen më mirë në tregun valutor.



• ÇMIMI I NAFTËS

Pasi shfaq shenja stabilizimi gjatë vjeshtës së vitit 2005, çmimi i naftës u rrit ndjeshëm gjatë pjesës së parë të vitit 2006, duke kapur një rekord të ri në muajin gusht. Në fillim të këtij muaji, një fuçi naftë u shit me 78 usd. Gjatë muajve në vijim, çmimi i naftës është stabilizuar dhe nafta e papërpunuar u tregtua në nivelet e fundvitit 2005.

Paniku që u krijua në tregje për një ulje të prodhimit nga vendet kryesore eksportuese të naftës si pasojë e tensioneve të shtuara gjeopolitike, ndikoi në rritjen e çmimit në pjesën e parë të vitit. Por, mbivlerësimi i rëndësisë së disa faktorëve, dimri i ngrohtë në Hemisferën Veriore, zvogëlimi i kërkesës dhe rritja e ofertës së OPEC-ut mbi nivelet e deklaruar, kanë ndikuar pozitivisht në stabilizimin e situatës.



1.2 EKONOMITË E RAJONIT

PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE KRYESORE NË RAJON

Vendet e rajonit³ në mënyrë graduale po përafrojnë zhvillimet e tyre ekonomike dhe monetare me vendet e Evropës Perëndimore. Kjo pasqyrohet edhe në ritmet më të shpejta të rritjes ekonomike për këto vende, në krahasim me ato të Eurozonës. Kështu, rritja reale e produktit të brendshëm bruto, nga 4.7⁴ për qind në vitin 2005 pritet të jetë rreth 5.9 për qind për vitin 2006, duke qenë kështu disa pikë përqindjeje më lart, se ajo e vendeve të Eurozonës. Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e konsiderueshme ekonomike, janë flukset hyrëse nga investimet e huaja direkte dhe kërkesa e brendshme e lartë, e nxitur kjo dhe nga rritja e shpejtë e kredive. Nga ana tjetër, kërkesa e brendshme dhe çmimet e larta të energjisë, po ushtrojnë presione inflacioniste kudo në rajon. Për më tepër, kursimet vendase janë të pamjaftueshme për të mbuluar investimet, duke rezultuar kështu në deficite të larta të llogarisë korente. Gjithsesi, zhvillimi i mëtejshëm ekonomik përballet me rreziqe, që vijnë nga çekuilibrimet globale dhe nga rritja e normave të interesit në vendet e OECD-së, gjë që zbeh stimujt e interesimit për të investuar në këto vende. Investimet e huaja direkte pritet të reduktohen disi, nga nivelet e shënuara në vitet 2004-2005.

Problemet e krijuara nga rritja e shpejtë e kredisë, e pagave reale të reflektuara në kërkesën e brendshme të lartë, janë pasqyruar në masat e marra nga bankat qendrore të vendeve të rajonit. Shumë banka qendrore, kanë vendosur të prezantojnë rregullore më strikte mbi minimumin e rezervave apo të ndërmarrin masa të tjera kundër inflacionit. Përkundrajt këtij sfondi, politikave fiskale në përgjithësi kanë qenë tepër lehtësuese, për të ndaluar kërkesën e brendshme në mënyrë efektive. Rasti i politikave fiskale më shtrënguese po

bëhet më i nevojshëm në këndvështrimin e implikimeve afatgjata të plakjes së popullatës, që do të ushtrojë presion të konsiderueshëm në buxhetin fiskal në të ardhmen.

Tabelë 3. Disa nga treguesit kryesorë të vendeve të rajonit.

Vendet	Rritja PBB (në %)		Inflacioni vjetor (në %)	Papunësia (në %)	Balanci fiskal* (në% të PBB-së)	Llogaria korente* (në % të PBB-së)
	2005	2006*				
Greqi	3.7	4.2	3.2	8.7 q3	-2.6	-11.4
Itali	0.0	1.5	2.1	6.9 q2	-4.0	-1.4
Kosovë	-0.2	--	0.7 (nëntor)	--	--	--
Kroaci	4.1	4.6	2.0	16.9(nëntor)	-3.0	-6.8
Maqedoni	3.8	3.8	2.9	37.1*	-0.6	-3.1
Serbi	6.3	5.5	6.6	26 (shtator)	+0.8	-10
Turqi	7.4	6	9.7	9.1(shtator)	-3.6	-8.1

Burimi: Eurostat, FMN, Bankat qendrore.

* Parashikime.

Për periudhën afatmesme parashikohet që vendet e Evropës Juglindore të vazhdojnë të kenë ritme të konsiderueshme rritjeje, megjithëse disi më të ngadalësuar për vitin 2007. Këto zhvillime pritet të reflektojnë progresin në reformat strukturore dhe rritjen e integritimit me ekonominë botërore.

• EKONOMIA E GREQISË

Aktiviteti ekonomik është rritur ndjeshëm gjatë vitit 2006. Në tremujorin e tretë të vitit, PBB-ja është rritur me 4.4 për qind në terma vjetorë ose pothuajse dy herë më shumë se sa në Eurozonë. Faktorët kryesorë të kësaj rritjeje, janë rritja e investimeve dhe konsistenca në shpenzimet për konsum. Pavarësisht pritjeve për shtrëngim të politikës monetare nga Banka Qendrore Evropiane, ecuria ekonomike pritet të jetë e kënaqshme dhe për vitin 2007 dhe të arrijë në 3.9 për qind. Kërkesa e brendshme e lartë dhe çmimi i lartë i naftës, janë pasqyruar dhe në thellimin e deficitit të llogarisë korente, i cili, për vitin 2006, pritet të kalojë 11 për qind të PBB-së. Situata fiskale është përmirësuar gjatë vitit 2006. Deficiti i llogarisë së qeverisë për vitin 2006, pritet të reduktohet në 2.6 për qind të PBB-së nga 5.2 për qind që ishte një vit më parë.

• EKONOMIA E ITALISË

Përmirësimi i ekonomisë italiane në vitin 2006, sinjalizon për një fund të periudhës 4-vjeçare të një situatë pothuajse stanjacioni ekonomik. Forcat kryesore që kanë nxitur performancën pozitive, kanë qenë rritja e eksporteve, kushtet lehtësuese të kreditimit, reformat e orientuara drejt rritjes së numrit të të punësuarve dhe përmirësimi i nivelit të besimit. Implementimi i plotë i reformave në tregjet e mallrave është një faktor i rëndësishëm, i cili do të ndikojë në mbajtjen nën kontroll të inflacionit për periudhën në vazhdim. Përcaktimi i pagave në mënyrë më të decentralizuar, do të ndikojë më tej për të kompensuar humbjet e mëparshme në konkurrencë. Deficiti fiskal për vitin 2006, vlerësohet të jetë 4 për qind e PBB-së.

- EKONOMIA E KOSOVËS

Reduktimi në ndihmat e donatorëve dhe ulja e pranisë së komunitetit ndërkombëtar, kanë ndikuar në ngadalësimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Gjithsesi, ripërtëritja e aktivitetit të sektorit privat për vitin 2006, ka ndikuar pozitivisht pritjet për rritjen e produktit të brendshëm bruto për këtë vit. Deficiti tregtar gjatë tre tremujoreve të parë të vitit 2006, arriti në 39 për qind të PBB-së. Financimi i deficitit korent vazhdon të bazohet në asistencën e huaj, në formën e mbështetjes së projekteve dhe më pak në transfertat kapitale private. Ecuria e ngadalhtë e aktivitetit ekonomik është pasqyruar dhe në normën e moderuar të inflacionit. Zhvillimet fiskale në nëntë muajt e parë të vitit, kanë qenë më të mira sesa ato të parashikuara. Në muajin nëntor, llogaria fiskale shënoi një suficit buxhetor të konsoliduar prej 119.7 milionë eurosh.

- EKONOMIA E KROACISË

Produkti i brendshëm bruto për tre tremujorët e parë të vitit 2006, shënoi një rritje prej 4.7 për qind. Rritja e aktivitetit ekonomik ka vazhduar të nxitet nga kërkesa e brendshme e lartë. Kjo ecuri ekonomike është shoqëruar dhe me rritje të numrit të të punësuarve dhe ulje të normës së papunësisë. Deficiti i llogarisë korente për periudhën 12-mujore deri në fund të muajit shtator, është thelluar në 8.2 për qind të PBB-së. Norma mesatare e inflacionit është rritur gjatë këtyre tre viteve të fundit, duke arritur në një mesatare rrëshqitëse prej 3.3 për qind në muajin nëntor të vitit 2006. Politika monetare ka vazhduar të jetë në varësi të objektivit kryesor të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Ky objektiv është ruajtur nëpërmjet shtrëngimit të kursit të administruar të këmbimit. Deficiti i konsoliduar i qeverisë parashikohet të reduktohet në 3 për qind të PBB-së, sipas rishikimeve të muajit korrik.

- EKONOMIA E MAQEDONISË

Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2006, ritmi i rritjes vjetore të aktivitetit ekonomik, u reduktua në 2.7 për qind nga 3.8 për qind në vitin 2005. Ngadalësimi pasqyron rritjen më të ulët të prodhimit industrial dhe të aktivitetit të ndërtimit. Ky zhvillim ekonomik është shoqëruar me përmirësim të llogarisë së jashtme, gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2006. Në muajin shtator bilanci i llogarisë korente shënoi një suficit prej rreth 2 për qind të PBB-së së. Norma e inflacionit ka shënuar rritje gjatë vitit 2006, megjithëse mbetet në nivele të ulëta negative prej 2.9 për qind, në muajin dhjetor. Kushtet monetare janë lehtësuar më tej gjatë vitit 2006, duke reflektuar rritjen e besimit në stabilitetin e kursit të këmbimit. Balanca fiskale pritet të shënojë një deficit fiskal prej 0.6 për qind të PBB-së.

- EKONOMIA E SERBISË

Produkti i brendshëm bruto për nëntë muajt e parë të vitit 2006, u rrit me 5.4 për qind në terma vjetorë. Kërkesa e brendshme ka qenë kontribuesi kryesor në rritjen e PBB-së. Deficiti tregtar, gjatë njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit, u thellua me 9.7 për qind. Norma vjetore e inflacionit shënoi 6.6 për qind në

muajin dhjetor 2006, nga 17.5 për qind që ishte një vit më parë. Reduktimi i normës së inflacionit është ndihmuar nga vlerësimi i monedhës vendase kundrejt euros, rënia e çmimit të naftës në tregun botëror gjatë gjashtëmuajorit të dytë, vonesat në rregullimin e disa çmimeve të administruara dhe kushtet e shtrënguara monetare. Reduktimi i vazhduar i normës së inflacionit është pasqyruar në lehtësimin e politikës monetare, nëpërmjet uljes me 4 pikë përqindjeje të normës bazë të interesit, në muajt e fundit të vitit. Banka Kombëtare e Serbisë modifikoi regjimin e politikës monetare në vitin 2006, drejt aplikimit të regjimit të inflacionit të shënjestruar.

- EKONOMIA E TURQISË

Ritmi i rritjes së produktit të brendshëm bruto është reduktuar gjatë vitit 2006, në krahasim me një vit më parë. Kështu PBB-ja është rritur vetëm me 3.4 për qind, në tremujorin e tretë të vitit 2006, nga 7 për qind që ishte në gjysmën e parë të tij. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik u shkaktua kryesisht nga rënia në konsumin privat, që erdhi si rrjedhojë e politikës monetare shtrënguese, e normave më të larta të interesit dhe e reduktimit të kredive. Disinflacioni ka qenë i shpejtë gjatë tre viteve të fundit por ritmi i tij, kryesisht në sajë të vlerësimit të Lirës Turke dhe rritjes së çmimit të energjisë, ka rënë duke e çuar normën e inflacionit në 9.7 për qind, në muajin dhjetor të vitit 2006. Deficiti i llogarisë korente, i cili pritet të arrijë një nivel prej 8 për qind të PBB-së për vitin 2006, financohet nga rritja e borxhit privat dhe investimet e huaja direkte. Ruajtja e disiplinës fiskale dhe besueshmëria ndaj politikës monetare në veçanti, nëpërmjet konsolidimit të pavarësisë së bankës qendrore, janë faktorë vendimtarë për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik në vend.

SHËNIME

¹ Çmimi i naftës së papërpunuar transmetohet në çmimin e benzinës, të naftës për ngrohje dhe të produkteve të tjera të energjisë, të përdorura nga konsumatorët.

² Kursi real efektiv llogaritet si një mesatare e peshuar e kursit të këmbimit të një monedhe, kundrejt një shporte me monedhat e partnerëve kryesorë tregtarë, të vendit në shqyrtim.

³ Në vendet e rajonit përfshihen: Italia, Greqia, Kosova, Kroacia, Bullgaria, Rumania, Bosnjë-Hercegovina, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbia dhe Mali i Zi.

⁴ Sipas Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

	Fq.
FJALA E GUVERNATORIT	11
KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE	1 31
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2 43
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET	3 85
KAPITULLI IV MBIKËQYRJA BANKARE	4 117
KAPITULLI V. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	5 131
KAPITULLI VI. RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2006	6 151

KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE

II.1 PBB DHE STABILITETI MAKROEKONOMIK


Zhvillimi ekonomik i vendit gjatë vitit 2006, ka qenë përgjithësisht në linjë me zhvillimet e programuara. Rritja ekonomike dhe stabiliteti makroekonomik, janë ndikuar nga politika makroekonomike relativisht akomoduese dhe nga përmirësimi i ambientit strukturor.

Në bazë të treguesve të disponueshëm ekonomikë, norma e rritjes ekonomike vlerësohet të jetë rreth nivelit 5 për qind. Kjo rritje është shoqëruar me stabilitet çmimesh, të shprehur në një inflacion mesatar vjetor prej 2.4 për qind. Kushtet monetare, të karakterizuara nga norma historikisht të ulëta interesi dhe qëndrueshmëri e kursit të këmbimit, kanë favorizuar rritjen e investimeve dhe të konsumit në ekonomi. Në mënyrë të veçantë, ato janë reflektuar edhe në rritjen e shpejtë të kredisë, duke mbështetur më tej rritjen e ekonomisë. Zhvillimet fiskale kanë rezultuar brenda kufijve të programuar, duke kontribuar në konsolidimin e mëtejshëm të financave publike dhe kontrollin e deficitit buxhetor.

Gjithsesi, realizimi i shpenzimeve kapitale kërkon një vëmendje më të madhe, si për realizimin e nivelit të programuar ashtu edhe për ritmikën e tij. Rritja e disa çmimeve të administruara gjatë gjysmës së dytë të vitit, nuk ka ndikuar në krijimin e spiraleve inflacioniste apo në reduktimin e prodhimit. Barra që kanë sjellë këto rritje për konsumatorët, është lehtësuar nga rënia e çmimeve të disa mallrave të rëndësishëm të shportës së konsumit. Rënia e çmimit në naftës në tregun ndërkombëtar, gjatë muajve të fundit të vitit, ka ndikuar në uljen e kostove të prodhimit dhe të transportit në vend. Rritja ekonomike është reflektuar edhe në tregun e punës. Numri i të punësuarve në vend ka shënuar rritje, ndonëse ajo ende nuk reflekton tërësisht zhvillimet në sektorët e tjerë të ekonomisë. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik në vend është shoqëruar me rritjen e shkëmbimeve tregtare me jashtë. Bilanci i pagesave është mbyllur në terma pozitivë, duke mbështetur qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit. Megjithatë, garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik në të ardhmen, do të kërkojë hartimin e strategjive integrale për kontrollin e deficitit të lartë tregtar.

Treguesit sasiorë dhe cilësorë të ecurisë ekonomike, flasin për një rritje të kënaqshme, të mbështetur kryesisht në aktivitetet e shërbimeve dhe të prodhimit industrial. Shitjet e realizuara nga ndërmarrjet ekonomike, gjatë nëntëmujorit të parë, ishin rreth 11 për qind më të larta sesa në vitin 2005. Fakti që tremujori i parë regjistroi një rritje të lartë vjetore të shitjeve, tregon se ndërmarrjet e prodhimit dhe të shërbimeve, i tejkalojnë problemet e shkaktuara nga kufizimet në furnizimin me energji elektrike, në fund të vitit 2005. Zhvillime pozitive janë regjistruar në sektorin e

industrisë dhe në mënyrë të veçantë, në industrinë përpunuese. Aktiviteti tregtar në vend, vazhdon të sigurojë pjesën më të madhe të shitjeve, si edhe të shënojë ritme të konsiderueshme rritjeje vjetore. Sektori i ndërtimit vlerësohet të ketë patur një rritje, ndonëse krahasimisht më të ulët se sa në vitet e mëparshme. Prodhimi bujqësor është rritur në mënyrë modeste dhe është përqendruar në gjysmën e dytë të vitit. Vrojtimet e Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet e kaluara dhe të pritshme në ekonomi, edhe për vitin 2006, kanë mbështetur konkluzionet e mësipërme për sektorët e veçantë të ekonomisë.



Tre tremujorët e parë të vitit, kanë regjistruar një ulje të lehtë të normës së papunësisë, ndërkohë që rritja më e madhe e numrit të të punësuarve është vërejtur në sektorin privat jobuqësor. Rreth 65 për qind e të papunëve janë të papunë afatgjatë, gjë që dëshmon për problemet e thella dhe të trashëguara të tregut të punës në Shqipëri.

Rritja ekonomike, ndër të tjera, është reflektuar edhe në rritjen e të ardhurave tatimore dhe të atyre të përgjithshme. Shpenzimet buxhetore kanë qenë brenda nivelit të parashikuar gjatë vitit 2006, duke mbetur poshtë nivelit të planifikuar në zërat e shpenzimeve kapitale. Respektimi i piketave të buxhetit të vitit 2006, veçanërisht në shpenzimet operative dhe të huamarrjes së brendshme, ka ndihmuar në ruajtjen dhe konsolidimin e stabilitetit makroekonomik, duke mos gjeneruar

presione të tepërta nëpërmjet stimulit fiskal të ekonomisë. Megjithatë, shpenzimet buxhetore kanë patur devijime të dukshme nga shpërndarja e planifikuar e tyre përgjatë vitit, duke sjellë luhatje të tregut financiar dhe duke vështirësuar harmonizimin me masat e politikës monetare, në nivel operacional.

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë kanë ndjekur tendencat e viteve të kaluara. Vëllimi i transaksioneve korente është rritur edhe gjatë vitit 2006. Eksportet dhe importet e mallrave kanë regjistruar një rritje vjetore përkatësisht prej 19 për qind dhe 15 për qind.

Megjithatë, vlerësohet se deficitin korent edhe këtë vit vazhdon të jetë në nivele të larta, 7,6 për qind të PBB-së. Ecuria e llogarisë korente ka vijuar të përcaktohet nga ecuria e tregtisë në mallra dhe nga flukset hyrëse të transfertave korente, të cilat janë burimi kryesor i financimit të importeve të mallrave dhe shërbimeve. Borxhi i jashtëm, deri në fund të vitit, vlerësohet të ketë arritur në rreth 17 për qind të PBB-së. Ky borxh është mjaft më i ulët se ai i vendeve të Evropës Qendrore dhe Juglindore, i cili luhetet në rreth 50 për qind të PBB-së.

Tabelë 1. Disa tregues të ekonomisë në vite.

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006*
Rritja reale e PBB-së (në %) ¹	7.7	6.5	4.7	6.0	6.0	5.5	5.0
PBB (me çmime korente, në milionë lekë) ²	530,900	588,700	624,700	682,700	766,100	836,600	896,300
PBB (me çmime korente, në milionë usd) ³	3,694	4,102	4,459.0	5,600.5	7,452.3	8,382.8	9,136.6
PBB (në usd për frymë)	1086	1329	1,438.4	1,806.6	2,328.9	2,619.6	2,855.2
Numri i të punësuarve (në mijë) ⁴	1068	1065	921	928	917	932	934
Përqindja e papunësisë	16.9	14.6	15.8	15.0	14.6	14.2	13.8
Përqindja e inflacionit (v/v)	4.2	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5
Deficiti i buxhetit (me grantet, në % të PBB-së)	-8.2	-7.9	-6.6	-4.5	-5.1	-3.6	-3.1
Borxhi publik (në % të PBB-së)	71.3	66.8	65.3	61.7	56.6	56.7	55.9
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së) ⁵	29.4	25.8	23.5	20.6	18	17.5	17.2
Borxhi i brendshëm (në % të PBB-së)	41.9	41.0	41.8	41.1	38.6	39.2	38.7
Llogaria korente (në % të PBB-së)	-7.0	-6.1	-10.0	-7.9	-4.8	-7.3	-7.6
Kursi mesatar i këmbimit, lek/usd	143.7	143.5	140.1	121.9	102.8	99.8	98.1
Kursi mesatar i këmbimit, lek/euro	132.6	128.5	132.4	137.5	127.7	124.2	123.1

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave, vlerësime të FMN-së dhe Banka e Shqipërisë.

* Vlerësime paraprake.

Sinjalet nga ambienti i jashtëm makroekonomik, janë përcjellë në ekonominë vendase kryesisht nëpërmjet lëvizjeve në çmimet e naftës dhe inflacionit të vendeve partnere. Tregu i brendshëm i karburanteve ka pasqyruar besnikërisht si rritjen, ashtu edhe uljen e çmimit të naftës jashtë. Vlera më e lartë e shitjes së njësisë së karburantit, u regjistrua në muajin gusht dhe ajo më e ulët, në muajin dhjetor. Ndikimi i kursit të këmbimit lek/usd në përcjelljen e çmimit të huaj në çmimin vendas, gjatë vitit 2006, ka qenë pothuajse i pandjeshëm. Ndërkohë që në vitin 2005, mbiçmimi i lekut ndaj dollarit amerikan ka frenuar deri në njëfarë mase rritjen e çmimit të naftës në vend, në vitin 2006, kursi i këmbimit nuk ka luajtur ndonjë rol të ndjeshëm në këtë drejtim. Ecuria e çmimeve të konsumit të partnerëve tregtarë të Shqipërisë, gjithashtu është reflektuar në çmimet e konsumit në vend. Ky fenomen është shfaqur më i fortë gjatë tremujorit të tretë, kur në Itali dhe Greqi u regjistruan rritje në çmimet e mallrave ushqimorë. Megjithatë "importi" i inflacionit vlerësohet të ketë qenë i moderuar, duke mos rrezikuar arritjen e objektivit të inflacionit në vend.

Përveç faktorëve me origjinë nga ambienti i jashtëm, inflacioni i çmimeve të konsumit është ndikuar edhe nga faktorë të brendshëm, si prodhimi bujqësor dhe vendimet për ndryshimin e çmimeve të administruara. Norma mesatare e rritjes së çmimeve në bazë vjetore, gjatë vitit 2006, ishte 2.4 për qind. Peshën më të madhe në formimin e kësaj norme e ka dhënë grupi "Qira, ujë, lëndë, djegëse dhe energji", i cili ka kontribuar mesatarisht me 1.4 pikë përqindjeje, në çdo muaj të vitit. Efekti më i madh i rritjes së çmimit të këtij grupi është regjistruar në gjysmën e dytë të vitit, duke reflektuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët me 13.7 për qind, në muajin gusht. Inflacioni i grupit të mallrave ushqimorë ka kontribuar me rreth 0.4 pikë përqindjeje në normën e përgjithshme të inflacionit, por kontributi nuk ka qenë i njëtrajtshëm përgjatë gjithë muajve të vitit. Ky grup shënoi vlera të larta inflacioni, gjatë pjesës më të madhe të gjashtëmujorit të parë, nën ndikimin e kufizimeve të ofertës së prodhimit bujqësor. Gjatë pjesës së dytë të vitit, rënia e çmimeve të ushqimeve ka kundërbalancuar rritjen e çmimit të energjisë dhe efektin e rritjes së taksës së akcizës për disa mallra.


II.2 PRODHIMI SIPAS SEKTORËVE TË EKONOMISË

• TREGTIA DHE SHËRBIMET E TJERA

Sektori i shërbimeve është një nga sektorët më dinamikë të ekonomisë shqiptare, duke dhënë vazhdimisht një kontribut të lartë në aktivitetin ekonomik dhe rritjen ekonomike në vend. Pesha e këtij sektori në ekonomi ka ardhur në rritje, duke shënuar një tendencë që pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ecuria e këtij sektori vlerësohet në bazë të indeksit të shitjeve të ndërmarrjeve ekonomike, sipas grupimeve të aktiviteteve të shërbimeve në tregti me shumicë dhe pakicë, shërbime hoteli dhe restoranti, shërbime telekomunikacioni dhe shërbime të tjera. Të ardhurat e gjeneruara nga shitjet e këtyre shërbimeve, janë rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë viteve të fundit dhe aktualisht, përbëjnë rreth 60 për qind të të ardhurave të përgjithshme të ndërmarrjeve ekonomike.


Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2006, vlera e shitjeve të sektorit të shërbimeve është rritur me rreth 13 për qind krahasuar me një vit më parë. Kontributin kryesor në shitjet e shërbimeve vazhdon ta japë dega e tregtisë. Sektori i telekomunikacionit, në përgjithësi, ka regjistruar zhvillime pozitive gjatë vitit 2006, pavarësisht një ngadalësimi të vërejtur gjatë tremujorit të dytë. Shitjet në shërbimet e tjera kanë shënuar gjithashtu rritje, gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit. Vlera e shitjeve të shërbimeve financiare, atyre në pasuri të patundshme dhe shërbimeve sociale kolektive dhe individuale është rritur me rreth 40 për qind, në krahasim me vitin 2005. Ndërkohë, vlerësimet e tërthorta të zhvillimeve të ekonomisë gjatë tremujorit të katërt, sugjerojnë vijimësinë e kësaj tabloje edhe në tremujorin e katërt.



• SEKTORI I BUJQËSISË

Prodhimi bujqësor gjatë vitit 2006 ka rikuperuar pjesërisht rënien e ritmit të rritjes, të vërejtur gjatë vitit 2005. Projeksioni për rritjen e sektorit në vitin

2006 qëndron në nivelin 2.5 për qind, duke qenë më i lartë se rritja në vitin 2005, por më i ulët se norma mesatare e rritjes gjatë pesë viteve të fundit. Zhvillimi i sektorit të bujqësisë, vazhdon të pengohet nga probleme të shumta strukturore. Infrastruktura relativisht e pazhvilluar e zonave rurale, vështirëson daljen e produkteve në treg. Copëzimi i tokës bujqësore pengon organizimin efektiv të prodhimit, ul rendimentin dhe rrit koston e përdorimit të mekanikës bujqësore. Ndërkohë, toka bujqësore nuk shfrytëzohet në maksimum, si pasojë e migrimit të jashtëm dhe të brendshëm. Ky fenomen, i shoqëruar me problemet për pronësinë, ka kufizuar në mënyrë të vazhdueshme investimet në sektorin e bujqësisë. Edhe gjatë vitit 2006, kredia e akorduar për aktivitetet me natyrë bujqësore ka qëndruar në nivele të ulëta, pavarësisht rritjes së konsiderueshme të kredisë për ekonominë.



Prodhimi i nëndegës së bujqësisë, i cili përfaqëson rreth 80 për qind të prodhimit të përgjithshëm bujqësor, vlerësohet të jetë rritur me 1.8 për qind gjatë vitit 2006. Ky vlerësim mbështetet kryesisht në madhësinë e rritjes së sipërfaqeve të mbrojtura të mbjelljes të produkteve bujqësore dhe në të dhënat operative⁶ për ecurinë e prodhimit bujqësor. Rritja e moderuar e prodhimit bujqësor është shoqëruar me rritjen e importeve të produkteve bujqësore nga jashtë. Importet e mallrave ushqimorë shënuan një rritje vjetore prej 17 për qind gjatë vitit 2006.

Dega e industrisë përpunuese të artikujve bujqësorë ose agroindustria, ka paraqitur një zhvillim më të mirë sesa dega e bujqësisë. Prodhim

agroindustrial, i cili përfaqëson rreth 20 për qind të prodhimit të përgjithshëm bujqësor, vlerësohet të jetë rritur me rreth 6 për qind në vitin 2006. Sipas të dhënave të Vrojimit të Agroindustrisë⁷, pavarësisht ngadalësimit të vërejtur në tremujorin e tretë të vitit, gjatë nëntë muajve të parë të këtij viti, prodhimi agroindustrial regjistroi një rritje vjetore prej 9 për qind. Perspektiva për rritje të prodhimit agroindustrial në të ardhmen është e mirë, për shkak të rritjes së produktivitetit në sektorin e blegtorisë, të rritjes së rendimentit të prodhimit të frutave dhe të perimeve dhe të kërkesës në rritje për prodhime vendase. Rritja e prodhimit agroindustrial dhe sidomos e atij të lidhur me përpunimin e frutave dhe zarzavateve, gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2006, ka ndikuar në rritjen e eksporteve të këtyre zërave.

Tabelë 2. Rritja vjetore e prodhimit bujqësor.

	2001	2002	2003	2004	2005	2006*
Bujqësi	1.4	2.3	2.8	3.4	1.6	1.8
-blegtoaria	3.5	3.4	4.8	3.1	1.1	1.9
-bimët e arave	-1.1	1.8	-1.7	2.3	2.0	0.9
-pemëtaria	4.7	-0.2	15.5	9.2	2.0	5.1
Agroindustri	7.8	13.1	10.2	11.2	5.7	6.0
Total	2.3	4.1	3.9	4.7	1.2	2.6

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

* Parashikime të MBUMK.

• SEKTORI I NDËRTIMIT

Gjatë viteve të fundit aktiviteti i ndërtimit është kthyer në një nga shtyllat kryesore të ekonomisë shqiptare, si për shkak të peshës në prodhimin e përgjithshëm, ashtu edhe për shkak të ritmeve të larta të rritjes, të evidentuara në këtë sektor. Prej disa vitesh, rritja vjetore e këtij sektori është luhatur në nivelet 10 – 15 për qind, gjë që ka bërë që ky sektor të renditet i pari për nga zhvillimi, midis të gjithë sektorëve të ekonomisë.

Megjithatë, treguesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të aktivitetit të prodhimit në këtë sektor, tregojnë se ecuria e mëtejshme kërkon një vëmendje më të madhe, veçanërisht në orientimin më të mirë të burimeve financiare, private apo publike. Zhvillimet në degën e ndërtimit gjatë viteve të fundit, veçanërisht përqendrimi i skajshëm i ndërtimeve në territore të caktuara, dëshmojnë për mungesën e vazhdueshme të vizionit të zhvillimit urban, duke mos garantuar qëndrueshmërinë afatgjatë të degës. Për më tepër, ende dega e ndërtimit vazhdon të mbizotërohet nga ndërtimet për banesa, duke lënë shumë prapa zëra të tjerë strategjikë siç janë investimet në infrastrukturën rrugore, në ndërtime industriale, në bonifikime dhe infrastrukturë bujqësore përfshirë dhe investime të tjera, që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës në komunitetet e vogla urbane dhe rurale.

Zhvillimet e verifikuara në vitin 2006, tregojnë për një ngadalësim të zgjerimit të aktivitetit ndërtues, ndërkohë që mbetet akoma për t'u vlerësuar aktiviteti gjatë tremujorit të fundit të vitit, që sapo u mbyll. Shitjet përfundimtare të ndërmarrjeve ekonomike në sektorin e ndërtimit, në terma vjetorë, kanë shënuar një rritje modeste prej rreth 4 për qind. Konsumi i dukshëm i çimentos, gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit, ka qenë pothuajse i njëjtë me atë të vitit 2005.

Numri i lejeve të reja të ndërtimit të dhëna gjatë periudhës janar-shtator 2006, ka qenë pothuajse i njëjtë me atë të së njëjtës periudhë të një viti më parë. Ashtu si edhe në vitet e mëparshme, pjesa dërrmuese e ndërtimeve të reja kanë qenë ndërtime për banim. Në krahasim me vitin 2005, është vërejtur rënie në numrin e lejeve për ndërtesa tregtare dhe rritje në numrin e lejeve për ndërtesa industriale.

Ndërtimet e reja deri në fund të muajit shtator të vitit 2006, kanë përfaqësuar rreth 70 për qind të vlerës së ndërtimeve gjithsej. Shpenzimet për rikonstrukcione gjatë vitit 2006 dhe sidomos në tremujorin e tretë, janë përqendruar në kryerjen e punimeve për rikonstrukcionin e rrugëve.

Grafik 4. Ndryshimet 12-mujore në shitjet e sektorit të ndërtimit (në përqindje).



Burimi: INSTAT.

	2001	2002	2003	2004	2005	9MI-06
Ndërtime inxhinierike-të reja	2.0	1.9	2.8	3.9	3.1	1.4
Ndërtesa - të reja	22.8	45.8	68.0	30.7	57.8	38.1
Ndërtime të reja gjithsej	24.8	47.8	71.0	34.6	60.8	39.5
Ndërtime inxhinierike-rikonstrukcion	1.1	1.3	0.4	1.7	30.9	14.7
Ndërtesa - rikonstrukcion	0.4	0.2	0.4	0.3	6.3	0.6
Ndërtime në rikonstrukcion gjithsej	1.5	1.5	0.8	2.0	37.3	15.3

Burimi: INSTAT.

Tabelë 3. Ndërtimet e reja dhe në rikonstrukcion (në miliardë lekë).

Boks 1. Opinionet mbi çmimet e banesave në Tiranë.

Në ditët e sotme, është pranuar ndikimi negativ që ka një efekt tullumbace i çmimeve të pasurive të patundshme në rritjen ekonomike. Rritja e shpejtë e çmimeve të banesave, e pajustificuar nga faktorët bazë ekonomike, mund të çojë në investime të papërshtatshme, që do të ulin eficiencën e ekonomisë. Çmimi i banesave, sikurse çmimi i çdo aseti, ndikon ndjeshëm prodhimin dhe inflacionin në një ekonomi, sepse kur çmimet e banesave rriten, vihet re se dhe pritshmëritë për ecurinë në të ardhmen e tyre, janë pozitive. Një fakt i tillë do të nxisë rritjen e kërkesës. Po kështu, një çmim më i lartë i banesave, rrit pasurinë e individëve, duke nxitur rritjen e konsumit dhe për rrjedhim, kërkesën agregate.

Në Shqipëri, kohët e fundit gjithmonë e më tepër po diskutohet mbi rritjen e ndjeshme të çmimeve të apartamenteve. Për të studiuar më nga afër zhvillimet në tregun e pasurive të patundshme dhe sidomos, duke marrë parasysh mungesën e statistikave zyrtare për këtë ecuri, Banka e Shqipërisë zhvilloi në muajt qershor-korrik 2006, vrojtimin për ecurinë e çmimeve në tregun e banesave në Tiranë. Në këtë vrojtim morën pjesë 16 agjenci të pasurive të patundshme, 12 firma ndërtimi dhe 17 banka tregtare. Nga përpunimi i rezultateve të këtij vrojtimi dolën në mënyrë të përmblodhur përfundimet e mëposhtme:

Në tregun e pasurive të patundshme, vlerësohet se apartamentet e banimit përbëjnë 68 për qind të sipërfaqeve të ndërtuara, kurse pjesa tjetër janë ambiente biznesi. Struktura e ambienteve të ndërtuara, gjykohet se ka ndryshuar në kohë drejt preferencës për ndërtimin e ambienteve të biznesit. Megjithatë, sikurse pranohet nga pjesa më e madhe e aktorëve të tregut, numri i shitblerjeve të apartamenteve ka ardhur në rritje, gjatë vitit 2006. Ndërsa e kundërta ka ndodhur me ambientet e biznesit. Pjesa më e madhe e të intervistuarve shprehën se ka rënie të shitblerjeve të këtyre ambienteve, si pasojë e reduktimit të kërkesës për to, gjatë të njëjtës periudhë. Si faktori kryesor që ka shkaktuar rritjen e çmimeve nga ana e ofertës, është zvogëlimi i numrit të lejeve të ndërtimit. Ndërkohë, reduktimi i sipërfaqeve të ndërtueshme dhe çmimi i truallit, janë cilësuar të një rëndësie mbi nivelin mesatar që ka ndikuar nga ana e ofertës, rritjen e çmimeve. Faktorë që cilësohen si më të rëndësishëm në nxitjen e kërkesës për apartamente banimi janë: kërkesa në rritje për strehim e shtyrë dhe nga lëvizjet demografike, rritja e preferencës për të investuar në periudha afatgjata si dhe rritja e të ardhurave të individëve (në veçanti e emigrantëve). Po kështu dhe ndryshimi i traditës dhe kulturës të shoqërisë shqiptare, me tendencë jetese drejt familjeve të vogla, vlerësohet nga disa prej agjencive si një faktor i rëndësishëm.

Nga opinionet e mbledhura për ecurinë e çmimeve në zona të ndryshme të Tiranës, vihet re një luhatshmëri e ndjeshme nga njëra zonë në tjetrën. Një fakt i tillë mund të vijë si rezultat jo vetëm i shumëllojshmërisë së apartamenteve me karakteristika specifike, që ndodhen në zonat e ndryshme por dhe si pasojë e kërkesës së lartë. Nga përpunimi i opinionëve vihet re se ndryshimi i qirave sipas zonave varion në intervale më të ngushta. Oferta e lartë e shtëpive që jepen me qira, duket të krijojë një treg më konkurrencial dhe më pak hapësira për luhatshmërinë e niveleve të qirave.

Ndërkohë, duket se çmimi i apartamentit nuk ndryshon nëse apartamenti blihet për herë të parë apo rishitet (i vjetër). Çmimet e apartamenteve të rishitura, luhaten ndjeshëm nga njëra zonë në tjetrën. Gjithsesi, disa prej të intervistuarve gjykojnë se vlera e lartë për banesat e ndërtuara para vitit 1990, vjen si prej besimit për një cilësi më të kontrolluar të banesave, ashtu edhe për faktin se shumë nga to janë rikonstruktuar, në përshtatje edhe me kërkesat e kohës.

Pjesa më e madhe e transaksioneve aktuale për blerjen e apartamenteve, bazohet në kursime individuale. Po kështu edhe dërgesat e emigrantëve, vlerësohet të kontribuojnë mesatarisht me 30 për qind, në financimin e blerjeve për apartamente. Sipas opinionëve të mbledhura, pjesa më e madhe e transaksioneve për shitje bëhen në euro, mbi 90 për qind të rasteve. Edhe në ato raste kur pagesa bëhet në lekë, shumica e blerjes së apartamentit është e kuotuar në euro. Për mënyrën e pagesës agjencitë theksojnë se pagesat me këste përfaqësojnë rreth 53 për qind të rasteve, ndërkohë që pjesa tjetër kryhet me shumë të plotë.

Aktualisht, një pjesë e konsiderueshme e blerjeve për pasuri të patundshme kryhet me financim nga sistemi bankar. Pjesa më e madhe e aktorëve të tregut, janë të mendimit se financimi me kredi bankare ka njohur rritje, gjatë vitit të fundit. Kredia e dhënë për blerjen e pasurive të patundshme, e akorduar nga sistemi bankar, zakonisht përbën 80 për qind të vlerës së kolateralit. Të gjitha bankat e sistemit përdorin metodën e vlerës së tregut për vlerësimin e kolateralit. Po kështu, bankat aplikojnë për kredinë hipotekare si norma interesi fikse ashtu dhe norma interesi të luhatshme.

- SEKTORI I INDUSTRIJË

Sektori i industrisë është karakterizuar nga zhvillime pozitive gjatë vitit 2006. Shitjet e sektorit të industrisë, duke zënë rreth një të katërtën e shitjeve të përgjithshme të ndërmarrjeve ekonomike, bëjnë që sektori i industrisë të jetë i dyti për nga rëndësia, pas atij të shërbimeve. Pavarësisht një ngadalësimi të vërejtur në tremujorin e dytë të vitit 2006, nëntëmujori i parë u mbyll me një rritje prej 15 për qind. Në rritjen e shitjeve të industrisë në përgjithësi, prej disa vitesh tashmë, një kontribut të rëndësishëm vazhdon të japë nëndega e industrisë përpunuese. Industria përpunuese dhe ajo nxjerrëse kanë regjistruar ritme të ngjashme rritjeje vjetore gjatë vitit 2006, por industria përpunuese vijon të përfaqësojë pjesën më të madhe të industrisë, duke siguruar rreth 70 për qind të shitjeve të përgjithshme të saj. Pësha e vogël e industrisë nxjerrëse, i atribuohet mungesës së investimeve të brendshme dhe të huaja. Industria përpunuese, ka regjistruar norma pozitive në rritje që nga tremujori i parë i vitit 2005. Kjo degë shënoi një rritje të shitjeve prej 19 për qind, në nëntëmujorin e parë të vitit 2006. Rritja e këtij nënsektori është nxitur nga gjallërimi i aktivitetit të metalurgjisë dhe ai i përpunimit të materialeve, sidomos në tremujorin e tretë të vitit. Ecuria e mirë e kësaj industrie është shoqëruar dhe me rritjen e numrit të të punësuarve pranë këtij sektori.

Grafik 5. Ndryshimet 12-mujore në shitjet e nënsektorëve të industrisë nxjerrëse dhe përpunuese.




Burimi: INSTAT.

- PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Energjia elektrike është burimi kryesor i energjisë që shfrytëzohet në vend nga konsumatorët industrialë, ata të sektorit të shërbimeve dhe konsumatorët familjarë. Mungesa e kapaciteteve të reja prodhuese, humbjet e larta teknike, kushtet jo të favorshme të motit dhe parregullsitë në pagesën e energjisë së konsumuar, kanë gjeneruar një sërë problemesh të akumuluar gjatë viteve. Kufizimet në prodhimin e energjisë përballë kërkesës në rritje, kanë çuar në rishfaqjen e krizës energjitike në muajin dhjetor të vitit 2006, duke penguar aktivitetin ekonomik në shumë ndërmarrje.

Struktura e kërkesës dhe e ofertës së energjisë elektrike gjatë vitit 2006, ka qenë e ngjashme me atë të viteve të fundit. Sasia e prodhuar e energjisë gjatë këtij viti ka qenë pothuajse e njëjtë me atë të prodhuar në vitin 2005, ndërkohë që bilanci neto i shkëmbimeve ka qenë 16 për qind më i lartë në krahasim me vitin e kaluar. Prodhimi vendas gjatë vitit 2006, ka siguruar rreth 90 për qind të sasisë së përgjithshme të energjisë elektrike të furnizuar. Pësha e prodhimit të brendshëm në burimet e përgjithshme të energjisë, ka ardhur në rënie që nga viti 2005. Konsumi familjar mesatar gjatë vitit 2006, ka shënuar një rritje modeste me 0.7 për qind, ndërkohë që konsumi jofamiljar është rritur me 2 për qind. Megjithatë, sasia e energjisë së konsumuar nga përdoruesit jofamiljarë edhe gjatë vitit 2006, ka mbetur në nivele të ulëta, duke zënë vetëm 25 për qind të konsumit të përgjithshëm të energjisë.

Viti 2006 nuk ka shënuar zhvillime pozitive në drejtim të pakësimit të humbjeve të energjisë. Raporti i humbjeve ndaj energjisë së furnizuar mbetet akoma mjaft i lartë, në nivelin 40 për qind. Gjatë këtij viti është regjistruar një rritje e humbjeve teknike, ndërkohë që humbjet si rezultat i konsumit të pafaturuar, janë ulur në krahasim me një vit më parë.



• SEKTORI I TRANSPORTIT

Sektori i transportit ka regjistruar ritme të kënaqshme rritjeje në vitet e fundit, duke dhënë një kontribut të konsiderueshëm në zhvillimin e ekonomisë. Pavarësisht nga potenciali i këtij sektori, tregues të ndryshëm japin sinjale kontradiktore për ecurinë e aktivitetit gjatë vitit 2006. Në ndryshim nga vitet paraardhëse, treguesi i shitjeve flet për një ngadalësim të aktivitetit të transportit. Shitjet, gjatë nëntëmujorit të parë të këtij viti, kanë qenë rreth 8 për qind më të ulëta nga ato të realizuara gjatë të njëjtës periudhë të vitit të kaluar, ndërkohë që rënia më e theksuar është vërejtur në tremujorin e dytë. Duke gjykuar nga vëllimi i shitjeve, viti 2006 është më pranë nivelit të aktivitetit të vitit 2004. Tremujori i katërt, duke qenë në përgjithësi një ndër tremujorët më dinamikë të vitit, mund të ndikojë pozitivisht në tablonë e krijuar deri në fund të tremujorit të tretë.

Numri i udhëtarëve të transportuar në mjete ajrore, detare dhe hekurudhore gjatë vitit 2006 është rritur me përkatësisht 15, 6 dhe 15 për qind. Trafiku i transportit detar ka shënuar një rritje të ndjeshme prej 20 për qind në numrin e udhëtarëve të huaj, që kanë vizituar Shqipërinë. Transporti hekurudhor ka regjistruar zhvillime pozitive si në drejtim të transportit të mallrave, ashtu edhe në drejtim të transportit të pasagjerëve. Një sinjal pozitiv për ecurinë e eksporteve vjen nga transporti detar i mallrave. Edhe pse eksportet përbëjnë vetëm 15 për qind të vëllimit të mallrave të transportuar në rrugë detare, rritja e tyre vjetore prej 70 për qind, është një tregues pozitiv për zhvillimin ekonomik të vendit. Në portet kryesore të vendit dhe konkretisht në atë të Durrësit, Vlorës

dhe Sarandës, është regjistruar një rritje e vëllimit të transportit të mallrave më e lartë se 10 për qind.

Mbi 80 për qind e shumës së investimeve në sektorin e transportit gjatë vitit 2006, është siguruar nga buxheti i shtetit. Investimet e përgjithshme gjatë këtij viti, në vlerë absolute kanë shënuar rreth 26 miliardë lekë dhe kanë qenë rreth 2.5 herë më të larta se sa në vitin 2005. Ato janë përqendruar kryesisht në tremujorin e katërt, i cili ka tërhequr rreth 60 për qind të investimeve të të gjithë vitit.

II.3 ZHVILLIMET NË SEKTORIN FISKAL

Zhvillimet fiskale të vitit 2006 janë karakterizuar nga ecuri më e mirë e të ardhurave buxhetore, orientim më i mirë i shpenzimeve publike drejt nevojave prioritare të ekonomisë si dhe ruajtje e nivelit të parashikuar të huamarrjes. Politika fiskale e kontrolluar, ka dhënë përgjithësisht një ndikim pozitiv në stabilitetin makroekonomik gjatë vitit 2006. Respektimi i kufijve të miratuar në programin buxhetor të vitit 2006, ka ndikuar në kontrollin e stimullit fiskal të ekonomisë, duke ndihmuar në balancimin e kërkesës me ofertën agregate dhe kontrollin e inflacionit. Nga ana tjetër, përqendrimi i shpenzimeve dhe i deficitit fiskal në tremujorin e fundit të vitit, kanë rritur luhatjen e likuiditetit dhe të normave të interesit në tregjet financiare.


Treguesit buxhetorë janë realizuar brenda parametrave të planifikuar. Kështu, të ardhurat dhe shpenzimet në total janë realizuar përkatësisht në masën 98.4 dhe 95.4 për qind të planit vjetor, duke u rritur përkatësisht me 12.6 për qind dhe 11.3 për qind. Tendencë pozitive e rritjes së të ardhurave buxhetore është pasqyruar në rritjen e tyre në 25.2 për qind të PBB-së, kundrejt realizimit në intervalin 21-24 për qind të PBB-së në vitet e mëparshme. Ruajtja e shpenzimeve në nivelet mesatare historike kundrejt rritjes së të ardhurave është shoqëruar me ulje të deficitit buxhetor vjetor.

Tabelë 4. Treguesit fiskalë në përqindje ndaj PBB-së.

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Të ardhurat totale	22.7	22.7	22.7	20.9	22.2	22.4	21.9	24.0	25.2
- Të ardhura tatimore	13.8	13.8	15.8	14.1	15.3	19.5	19.7	22.0	22.8
Shpenzime totale	34.4	34.9	32.1	28.9	28.4	27.0	26.5	27.3	28.3
- Shpenzime kapitale	5.9	7.2	6.8	6.9	5.6	4.2	4.6	4.2	5.3
Deficiti buxhetor	-11.7	-12.3	-9.4	-8.0	-6.2	-4.6	-4.5	-3.3	-3.2
- Financimi i brendshëm	6.0	5.9	5.6	4.7	3.2	3.2	3.7	2.8	2.6
- Financimi i huaj	5.6	6.4	3.8	3.3	3.1	1.3	0.9	0.6	0.6


Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Grafik 7. Ndryshimet 12-mujore në shitjet e sektorit të transportit.




Burimi: INSTAT.

Grafik 8. Investimet në sektorin e transportit në vite sipas burimeve (në miliardë lekë).



Burimi: Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Grafik 9. Ecuria e treguesve kryesorë fiskalë gjatë vitit 2006 (në miliardë lekë)⁹.



Burimi: Ministria e Financave.
Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Në tërësi, ecuria mujore e treguesve fiskalë ka ndjekur tendencat e viteve të mëparshme të realizimit të deficitit buxhetor, duke pësuar një rritje të dukshme, kryesisht në gjysmën e dytë të vitit.

Gjithashtu, ruajtja brenda parametrave të parashikuar e shpenzimeve korente kundrejt rritjes së të ardhurave, ka mundësuar një normë më të lartë të kursimeve publike. Kjo ka bërë të mundur rritjen e financimit të shpenzimeve kapitale me anë të burimeve buxhetore. Kursimet publike rezultuan 2.43 për qind të PBB-së, nga 1.24 për qind në vitin 2005. Paralelisht, stoku i borxhit publik në raport me PBB-në zbriti në 55 për qind të PBB-së, kundrejt 56.9 për qind në vitin 2005.

• TË ARDHURAT BUXHETORE

Të ardhurat totale prej 226.3 miliardë lekësh u realizuan në masën 98.4 për qind të nivelit të planifikuar, duke u rritur me 12.6 për qind në terma vjetorë⁹. Përmirësimi i administrimit të të ardhurave tatimore ka shoqëruar tendencat e përgjithshme të politikës fiskale, të ndjekur në vitet e fundit. Të ardhurat tatimore përbëjnë një burim në rritje të të ardhurave buxhetore dhe element kryesor të ruajtjes së balancës fiskale. Ecuria e këtij treguesi ka qenë pozitive në perspektivën e qëndrueshmërisë fiskale.

Tabelë 5. Rritja vjetore e treguesve kryesorë të të ardhurave buxhetore (në përqindje).

	Mesatare '98-06	2005	T1 06	T2 06	T3 06	T4 06	2006	Përqindje ndaj PBB
Të ardhurat totale	11.7	8.9	14.3	11.6	15.0	10.1	12.6	25.2
-Të ardhura tatimore	12.9	10.8	15.2	13.3	13.8	11.4	11.8	22.8
-Tatimi mbi vlerën e shtuar	23.1	11.0	16.3	17.3	14.4	13.0	15.1	8.3
-Tatimi mbi fitimin	22.1	18.0	24.4	27.7	13.5	0.7	15.7	2.5
-Akcizat	1.7	17.2	34.1	21.1	24.3	20.1	24.2	2.6
-Taksa doganore	48.9	-1.7	18.0	21.7	-4.1	-16.0	2.6	1.6
-Pushteti lokal	46.3	25.0	-13.4	8.0	-7.8	-12.9	-7.5	1.2
-Tatimi mbi biznesin e vogël	17.5	-6.6	-26.7	-35.9	-12.9	-42.8	-30.8	0.3
-Buxheti i pavarur	12.2	8.8	11.5	11.7	15.0	-2.0	8.6	4.4
-Të ardhura jotatimore	-1.6	-11.4	24.8	1.9	-15.1	35.7	12.6	1.8

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Tatimi mbi vlerën e shtuar është i lidhur ngushtë me ecurinë e qarkullimit të mallrave dhe të shërbimeve në ekonomi. Ky tregues, ka peshën më të madhe në grupin e të ardhurave tatimore, me rreth 33 për qind të të ardhurave totale buxhetore të vitit 2006. Gjatë këtij viti, vërehet rënie e sezonalitetit të këtij treguesi, ndërsa të ardhurat nga TVSH janë realizuar në 97.7 për qind të planit vjetor. Rritja vjetore e këtij treguesi shënoi 15.1 për qind, duke rritur peshën e tij ndaj PBB-së me 0.6 pikë përqindjeje kundrejt vitit të mëparshëm.

Tatimi mbi fitimin është gjithashtu, një tregues tjetër i rëndësishëm, i lidhur ngushtë me aktivitetin ekonomik të vendit. Tendanca pozitive e këtij treguesi

u manifestua në rritje vjetore të tij me 15.7 për qind. Tremujori i parë dhe ai i tretë i vitit patën, rritjen më të lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Norma vjetore prej 15.7 për qind është realizuar në kushtet e një norme tatimore më të ulët sesa ajo e vitit 2005. Paralelisht, të ardhurat nga akcizat shënuan rritjen më të lartë të të ardhurave vjetore në grupin e të ardhurave tatimore për vitin 2006. Në kushtet e minimizimit të barrierave doganore, të ardhurat doganore kanë shënuar rritje vjetore prej 2.6 për qind. Ky tregues pëson rritje të ndjeshme në tremujorin e fundit të vitit, në sajë të rritjes së konsumit me rastin e festave të fundvitit.

Ecuria e përgjithshme e treguesve të të ardhurave, është në përputhje me tendencën pozitive të rritjes graduale dhe të qëndrueshme të arkëtimit të totale dhe të përmirësimit të administrimit të të ardhurave tatimore, në funksion të stabilitetit të balancës fiskale dhe makroekonomike.

- SHPENZIMET BUXHETORE

Shpenzimet buxhetore u rritën me 11.3 për qind gjatë vitit 2006, duke u realizuar në masën 95 për qind të nivelit të parashikuar. Niveli total i shpenzimeve ka arritur në 28.3 për qind të PBB-së, nivel ky 1 pikë përqindjeje më i lartë se ai i regjistruar në vitin 2005. Rritja e shpenzimeve buxhetore u ndikua kryesisht nga rritja e shpenzimeve kapitale për investime publike. Shpenzimet kapitale janë rritur në 5.3 për qind të PBB-së, kundrejt nivelit 4.2 për qind në vitin 2005. Suficiti korent i buxhetit ka pësuar rritje në 21.9 miliardë lekë, kundrejt rreth 7 miliardë lekëve në vitin 2005¹⁰. Në perspektivën makroekonomike, rritja e peshës së shpenzimeve për investime publike përbën një zhvillim pozitiv. Megjithatë, përqendrimi i shpenzimeve buxhetore në tremujorin e fundit krijoi probleme për administrimin e tregjeve të parasë dhe për zbatimin e politikës monetare.


Tabelë 6. Rritja vjetore e treguesve kryesorë të shpenzimeve buxhetore (në përqindje).

	Mesatarja 98-06	2005	T1 06	T2 06	T3 06	T4 06	2006	Përqindje ndaj PBB
Totali i shpenzimeve	7.7	2.7	-8.9	-6.0	-3.4	53.0	11.3	28.3
Shpenzime korente	7.3	5.3	-6.0	-0.3	2.0	21.9	5.4	22.7
Personeli	9.1	9.6	-0.2	5.7	4.9	10.7	5.6	6.3
Sigurimet shoqërore	12.9	11.2	5.7	7.6	7.5	8.6	7.4	6.7
Interesat	-3.4	-8.4	-9.0	-5.9	-2.0	2.1	-3.9	2.8
Të brendshme	-4.3	-9.5	-10.2	-6.9	-2.2	0.4	-5.0	2.6
Të huaja	21.1	7.8	20.3	3.2	3.9	14.3	9.9	0.2
Operative mirëmbajtjeje	3.7	2.1	-30.7	-15.4	-16.6	21.2	-6.9	2.5
Buxheti lokal	6.4	25.9	48.5	115.7	13.3	42.4	13.4	2.5
Shpenzimet kapitale	10.7	-9.6	-33.7	-39.0	-31.4	171.4	36.3	5.3
Financim i brendshëm	19.8	-12.0	5.3	-42.6	-22.4	173.1	45.7	3.9
Financim i huaj	0.0	-3.7	-58.8	-27.4	-57.8	166.7	14.8	1.3

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Struktura e destinacionit të shpenzimeve korente është në linjë me prirjen e përgjithshme të ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale. Shpenzimet për "personelin" për vitin 2006, ruajtën ritmet e qëndrueshme kundrejt rritjes së ekonomisë. Në terma të PBB-së, pesha e shpenzimeve për personelin ruajti

nivelin e vërejtur në vitin 2005, prej rreth 6.3 për qind. Paralelisht, shpenzimet për “sigurime sociale dhe transferime të tjera” ruajnë të njëjtën peshë ndaj PBB-së, prej 6.7 për qind kundrejt vitit 2005. Shpenzimet për këta dy zëra, përbëjnë peshën kryesore të shpenzimeve korente të buxhetit me rreth 57 për qind. Në terma të shpenzimeve totale ato përbëjnë rreth 45.8 për qind, kundrejt 18.6 për qind të shpenzimeve kapitale.



Tabloja fiskale në kahun e shpenzimeve për interesa, paraqet një zhvillim pozitiv për stabilitetin afatgjatë të llogarisë fiskale. Barra fiskale e shpenzimeve në funksion të shërbimit të borxhit publik, po ndjek tendencën rënëse. Pagesat për interesat e borxhit publik kanë pësuar rënie në 2.8 për qind të PBB-së, kundrejt 3.1 për qind në vitin 2005. Kjo rënie e barrës fiskale të shërbimit të borxhit, i detyrohet pjesërisht zgjatjes së afatit të shërbimit të borxhit nga 195 ditë në vitin 2005, në 235 ditë në fund të vitit 2006. Emetimi i letrave me vlerë me afat të gjatë, mundëson norma të qëndrueshme interesi për refinancimin e borxhit të brendshëm publik. Zhvendosja drejt emetimit të bonove afatgjata bëri të mundur uljen e kostos së shërbimit të borxhit publik, me 0.4 pikë përqindjeje kundrejt PBB-së, gjatë vitit 2006. Në terma nominalë, shpenzimet për interesa shënuan rënie prej 1 miliard lekësh ose 3.9 për qind, kundrejt nivelit të vitit 2005.


Megjithëse shpenzimet për interesa dhe deficitit buxhetor kanë ruajtur tendencën rënëse, investimet publike kanë ruajtur prirjen rritëse gjatë këtij viti. Shpenzimet kapitale pësuan rritje në 47.5 miliardë lekë ose 36.3 për qind, kundrejt nivelit prej 34.9 miliardë lekësh, në vitin 2005. Pësua e tyre ndaj shpenzimeve gjithsej është rritur në 18.6 për qind. Për vitin 2006, shpenzimet kapitale përbëjnë 5.3 për qind të PBB-së ose 1.2 pikë përqindjeje më tepër se në vitin 2005. Financimi i shpenzimeve kapitale është realizuar nëpërmjet mjeteve të brendshme në masën 75 për qind, ndërsa rreth ¼ është financuar nëpërmjet burimeve të jashtme. Në periudhën afatgjatë, tendenca e rritjes së

peshës së shpenzimeve kapitale të buxhetit fiskal, tenton të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik.

- DEFICITI BUXHETOR

Deficiti buxhetor prej rreth 28.5 miliardë lekësh në vitin 2006 është në konsistencë me kuadrin e përgjithshëm makroekonomik. Niveli aktual i deficitit buxhetor përbën një peshë më të ulët ndaj PBB-së kundrejt mesatares historike dhe kontribuon pozitivisht në uljen e peshës së shpenzimeve të interesave, për shërbimin e borxhit publik. Ndërsa, në terma nominalë deficiti buxhetor ka pësuar rritje vjetore prej 0.6 miliardë lekësh, në terma të PBB-së deficiti buxhetor ka ruajtur të njëjtën peshë, prej rreth 3.2 - 3.3 për qind. Rritja e deficitit buxhetor me ritëm më të ulët se rritja ekonomike, kontribuon në uljen e treguesit të borxhit publik ndaj PBB-së dhe të kostos së shërbimit të tij.

Grafik 11. Shpenzimet e interesave të borxhit të brendshëm dhe të huaj (në përqindje ndaj PBB).



Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Financimi i deficitit është realizuar kryesisht nëpërmjet huamarrjes së brendshme, me rreth 20.7 miliardë lekë. Burimet e huaja të financimit të deficitit përbëjnë vetëm 5.4 miliardë lekë, ndërsa të ardhurat nga privatizimi kanë financuar rreth 2.0 miliardë lekë¹¹.

Tabelë 7. Rritja vjetore e treguesve kryesorë të deficitit buxhetor (në përqindje).

	2002	2003	2004	2005	2006	Mesatare 1998-06	Përqindje ndaj PBB në 2006
Deficiti	-13.7	-19.3	12.4	-27.0	2.3	-5.1	-3.2
Financimi i brendshëm	-25.5	11.8	29.0	-24.6	-1.0	0.6	2.6
Financimi i huaj	3.4	-51.6	-27.2	-37.3	19.0	-12.2	0.6

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

II.4 TREGU I PUNËS

Përmirësimi i treguesve të punësimit është një nga përparësitë kryesore për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së një vendi. Megjithatë, zhvillimet në tregun e punës gjatë viteve të fundit paraqiten të ngadalta, sidomos në krahasim me rritjen e konsiderueshme ekonomike. Duke përjashtuar pasaktësitë e krijuara nga statistikat, ende të pazhvilluara të punësimit, kjo veçori tregon për problemet strukturore të tregut të punësimit dhe shkallën e ulët të lëvizjes rajonale apo ndërmjet sektorëve ekonomikë, të forcës punëtore. Gjatë katër viteve të fundit, vetëm rreth 50 për qind e popullsisë së aftë për punë ka qenë e punësuar. Ndërkohë, mbeten të theksuara dallimet në shpërndarjen e forcës së punës, midis rajoneve të vendit.

Edhe gjatë vitit 2006, rënia në numrin e të papunëve nuk është përputhur me rritjen e numrit të të punësuarve, duke sugjeruar se një pjesë e ofertës për punë është plotësuar jashtë tregut formal të saj. Migrimi i krahut të punës si brenda edhe jashtë vendit, dhe prania e ekonomisë joformale, kanë


vështirësuar monitorimin e ecures së tregut të punës. Këto dukuri, duket se kanë penguar vlerësimin e saktë të numrit të të punësuarve në sektorin privat bujqësor, i cili për shumë tremujorë rradhazi, ka regjistruar një numër të pandryshuar të të punësuarve. Sipas statistikave zyrtare, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2006, forca e aftë për punë ishte rreth 1.084 milionë vetë, ndërkohë që shkalla e papunësisë është vlerësuar rreth 13.8 për qind ose 0.4 pikë përqindjeje më e ulët sesa në fund të vitit 2005.

Tabelë 8. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë).

	2005				2006		
	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV	Tr.I	Tr.II	Tr.III
Forca e punës gjithsej (në mijë)	1087	1086	1086	1086	1082.8	1081.3	1084.1
A. Të punësuar gjithsej (në mijë)	931	931	931.2	932	931	931.3	934.4
i) në sektorin shtetëror	176	175.6	175.6	175	174	172.1	170.5
ii) në sektorin privat jobujqësor	213	213.4	214	215	215	217.1	221.9
iii) në sektorin privat bujqësor	542	542	542	542	542	542	542
B. Papunësia (në mijë)							
i) të papunë gjithsej	156	155	154.8	154	152	150.1	149.7
C. Shkalla e papunësisë (në %)	14.3	14.3	14.2	14.2	14	13.9	13.8

Burimi: INSTAT, Konjuktura.

Gjatë vitit të kaluar, në vijim të një periudhë trevjeçare rritjeje, punësimi u rrit me 0.3 për qind, duke regjistruar rreth 934 mijë të punësuar. Prej këtyre, 58 për qind janë të vetëpunësuar në sektorin bujqësor, 18 për qind të punësuar në sektorin shtetëror dhe 24 për qind në sektorët e tjerë privatë të ekonomisë. Kjo shpërndarje, tregon për rolin dominues që zë sektori i bujqësisë në punësim.



Sipas INSTAT-it, për sa i përket ndarjes sipas sektorëve privatë të ekonomisë, punësimi u rrit kryesisht në sektorët e tregtisë, të industrisë përpunuese dhe të ndërtimit, të cilët kanë qenë dhe sektorët kryesorë që kanë drejtuar rritjen ekonomike. Forca e punës në sektorin shtetëror ka rënë me rreth 5 mijë vetë, ndërkohë që sektori privat jobujqësor ka regjistruar një rritje të numrit të të punësuarve, prej rreth 8 mijë vetësh.

Një nga treguesit socialë më të rëndësishëm për një vend - raporti i numrit të të papunëve afatgjatë ndaj numri të të papunëve gjithsej - shënoi 66 për qind në fund të vitit 2006. Ky raport është pak a shumë në të njëjtin nivel me atë të vitit të kaluar.

II.5 ZHVILLIMET NË INFLACION DHE POLITIKA MONETARE

Inflacioni i çmimeve të mallrave të konsumit gjatë vitit 2006 është luhatur në pjesën më të madhe midis kufijve të intervalit 2 - 3 për qind, duke qenë

afër objektivit prej 3 për qind të Bankës së Shqipërisë dhe brenda intervalit të tolerancës së saj. Viti u mbyll me një normë vjetore të inflacionit prej 2.5 për qind. Kjo vlerë ishte pranë inflacionit mesatar vjetor prej 2.4 për qind, duke qenë e njëjtë me atë të vitit 2005. Presionet inflacioniste kanë ardhur në rritje, gjatë vitit 2006. Norma mesatare e inflacionit vjetor u ngjiti në 2.7 për qind gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit, nga 2.0 për qind që ishte në gjysmën e parë të vitit.

Në përgjithësi, stabiliteti i inflacionit mesatar vjetor gjatë viteve të fundit flet për qëndrueshmëri të normës së inflacionit, pavarësisht nga luhatjet në kohë dhe në madhësi, të faktorëve që kanë kushtëzuar ecurinë e çmimeve të konsumit. Zhvillimet në anën e kërkesës dhe të ofertës së ekonomisë kanë qenë të balancuara, duke mos krijuar premisa për presione inflacioniste. Politika fiskale ka respektuar treguesit e programuar në nivel vjetor, duke stabilizuar ndikimin e komponentit të sektorit publik në kërkesën agregate. Po kështu, politika monetare ka kontrolluar kushtet e likuiditetit, zhvillimin e normave të interesit dhe të kursit të këmbimit, duke monitoruar nëpërmjet tyre stimujt financiarë të aktivitetit ekonomik. Nga ana tjetër, nivelet e ulta të inflacionit gjatë viteve të fundit, janë reflektuar në ankorimin e pritjeve inflacioniste të ekonomisë. Ky faktor i fundit, mund të ketë kontribuar në frenimin e efekteve të raundit të dytë, që mund të shkaktonin në ekonomi disa nga goditjet e ofertës, me të cilat u përball ekonomia shqiptare, si çmimet e larta të naftës dhe rritjet e çmimeve të administruara.

	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3	1.4
Shkurt	1.5	7.7	1.1	4.4	1.8	1.3
Mars	2.9	7.6	1.3	4.0	1.6	1.5
Prill	3.0	6.6	2.3	3.2	1.3	2.4
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0	3.1
Qershor	4.0	3.8	2.6	2.9	2.9	2.4
Korrik	5.6	4.3	3.0	3.1	1.8	3.2
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	2.3	2.9
Shtator	3.5	5.4	2.8	2.0	3.1	2.6
Tetor	1.8	6.1	2.9	2.0	3.3	2.2
Nëntor	2.8	4.1	3.4	2.2	3.0	2.9
Dhjetor	3.5	2.1	3.3	2.2	2.0	2.5
Inflacioni mesatar	3.1	5.4	2.2	3.0	2.4	2.4


Burimi: IÇK, INSTAT, 2006.

Tabelë 9. Norma vjetore e inflacionit.

Muajt e parë të vitit 2006 regjistruan norma të ulëta inflacioni vjetor, të cilat u luhatën edhe nën kufirin e poshtëm të zonës së tolerancës. Rënia në ritmin e rritjes vjetore të çmimeve u shkaktua kryesisht si pasojë e shuarjes së efektit të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, në muajin janar të vitit 2005. Për pasojë, në fund të tremujorit të parë, inflacioni i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” shënoi vlerën më të ulët që nga viti 2003, duke tërhequr normën e përgjithshme të inflacionit drejt niveleve të ulëta. Gjatë kësaj periudhe, faktorët e kërkesës kanë ndikuar pozitivisht në ecurinë e inflacionit, ndërkohë që prania e faktorëve *shock* në ekonomi, ka qenë pothuajse e pandjeshme.

Gjatë periudhës prill – gusht të vitit 2006, inflacioni vjetor shënoi vlera në rritje. Shkaku kryesor i prirjes së çmimeve drejt një niveli më të lartë, ishte veprimi i vonuar i faktorëve sezonalë, nën ndikimin e kushteve jo të favorshme të motit. Ky fenomen, çoi në tkurrjen e ofertës të prodhimit të brendshëm bujqësor në tregun vendas. Në të njëjtën kohë, zhvillimet në kursin e këmbimit të lekut ndaj euros, prirja rritëse në çmimet e importit si pasojë e rritjes së inflacionit në vendet partnere dhe rritja e çmimeve të naftës në nivele tepër të larta, përforcuan presionet inflacioniste nga kahu i ofertës.


Periodha shtator – dhjetor u karakterizua nga zhvillime më të qeta në ecurinë e çmimeve të konsumit. Kushtet klimaterike, jo tipike për periudhën, favorizuan prodhimin e brendshëm bujqësor. Në të njëjtën kohë, kontrolli monetar dhe fiskal i presioneve të kërkesës dhe rënia e ndjeshme e çmimeve të naftës, bënë të mundur që norma e inflacionit gjatë kësaj periudhe, të jetë poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë, por brenda kufijve të zonës së tolerancës.



II.5.1 ECURIA E INFLACIONIT DHE E GRUPEVE PËRBËRËSE

Gjatë vitit 2006, kontributi i grupeve kryesore në normën vjetore të inflacionit paraqiti një strukturë të ndryshme në krahasim me një vit më parë. Disa nga faktorët që kanë përcaktuar këtë ndryshim ishin: panorama e ndryshme sezonale e prodhimit të brendshëm bujqësor, rritja e çmimit të energjisë elektrike në muajin gusht, ecuria e çmimit të naftës si edhe rritja në çmimet e disa mallrave të akcizës.

Norma e inflacionit e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” ka qenë vendimtare në përcaktimin e normën së përgjithshme të inflacionit në gjysmën e dytë të vitit, për shkak të rritjes së çmimit të energjisë në muajin gusht, me 13.7 përqind. Kontributi mesatar i këtij grupi në normën vjetore të inflacionit, pas muajit gusht, u rrit deri në 2.0 pikë përqindjeje, nga 0.9 pikë përqindjeje në gjashtëmuajorin e parë. Rritja modeste e çmimeve të energjisë, në tetë muajt e parë të vitit, ishte rezultat i shuarjes së efektit të rritjes së çmimit të energjisë një vit më parë. Çmimet e përbërësve të tjerë të grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” nuk kanë shënuar luhatje të theksuara nga mesatarja vjetore, me përjashtim të periudhave të veçanta si ajo e fillimit të vitit të ri akademik. Në muajt shtator-tetor, rritja e kërkesës për shtëpi nga ana e studentëve ka shkaktuar rritjen e përkohshme të qirave të banimit.



Tabelë 10. Norma vjetore e inflacionit total dhe e grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" si dhe kontributi i tij dhe i nëngrupeve në inflacionin total.

	Mars	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Inflacioni total vjetor (në %)	1.5	2.5	3.2	2.9	2.6	2.3	2.9	2.5
Inflacioni i grupit (në %)	3.2	3.9	3.2	6.5	8.5	8.0	7.0	7.0
Kontributi në inflacionin total (në pikë përqindjeje)								
Qira, ujë, lëndë djegëse, energji	0.9	1.0	0.9	1.8	2.3	2.2	1.9	1.9
Qira	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
Renta e imputuar	0.7	0.9	0.8	0.8	1.2	1.1	0.9	0.9
Lëndë djegëse, energji	0.0	0.0	0.0	0.9	0.9	0.9	0.9	0.9

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT, 2006.

Inflacioni vjetor i grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" ka shfaqur ecuri të ndryshme gjatë vitit 2006, krahasuar me dy vitet e mëparshme. Kontributi mesatar i inflacionit të këtij grupi në inflacionin e përgjithshëm, në vitin 2006 ka qenë 0.4 për qind, ndërkohë që në dy vitet e kaluara ai ka qenë respektivisht 0.0 dhe -0.2 për qind. Fakti që ky grup ka peshën më të madhe në shportën e indeksit të çmimeve të konsumit, ka bërë që ecuria e çmimeve të këtij grupi të përcaktojë më pas dhe ecurinë e çmimeve në përgjithësi. Në mënyrë të veçantë gjatë periudhës maj- korrik, ky grup ushtroi presion në kahun rritës tek inflacioni, duke përcaktuar mesatarisht 50 për qind të vlerës së përgjithshme të inflacionit. Në përgjithësi, çmimet e këtij grupi, gjatë pjesës më të madhe të vitit reflektojnë çmimet e mallrave të importit, duke qenë se një pjesë e mirë e ofertës në treg plotësohet nëpërmjet tregtisë së jashtme. Përfundimisht nën periudhën prill-shtator, kur hyrja e prodhimit vendas rrit ofertën e përgjithshme dhe bën që kërkesa e konsumatorit të përballohet më mirë. Kushtet klimaterike të këtij viti, krijuan luhata të mëdha në ofertën e mallrave ushqimorë. Gjatë këtij viti, u vu re një shmangie nga korniza sezonale e prodhimit të brendshëm bujqësor. Deri në muajin shtator, kushtet jo të mira klimaterike patën ndikim negativ mbi ofertën, duke nxitur hyrjen në tregun vendas të mallrave të importit me çmime të larta. Në kushtet kur në tregjet evropiane, çmimet e këtyre mallrave shfaqën tendenca rritëse, sjellja e favorshme e kursit të këmbimit të lekut ndaj euros, arriti të zbuste disi efektin e rritjes së çmimeve të huaja mbi çmimet vendase.

Gjatë tremujorit të fundit të vitit, situata e çmimeve u paraqit e favorshme, pasi faktorët e lartpërmendur ndërruan kahun e veprimit. Kushtet e favorshme klimaterike, inflacioni i ulët në vendet kryesore partnere, forcimi i përpjekjeve për parandalimin e spekulimeve, kryesisht në fushën e doganave dhe tatimeve në periudhën e fundvitit, bënë që çmimet e mallrave ushqimorë të rriten në masë të moderuar.


	Inflacioni vjetor'05	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor'06	Kontributi (pp)	Itali ¹² Inflacioni vjetor'06	Greqi ¹³ Inflacioni vjetor'06	Eurozona ¹⁴ (12 vende)
T1	-1.2	-0.5	-0.1	0.0	1.6	2.4	1.0
T2	-0.5	-0.2	2.7	1.1	1.8	3.0	1.1
T3	0.0	0.0	1.6	0.6	2.9	4.6	2.2
T4	0.0	0.0	-0.1	0.0	2.9	3.8	2.8

Burimi: Banka e Shqipërisë; Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar Statistikor të Greqisë; ISTAT-Itali.

Tabelë 11. Inflacioni vjetor i grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" në vend dhe jashtë, dhe kontributi i inflacionit të këtij grupi në inflacionin total (vlera mesatare sipas tremujorëve).

Gjatë vitit 2006, inflacioni u kushtëzua në një masë të madhe nga vendimet për rritjen e disa çmimeve të administruara dhe të akcizës. Krahas çmimit të energjisë elektrike, rritje u regjistrua në çmimin e grupit “Shërbim arsimor”. Kjo rritje u materializua në një normë vjetore të inflacionit të këtij grupi, prej rreth 8 për qind, në muajin tetor. Gjatë vitit 2006 u shënuar rritje në çmimet e disa mallrave që janë subjekt i taksës së akcizës dhe që përfshihen në grupin “Pije alkoolike dhe duhan”. Duke filluar nga muaji gusht, ky grup ndikoi në mënyrë të ndjeshme në rritjen e normës së inflacionit vjetor.

Çmimet e grupit “Transport” u ndikuan nga lëvizjet në çmimin e naftës në tregun e jashtëm dhe atë vendas. Periudha e rritjes së çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare u reflektua dhe në tregun vendas, deri në muajin shtator. Më pas, çmimet filluan të bien, të ndihmuara dhe nga mbiçmimi më i theksuar i lekut kundrejt dollarit amerikan. Peshë e vogël e grupit “Transport” në shportën e konsumit në përgjithësi, bën që efekti i drejtpërdrejtë i rritjes së çmimit të naftës që përdoret për transport personal, të jetë pothuajse i pandjeshëm. Megjithatë, lëvizjet në çmimin e naftës, sidomos në kahun rritës, janë konsideruar si burime të presioneve inflacioniste, kryesisht për shkak të efekteve të raundit të dytë të rritjes së çmimit të naftës.



Kontributet e grupeve të tjera nuk kanë pësuar luhatje të theksuara si në madhësi, ashtu edhe në kahun me të cilin kanë ndikuar normën vjetore të inflacionit. Kontributet e tyre kanë qenë të ulëta dhe kanë tentuar të

kompensojnë njëri-tjetrin. Kështu, inflacioni i ulët pozitiv i grupit “Hotele, restorante e kafene” është balancuar nga deflacioni i grupeve “Veshje dhe këpucë” dhe “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje”.

II.5.2 AMBIENTI MAKROEKONOMIK DHE ÇMIMET E KONSUMIT


Gjatë vitit 2006 çmimet e konsumit regjistruan për të dytin vit rradhazi një normë mesatare vjetore rritjeje, prej rreth 2.4 për qind. Ecuria e inflacionit gjatë viteve të fundit, ka qenë në linjë me parashikimet e programit makroekonomik të vendit, duke mbështetur dhe krijuar kushte për një rritje të qëndrueshme ekonomike. Edhe pse presionet inflacioniste nuk kanë munguar, sidomos gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006, norma vjetore e inflacionit është luhatur në intervalin e ngushtë 1.3 - 3.2 për qind. Presionet inflacioniste janë shfaqur si nga kahu i ofertës, ashtu edhe nga ai i kërkesës. Politika e matur monetare dhe respektimi i parametrave kryesorë nga ana e politikës fiskale, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në drejtim të kontrollit të këtyre presioneve. Respektimi i objektivave të përcaktuar në programin monetar të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2006, ka gjeneruar një klimë monetare të përshtatshme për vënien nën kontroll, në masën dhe në kohën e duhur, të prirjeve inflacioniste në ekonomi. Në reflektim të sinjaleve shtrënguese të politikës monetare, normat reale të interesit në terma 12-mujorë, reflektuan rritje gjatë muajve të fundit të vitit. Një prirje e tillë, vlerësohet të ketë ndihmuar në mirëadministrimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe në frenimin e zgjerimit monetar, fenomen ky më i theksuar gjatë fundviteve. Pozita relativisht e qëndrueshme e lekut në tregun e këmbimeve valutore, ka favorizuar zbutjen e presioneve inflacioniste kryesisht me origjinë në ambientin e jashtëm. Ndërkohë, ecuria e treguesve kryesorë në fushën e financave publike, ka favorizuar krijimin e hapësirave të përshtatshme për veprimin më efikas të vendimeve të politikës monetare.

- KUSHTET MONETARE DHE VENDIMET E POLITIKËS MONETARE

Vendimet e politikës monetare për normën bazë të interesit në ekonomi, janë ndërmarrë në bazë të analizave të vazhdueshme të zhvillimeve korente dhe të pritshme, të faktorëve të kërkesës dhe të ofertës me origjinë në ambientin e brendshëm dhe të jashtëm. Në kushtet e një inflacioni në rritje dhe në praninë e një numri faktorësh, që pritej të favorizonin rritjen e mëtejshme të çmimeve, Banka e Shqipërisë vendosi për një ndryshim të kahut të politikës monetare, në fillim të tremujorit të tretë të vitit 2006. Ky ndryshim erdhi pas një periudhe neutraliteti, që zgjati rreth 1.5 vjet. Ndryshimi i kahut të politikës monetare, u materializua në dy rritje të normës bazë të interesit, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2006. Në muajt korrik dhe nëntor 2006, norma e repove njëjavore u rrit përkatësisht me nga 0.25 pikë përqindjeje, duke stimuluar krijimin e një ambienti më likuid në tregun bankar. Maturia në vendimmarrjen e politikës monetare, gjeti shprehje në distancimin në kohë të dy lëvizjeve shtrënguese në normat e interesit. Në periudhën kohore korrik – nëntor 2006, janë bërë vlerësime të vazhdueshme mbi masën e reagimit dhe ndjeshmërinë e tregut bankar ndaj qëndrimit të politikës monetare mbi normat e interesit. Rritja totale e këtyre të fundit me 0.5 pikë përqindjeje, vlerësohet të ketë normalizuar ritmet e rritjes vjetore të ofertës së parasë, duke iu

përgjigjur në mënyrë më të plotë kërkesës nga ana e sektorit publik e atij privat, për mjete monetare. Megjithë rritjen sezonale të ofertës së parasë në fund të vitit me rreth 17 për qind, raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare vijoi të ruajë nivele të ulëta historike. Ky raport ishte 24.2 për qind, duke qenë 1.7 pikë përqindjeje më i ulët sesa ai i të njëjtës përdhë të një viti më parë. Rënia e këtij raporti tregon se Banka e Shqipërisë dhe sistemi bankar kanë qenë më aktivë se një vit më parë, në thithjen e parasë drejt kanaleve formale. Ky zhvillim është reflektuar edhe në ritmet e larta të rritjes së kreditimit, nën veprimin e kërkesës në rritje të sektorit privat për zgjerim të aktivitetit ekonomik. Banka e Shqipërisë, duke vlerësuar zgjerimin e kreditimit të ekonomisë si një zhvillim të mirëpritur, nuk la jashtë vëmendjes faktin se një fenomen i tillë mund të ndikonte në shtimin e presioneve inflacioniste, me kah nga kërkesa e brendshme. Përballë kërkesës së rritur të sektorit privat, kërkesa nga ana e sektorit publik rezultoi në nivele më të ulëta se në vitet e kaluara, kur ajo dominonte ritmet e zgjerimit monetar. Nga ana tjetër, administrimi i mirë i nevojave për likuiditet ka bërë që luhatshmëria e normave të interesit të jetë në nivele të ulëta, gjë që ka siguruar një qëndrueshmëri të kënaqshme në tregun e parasë.

Shtrengimi i kushteve monetare gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006 është kanalizuar drejt plotësimit të kërkesës për likuiditet së tregut, ruajtjes së niveleve të ulëta të parasë jashtë bankave dhe disiplinimit relativ të ritmeve rritëse të kërkesës së brendshme për mjete monetare. Veprimet e politikës monetare kanë ndihmuar në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve për një periudhë afatmesme.




- POLITIKA FISKALE

Politika fiskale përbën një prej aspekteve përcaktuese në përmbushjen e objektivave të programit makroekonomik të vendit. Shkalla e suksesit dhe eficiencës së saj, garanton në një masë të madhe rezultatet e politikës monetare të ndërmarrë nga banka qendrore, që si objektiv parësor ka ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Në të njëjtën kohë, sigurimi i stabilitetit të çmimeve, të shprehur në vlera të ulëta të inflacionit vjetor, përbën një kusht të rëndësishëm për sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme në terma afatgjatë. Në këtë marrëdhënie shumëpërmasore, Banka e Shqipërisë vlerëson se gjatë vitit 2006, politika fiskale ka mbështetur kënaqshëm zhvillimet në inflacion.

Treguesit fiskalë u realizuan brenda kufijve të programit buxhetor, duke mos krijuar premisa për rritjen e presioneve inflacioniste në ekonomi. Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2006, u konstatua fenomeni i njohur i përqendrimit të shpenzimeve buxhetore, madje në nivele më të larta se në vitet e kaluara. Ky përqendrim shkaktoi presione afatshkurtra mbi çmimet, megjithëse presionet afatgjata të tij mbeten të kufizuara në ndikimin që jep ai në tregun monetar dhe në pritjet e ekonomisë për inflacionin. Banka e Shqipërisë gjykon se të dy këta tregues mbetën të paprekur.

Realizimi i deficitit buxhetor në fund të vitit, i vlerësuar me rreth 3.2 për qind të PBB-së apo 0.7 pikë përqindjeje më i ulët se ai i një viti më parë, është shprehje e ndjekjes së një politike të kujdesshme fiskale nga ana e qeverisë. Në arritjen e vlerave më të ulëta historike të financimit të deficitit buxhetor, rol të rëndësishëm ka luajtur niveli i kontrolluar i huamarrjes së brendshme. Në fund të vitit 2006, kërkesa e qeverisë për hua të brendshme ishte rreth 2.6 për qind e PBB-së. Vlerat më të ulëta të këtij treguesi krahasuar me një vit më parë, kanë ndikuar në tkurrjen e presioneve inflacioniste dhe në kontrollin e zgjerimit monetar.

Grafik 17. Prirja e ndryshimeve 12-mujore për shpenzimet buxhetore (në përqindje).



Burimi: Ministria e Financave, shkurt 2007.

- FAKTORË TË KËRKESËS

Kërkesa e brendshme gjatë vitit 2006, ka mbështetur në një masë të konsiderueshme ritmet pozitive të rritjes ekonomike. Ecuria e mirë e kërkesës së brendshme është reflektuar nga një numër treguesish të aktivitetit ekonomik. Kështu, treguesi i shitjeve për nëntëmuajorin e parë të vitit, shënoi një rritje vjetore prej 12.4 për qind. Rritja e importeve me 16 për qind dhe e eksporteve me 17 për qind, flasin për një aktivitet intensiv të tregtisë së jashtme. Rritja e importeve ka ardhur si pasojë e rritjes së importeve të mallrave të konsumit dhe të atyre, që përdoren për investime, me përkatësisht 32 dhe 11 për qind. Kërkesa e brendshme ka ardhur në rritje edhe si pasojë e zgjerimit të shpejtë të aktivitetit kreditues, i cili shënoi një rritje prej 57 për qind në terma vjetorë. Ecuria e këtyre treguesve, flet për një ecuri të mirë të konsumit dhe të investimeve në vend. Në mënyrë të veçantë, rritja e importeve të makinerive dhe pajisjeve

dhe rritja e kredive për pasuri të patundshme, janë tregues të zgjerimit të investimeve në vend. Krahas efekteve pozitive të zgjerimit të investimeve në rritjen ekonomike të vendit, rritja e kërkesës së brendshme ushtron presion për rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Në mungesë të ndonjë presioni të dukshëm inflacionist nga ana e kërkesës, mund të vlerësohet se ekonomia shqiptare po shfrytëzon kapacitetet e lira pa rritur kostot dhe rrjedhimisht, çmimet përfundimtare të mallrave dhe shërbimeve.

- FAKTORË TË OFERTËS

Ambienti i jashtëm. Zhvillimet në mjedisin e jashtëm ekonomik gjatë këtij viti, mund të përmbliidhen në ecurinë pozitive të ekonomive të vendeve partnere dhe tendencën në rënie të çmimeve të naftës, kryesisht gjatë gjashtëmuorit të dytë. Këto pririje, të kombinuara me qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit dhe me praninë e faktorëve e brendshëm, kanë krijuar kushte të përshtatshme për ruajtjen e normës së inflacionit brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.


Çmimet e importit. Ekonomia shqiptare është një ekonomi relativisht e hapur dhe, për pasojë, çmimet e importit përbëjnë një element të rëndësishëm të inflacionit në vend. Përgjithësisht, gjatë këtij viti, kushtet ekonomike të partnerëve tregtarë të Shqipërisë kanë qenë të favorshme, duke lehtësuar kontrollimin e presioneve nga ana e ofertës dhe duke mundësuar respektimin e objektivit të inflacionit.

Partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë, Greqia dhe Italia, si edhe vendet e tjera të Eurozonës kanë regjistruar norma të qëndrueshme inflacioni, gjatë këtij viti. Megjithatë, çmimet e grupeve të veçanta si nafta dhe mallrat ushqimorë, kanë shfaqur herë pas here tendenca për rritje, duke ndikuar inflacionin e kategorive përkatëse të mallrave të konsumit në vend. Rënia e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar, u reflektua në zvogëlimin e normës së inflacionit të grupit "Transport", sidomos në tremujorin e fundit të vitit. Rritja e çmimeve të mallrave ushqimorë në tregjet e vendeve partnere, gjatë tremujorit të tretë

të vitit, u përçoll në rritjen e çmimeve të mallrave të kësaj kategorie në vend. Ndikimi i inflacionit të importuar, megjithatë, nuk ka qenë aq i fortë sa të rrezikonte përmbushjen e objektivit për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve të konsumit.

Çmimet e naftës. Çmimet e konsumit gjatë vitit 2006 u ndikuan nga situata e tensionuar në tregun ndërkombëtar për çmimin e naftës. Ndikimi i këtij faktori, përse i përket intensitetit të veprimit në normën e inflacionit, nuk ishte i njëtrajtshëm. Gjatë periudhës janar-shtator, vlerësohet se efekti i rritjes së çmimit të naftës në inflacionin e përgjithshëm në vend, ka qenë mesatarisht 0.2 pikë përqindjeje. Gjatë tremujorit të katërt, si inflacioni i grupit "Transport" ashtu edhe kontributi i tij në normën e përgjithshme të inflacionit, kanë shënuar rënie

Grafik 18. Norma vjetore e ndryshimit të IÇK-së dhe indeksit të çmimeve të importit (në përqindje).



Burimi: IÇK, INSTAT, janar 2007; Banka e Shqipërisë, janar 2007.

të vazhduar. Ndikimi i kursit të këmbimit lek/usd, i cili përkthen çmimin e naftës në tregjet e huaja në çmimin e naftës në vend, gjatë vitit 2006 ka qenë pothuajse i pandjeshëm. Rritja e çmimit të naftës në vend, gjatë vitit 2005 ishte mjaft më e vogël sesa ajo në tregun ndërkombëtar, ndërkohë që në vitin 2006, tregu i brendshëm ka reflektuar me besnikëri ecurinë e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar. Ky zhvillim mund të shpjegohet kryesisht me faktin që mbiçmimi i lekut ndaj dollarit amerikan ka qenë mjaft më i zbutur gjatë kësaj periudhe, në krahasim me vitin paraardhës.

Kursi i këmbimit. Gjatë vitit 2006, zhvillimet në kursin e këmbimit kanë mbështetur dobësimin e presioneve inflacioniste të kahut të ofertës. Monedha vendase është mbiçmuar ndaj dollarit amerikan dhe ka ruajtur të pandryshuar pozitën e saj në lidhje me euron. Tendencat mbiçmuese të lekut, ndonëse të dobësuara në muajt e fundit, kanë bërë që çmimi i importeve në monedhën vendase të bjerë. Në këtë mënyrë, kursi i këmbimit ka ndihmuar në frenimin e efektit të çmimit të lartë të naftës në tregjet botërore dhe në ruajtjen e një norme të ulët inflacioni.



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT, Bloomberg, dhjetor, 2006.

	T1-06*	T2-06*	T3-06*	T4-06*
Greqi ¹⁵	3.2	3.2	3.4	2.9
Itali ¹⁶	2.2	2.2	2.2	1.8
Eurozonë ¹⁷	2.3	2.4	2.1	1.8
Lek/Euro	-2.9	-1.4	0.1	0.7
Lek/Usd	5.7	-1.1	-4.1	-7.0

Burimi: IÇK, INSTAT.

Shënime: (*) Shifrat për tremujorët janë mesatare e treguesve përkatës mujorë.

Tabelë 12. Normat vjetore të inflacionit të Italisë, Greqisë, Eurozonës dhe ndryshimi vjetor i kurseve të këmbimit (në përqindje).

Boks 2. Tendanca e çmimeve në Shqipëri në krahasim me Greqinë dhe Italinë. Çfarë mund të themi për konvergencën? *

Një nga objektivat më të rëndësishëm të ekonomive në tranzicion të Evropës Juglindore, është anëtarësimi në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar Evropian. Hyrja në Bashkimin Monetar dhe adoptimi i euros si monedhë vendase, kërkon arritjen e disa kriterëve ekonomike dhe legjislativë. Kriteret ekonomike janë të njohura si kriteret e konvergencës dhe në mënyrë të përmbledhur përfshijnë: inflacion të ulët, kurs këmbimi të qëndrueshëm, financa publike të shëndetshme dhe norma interesi të ulëta. Përveç këtyre, legjislati i bankës qendrore të secilit vend duhet të plotësojë disa kërkesa. Si një përafrim për integrimin, mendohet që tregjet më të integruara dhe më konkurruese kanë diferencë të vogla në çmime. Në këtë këndvështrim, konvergjenca apo divergjenca e çmimeve përbën një çështje të rëndësishme për t'u

analizuar, duke marrë në konsideratë që e ardhmja e Shqipërisë është hyrja në BE. Për këtë qëllim, në një nga materialet e realizuara nga stafi i bankës gjatë vitit 2006, është shqyrtuar ecuria e çmimeve të konsumit në vendin tonë në krahasim me ato të Italisë e Greqisë, si dy nga partnerët tanë kryesorë dhe vende anëtare të BE-së.*

Për të krahasuar ecurinë e çmimeve midis Shqipërisë nga njëra anë dhe Italisë e Greqisë nga ana tjetër, në mungesë të të dhënave për vlerat absolute të çmimeve, materiali bazohet në seritë e të dhënave të indekseve të çmimeve të konsumit. Në përfundimet e gjetura në këtë material, duhet mbajtur parasysh shkalla e ndryshme e zhvillimit ekonomik midis këtyre vendeve, ndryshimet në përbërjen e indekseve të çmimeve të konsumit, në ndarjet në nëngrupe dhe në peshat e ndryshme të grupeve dhe nëngrupeve, si edhe periudha e shkurtër kohore e serive të përdorura në këtë metodologji.

Krahasim i tendencave të çmimeve, të 12 grupeve të IÇK-së, midis Shqipërisë dhe Italisë e Greqisë, tregoi dy tendenca kryesore:

1. Një tendencë rënëse në nivelin e çmimeve të grupeve "Veshje dhe këpucë", "Pajisje shtëpie", "Argëtim dhe kulturë" dhe "Mallra dhe shërbime të ndryshme", në krahasim me ato të dy vendeve partnere ku tendenca e çmimeve ishte rritëse.
2. Një rritje më të shpejtë në nivelin e çmimeve të grupeve "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji", "Shëndet", "Komunikim" dhe "Arsim", në krahasim me ato të Italisë dhe Greqisë.

Ecuria e çmimeve për rastin e parë mund të shpjegohet nga liberalizimi i tregut, nënshkrimi i Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë me vendet e rajonit, rritja e prodhimit vendas dhe vlerësimi i kursit të këmbimit. Në rastin e dytë, ku çmimet shqiptare rriten më shpejt në krahasim me çmimet në dy vendet e tjera, sjellja mund të shpjegohet nga vetë karakteristikat e këtyre të mirave dhe shërbimeve si dhe me faktin që një pjesë e mirë e çmimeve të tyre, janë të administruara.

Analiza e ecurisë së çmimeve na mundëson të dallojmë nëse seritë e 12 grupeve të indeksit të çmimeve të konsumit, kanë konverguar, janë duke konverguar apo divergojnë në çmime relative apo në norma inflacioni. Në pjesën më të madhe të rasteve, testet çojnë në përfundimin e konvergencës në diferencat e nivelit të çmimeve. Megjithatë, theksojmë që përfundimi më i rëndësishëm është se në të gjitha rastet, testet hedhin poshtë hipotezën e divergjencës në inflacion. Kjo gjetje është me interes, pasi tregon që inflacioni i grupeve të indeksit të çmimeve të konsumit është konsistent me inflacionin e Italisë dhe Greqisë, anëtare të BE-së, dhe mund të pasqyrojë perspektivën afatgjatë të proceseve inflacioniste në vend, në kontekstin e procesit të integritimit evropian.

* Tendenca e çmimeve në Shqipëri në krahasim me Greqinë dhe Italinë. Çfarë mund të themi për konvergencën? - Material studimor.

• AMBIENTI I BRENDSHËM

Prodhimi bujqësor. Prodhimi bujqësor është një ndër faktorët kryesorë të brendshëm, që kushtëzojnë zhvillimet në çmimet e konsumit. Sasia e prodhimeve bujqësore të prodhuara në vend, ndikon në mënyrë të menjëhershme nivelin


e çmimeve të mallrave ushqimorë. Gjatë këtij viti, efekti sezonal i rritjes së prodhimit bujqësor, është shfaqur më me vonesë sesa në vitet e kaluara, duke bërë që rënia e çmimeve të mallrave ushqimorë të regjistrohej vetëm në muajt shtator dhe tetor. Kushtet jo të favorshme atmosferike, sidomos gjatë stinës së pranverës, kanë patur efekt negativ në nivelin e prodhimit bujqësor. Nga ana tjetër, dalja në treg e prodhimeve bujqësore të vendit në periudhën gusht – tetor, arriti të balancojë presionet inflacioniste, të krijuara nga rritja e çmimit të energjisë elektrike, të qirasë dhe akcizave, gjatë muajve gusht dhe shtator.

Çmimet e prodhimit. Gjatë vitit 2006, çmimet e prodhimit vazhduan të ndjekin prirjen rënëse, të vërejtur që prej muajit prill 2005. Pritet që çmimet e prodhimit, si hallka e parë e formimit të kostove, të materializohen në çmimet e konsumit. Një gjë e tillë nuk vërehet në lidhjen midis këtyre dy indekseve. Mospërputhshmëria në kohë dhe në kahun e lëvizjes, mund të shpjegohet si me formën e këtyre indekseve, ashtu edhe me strukturën e ofertës së mallrave në tregun e brendshëm. Përqendrimi i IÇP-së në sektorin prodhues të industrisë, e vështirëson krahasimin e këtyre dy indekseve. Gjithashtu, vlerësohet se pjesa e prodhimit vendas nuk është ende një përbërës përcaktues i ofertës së mallrave në tregun vendas, duke mos ndikuar kështu çmimet e konsumit.

Papunësia dhe pagat. Ecuria e mirë e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2006 u reflektua dhe në treguesit e tregut të punës, dhe kryesisht në nivelin e papunësisë. Mundësi të reja punësimi u krijuan, duke bërë që norma e papunësisë të vazhdojë prirjen rënëse të vërejtur prej më shumë se dy vjetësh. Përmirësime janë vërejtur dhe në drejtim të të ardhurave. Kështu, pagat në sektorin shtetëror, paga minimale dhe pensionet janë rritur sipas programit të buxhetit. Ecuria e deritanishme e inflacionit tregon se ekonomia shqiptare nuk vuan nga mospërputhje të ndjeshme midis rritjes së pagave dhe produktivitetit.

Pritjet inflacioniste. Tendanca e pritjeve të bizneseve dhe të publikut në terma afatshkurtër deri afatmesëm, tregon se këto të fundit janë luhatur pranë prirjeve të faktuara të inflacionit. Sipas vlerësimeve periodike të Bankës së Shqipërisë, pritjet e publikut kanë konverguar në pjesën më të madhe, rreth vlerave 1 - 3 për qind. Ndërkohë, pritjet e biznesit për ecurinë e çmimeve, ndonëse kanë paraqitur një luhatshmëri më të lartë, kanë tentuar të ndjekin tendencat historike. Në ankorimin e pritjeve të publikut të gjerë drejt vlerës së synuar nga Banka e Shqipërisë, një rol të rëndësishëm vlerësohet të ketë luajtur politika monetare. Pritjet e biznesit dhe të konsumatorëve, vlerësohet të jenë kanalizuar në drejtimin e duhur, duke mos shtuar në mënyrë të pakontrolluar presionet inflacioniste në ekonomi.


Grafik 20. Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të prodhimit (në përqindje).



Burimi: INSTAT.

II.6 BILANCI I PAGESAVE

Sektori i jashtëm i ekonomisë, gjatë vitit 2006, paraqitet me një rritje të bilancit negativ të llogarisë korente, shkaktuar nga deficitet e lartë tregtar. Treguesi relativ i deficitit korent ndaj PBB-së, vlerësohet në rreth 7.6 për qind nga 7.3 për qind në vitin 2005. Megjithatë, flukset hyrëse në llogarinë kapitale kanë qenë të mjaftueshme për mbulimin e deficitit korent, duke mundur një bilanc të përgjithshëm pozitiv, në nivelin 207 milionë euro.



Deficiti tregtar ka përbërë një tipar të përhershëm të zhvillimeve të tregtisë së jashtme, duke diktuar nivelet e larta të deficitit të llogarisë korente. Ekonomia shqiptare, si një ekonomi në rritje, karakterizohet nga një kërkesë e lartë për mallra importi, duke mbuluar konsumin në rritje të ekonomisë dhe shtimin e kapaciteteve të reja. Kjo dinamikë ka evidentuar përshejtimin e importeve në vitet e fundit. Megjithatë, rritja e importeve gjatë vitit 2006 është ndikuar si nga faktorë të jashtëm, si rritja e pazakontë e çmimeve të naftës dhe rritja e çmimeve të disa produkteve në tregjet ndërkombëtare, ashtu dhe nga disa faktorë të brendshëm, si situata e përkeqësuar energjitike në vend, e cila çoi në importe të larta në energji elektrike. Për rrjedhojë, treguesi relativ i importeve ndaj PBB-së, për vitin 2006 vlerësohet në rreth 31.7 për qind, nga 29.8 për qind në vitin 2005. Në vitin 2006, Shqipëria regjistroi deficitin tregtar më të lartë në vite, prej 1.7 miliardë eurosh. Importi i mallrave të ndërmjetëm dhe mallrave kapitale, përbën rreth 64 për qind të totalit, ndërkohë që kërkesa e brendshme për mallra konsumi ka mbetur e lartë.

Ngadalësimi i eksporteve, i vërejtur gjatë vitit të kaluar është recuperuar gjatë vitit 2006. Të ardhurat nga eksporti vlerësohen në rreth 8.7 për qind të PBB-së, që përfaqëson nivelin më të lartë, të arritur në vite.

Hyrjet e konsiderueshme në formën e transfertave korente, në vite kanë ndihmuar në zbutjen e deficiteve të larta tregtare, duke çuar në lehtësimin e pozicionit të bilancit të pagesave. Gjatë vitit 2006, fluksi neto i transfertave korente arriti në rreth 979 milionë euro, nga të cilat vlerësohet se mëse 95 për qind janë kontribut i emigracionit shqiptar. Dërgesat e emigrantëve për vitin 2006, vlerësohen në 934 milionë euro ose në rreth 12.8 për qind të PBB-së. Nga ana tjetër, financimi i deficitit korent të këtij viti, ka qenë plotësisht i mundur nëpërmjet flukseve hyrëse të kapitalit të huaj në formën e transfertave kapitale, si dhe flukseve financiare në formën e investime të huaja direkte dhe huamarrjes me jashtë. Këto flukse hyrëse të kapitalit, bënë që bilanci i përgjithshëm i pagesave të mbyllet me suficit prej rreth 210 milionë eurosh nga 125 milionë euro, në vitin 2005. Ky suficit në bilancin e përgjithshëm, ka çuar në rritje të rezervave valutore (të cilat në fund të vitit 2006 u vlerësuan në rreth 1.3 miliardë euro).

Rezervat e mjaftueshme valutore, rritja ekomomike dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik, justifikojnë ekzistencën e deficiteve të larta në një periudhë afatshkurtër. Shërbimi i borxhit të jashtëm vlerësohet në nivele modeste. Për vitin 2006 ai u llogarit në rreth 4.1 për qind të totalit të eksporteve. Megjithatë, qëndrueshmëria e borxhit në periudhën afatgjatë duhet konsideruar me përparësi në formulimin e politikave të zhvillimit. Këto politika, duhet të synojnë gjenerimin e flukseve hyrëse afatgjata, në formën e rritjes së bazës së eksportit, të mbështetjes së industrive që zëvendësojnë importin apo të nxitjes së shfrytëzimit të potencialit turistik të vendit. Gjithashtu, investimet e huaja direkte përbëjnë një burim kyç financimi, duke marrë parasysh natyrën e qëndrueshme të këtyre flukseve dhe faktin se ato kontribuojnë në teknologji dhe aftësi drejtimi. Ndonëse gjatë periudhave të privatizimit Shqipëria ka tërhequr flukse të larta të investimeve të huaja direkte, treguesi relativ i tyre në PBB mbetet i ulët. Për vitin 2006, ky tregues vlerësohet në 3.6 për qind të PBB-së.

	2004	2005	2006	2004	2005	2006
	në milionë euro			në përqindje ndaj PBB-së		
Llogaria korente	(286.2)	(492.1)	(556.4)	(4.8)	(7.3)	(7.6)
Bilanci tregtar	(1276.7)	(1476.7)	(1685.4)	(21.3)	(21.9)	(23.1)
Eksport	485.6	530.2	630.6	8.1	7.9	8.6
Import	(1,762.3)	(2,006.9)	(2,316.0)	(29.4)	(29.8)	(31.7)
Shërbime (neto)	(40.5)	(140.4)	(65.4)	(0.7)	(2.1)	(0.9)
Të ardhura (neto)	140.7	136.1	215.3	2.3	2.0	2.9
Transferta korente (neto)	890.3	988.9	979.0	14.8	14.7	13.4
Llogaria kapitale (neto)	422.9	438.5	557.8	7.0	6.5	7.6
Bilanci i përgjithshëm	233.7	125.1	209.6	3.9	1.9	2.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 13. Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave në raport ndaj PBB-së.

II.6.1 TREGUES TË SEKTORIT TË JASHTËM

Shumë tregues kyç të bilancit të pagesave dëshmojnë për përmirësim gjatë vitit 2006, ndonëse disa dobësi shfaqen në tregues të tjerë. Shkalla e hapjes tregtare¹⁸ të Shqipërisë është përmirësuar në 74 për qind nga 68 për qind në vitin e kaluar, ndonëse mbetet në nivele mjaft të ulëta në raport me ekonominë e rajonit. Duke marrë parasysh lidhjen mes hapjes tregtare dhe rritjes ekonomike, rritja e hapjes tregtare të vendit është një zhvillim i mirëpritur. Megjithatë, një zhvillim i tillë do të ishte më inkurajues nëse do të buronte nga eksportet, përderisa kompanitë me orientim eksporti, të cilat përballohen me konkurrencën e fortë ndërkombëtare, janë shpesh me eficiente. Për fat të keq, këtë vit përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur në masë më të madhe nga rritja e importeve.

Gjatë vitit 2006, eksporti (në mallra dhe shërbime) u rrit me rreth 22 për qind krahasimisht me një vit më parë. Shërbimi i borxhit të jashtëm vlerësohet në nivele modeste, duke arritur në rreth 4.1 për qind të totalit të eksporteve ose shumë poshtë nivelit prej 25 për qind, të konsideruar përgjithësisht si nivel kritik.

Roli i importeve në rritje të treguesit të hapjes tregtare është reflektuar gjithashtu, në raportin e deficitit korent ndaj PBB-së, i cili mund të përdoret si instrument matës i qëndrueshmërisë së deficitit korent. Si pasojë e rritjes

së madhe të importeve, ky raport është përkeqësuar gjatë dy viteve të fundit. Deficiti korent pa transfertat zyrtare, kapi shifrën 8.3 për qind.


Treguesi relativ i investimeve të huaja direkte ndaj PBB-së u vlerësua në 3.6 për qind, me një rritje të lehtë prej rreth 0.3 pikë përqindjeje kundrejt një viti më parë. Ky raport, konsiderohet në nivele të ulta, gjithashtu krahasuar me ekonomitë e rajonit.

Së fundmi, një tregues kritik i sektorit të jashtëm është mjaftueshmëria e rezervave për shembull, raporti i mbulimit të importeve, që mat aftësinë e ekonomisë për të plotësuar nevojat e saj për importe (të mallrave dhe shërbimeve) përmes rezervave të saj. Për vitin 2006, ky raport vlerësohet në 4.5 muaj importe dhe përbën një nivel të kënaqshëm¹⁹.

II.6.2 LLOGARIA KORENTE

Viti 2006 është karakterizuar nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente. Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me 14 për qind krahasuar me vitin 2005, duke shënuar një nivel prej 6.9 miliardë eurosh. Mëse 95 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Rreth 35 për qind e të ardhurave korente kanë hyrë në formën e transfertave korente, ndërkohë që shërbimet dhe eksportet e mallrave kanë siguruar përkatësisht 37 për qind dhe 20 për qind të të ardhurave.

Deficiti korent, për vitin 2006, u vlerësua në nivelin 556 milionë euro, me një rritje prej rreth 13 për qind kundrejt vitit 2005, duke qenë i barazvlefshëm me rreth 7.6 për qind të PBB-së. Deficiti i lartë tregtar, që ka karakterizuar zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë gjatë këtij viti, ka neutralizuar efektet pozitive të zvogëlimit të ndjeshëm të pozicionit deficit në llogarinë e shërbimeve si dhe rritjen e flukseve pozitive të të ardhurave faktoriale neto, duke mbetur shkaktari kryesor në thellimin e deficitit korent për këtë periudhë.



Megjithëse norma vjetore e rritjes të eksporteve ishte më e lartë se ajo e importeve, vëllimi i lartë i këtyre të fundit bëri që deficitin tregtar të rritej me rreth 209 milionë euro ose me 14 për qind.

Llogaria e shërbimeve gjatë këtij viti ka regjistruar rritje si në kahun e të ardhurave, ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Në krahasim me vitin 2005, të ardhurat janë rritur më shpejt sesa shpenzimet. Për rrjedhojë, rezultati neto i transaksioneve në shërbime ka çuar në zvogëlim të ndjeshëm të deficitit të kësaj llogarie, me rreth 75 milionë euro.

Bilanci pozitiv i hyrjeve korente në formën e transfertave dhe të të ardhurave, vlerësohet të jetë rreth 69 milionë euro më i lartë, krahasuar me vitin e kaluar. Një zhvillim i tillë, i dedikohet kryesisht rritjes së të ardhurave nga interesat mbi investimet e njësisve rezidente jashtë, ndërkohë që transfertat korente kanë rënë me rreth 10 milionë euro – për efekt të zvogëlimit të transfertave zyrtare.

• TREGTIA E MALLRAVE

Viti 2006 u mbyll në një vëllim transaksionesh tregtare prej 2.9 miliardë eurosh, dhe përfaqësim prej 42 për qind, në totalin e transaksioneve korente. Shpenzimet për import mallrash, shënuan afërsisht vlerën 2.3 miliardë euro ose 309 milionë euro më shumë, krahasuar me vitin 2005. Të ardhurat nga eksporti i mallrave vlerësohen në rreth 631 milionë euro, me një rritje nominale prej rreth 100 milionë eurosh.


Zhvillimet në tregtinë e jashtme shfaqin divergjencë në rritje të importeve dhe të eksporteve. Ndonëse, rritja e eksporteve gjatë këtij viti (prej 19 për qind), ka tejkaluar rritjen e importeve (prej 15 për qind) deficitin tregtar ka vijuar të thellohet, duke kapur nivelin 1.7 miliardë euro.

Megjithatë, një zhvillim pozitiv vërehet në përmirësimin e raportit të mbulimit të importeve nga eksportet, i cili për këtë vit shënoi 27 për qind, me një rritje prej 1 pikë përqindjeje ndaj vitit 2005.

Ngadalësimi i eksporteve, i vërejtur gjatë vitit të kaluar - pasojë e rritjes së presioneve konkurrionale në industrinë kyçe të eksporteve shqiptare (tekstile dhe këpucë), nga hapja e tregjeve evropiane drejt vendeve të Lindjes së Largët (Kina, India) dhe Turqisë, shoqëruar kjo edhe me ngadalësimin e rritjes ekonomike në vendet partnere, si dhe me situatën e përkeqësuar në furnizim me energji elektrike në vend - është recuperuar ndjeshëm gjatë këtij viti.

Masat anti-dumping të marra nga BE²⁰, ndikuan ndjeshëm në përmirësimin e situatës së industrisë përpunuese në vend (tekstile dhe këpucë). Pikërisht

Grafik 23. Divergjencia në eksporte dhe importe (ritmet e rritjes vjetore).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

suficiti tregtar që erdhi nga kjo industri, gjatë këtij viti, rezultoi 45 për qind më i lartë se ai i një viti më parë. Industria e tekstileve dhe këpucëve përbën thelbin e industrisë eksportuese në vend, duke kontribuar me rreth 55 për qind në të ardhurat vjetore nga eksporti i mallrave.

Ndërkohë, zhvillime pozitive ka shfaqur eksporti i brendshëm (eksporte në bakër, në minerale dhe në lëndë djegëse minerale), duke kontribuar ndjeshëm në rritje të të ardhurave të eksportit, për vitin 2006.

Eksportet e bakrit dhe të artikujve të tij u trefishuan, me treg të përqendruar kryesisht drejt Italisë. Kontributi i tyre, në rritjen vjetore të eksportit, vlerësohet në rreth 15 për qind. Eksportet në produkte minerale, janë rritur me rreth 72 për qind dhe kontribuan me rreth 20 për qind, në rritjen e të ardhurave totale të eksportit të mallrave.

Eksporti i mineraleve të kromit dhe të hekurit, dha ndikimin kryesor në rritje të vëllimit të eksportit të mineraleve gjatë këtij viti. Eksporti i kromit u rrit rreth 4 herë, si në terma nominalë ashtu edhe në sasi, dhe pati për destinacion Kinën. Ndërkohë, eksporti i hekurit u dyfishua, me tregje drejt vendeve të rajonit (kryesisht në Maqedoni). Rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare për këto produkte, mendohet të ketë ndikuar ndjeshëm në ecurinë e tyre.

Eksportet e lëndëve djegëse gjithashtu, u dyfishuan. Nafta e papërpunuar, përfaqëson me rreth 70 për qind të eksporteve të kësaj kategorie. Destinacioni kryesor në këto eksporte ishte Italia. Efekti i tyre në totalin e të ardhurave nga eksporti për vitin 2006 vlerësohet të jetë 12 për qind, efekt ky i amplifikuar edhe nga rritja e çmimeve të naftës.

Tabelë 14. Shpërndarja e eksportit/importit sipas grupmallrave²¹ (në milionë euro).

Kodi	Përshkrimi	Import		Eksport		Import		Eksport	
		2005	2006	2005	2006	2005	2006	2005	2006
		Struktura në %		Struktura në %		Ndryshimi në %			
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	13.1	13.3	3.9	4.2	17.8		31.1	
1	Pije dhe duhan	3.1	3.2	1.8	1.3	19.5		-13.5	
2	Materiale të papërpunuara	3.6	3.6	4.8	5.5	13.4		36	
3	Lëndë djegëse	8.7	10.6	2.9	4.3	40.2		77.6	
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	1.4	1.3	0	0.1	10.7		88.4	
5	Produkte kimike	9.7	10.5	0.9	1.0	25.2		30.1	
6	Mallra të përpunuar	24.5	25.6	21.6	22.4	21.3		23.8	
7	Makineri dhe pajisje	23.5	20.1	4.2	3.9	-0.9		10.7	
8	Mallra të tjerë të përpunuar	12.5	11.8	59.9	57.2	9.5		13.6	
	Total	100	100	100	100	15.7		19	

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Importet vazhdojnë të jenë kahu dërrmues i rrjedhjes së shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë me botën, duke përfaqësuar mëse 79 për qind të vëllimit tregtar.

Variacioni në grupmallra dhe vëllimi i madh i importeve (31.8 për qind e PBB-së), pasqyrojnë ritmet e rritjes ekonomike të vendit, me përshejtim të sektorit të ndërtimeve dhe investime në infrastrukturë, të cilat kërkojnë

importe në mallra dhe makineri. Ai, gjithashtu, reflekton një shkallë të lartë të importeve në mallra për konsum, kërkesa për të cilët, sikurse edhe ajo në ndërtim, ushqehet nga dërgesat e emigrantëve dhe vlerësimi i lekut.

Rritja e pazakontë e çmimeve të naftës, importet e larta në energji elektrike si dhe rritja e çmimeve të metaleve në tregjet botërore, shoqëruar me kërkesën e lartë për mallra konsumi, përbëjnë faktorët kryesorë në rritjen e importeve gjatë vitit 2006.

Plotësimi i nevojave të brendshme me energji elektrike, si dhe rritja e çmimit të energjisë - duke pasuar zhvillimet e çmimeve të naftës - kanë pesëfishuar shpenzimet në importe të kësaj kategorie, ndërkohë që sasia e importuar u rrit gjithashtu ndjeshëm, me rreth 3.5 herë krahasuar me një vit më parë. Po kështu, importi i karburanteve rezultoi 22 për qind më i lartë se në vitin 2005. Kontributi i energjisë elektrike dhe karburanteve, në rritjen totale të importit vlerësohet respektivisht 8 për qind dhe 12 për qind.

Kërkesat gjithnjë e më të larta të sektorit të ndërtimit, kombinuar dhe me rritjen e çmimeve, çuan në rritjen me 30 për qind të importeve të metaleve. Ndërkohë, makineritë dhe pajisjet, të cilat zënë dhe peshën më të rëndësishme, rreth 14 për qind të importeve, këtë vit pësuan një rënie të lehtë (me 1 për qind), duke thyer kurbën rritëse që ka karakterizuar këtë grupmall, gjatë viteve të fundit. Megjithatë, importi i tyre këtë vit mbetet rreth 30 për qind më i lartë, krahasuar me mesataren e importeve në makineri dhe pajisje, përgjatë viteve 2000-2005.

BE mbetet dominues në shkëmbimet tregtare të vendit tonë me botën, duke përfaqësuar 64 për qind të totalit të tyre. Shkalla e ulët e diversifikimit të shpërndarjes gjeografike të tregtisë, tregon për një varësi të theksuar kundrejt fqinjëve Itali dhe Greqi, duke tërhequr kështu vëmendjen drejt eksplorimit të tregjeve të reja.

Viti 2006 shënoi edhe nënshkrimin e dy marrëveshjeve tepër të rëndësishme për vendin tonë, ajo me BE-në dhe me Turqinë. Gjatë këtyre viteve të fundit Turqia është shndërruar në një nga partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë, me një vëllim transaksionesh prej 190 milionë eurosh, gjë që shton vëmendjen drejt MTL-së me këtë shtet. Gjithashtu, edhe kurorëzimi i negociatave për nënshkrimin e MSA pritet të sjellë efekte të ndjeshme kundrejt hapjes së tregjeve me këto vende. Këto marrëveshje kanë hyrë në fuqi respektivisht në 1 dhjetor të vitit 2006 dhe 1 janar 2007.

Eksporti	Pesha në totalin e eksportit			Ndryshimi (2006/2005) %
	2004	2005	2006	
Total	100.0	100.0	100.0	19.0
Vendet e BE-15	89.9	88.0	87.7	18.6
Itali	73.0	72.4	72.6	19.3
Greqi	12.0	10.5	9.6	9.4
Gjermani	3.1	3.3	3.2	13.1
Vendet e Evropës Juglindore	8.5	9.2	9.3	19.8
Serbi-Mal i Zi	0.4	0.8	1.4	91.0

Tabelë 15. Shpërndarja e eksporteve sipas partnerëve tregtarë në vite dhe ndryshimi vjetor për vitin 2006.

Maqedoni	1.2	1.6	1.6	20.9
Kosovë	4.5	4.1	3.8	8.6
Turqi	1.9	1.7	1.3	(12.2)
Vende të tjera	1.6	2.7	2.9	28.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ritmet e rritjes së eksporteve drejt vendeve të BE-së dhe atyre të Rajonit duket se kanë ecur krahas për krahas gjatë këtij viti, duke qenë përkatësisht 18.6 për qind dhe 19.8 për qind. E kundërt paraqitet situata në kahun e importeve ku ka pasur fluks të madh nga vendet e rajonit, me një rrije prej 32 për qind. Duket se furnizimi me lëndë djegëse dhe energji elektrike gjatë këtij viti, ka ardhur nga Ballkani dhe pikërisht nga Rumania, e cila si rezultat regjistroi rritjen më të ndjeshme në importe (rreth 170 për qind). Ritme të larta të zgjerimit të importeve kanë pësuar edhe partnerët e tjerë të Rajonit, çka dëshmon për një përfitim më të mirë të MTL-ve nga ana e tyre, kundrejt vendit tonë.

Rivendoja e kuotave për eksportin e tekstileve në qershor të vitit 2005 nga OBT, solli zbutjen e ndikimit të konkurrencës kineze. Kjo u ndje edhe gjatë vitit 2006, kur importet nga ky vend pësuan një rritje modeste prej 4 për qind.

Tabelë 16. Shpërndarja e importeve sipas partnerëve tregtarë në vite dhe ndryshimi vjetor për vitin 2005.

Importi	Pesha në totalin e Importit			Ndryshimi (2006/2005) %
	2004	2005	2006	
Total	100.0	100.0	100.0	15.7
Vendet e BE-15	65.0	60.4	57.5	10.1
Itali	32.6	29.3	28.1	10.9
Greqi	18.6	16.6	15.8	10.0
Gjermani	6.2	5.4	5.6	20.7
Vendet e Evropës Juglindore	12.8	14.8	16.9	32.1
Bullgari	2.0	2.8	2.7	12.0
Bosnje-Hercegovinë	-	0.1	0.3	142.8
Kroaci	1.3	1.2	1.4	38.5
Kosovë	0.2	0.4	0.5	47.9
Serbi-Mal i Zi	0.6	0.6	0.9	64.0
Maqedoni	1.0	1.2	1.6	50.4
Rumani	0.4	0.7	1.7	173.5
Turqi	7.1	7.5	7.6	17.4
Vende të tjera	22.1	24.8	25.6	19.5
Rusi	2.8	4.1	4.1	16.1
Ukrainë	2.5	2.9	3.9	54.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

• SHËRBIMET

Zhvillimi i sektorit të shërbimeve në ekonominë shqiptare ka çuar në zgjerimin e aktivitetit të tregtisë së shërbimeve me botën, tregues ky i një ekspansioni të hapjes së ekonomisë shqiptare në tregtinë ndërkombëtare. Këtë gjë e tregon edhe vëllimi i këtyre transaksioneve në rreth 2.5 miliardë euro, i vlerësuar me një rritje vjetore prej 18.3 për qind. Importi i shërbimeve, me rreth 1.3 miliardë euro, vlerësohet me një rritje vjetore prej 13.7 për qind. Të ardhurat e përftuara nga eksporti i shërbimeve (rreth 1.2 miliardë) vlerësohen rreth 1.9 herë më të larta se eksporti i mallrave, gjë që ka çuar në reduktimin e deficitit të tregtisë së shërbimeve me rreth 2 herë, kundrejt vitit të kaluar.


Pikërisht është sektori i turizmit, i cili për një periudhë mëse 7-vjeçare luan një rol shumë të rëndësishëm në eksportet tona, duke përfaqësuar mesatarisht rreth 77 për qind të tyre. Viti 2006 regjistroi një fluks të ardhurash nga turizmi prej 805 milionë eurosh ose 16 për qind më shumë se një vit më parë. Kjo rritje vihet re në të ardhurat e siguruara nga shërbimet e ofruara udhëtarëve jorezidentë, që vizitojnë Shqipërinë për qëllime biznesi dhe personale (kryesisht në tremujorin e tretë duke theksuar efektin sezonal të turizmit në Shqipëri). Vlen të përmendim se rritja me 21.2 për qind e numrit të jorezidentëve që kanë hyrë në vend, me gjithë rënien e lehtë të shpenzimeve dhe të ditëqëndrimit të tyre në Shqipëri, ka çuar në rritje të të ardhurave të këtij aktiviteti me 18 për qind. Këto të ardhura, kanë rritur indirekt kërkesën për faktorët e prodhimit (toka, puna, kapitali), rrjedhimisht edhe kontributin në të ardhurat kombëtare, duke e shndërruar turizmin në një aktivitet me produktivitet të lartë. Sipas treguesit të shitjeve, sektori i hotelierisë dhe restoranteve, me një rritje prej 17 për qind, vlerësohet si një ndër sektorët me ritëm rritjeje të lartë, veçanërisht gjatë tremujorit të tretë.

Njëkohësisht, kërkesa për mallra e shërbime të udhëtarëve shqiptarë rezidentë në vendet e Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Greqia, Italia, vendet e rajonit si Kosova, Mali i Zi, Maqedonia çoi në regjistrimin e një importi shërbimesh turizmi, prej rreth 768 milionë eurosh. Këto shpenzime zënë rreth 82 për qind të prurjeve të emigrantëve dhe vlerësohen me një rritje vjetore rreth 21 për qind. Kjo rritje vjen si rrjedhojë e rritjes me 22.4 për qind të numrit të udhëtarëve, pasi kohëqëndrimi ka pësuar një rënie prej 10 për qind, ndërkohë që shpenzimet kanë ruajtur nivelet e një viti më parë.

Megjithatë, fundi i vitit regjistroi një bilanc pozitiv të shërbimeve të turizmit, duke nxjerrë në pah avantazhin konkurrues të Shqipërisë në tregun ndërkombëtar të shërbimeve të këtij aktiviteti.

Në shtesë të shërbimeve të turizmit, vihet re një përmirësim i bilancit të tregtisë në pothuaj të gjithë sektorët e shërbimeve. Zhvillimet e sektorëve të shërbimeve karakterizohen nga liberalizimi i tregut, zgjerimi i teknologjisë në shërbimet e informacionit, shumëllojshmëria e shërbimeve kulturore, si dhe rritja në vëllimin e shërbimeve financiare. Ndërkohë, vihet re që Shqipëria vazhdon të jetë importuese neto e shërbimeve të transportit dhe të sigurimit të mallrave, fenomen ky që lidhet natyrshëm me rritjen e importeve të mallrave dhe që ndikon drejtpërdrejt në deficitin e tregtisë së shërbimeve.

Grafik 24. Shërbimet – fluksi neto në milionë euro.



• TË ARDHURAT DHE TRANSFERTAT KORENTE

Bilanci pozitiv i të ardhurave faktoriale në fund të vitit (215 milionë euro), vlerësohet i rritur ndjeshëm kundrejt vitit paraardhës (58 për qind). Kjo rritje, nuk i dedikohet vetëm të ardhurave nga puna e punëtorëve sezonalë e atyre

kufitarë dhe interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente por edhe të ardhurave të përfuara nga investimet tona direkte jashtë Shqipërisë, dhe investimeve të mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit. Të ardhurat nga puna, përfaqësuan rreth 58 për qind të bilancit pozitiv të të ardhurave, ndërkohë, të ardhurat neto në formën e interesit nga investimet, kanë pësuar rritje prej 42 për qind. Shqipëria gjatë vitit 2006, ka paguar 24 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm, të cilat vlerësohen lehtësisht në rënie kundrejt vitit 2005 (4 për qind).

Të ardhurat nga emigrantët, me një rëndësi jetësore për pjesën më të madhe të shqiptarëve, janë bërë një nga fenomenet tipike në ekonominë shqiptare. Vitet e fundit, këto para nuk konsiderohen vetëm si burime të ardhurash për qëllime joproduktive, për përmbushjen e nevojave themelore aktuale që lidhen me përmirësimin e kushteve të jetesës, por kanë qenë burime financimi për qëllime produktive, në formën e investime në pasuri të patundshme apo investime të tjera afatgjata.


Totali i dërgesave nga emigrantët, për vitin 2006 vlerësohet të jetë rreth 934 milionë euro ose 12.8 për qind e PBB-së. Kontributi i këtyre dërgesave në zbutjen e deficitit tregtar llogaritet në rreth 55.4 për qind ose 5 pikë përqindje më pak se në vitin e kaluar. Prurjet nga emigrantët janë shoqëruar edhe nga transferta zyrtare, kryesisht në formë të asistencës teknike (39 milionë euro), të cilat vlerësohen me një rënie prej 17 për qind kundrejt një viti më parë.

II.6.3 LOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Viti 2006, karakterizohet nga një lëvizje shumë e madhe e kapitalit në të dy kahet, si në flukset hyrëse ashtu edhe ato dalëse. Përjashtuar transfertat e njëanshme të kapitalit, llogaria financiare këtë vit përkufizohet në rritje të madhe si të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën, ashtu edhe të mjeteve tona jashtë ekonomisë shqiptare. Megjithatë, viti u mbyll me një bilanc pozitiv të llogarisë kapitale dhe financiare (rreth 558 milionë euro), duke mundur plotësisht financimin e deficitit korent.

Transfertat kapitale, të cilat karakterizohen kryesisht nga grante me karakter investimi si në sektorin shtetëror ashtu edhe atë privat, vlerësohen 167 milionë euro, rreth 68 milionë euro më shumë se vitin e kaluar.

Në llogarinë financiare vihet re një rritje sinjifikative e mjeteve tona valutore të investuara jashtë ekonomisë shqiptare, kryesisht ato të sistemit bankar, përfaqësuar nga investime afatshkurtra dhe afatmesme. Akumulimi i madh, i ndodhur këtë vit i



mjeteve valutore në bankat tregtare, ka detyruar këto të fundit që të zgjedhin alternativën e rritjes së investimit të tyre në institucionet financiare jashtë, duke ulur me 11 për qind ritmin e rritjes së kreditimit të ekonomisë.

Mjetet valutore, të zotëruara nga sistemi bankar, në formën e depozitave jashtë, të cilat zënë peshën kryesore të rritjes së mjeteve, vlerësohen me rritje (rreth 157 milionë euro) kundrejt rënies së vitit të kaluar. Në përbërjen e tyre, 55 për qind zënë këto mjete në dollarë, ndërsa pjesa tjetër është në euro (39 për qind) dhe stërlina angleze (6 për qind). Rritja e këtyre mjeteve ka ardhur si pasojë e rritjes së depozitave të rezidentëve dhe jorezidentëve në sistemin tonë bankar, i cili i ka investuar këto në institucionet financiare jashtë. Njëkohësisht, është vënë re edhe një ndryshim i raportit të mjeteve të investimit. Sistemi bankar këtë vit, ka preferuar zhvendosjen e mjeteve nga investime portofoli në depozita me jashtë. Kështu, mjetet financiare në formën e investimeve të portofolit regjistrojnë shumën 84.3 milionë euro, duke shënuar një rënie vjetore prej rreth 27 milionë eurosh. Në përbërjen strukturore sipas monedhave, investimet e portofolit gjatë këtij viti mbizotërohen nga ato në dollarë rreth 77 për qind, në euro 16 për qind dhe në stërlinën angleze 7 për qind.

Njëkohësisht edhe këtë vit, ekonomia shqiptare ka pritur flukse hyrëse të kapitaleve të huaja, duke rritur detyrimet e saj me rreth 546 milionë euro. Kjo rritje, e cila vlerësohet rreth 51 qind më lart se viti 2005, vjen kryesisht nga investimet direkte, ato nëpërmjet huamarrjes afatgjatë me terma të zbutur si dhe detyrimeve të krijuara nga depozita të vendosura në sistemin tonë bankar, nga jorezidentë. Fluksi i investimeve të huaja direkte gjatë vitit 2006, regjistroi 260 milionë euro kundrejt 224 milionë eurove, realizuar në vitin e kaluar. Këto vazhdojnë të jenë një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare të vendit.

Investitorët nga vendet e Bashkimit Evropian (Itali, Greqi), të cilët janë edhe partnerë të tregtisë, vazhdojnë të dominojnë këto investime, që përqendrohen kryesisht në industrinë përpunuese të tekstileve (veshjeve dhe të këpucëve).

Marrëveshjet e tregtisë së lirë me BE, pritet të ndikojnë ndjeshëm në rritjen e këtyre investimeve, duke sjellë përmirësimin e prodhimit nëpërmjet transferimit të teknologjisë dhe rritjen e kapacitetit teknologjik të prodhimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, gjë kjo që do të çojë në rritjen e tregtisë me këto vende.


Zhvillimet e vullshme në sektorin e ndërtimit, kanë tërhequr vëmendjen e investitorëve të huaj. Prania e kapitalit të huaj në këtë sektor është rritur ndjeshëm përgjatë dy viteve të fundit, duke sjellë me vete flukse të reja të kapitalit të huaj në fusha të reja mbështetëse të këtij sektori, si aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike. Gjithashtu, vihen re rritje të kapitalit të huaj në sistemin financiar si dhe në fushën e telekomunikacionit.

Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte janë shoqëruar me flukse të kapitalit në formën e huamarrjes, duke rritur borxhin e jashtëm të Shqipërisë. Lëvrimet e kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, të cilat mbeten një

faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë me pjesën tjetër të botës, gjatë këtij viti vlerësohen 147 milionë euro, nga të cilat 80 për qind kanë shkuar në sektorin e qeverisë. Kjo rritje ka financuar kryesisht investimet dhe konsumin, e reflektuar kjo edhe në rritje të importeve për konsum si dhe nevojat për kapital dhe/ose mallra kapitalë të kompanive. Rritja e këtyre detyrimeve ka çuar në rritjen e pagesave të ardhshme të borxhit të jashtëm.

Shërbimi i borxhit të jashtëm për vitin 2006, ka reduktuar detyrimet tona me rreth 55 milionë euro, duke përfaqësuar vetëm 3 për qind të eksporteve tona gjatë vitit 2006, gjë që tregon për një aftësi paguese brenda niveleve të pranuar. Ndërkohë, huamarrja private duket të ketë ngadalësuar ritmet e rritjes së saj. Krahasuar me vitin 2005 rritja e detyrimeve të këtij sektori vlerësohet, sa gjysma e fluksit hyrës të një viti më parë dhe zë vetëm 20 për qind të huamarrjes. Struktura e borxhit të jashtëm, të krijuar nga huamarrja, dominohet nga sdr (58 për qind) ndjekur nga monedha evropiane dhe dollari amerikan.

Këtë vit, një rëndësi të veçantë kanë marrë detyrimet financiare, të krijuara në formën e rritjes së depozitave të jorezidentëve në sistemin bankar me 119 milionë euro. Këtu vlen të përmendet që kjo rritje ka ardhur edhe si rrjedhojë e vendosjes së depozitave të emigrantëve në sistemin tonë bankar, gjë që tregon rritje të interesit të emigrantëve për të investuar në ekonominë shqiptare.



Detyrimet në formën e kredisë tregtare u rritën me 7.5 milionë euro, e reflektuar kjo edhe në rritje të importeve për këtë periudhë.

II.6.4 REZERVA VALUTORE

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare, u reflektuan në rritje të rezervës valutore të autoritetit monetar, me rreth 207 milionë euro. Stoku i rezervës valutore në fund të vitit 2006 shënoi nivelin 1.3 miliardë euro, duke qenë i mjaftueshëm për të mbuluar, rreth 4.5 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Tabelë 17. Bilanci i pagesave në vite (në milionë euro).

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Llogaria korente	(186.6)	(314.6)	(426.5)	(336.2)	(287.8)	(492.1)	(556.4)
Eksporti i mallrave	277.2	339.7	350.5	397.0	485.6	530.2	630.6
Importi i mallrave	(1,168.4)	(1,484.9)	(1,576.6)	(1,583.4)	(1,762.3)	(2,006.9)	(2,316.0)
Bilanci tregtar	-891.2	-1,145.2	-1,226.1	-1,186.3	-1,276.7	-1,476.7	-1,685.4
Shërbimet: kredi	486.4	595.0	621.0	638.9	807.5	967.3	1,194.9
Shërbimet: debi	(466.7)	(495.4)	(626.5)	(712.4)	(848.0)	(1,107.7)	(1,260.3)
Të ardhurat: kredi	123.0	170.3	160.0	173.0	166.5	178.4	262.6
Të ardhurat: debi	(9.9)	(15.0)	(21.9)	(21.7)	(24.0)	(42.3)	(47.3)
Transferta private pa shpërblim	469.4	544.3	626.4	718.8	826.3	927.6	936.5
Transferta shtetërore pa shpërblim	102.5	31.4	40.6	53.5	60.7	61.4	42.5
Llogaria kapitale	84.8	131.3	128.7	139.3	106.2	99.2	167.2
Llogaria financiare	195.7	114.3	212.6	169.3	306.8	329.9	384.9
Investime direkte	155.2	231.2	143.3	158.1	278.4	224.1	259.8
Investime portofoli	(27.2)	(26.1)	(39.1)	(20.0)	4.6	(2.0)	27.2
Kapitale të tjera*	67.7	-90.7	108.4	31.2	23.8	107.7	97.9
Gabime dhe harresa neto	28.2	217.3	109.9	106.2	98.7	178.6	205.2
Bilanci i përgjithshëm	143.2	161.7	30.4	88.5	233.7	125.1	206.6
Mjetet e rezervës	(143.2)	(161.7)	(30.4)	(88.5)	(233.7)	(125.1)	(206.6)
Përdorim huash e kredish nga FMN	20.9	13.4	5.6	9.9	9.6	9.4	5.8
Ndryshimi total në rezerva	(141.8)	(146.0)	(103.0)	(158.0)	(276.1)	(179.0)	(157.3)
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	(1.4)	(15.7)	72.7	69.6	42.4	53.9	(49.3)

* Nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

SHËNIME

¹ Të dhënat për PBB-në dhe rritjen reale të saj për vitet 1999-2000 janë të INSTAT-it. Për pjesën tjetër të dhënat janë vlerësime të Ministrisë së Financave, të FMN-së dhe të dhëna të Bankës së Shqipërisë.

² Tabela është ndërtuar duke u bazuar në PBB-në nominale të rishikuar.

³ PBB nominale, e konvertuar me kursin mesatar të periudhës.

⁴ Të dhënat e të punësuarve dhe të përqindjes së papunësisë për vitin 2006, i përkasin shtatorit, sipas INSTAT.

⁵ Borxhi qeveritar, duke përfshirë borxhin e garantuar nga qeveria.

⁶ Të dhënat operative të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

⁷ Burimi: Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

⁸ Të dhënat e vitit 2006 janë të dhëna paraprake të Ministrisë së Financave.

⁹ Sipas Ministrisë së Financave, kjo rritje është realizuar në kushtet e uljes së ndjeshme të barrës tatimore ndaj subjekteve ekonomike, e cila ka synuar një nivel tatimi të sheshtë. Ndër treguesit kryesorë të ndikuar nga kjo politikë fiskale janë, përgjysmimi i taksës së biznesit të vogël, zbritja me 9 për qind e kontributit të sigurimeve shoqërore, ulja e tatimit mbi fitimin nga 23 në 20 për qind, si dhe minimizimi i barrierave doganore në zbatim të marrëveshjeve rajonale dhe evropiane.

¹⁰ Suficiti korent llogaritet si diferencë e të ardhurave ndaj shpenzimeve korente.

¹¹ Pjesa tjetër e financimit nga burime të tjera.

¹² Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://ëëë.istat.it>

¹³ Burimi: Shërbimi Kombëtar Statistikor i Greqisë; faqja e internetit: <http://ëëë.statistics.gr>

¹⁴ Burimi: Eurostat, faqja e internetit <http://epp.eurostat.cec.eu.int>

¹⁵ Burimi: Shërbimi Kombëtar Statistikor i Greqisë; faqja e internetit: <http://ëëë.statistics.gr>.

¹⁶ Burimi: Instituti i Statistikave të Italisë; faqja e internetit <http://ëëë.istat.it>.

¹⁷ Burimi: EUROSTAT; faqja e internetit <http://epp.eurostat.cec.eu.int>.

¹⁸ E llogaritur si raport i vëllimit tregtar në mallra dhe shërbime ndaj PBB-së.

¹⁹ Nuk ka një kriter specifik; varet nga rrethanat, mbulimi me rezerva i 3-6 muajve importe konsiderohet i mjaftueshëm.

²⁰ Gjatë vitit 2006, një komision investigativ anti-dumping në BE, zbuloi suvencionime të shtetit në industrinë e këpucëve në Kinë dhe Vietnam. BE vendosi një taksë ekstra doganore, prej rreth 19 për qind për importet nga këto vende.

²¹ Sipas klasifikimit SITC.

	Fq.
FJALA E GUVERNATORIT	11
KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE	1 31
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2 43
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET	3 85
KAPITULLI IV MBIKËQYRJA BANKARE	4 117
KAPITULLI V. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	5 131
KAPITULLI VI. RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2006	6 151

KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET


III.1 PROGRAMI MONETAR DHE OBJEKTIVAT SASIORË

Hartimi dhe zbatimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, parashikon monitorimin dhe kontrollin e treguesve kryesorë monetarë në ekonomi. Programi monetar i Bankës së Shqipërisë analizon informacionin sasior që mbartin treguesit monetarë rreth zhvillimeve të pritura monetare në ekonomi. Kjo analizë orienton vendimmarrjen e politikës monetare drejt përmbushjes së objektivit të inflacionit.

Programi monetar bazohet në parashikimin dhe përmbushjen e kërkesës joinflacioniste të ekonomisë për para. Kërkesa për mjete monetare, pasqyron kanalizimin e flukseve monetare në sektorët privat dhe publik të ekonomisë, si dhe ecurinë e bilancit të pagesave. Gjatë vitit 2006, flukset vjetore të kërkesës për para - rreth 70 për qind të kërkesës totale - janë orientuar kryesisht drejt sektorit privat të ekonomisë. Sektori publik i ekonomisë ka thithur më pak se 10 për qind të flukseve monetare neto, të gjeneruara në ekonomi gjatë këtij viti. Pjesa tjetër e këtyre flukseve, rreth 20 për qind e tyre, kanë shkuar për rritjen e mjeteve valutore neto të sistemit bankar.

Kjo shpërndarje pasqyron tendencën në rritje të kanalizimit të parasë drejt sektorit privat dhe uljen e dominimit të huamarrjes së brendshme të sektorit publik në zhvillimet monetare. Kjo, përbën një zhvillim pozitiv për ekonominë dhe për rritjen e eficiencës së sistemit financiar. Rritja e shpejtë e kreditimit të sektorit privat, është në linjë me tendencën e përgjithshme të vërejtur në ekonomitë në zhvillim. Në terma të rritjes ekonomike, ky fenomen përgjithësisht shoqërohet me rritje të potencialit prodhues të ekonomisë dhe të produktivitetit të faktorëve të prodhimit. Gjithashtu, fluksi pozitiv i mjeteve valutore neto të sistemit bankar pasqyron mjaftueshmërinë e hyrjeve kapitale për financimin e deficitit të llogarisë korente për vitin 2006, duke kontribuar në qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit.

Grafik 1. Shpërndarja vjetore e flukseve monetare sipas sektorëve (në miliardë lekë).



Rritja e kredisë me rreth 71 miliardë lekë gjatë vitit 2006¹, ka gjeneruar rritje të parasë së gjerë prej rreth 16 për qind, ndërsa norma mesatare e inflacionit rezulton afër objektivit prej 3 për qind të Bankës së Shqipërisë. Megjithëse, ritmet e larta të kreditimit të sektorit privat po shfaqin tendencë rënëse drejt normave të qëndrueshme, ato përbëjnë kontribut në rritje të

zgjërimit monetar aktual. Banka e Shqipërisë po monitoron vazhdimisht këto tendenca dhe implikimet që ato kanë për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit në të ardhmen.


Tabelë 1. Ecuria e treguesve kryesorë krahasuar me programin monetar.

Rritja vjetore e faktorëve të kërkesës (në miliardë lekë)	Programuar	Aktual
Kredia për ekonominë	63.0	70.8
Kërkesa e qeverisë	19.3	10.9
Mjetet Valutore Neto të Sistemit	20.9	22.4
Total	103.2	104.1
Rritja vjetore e agregatëve të ofertës (në përqindje)		
M3	15.2	16.3
M2	11.0	11.9
Baza Monetare	10.4	9.8
Pesha e komponentëve të M3 në fund të vitit (në përqindje)		
Paraja jashtë bankave / M3	25.0	24.5
Depozitat në valutë / M3	28.3	28.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura valutore e kredisë për sektorin privat është zhvendosur lehtësisht drejt kredisë në lekë. Në vitin 2006, raporti i kredisë në valutë ndaj kredisë gjithsej shënoi rënie në 71 për qind, kundrejt normës prej 74.4 për qind në vitin 2005. Zhvendosja drejt kreditimit në lekë, përbën një prirje pozitive për ruajtjen e stabilitetit financiar në të ardhmen. Pesha e lartë e kredisë në valutë në vitet e fundit, ka ruajtur koston e financimit të sektorit privat në nivele të ulëta. Zhvendosja graduale e këtij financimi drejt kredisë në lekë, rrit koston mesatare të kredisë. Megjithatë, ky faktor do të kompensohet nga rritja e konkurrencës dhe eficiencës së sistemit bankar në kreditimin në lekë. Në kahun e ofertës, Banka e Shqipërisë ka plotësuar kërkesën për para likuide nëpërmjet rritjes së mjeteve valutore neto të saj me rreth 22.4 miliardë lekë, ndërsa ka shënuar rënie të lehtë, prej rreth 3 miliardë lekësh, të mjeteve të brendshme neto. Treguesi i bazës monetare shpreh kërkesën e ekonomisë për para likuide. Në fund të vitit 2006, baza monetare ka pësuar një rritje prej 9.8 për qind, duke qenë më e ulët se ritmet e zgjerimit të kredisë për sektorin privat dhe të ofertës monetare.

Grafik 2. Tepriat mujore të likuiditetit të sistemit në fund të muajit (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e balancës së kërkesës dhe ofertës për likuiditet, ka diktuar kuadrin e instrumenteve të përdorura nga politika monetare. Banka e Shqipërisë ka tërhequr rreth 3.9 miliardë lekë likuiditet në gjysmën e parë të vitit 2006, duke kaluar në kahun injektues në gjysmën e dytë të tij. Ky zhvillim erdhi si pasojë e intensifikimit të kërkesës për para në fund të vitit dhe përqendrimit të deficitit buxhetor në këtë periudhë. Prania e Bankës së Shqipërisë në tregun e likuiditetit, ka synuar balancimin afatshkurtër të kërkesës për mjete monetare, duke mundur zbutje të luhatjeve në ecurinë e normave të interesit, në tregjet e parasë.

Administrimi i mjeteve valutore neto dhe i mjeteve të brendshme neto, si pjesë e kuadrit operacional të implementimit të politikës monetare, ka mundur

respektimin objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë, në funksion të ruajtjes së stabilitetit monetar.

Tabelë 2. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.

	Dhjetor '05	Mars '06	Qershor '06	Shtator '06	Dhjetor '06
Rezervat Ndërkombëtare Neto (milionë dollarë)					
Objektivi	1,172	1,117	1,112	1,252	1,268
Aktuale	1,172	1,202	1,224	1,296	1,394
Diferenca	0.0	85.3	112.4	44.5	126.8
Mjetet e Brendshme Neto (miliardë lekë)					
Objektivi	82.0	85.0	90.0	82.9	86.9
Aktuale	76.9	61.9	67.8	71.2	73.2
Diferenca	-5.1	-23.1	-22.2	-11.7	-13.7
Kredia e Brendshme Neto për Qeverinë (miliardë lekë)					
Objektivi	317.8	325.7	329.7	335.7	341.7
Aktuale	317.7	313.7	306.6	307.9	329.2
Diferenca	-0.1	-12.0	-23.2	-27.9	-12.5


Burimi: Banka e Shqipërisë.

III.2 ZHVILLIMET NË OFERTËN E PARASË


Gjatë pjesës më të madhe të vitit 2006, treguesit monetarë kanë pasqyruar kërkesën e stabilizuar për mjete monetare. Ritmi mesatar i rritjes së M3 rezultoi 12 për qind². Kërkesa për para e sektorit publik u rrit me vetëm 3.3 për qind, gjatë vitit 2006. Kjo huamarrje, relativisht e ulët, ka balancuar ritmet e larta të kreditimit të sektorit privat, duke influencuar pozitivisht në ruajtjen e stabilitetit monetar. Në përpundje me tendencën e vënë re gjatë viteve të fundit, zhvillimet monetare janë karakterizuar nga zhvendosja drejt mjeteve monetare më afatgjata. Kjo tendencë ilustron nga rritja e ulët vjetore, prej rreth 9 për qind, e bazës monetare. Ulja e likuiditetit të mjeteve monetare, ilustron rritjen e besimit në sistemin bankar dhe stabilizimin e pritjeve inflacioniste në ekonomi.

Treguesit monetarë shfaqin luhajtje të dukshme gjatë vitit, si rezultat i elementit sezonal të kërkesës për para. Rritja vjetore e M3 është luhatur midis minimumit prej 9.7 për qind në muajin qershor dhe normës maksimale prej 16.7 për qind, në muajin dhjetor. Sezonaliteti i kërkesës për mjete monetare nga sektori publik, kontribuon në luhajtjen e ritmit të rritjes së M3. Kërkesa për para e sektorit privat, burimi kryesor i rritjes së parasë së gjerë, ka qenë e orientuar drejt valutës. Kjo tendencë ka rezultuar

Grafik 3. Normat mesatare të rritjes vjetore të bazës monetare dhe parasë së gjerë, M3.



Grafik 4. Normat mesatare të rritjes vjetore të agregatëve M3 dhe M2.



në ritme relativisht më të larta të agregatit M3 kundrejt ritmeve të M2. Rritja vjetore mesatare e këtij agregati rezulton rreth 7.6 për qind³.

Megjithatë, rritja e kërkesës për mjete monetare në fund të vitit, ka ndikuar të dy agregatët monetarë. Rritjet vjetore të agregatëve M3 dhe M2, përkatësisht prej 16.7 për qind dhe 12.1 për qind në muajin dhjetor, kanë rezultuar mbi normat mesatare vjetore.


Tabelë 3. Ecuria e treguesve monetarë.

	Normat e rritjes vjetore (në përqindje)				Niveli dhjetor-2006 (në miliardë lekë)
	2003	2004	2005	2006	
M1	-5.2	19.4	31.7	8.7	248
M2	7.6	12.0	8.9	12.1	478
M3	7.6	13.1	14.0	16.7	674
Baza monetare	-2.0	11.2	11.0	9.8	218

Burimi: Banka e Shqipërisë.

III.2.1 ZHVILLIMET NË STRUKTURËN KOHORE TË M3

Struktura kohore e ofertës monetare në lekë është zhvendosur drejt depozitave. Kjo tendencë është shoqëruar me ulje të përdorimit të parasë fizike në aktivitetin ekonomik. Pesha e parasë jashtë bankave ndaj agregatit M2, ka shënuar një rënie prej rreth 1 pikë përqindjeje, gjatë vitit 2006. Në tërësi, ulja e përdorimit të parasë fizike në ekonomi mundëson rritjen e ndërmjetësimit financiar dhe uljen e kostos së parasë për financimin e aktivitetit ekonomik. Stabiliteti i normave reale të interesave në lekë dhe zhvendosja e strukturës së kërkesës për para drejt kreditimit të sektorit privat, favorizojnë tendencën rënëse të kërkesës për para likuide. Struktura kohore e depozitave totale nuk ka pësuar ndryshime të dukshme. Pesha e depozitave pa afat, në lekë dhe në valutë, ndaj depozitave me afat rezultoi 43.6 për qind kundrejt 43.3 për qind në vitin 2005.



• PARAJA JASHTË BANKAVE

Ecuria e parasë jashtë bankave ka ndjekur tendencën e përgjithshme të kërkesës për para. Përgjithësisht, faktorët makroekonomikë të kahut të kërkesës kanë influencuar ecurinë e këtij treguesi. Në kahun e ofertës, kërkesa për para jashtë bankave është furnizuar nëpërmjet operacioneve monetare në tregjet e parasë. Norma e kthimit në sistem të parasë së injektuar në treg, ka rezultuar në përputhje me tendencën afatmesme të zhvendosjes së strukturës kohore të agregatit M2 drejt depozitave. Pesha e parasë jashtë bankave ndaj M2 shënoi rënie në 34.2 për qind kundrejt vlerës 35.1 për qind, të shënuar në vitin 2005. Pesha e parasë jashtë bankave ndaj M3 në fund të vitit, shënoi 24.2 për qind ose 1.7 pikë përqindjeje më pak se një vit më

parë. Në terma nominalë, paraja jashtë bankave pësoi rritje prej 13.6 miliardë lekësh ose 9.1 për qind.

Ecuria e parasë jashtë bankave gjatë vitit ka patur një karakter të dukshëm sezonal. Përqendrimi i huamarrjes buxhetore dhe i shpenzimeve konsumatore në tremujorin e fundit të vitit, bënë që niveli i parasë jashtë bankave të rritet, me rreth 17 miliardë lekë në këtë periudhë.

• DEPOZITAT NË LEKË


Ambienti makroekonomik ka qenë i favorshëm për rritjen e qëndrueshme të depozitave në lekë të sistemit bankar, gjatë vitit 2006. Normat pozitive të interesave realë, janë shoqëruar me rritje të mëtejshme të depozitave në lekë. Depozitat në lekë janë rritur me 38.0 miliardë lekë gjatë vitit 2006, duke plotësuar nevojat prej 35.9 miliardë lekësh të ekonomisë dhe të qeverisë, për kredi në monedhën kombëtare. Ruajtja e ritmeve pozitive të depozitave ruan ekuilibrat e kërkesës ndaj ofertës për mjete monetare, ndërsa interesi real mbetet në intervale të qëndrueshme mbi 2 për qind.

Oferta monetare në lekë, M2 është zhvendosur lehtësisht drejt depozitave në lekë. Norma e rritjes vjetore të depozitave në lekë rezultoi 13.7 për qind, ndërsa rritja e agregatit M2 rezultoi 12.1 për qind. Gjithashtu, niveli i depozitave pa afat në lekë është stabilizuar afër nivelit 80 miliardë lekë, ndërsa raporti i tyre ndaj depozitave me afat në lekë ka shënuar rënie vjetore prej 2.8 pikë përqindjeje, në 36.6 për qind.

III.2.2 ZHVILLIMET NË STRUKTURËN VALUTORE


Përbërësi valutor i ofertës monetare ka shënuar ritme relativisht të larta të rritjes vjetore. Në vitin 2006, depozitat në valutë janë rritur me rreth 29.4 për qind. Ritmi më i lartë i rritjes së depozitave në valutë kundrejt ritmit të rritjes së ofertës monetare, ka çuar në rreth 29.1 për qind raportin e depozitave në valutë ndaj M3⁴. Gjithashtu, pesha e depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave u rrit në 38.5 për qind, kundrejt 35.5 për qind në vitin 2005.

Grafik 6. Peshë e rritjes vjetore të parasë jashtë bankave ndaj rritjes vjetore të M2.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7. Ecuria e depozitave në lekë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8. Rritja vjetore e parasë jashtë bankave dhe e depozitave në lekë (në miliardë lekë).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 9. Rritja vjetore e depozitave në valutë dhe pesha ndaj M3 (në përqindje).



Grafik 10. Rritja vjetore e depozitave dhe e kredisë në valutë (në miliardë lekë).



Struktura valutore e ofertës monetare, në periudhën afatgjatë, ndikohet nga diferenca e normave të interesit midis mjeteve monetare në lekë dhe në valutë, si në kahun e aktiveve ashtu dhe në atë të pasiveve të sistemit bankar. Krijimi i parasë në ekonomi në monedhë të huaj, si rezultat i kërkesës për kredi, pasqyrohet në kahun e ofertës së parasë së gjerë. Megjithatë, ecuria e depozitave në valutë favorizohet edhe nga prurjet valutore të llogarisë së bilancit të pagesave, kryesisht në formën e remitançave, duke e bërë balancën e këtyre faktorëve, të vështirë për t’u gjykuar.

Përbërja kohore e depozitave valutore gjatë këtij viti, tregon për një rritje më të shpejtë të depozitave pa afat në valutë, me rreth 37.7 për qind, kundrejt rritjes prej 25 për qind të depozitave me afat. Tendenca e rritjes së depozitave pa afat në valutë, vërehet në ecurinë e raportit të depozitave pa afat në valutë ndaj depozitave me afat në valutë. Ky raport është rritur në 56.4 për qind kundrejt 51.2 për qind, në vitin 2005.

Tabelë 4. Treguesit monetarë.

	Dhjetor 2006	Ndryshimi vjetor	
	në miliardë lekë		
			në përqindje
Para jashtë bankave	163.3	13.6	9.1
Depozitat totale	511.0	82.7	19.3
- në lekë	314.5	38.0	13.7
- në valutë	196.5	44.7	29.4
Depozita pa afat	155.1	25.6	19.8
- në lekë	84.2	6.2	8.0
- në valutë	70.9	19.4	37.7
Depozita me afat	355.9	57.0	19.1
- në lekë	230.2	31.8	16.0
- në valutë	125.7	25.2	25.1
M3	674.3	96.3	16.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Boks 1. Dollarizimi dhe politika monetare: implikimet për stabilitetin e çmimeve.

Dollarizimi – përdorimi i një monedhe të huaj, kryesisht dollarit amerikan, në një ekonomi - mund të njohë disa forma*. Dollarizimi i pjesshëm (de-facto) ndodh kur në një ekonomi, që ka në qarkullim monedhën e vet zyrtare, kryhen transaksione të pagesave dhe ato financiare në monedhë të huaj. Njihen tre forma kryesore të dollarizimit: dollarizimi i pagesave (kryerja e transaksioneve në valutë), dollarizimi financiar (mbajtja e aktiveve të rezidentëve në valutë) dhe dollarizimi real (indeksimi i disa prej çmimeve ose pagave në valutë). Në Shqipëri, dollarizimi mund të haset në të treja format e tij. Indeksimi i çmimit të banesave dhe rrjedhimisht, kryerja e transaksioneve në valutë si dhe prania e depozitave dhe kredive bankare në valutë, janë evidenca të dollarizimit në tre format e tij. Ekonomia shqiptare ka njohur dollarizimin financiar që prej vitit 1992. I matur në formën e raportit të depozitave në valutë ndaj depozitave gjithsej, dollarizimi financiar është luhatur kryesisht në intervalin 25-35 për qind. Megjithatë, në vitet e fundit ky tregues ka shfaqur tendencë rritëse, duke shënuar rreth 39 për qind në fund të vitit 2006.

Vlerësimet akademike konvergojnë në një konkluzion të përgjithshëm, se dollarizimi në shumë ekonomi ka lindur si masë mbrojtëse ndaj luhatjeve të normës së inflacionit dhe pasigurisë së nivelit të çmimeve në të ardhmen, kundrejt luhatjeve më të vogla të kursit të këmbimit. Megjithëse rreziku i luhatjes së çmimeve minimizohet me kalimin e kohës, ekonomia mund të mbetet financiarisht e dollarizuar për efekt të inercisë. Gjithashtu, hapja ekonomike, e llogarisë së jashtme dhe asaj kapitale, tenton të shoqërohet me dollarizim të ekonomive të vogla. Në tërësi, ekziston një lidhje e ndërsjelltë midis politikës monetare dhe dollarizimit, në sajë të ndërveprimit të kursit të këmbimit me normën e inflacionit në ekonomi.

Studime të ndryshme empirike sugjerojnë se ekonomitë pjesërisht të dollarizuara, përballeshin me një sfidë shtesë për hartimin e politikës monetare nën një regjim të shënjestrimit monetar. Dollarizimi i pjesshëm dhe norma e lartë e tejçimit të efekteve të kursit të këmbimit në nivelin e çmimeve, nxjerrin në pah nevojën e një objektivit të qëndrueshëm dhe të kontrollueshëm nga politika monetare, që mundëson qëndrueshmëri të çmimeve në ekonomi. Adoptimi i kursit të këmbimit, si objektiv i ndërmjetëm i politikës monetare, ka qenë një alternativë e suksesshme në vitet '80. Stadi i zhvillimit dhe niveli i ulët i hapjes ekonomike kundrejt ritmeve të sotme, e bënin kuadrin e kursit të kontrolluar (fiksuar) të këmbimit, një regjim të përshtatshëm për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në atë periudhë. Ndërsa në vitin 1985, regjimi i kursit fiks të këmbimit ishte kuadri zyrtar i politikës monetare në rreth gjysmën e vendeve të industrializuara, në vitin 2005 ky regjim aplikohet në rreth 5 për qind të vendeve. Në vendet në zhvillim, regjimi i kursit fiks të këmbimit aplikohet në rreth gjysmën e vendeve, ndonëse me tendencë largimi drejt regjimeve të tjera në rreth $\frac{3}{4}$ e tyre, në vitet '80. Suksesi i regjimit të kursit të këmbimit lidhet, përgjithësisht, me nivelin e ulët të hapjes ekonomike, veçanërisht të llogarisë kapitale. Kjo mund të shpjegojë pse vendet në zhvillim gjejnë ende të përshtatshëm regjimin e kursit fiks të këmbimit. Niveli i ulët i hapjes ekonomike në vendet në zhvillim, mundëson avantazhe të këtij regjimi. Hapja e ekonomisë nënkupton transmetim të goditjeve të jashtme në kërkesën për para, në normën e inflacionit dhe në ekonomi nëpërmjet

Grafik 1. Dollarizimi financiar në Shqipëri.



kursit të këmbimit. Në kushtet të tjera të njëjta, hapja ekonomike shoqërohet me rritje të dollarizimit (Ize dhe Levy Yeyati, 2003). Në sajë të këtyre implikimeve të hapjes ekonomike, regjimi i kursit fiks të këmbimit bëhet më pak i qëndrueshëm, në prani të goditjeve të jashtme.

Hapja ekonomike është shoqëruar me tendencë largimi nga regjimi i kursit të këmbimit, kryesisht drejt regjimit të shënjestrimit monetar, si edhe me rritje graduale të dollarizimit financiar. Megjithatë, me rritjen e dollarizimit, efektiviteti i regjimit të shënjestrimit monetar vështirësohet. Përgjithësisht, dollarizimi financiar i një ekonomie shoqërohet me një kërkesë më pak të qëndrueshme për para. Kërkesa për para në ekonomi bëhet më e luhatshme, në sajë të zhvendosjes së mjeteve monetare lehtësisht, në depozita dhe kredi valutore. Këto elemente të parasë së gjerë, influencohen me një diferencë kohore të ndryshme nga përbërësit në monedhën vendase, ndërsa janë edhe nën efektin e kursit të këmbimit. Përfshirja e kursit të këmbimit në lidhjen midis politikës monetare dhe parasë së gjerë, ndryshon dinamikën e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Kështu, vlerësimi ose zhvlerësimi i kursit të këmbimit, jep ndikime direkte jo vetëm në çmimet e importit por edhe në kërkesën për para. Në prani të një niveli të caktuar dollarizimi financiar, kontrolli i parasë së gjerë, si objektiv i ndërmjetëm i politikës monetare për arritjen e stabilitetit të çmimeve, bëhet më i vështirë.

Tabelë 1. Niveli i dollarizimit të vendeve të rajonit.

Vendi	Dollarizimi financiar* (në përqindje)
Shqipëri	36.6
Maqedoni**	56.5
Turqi	28.3
Rumani	32.0
Bullgari	48.8
Serbi	72.1

*Llogaritet si raport i depozitave në valutë ndaj depozitave gjithsej të sistemit bankar. Të dhëna të gjashtënmujorit të parë të vitit 2006.

** Të dhëna të vitit 2005.

Burimi: "Southeastern Europe and Mediterranean emerging market economies bulletin", Vëll. 7, botimi 3 NBG.

Zhvendosja drejt regjimeve më fleksibël të këmbimit është kombinuar me implementimin e strategjive të reja të politikës monetare. Në kushtet e një dollarizimi në rritje, kërkesa për para është bërë më pak e qëndrueshme, duke nxitur lëvizjen drejt një kuadri më të përgjithshëm të politikës monetare. Gjithashtu, administrimi me efektivitet i goditjeve të jashtme, ka rritur nevojën për pavarësi të bankave qendrore dhe të transparencës së politikës monetare. Faktorizimi i këtyre elementeve të politikës monetare është formalizuar nën një regjim të ri, regjimin e inflacionit të shënjestruar. Ndërsa implementimi i regjimit të shënjestrimit monetar ka qenë një nga tendencat e ekonomive në tranzicion në vitet '90, regjimi i shënjestrimit të inflacionit ka rezultuar një alternativë e suksesshme për ankorimin e pritjeve inflacioniste, në vitet e fundit. I implementuar së pari në fillim të viteve '90 nga Zelanda e Re, si një kuadër i përgjithshëm i ankorimit të pritshmërive të inflacionit, regjimi i shënjestrimit të inflacionit është konsoliduar në një regjim të mirëfilltë të politikës monetare. Adoptimi formal i regjimit të inflacionit të shënjestruar është një njohje e hapur e objektivit të stabilitetit të çmimeve, kundrejt objektivave makroekonomikë realë, të cilët janë përtej mundësive të politikës monetare për t'u influencuar.

Vendet që aplikojnë një strategji të tillë të politikës monetare, janë të shumta dhe aspektet institucionale dhe operationale të tyre, gëzojnë karakteristika të ndryshme. Megjithatë, regjimi i inflacionit të shënjestruar përmban disa kritere që kuzhtëzojnë

implementimin e tij. Tiparet kryesore konsistojnë në angazhimin institucional ndaj stabilitetit të çmimeve dhe shpalljen publike të objektivit numerik të inflacionit, përfshirjen e një informacioni të gjerë në procesin e vendimmarrjes përveç agregatëve monetarë dhe kursit të këmbimit, rritjen e përgjegjësisë dhe pavarësisë së bankës qendrore për arritjen e objektivit të inflacionit dhe rritjen e transparencës së saj. Performanca e bankës qendrore nën këtë regjim, matet nga ecuria e normës së inflacionit kundrejt objektivit të caktuar. Ndonëse, shumë banka qendrore nuk kanë në zbatim një regjim formal të inflacionit të shënjestruar, ato praktikojnë një sërë tiparesh të ngjashme me këtë regjim, sikurse fokusi mbi inflacionin dhe besueshmërinë e bankës qendrore, vlerësimi dhe reagimi i hershëm ndaj presioneve inflacioniste dhe rritja e transparencës së politikës monetare.

Regjimi i inflacionit të shënjestruar, përbën një alternativë ndaj sfidave të hapjes ekonomike dhe dollarizimit të ekonomisë, nëpërmjet përfshirjes së gjerë të informacionit në vendimmarrjen e politikës monetare dhe ankorimin e pritjeve inflacioniste. Gjithashtu, dollarizimi financiar kërkon zbatimin në mënyrë të kujdesshme të rregullave të fortë dhe mbikëqyrje strikte të sistemit financiar, për të siguruar qëndrueshmërinë dhe rezistencën e sistemit ndaj goditjeve të jashtme.

** Dollarizimi zyrtar ndodh kur një monedhë e huaj adoptohet të qarkullojë si monedhë zyrtare në ekonomi. Dollarizimi mund të bëhet në çdo monedhë të një ekonomie të konsoliduar, por fenomeni njihet me termin gjenerik "dollarizim".*

III.3 KËRKESA PËR PARA

Zgjerimi i kërkesës për para kulmoi në muajin dhjetor, me një rritje vjetore prej 16.7 për qind. Kontributin kryesor në rritjen e kërkesës për para gjatë vitit e ka dhënë kredia për ekonominë. Ky kontribut shënoi maksimumin e tij në muajin qershor, duke ardhur në zbehje në muajt në vijim, si pasojë e rritjes së huamarrjes publike. Pozicioni valutator me jashtë ka ruajtur një peshë relativisht të qëndrueshme në krijimin e mjeteve monetare gjatë vitit (shih grafikun 1).

III.3.1 KREDIA PËR EKONOMINË

Zhvillimi i sistemit bankar dhe rritja e rolit të bankave si ndërmjetës financiarë, ka sjellë zgjerim të ndjeshëm të aktivitetit kreditues gjatë viteve të fundit. Portofoli i kredisë arriti në 191.2 miliardë lekë ose 21.3 për qind të PBB-së, në fund të vitit 2006. Portofoli i kredisë për ekonominë përbënte 31.3 për qind të totalit të aktiveve të sistemit bankar dhe rreth 37.4 për qind të depozitave të sistemit bankar. Në terma absolutë, kredia për ekonominë u rrit me 69.3 miliardë lekë gjatë vitit 2006, krahasuar me rritjen prej 52 miliardë lekësh gjatë vitit të kaluar. Megjithatë, norma vjetore e rritjes së saj ka shënuar ulje gjatë vitit 2006, përgjithësisht në të gjitha kategoritë. Ky zhvillim reflekton më së shumti zgjerimin e dukshëm të bazës së saj gjatë dy viteve të fundit. Rritja vjetore e kredisë në vitin 2006 ishte 56.7 për qind, duke mbështetur mirë nevojat e ekonomisë.

Gjatë vitit 2006, sistemi bankar ka akorduar 157 miliardë lekë kredi të re ose 32 për qind më shumë sesa një vit më parë. Përshpejtimi i kredisë është mbështetur në zgjatjen e maturiteteve të kredive (orientim në rritje drejt kredive afatmesme dhe afatgjata) si dhe në ruajtjen e nivelit të lartë të kredive të reja. Nën tryshinë e konkurrencës, bankat kanë qenë më agresive në kredidhënie duke shfrytëzuar dhe segmente të reja të tregut të kredisë, si kredia konsumatore apo huatë për pasuri të paluajtshme.


Tabelë 5. Ecuria e treguesve kryesorë të kërkesës për mjete monetare.

	2003	2004	2005	T1 '06	T2 '06	T3 '06	T4 '06
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	448.4	507.2	578.0	580.4	594.5	627.0	674.3
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	71.5	68.9	70.0	70.1	71.0	69.8	71.8
- Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	60.2	55.1	48.9	46.9	45.3	43.4	43.4
- Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	11.3	13.8	21.1	23.2	25.7	26.4	28.4
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	13.7	16.9	25.1	26.4	28.7	29.8	31.3
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	6.8	8.4	14.6	15.9	17.7	18.7	21.3
Raporti kredi/depozita (në %)	15.7	19.0	28.5	30.4	33.7	34.5	37.4
Rritja vjetore e kredisë (në %)	31.1	38.1	74.3	68.6	59.4	56.3	56.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë dy viteve të fundit, bankat tregtare kanë plotësuar më mirë kërkesën në rritje për kredi në lekë. Në fund të vitit 2006, kredia në lekë përbënte 29 për qind të portofolit të kredisë, duke shënuar një zgjerim të moderuar në peshën e saj.


Gjithsesi, kredia në monedhën vendase ka shënuar ulje në ritmet e rritjes së saj gjatë vitit 2006, duke zbritur në 78.2 për qind nga 127 për qind që shënoi një vit më parë. Megjithë rritjen e shpejtë të kredisë në lekë, portofoli i bankave vazhdon të dominohet nga kredia në valutë. Struktura e kredisë në valutë gjatë dy viteve të fundit, ka tentuar drejt rritjes së peshës së kredisë në euro ndaj asaj në usd. Në muajin dhjetor, kredia në euro përbënte 82 për qind të totalit të kredisë në valutë.



• KREDIA SIPAS SUBJEKTIT

Kredia për bizneset përbën pjesën kryesore të portofolit të bankave, duke arritur në 66.5 për qind të totalit në fund të vitit 2006. Në terma vjetorë, kredia për biznese u rrit me 52 për qind. Struktura e shpërndarjes së kësaj kredie sipas përdorimit, ka tentuar të bëhet më uniforme krahasuar me një vit më parë. Pjesa më e madhe e kredisë për bizneset (34.5 për qind) përdoret për blerjen e pajisjeve dhe makinerive. Financimi i investimeve të bizneseve në zgjerimin e sipërfaqeve të kryerjes së aktivitetit, ka patur ecurinë më të mirë në kredinë për biznese. Kjo kredi përbënte 23.2 për qind të portofolit të kredisë për biznese, në fund të vitit 2006.

Grafik 12. Ecuria e kredisë sipas subjektit kredimarrës.



Kredia për individët arriti në 7 për qind të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2006 ose 33.5 për qind të totalit të portofolit të kredisë. Norma vjetore e rritjes së kredisë për individët shënoi 68 për qind, duke qëndruar në nivelet më të ulta të tre viteve të fundit. Më shumë se gjysma e kredisë së individëve (59.3 për qind) është akorduar për financimin e blerjeve të pasurive të paluajtshme. Bankat kanë zgjeruar kreditimin e individëve për financimin e blerjeve të mallrave të konsumit. Raporti i kredisë për konsum në totalin e portofolit të individëve është 27.3 për qind, nga 20 për qind një vit më parë. Në veçanti, kredia konsumatore ka njohur rritje të dukshme në muajt karakteristikë të pushimeve verore si dhe gjatë muajve të fundit të vitit, në periudhën e festave. Angazhimi i bankave në plotësimin e kërkesave të individëve për kredi dhe, në veçanti, në financimin e blerjeve të mallrave për konsum, ka përbërë nxitje për rritjen e kredisë në lekë.

Boks 2. Kredia për individët.

Kredia për individët po njih rritje të shpejtë në Shqipëri. Norma vjetore e rritjes së kësaj kredie është dukshëm më e lartë se ajo e bizneseve. Faktorët që kanë kontribuar në këtë rritje vlerësohen të jenë normat e ulta të inflacionit dhe interesave, nivelet më të larta të të ardhurave, çmimet më të larta të aseteve (më konkretisht të banesave), liberalizimi i sistemit financiar si dhe orientimi i bankave më shumë drejt bankingut me pakicë. Duke marrë parasysh se këta faktorë do të vijojnë të ndikojnë ecurinë e kredidhënies edhe në të ardhmen, pritet që kredia konsumatore, të ruajë ritme të larta rritjeje.

Megjithë zhvillimet pozitive të kredisë për individë në Shqipëri, ajo vazhdon të qëndrojë në nivele të ulta krahasuar me vendet me tregje financiare të zhvilluara si dhe me vendet e rajonit. Në Shqipëri, kredia totale për individë zë 33 për qind të portofolit të kredisë dhe norma vjetore e rritjes shënon 67.7 për qind, në fund të vitit 2006. Në raport me PBB, kredia për individë arriti në 7.2 për qind nga 4.6 që zinte një vit më parë. Pjesa më e madhe e kësaj kredie prej (59.3 %) është kredi për pasuri të paluajtshme, e akorduar kryesisht në monedhë të huaj.

Në vendet e Eurozonës kredia për individë përbën 44 për qind të prodhimit të brendshëm bruto dhe pasqyron një normë rritjeje vjetore prej 8.2 për qind. Ndërkohë që në vendet e rajonit, kredia për individë mesatarisht shënon rreth 9 për qind të prodhimit të brendshëm bruto. Megjithatë, kur krahasojmë këto raporte midis vendeve, duhet mbajtur parasysh se zhvillimet në borxhin e individëve kushtëzohen edhe nga faktorë të tjerë si sistemi i taksave, termat e kredithënies, përqindja e popullsisë që zotëron një shtëpi etj..


Tabelë 1. Tregues të kredisë për individë (në përqindje).

Shteti	Kredia për individë		Kredi për pasuri të paluajtshme	
	ndaj PBB	Rritja vjetore	ndaj PBB	Rritja vjetore
Shqipëri	7.2	67.7	4.6	140
Bullgari	16.1	37.1	5.8	68.4
Rumani	10.6	90.2	2.1	54.7
Maqedoni	8.8	35.9	1.5	40
Serbi	8.7	85.7	--	--
Turqi	11.7	74.7	3.9	250.5
Eurozonë	44	8.2	37	9.5

Burim: Buletini Ekonomik - Banka Kombëtare e Greqisë, shtator 2006; Raporti Mujor i BQE, janar 2007; Banka e Shqipërisë.

Gjatë viteve të fundit, kredia për pasuri të paluajtshme ka njohur rritje të qëndrueshme në nivele të larta*. Në vitin 2006, kjo kredi përbënte rreth 24 për qind të portofolit të sistemit bankar dhe rritje vjetore prej 59 për qind. Aktualisht, niveli i huave për shtëpi përbën 4 për qind të prodhimit të brendshëm bruto të vendit ose ndryshe, 96 euro kredi për banorë. Treguesi i fundit përafron me nivelet e vendeve që aspirojnë aderimin në BE, por është larg niveleve të vendeve që kanë hyrë në BE para disa vitesh apo vendeve të zhvilluara evropianoperëndimore.

Grafik 1. Ecuria e totalit të kredisë për individë dhe kredia për pasuri të paluajtshme (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Viti 2006 demonstroi zgjerim drejt kredisë së individëve në lekë, e nxitur kjo nga rritja e ndjeshme e kredisë konsumatore. Ndërkohë, kredia konsumatore në fund të vitit 2006 zë 27.6 për qind të totalit të kredisë për individë, nga 20 për qind që përbënte një vit më parë. Ndaj totalit të kredisë, kredia konsumatore ka dyfishuar peshën e saj brenda një viti, në 10 për qind. Gjithsesi, ecuria pozitive e kredisë konsumatore në portofolin e kredisë shfaqet disi më e kufizuar, për shkak të natyrës së saj afatshkurtër.

Po kështu, ecuria e kredisë konsumatore ka treguar sezonalitet me rritje më të lartë në muajt e verës dhe në muajt e festave. Kredia e re konsumatore e akorduar në muaj, në fillim të vitit përbënte 28 për qind të kredisë së re të individëve, ndërkohë që në fund të tij, arriti deri në 48 për qind.


* Në vitin 2005 kredia për pasuri të paluajtshme u rrit me 47 për qind.

• KREDIA SIPAS SEKTORËVE TË EKONOMISË

Kredia për pasuri të paluajtshme, ka patur rritjen më të lartë gjatë vitit 2006. Kjo kredi përbën 24.6 për qind të portofolit të kredisë në fund të vitit. Megjithatë, sektori i tregtisë mbetet sektori më i kredituar nga sistemi bankar. Kredia për këtë sektor përbën 22.4 për qind të portofolit të kredisë.

Kredia për sektorin e ndërtimit ka paraqitur frenim të ritmeve të rritjes, gjatë vitit 2006. Ky sektor paraqiti shenja të përkohshme përmirësimi gjatë muajve të verës, duke iu rikthyer më pas trendit rënës. Ndërkohë, kreditimi i ulët i sektorit të bujqësisë tregon për probleme të vazhdueshme strukturore, që pengojnë kreditimin e këtij sektori. Zgjidhja e këtyre problemeve do të çlironte një pjesë të potencialit financiar të ekonomisë drejt këtij sektori të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit.⁵

Grafik 13. Ecuria e indeksit të kredisë sipas degëve të ekonomisë, me bazë dhjetor 2004.



Tabelë 6. Teprica e kredisë sipas degëve të ekonomisë (në përqindje të kredisë në total).

	2002	2003	2004	T-4 '05	T1-'06	T2-'06	T3-'06	T4-06
1 Bujqësia, gjuetia dhe sivikultura	0.8	1	1.5	2.7	2.2	0.9	0.7	0.7
2 Peshkimi	0.2	0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
3 Industria nxjerrëse	0.2	1	0.3	0.5	1.4	2.3	1.0	1.0
4 Industria përpunuese	17.0	17	17.1	13.8	14.2	15.3	15.5	14.3
5 Prodhimi, shpërndarja energji elektrike, gaz dhe ujë	3.3	3	2.8	2.6	2.4	1.1	1.2	1.5
6 Ndërtimi	8.6	10	9.8	13.0	13.0	12.2	12.6	12.6
7 Tregtia, riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiakë	40.4	34	23.3	18.9	19.0	22.5	23.1	22.4
8 Hotele dhe restorante	6.0	6	8.3	4.3	4.8	4.1	3.9	3.5
9 Transporti dhe telekomunikacioni	2.4	1	2.0	1.48	1.3	1.6	1.6	2.0
10 Aktivitete financiare	-	0	0.2	0.8	0.7	1.3	0.8	2.1
11 Pasuritë e patundshme	9.1	13	9.8	14.2	14.6	25.5	25.7	24.6
12 Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	0.5	0	0.5	0.6	0.6	0.6	0.3	0.0
13 Shërbime kolektive, sociale dhe personale	4.2	8	4.8	5.8	4.6	1.7	2.0	0.6
14 Kredi konsumatore				4.5	4.9	6.1	7.7	9.1
15 Të tjera	7.3	4	19.3	16.7	16.2	4.6	3.8	5.5
Totali	100	100	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- KREDIA SIPAS SHPËRNDARJES GJEOGRAFIKE

Në shpërndarjen gjeografike të kredisë, vihet re se 68 për qind e portofolit është e përqendruar në Tiranë. Jashtë saj, vetëm qytetet bregdetare të Durrësit dhe Vlorës akordojnë një pjesë të konsiderueshme të kredisë, me 8 dhe 4 për qind të portofolit të kredisë secili, ndërkohë që rrethet e tjera ndajnë pjesën e mbetur. Përqendrimi i kredisë në zonën e Tiranës është ndikuar nga prania më e lartë e klientelës (biznese dhe individë) në këtë rreth, krahasuar me rrethet e tjera. Viti 2006 demonstroi një shpërndarje gjeografike të njëjtë, gjatë të gjithë tremujorëve.⁶


Tabelë 7. Shpërndarja gjeografike e kredisë sipas rretheve kryesore (në përqindje).

	Mars	Qershor	Shtator	Dhjetor
Tiranë	64.3	68.0	67.8	67.5
Durrës	9.0	7.8	7.7	7.6
Elbasan	4.4	3.6	3.2	3.2
Shkodër	4.0	2.4	2.5	2.5
Korçë	2.3	2.3	2.4	2.3
Vlorë	3.7	3.4	3.5	4.0
Lushnjë	2.1	1.3	1.3	1.2
Gjirokastër	0.7	1.4	1.4	1.3
Fier	3.3	3.6	3.5	3.9
Të tjera	6.2	6.2	6.7	6.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

III.3.2 MJETET VALUTORE NETO

Pozicioni valutore i sistemit bankar është përmirësuar gjatë vitit 2006. Mjetet valutore neto të sistemit bankar arritën në nivelin 2.4 miliardë usd në fund të këtij viti, duke shënuar një rritje vjetore prej rreth 440 milionë usd. Rreth 84 për qind e kësaj rritjeje i detyrohet akumulimit të rezervës valutore neto të Bankës së Shqipërisë. Duke shmangur efektin e kursit të këmbimit, rritja e këtyre mjeteve rezulton rreth 302 milionë usd.




Rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë ka qenë në rritje të vazhdueshme gjatë vitit 2006, duke shënuar nivelin 1.69 miliardë usd ose 371 milionë usd më shumë se një vit më parë. Nga kjo rritje, rreth 138 milionë usd janë akumulim nga ndërhyrjet valutore të Bankës së Shqipërisë. Këto ndërhyrje kanë synuar përbushjen e objektivit sasior për këto mjete dhe zbutjen e luhatjeve në periudhat e pikut të ofertës valutore. Rreth 114 milionë usd janë efekt i kursit të këmbimit, mbiçmimit me 8.9 për qind të euros kundrejt dollarit gjatë vitit 2006. Pjesa tjetër e rritjes është kontribut i hyrjeve nga disbursimet e huaja.

Në fund të vitit 2006, niveli i mjeteve valutore neto të bankave tregtare shënoi 762 milionë usd ose 67 milionë usd më shumë se një vit më parë. Zhvillimet

në këto mjete, përforcojnë idenë e një sezonaliteti të vërtetuar edhe në vitet e mëparshme. Rritja më e fortë e mjeteve valutore ndodh gjatë tremujorit të tretë të vitit, periudhë ku zakonisht ka rritje të konsiderueshme të depozitave në valutë. Kështu, vetëm në muajin gusht të këtij viti, mjetet valutore neto u rritën me 145.4 milionë usd. Kredia në valutë ka patur një ecure pozitive gjatë vitit 2006, shpesh duke tejkaluar rritjen e depozitave në valutë dhe duke ulur mjetet valutore neto.

Gjatë vitit 2006 është vënë re një rritje e shpejtë e detyrimeve në valutë të bankave tregtare. Këto detyrime kanë qenë kryesisht në formën e kredive nga jorezidentët dhe depozitave pa afat të bankave të huaja.




Dollari amerikan ka zënë pjesën më të madhe në strukturën e mjeteve valutore të bankave tregtare gjatë vitit 2006, me rreth 50 për qind. Bankat kanë denominuar në dollarë pjesën më të madhe të letrave me vlerë të jorezidentëve dhe depozitave me afat në bankat e huaja. Arka dhe kredi të dhëna jorezidentëve, janë më së shumti në monedhën euro. Nga ana tjetër, rreth 70 për qind e detyrimeve valutore është e denominuar në euro, ku pjesa më e madhe përbëhet nga kredi nga bankat e huaja.


III.3.3 KËRKESA PËR PARA E QEVERISË

Llogaria e qeverisë ka paraqitur një ecure jo të zakonshme, gjatë vitit 2006. Ndërsa në vitet e mëparshme, qeveria ka rritur në mënyrë të vazhdueshme financimin neto, këtë vit kjo kërkesë ka qenë negative për pjesën më të madhe të tij, me një përqendrim total të saj në dy muajt e fundit. Në të dhënat fiskale të qeverisë parashikohet që niveli i financimit të brendshëm për vitin 2006, të arrijë në 22.8 miliardë lekë. Deri në muajin tetor ky financim ishte negativ, ndërkohë që në muajin dhjetor financimi bruto rezultoi rreth 22.6 miliardë lekë.

Grafik 16. Financimi i brendshëm bruto i qeverisë (në milionë lekë).



Grafik 17. Ecuria kumulative e financimit të brendshëm të qeverisë (në miliardë lekë).



Gjatë vitit 2006, qeveria ka përmirësuar strukturën e borxhit të qeverisë, duke përmirësuar shtrirjen e tij në kohë dhe duke emetuar për herë të parë borxh në valutë të huaj. Kjo politikë, ka synuar rritjen e fleksibilitetit në huamarrje dhe uljen, në një periudhë afatgjatë, të kostos së borxhit. Borxhi i qeverisë është orientuar drejt maturimeve afatgjata, ku vërehet reduktimi i emetimit të bonove të thesarit dhe zhvendosja drejt emetimit të obligacioneve 2, 3 dhe 5-vjeçare. Këto të fundit, u prezantuan për herë të parë në nëntor të këtij viti. Në muajin dhjetor, qeveria emetoi për herë të parë bono thesari në valutë të huaj, me maturim 9-mujor.

Qeveria ka paraqitur një kërkesë në rritje për likuiditet edhe pse në kushtet e një bilanci fiskal pozitiv, për pjesën më të madhe të vitit.⁷ Kërkesa e qeverisë për para është mbuluar në pjesën më të madhe nga bankat tregtare, kryesisht nëpërmjet blerjes së obligacioneve qeveritare, ndërsa një pjesë është mbuluar nga të ardhurat e privatizimit⁸ dhe financimi i huaj. Gjatë vitit 2006, portofoli i obligacioneve 2, 3 dhe 5-vjeçare është ritur përkatësisht me 20.9, 9.96 dhe 6.36 miliardë lekë. Ndërkohë, portofoli i bonove të thesarit ka shënuar një ulje prej 23 miliardë lekësh. Rreth 90 për qind e kësaj uljeje vjen nga reduktimi i portofolit të bonove të thesarit të bankave tregtare. Ndërkohë, emetimi i bonove të thesarit në valutë të huaj, kapi shumën 2.6 miliardë lekë.

Në kushtet e suficitit buxhetor, deri në muajin nëntor, qeveria ka investuar likuiditetin e saj të tepërt në formën e repove të anasjellta për bankat tregtare. Ndërkohë, pjesa tjetër ka kaluar në depozitën e qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë.

Boks 3. Karakteristika të borxhit publik dhe implikimet makroekonomike.

Në ditët e sotme, shumë qeveri paraqiten si huamarrëse të përhershme, duke ripaguar borxhet e vjetra me huamarrje të re. Një situatë e tillë është normale, për sa kohë që niveli i borxhit ndaj PBB-së nuk është i lartë⁹. Struktura e borxhit të qeverisë mund të ndikojë kushtet monetare të një vendi. Ndryshime të rëndësishme në madhësinë, strukturën dhe kompozimin e instrumenteve të borxhit qeveritar, mund të ndikojnë stabilitetin financiar. Kështu, me qëllim ruajtjen e kushteve monetare dhe stabilitetin financiar, është e rëndësishme të monitorohet struktura, karakteristikat dhe niveli i rrezikut në portofolin e borxhit.

• **MADHËSIA E BORXHIT PUBLIK.**

Disiplina fiskale konsiderohet si parakusht për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, sidomos për ekonominë në zhvillim dhe në tranzicion. Në këto vende, shpesh qeveritë mbështeten në krijimin e parasë për të mbuluar shpenzimet e tyre, pasi marrja e borxhit në tregjet financiare nuk është e lehtë. Një veprim i tillë ka pasoja inflacioniste. Megjithatë, në vendin tonë, politika monetare dhe ajo fiskale kanë punuar në të njëjtin drejtim për

forcimin e stabilitetit makroekonomik. Gjatë pesë viteve të fundit deficiti fiskal ka qenë në ulje të vazhdueshme, bashkë me nivelin e borxhit publik ndaj PBB-së. Krahasuar me kriteret e konvergencës, niveli aktual i deficitit buxhetor është shumë afër kufirit maksimal prej 3 për qind ndaj PBB-së, ndërsa borxhi publik prej tre vjetësh shënon poshtë kufirit prej 60 për qind ndaj PBB-së.

• **KOMPOZIMI I BORXHIT PUBLIK.**

Deri në shtator të vitit 2002, borxhi i brendshëm i Qeverisë Shqiptare shprehej në formën e letrave me vlerë të tregtueshme (bono thesari) me afate të shkurtra maturimi, 3, 6 dhe 12 – mujore. Ndërkohë, gjatë periudhës 2002 - 2006, qeveria ka rritur maturitetin e borxhit të saj, nëpërmjet emetimit të instrumenteve më afatgjata, me qëllim rritjen e fleksibilitetit të huamarrjes dhe uljen e luhatshmërisë së kostos së shërbimit të borxhit. Në fund të vitit 2002, struktura e borxhit zgjerohet me një instrument të ri, obligacione qeveritare me maturim 2-vjeçar. Më tej, ndryshime të rëndësishme në këtë strukturë kanë të bëjnë me emetimin e obligacioneve 3-vjeçare në vitin 2005, emetimin e obligacioneve 5-vjeçare dhe të borxhit në valutë të huaj, në vitin 2006.


Hedhja në treg e instrumenteve të reja të borxhit përbën një zhvillim pozitiv, pasi sjell një sërë përfitimesh si për emetuesin ashtu dhe për zhvillimin e tregjeve financiare. Nëpërmjet këtyre instrumenteve, qeveria siguron burime financimi të qëndrueshme, duke shmangur mungesat e likuiditetit për borxhin publik. Në të njëjtën kohë, këto instrumente lejojnë një administrim më të mirë të borxhit. Për investitorët zgjerohen mundësitë e mbajtjes së kursimeve të tyre. Në të shumtën e rasteve, këto instrumente janë pjesë kryesore e kolateraleve në tregjet financiare. Gjithashtu, normat e interesit të instrumenteve afatgjata të borxhit të qeverisë zgjasin kurbën kohore të yield-it, duke shërbyer si benchmark për normat afatgjata të interesit, si kreditë.

• **MBAJTËSIT E BORXHIT PUBLIK (TREGU PRIMAR).**


Blerja e borxhit të qeverisë nga sektori privat, konsiderohet si mënyra më pak e dëmshme e financimit të qeverisë. Literatura sugjeron se blerja e borxhit të qeverisë nga bankat tregtare, mund të reduktojë ofertën e bankave për kredi për sektorin privat, ndërsa blerja e borxhit të qeverisë nga bankat qendrore rrit presionet inflacioniste.

Baza e investuesve të borxhit të Qeverisë Shqiptare mbetet e kufizuar. Bankat tregtare janë mbajtëset kryesore të tij, duke qenë pjesëmarrëse direkte në blerjen e bonove të thesarit dhe të obligacioneve qeveritare. Banka e Shqipërisë mban një pjesë të borxhit të qeverisë (bono thesari), i akumuluar kryesisht në vitet '90, kur tregu i bonove të thesarit ishte i kufizuar. Individët dhe institucionet marrin pjesë vetëm në blerjen e bonove të thesarit.


Grafik 1. Borxhi publik, borxhi i brendshëm dhe deficiti buxhetor* (në % të PBB-së).



Grafik 2. Portofoli i borxhit të brendshëm bruto të qeverisë.




Grafik 3. Portofoli i mbajtësve të borxhit të brendshëm bruto të qeverisë.




III.4 TREGU FINANCIAR DHE NORMAT E INTERESIT

Viti 2006 është karakterizuar nga rritja e aktivitetit në tregun e parasë dhe në tregun e kapitaleve, dhe nga ulja e luhatshmërisë së normave të interesit. Këto të fundit, janë orientuar përgjithësisht nga politika monetare e Bankës së Shqipërisë. Në kushtet e tepricës së likuiditetit, normat e interesit kanë patur një tendencë rënëse, gjatë gjysmës së parë të vitit. Pas sinjalizimit të shtërngimit të kushteve monetare në gjashtëmuorin e dytë, normat e interesit kanë qenë në rritje.



- TREGU I PARASË

Tregu ndërbankar ka qenë më aktiv gjatë vitit 2006, duke siguruar një mënyrë më efektive për administrimin e fondeve të tepërta të bankave. Vëllimi mesatar ditor i transaksioneve, arriti shifrën 1.6 miliardë lekë ose 0.2 miliardë lekë më shumë se mesatarja e vitit të kaluar. Rritja e vëllimit të tregtimit, i detyrohet tërësisht rritjes së vëllimit të transaksioneve shtatëditorë, ndërkohë që huadhënia njëditorë ka mbetur afërsisht në të njëjtat nivele si në vitin 2005, 0.7 miliardë lekë.



Megjithë zhvillimin e tregut ndërbankar gjatë vitit 2006, ai mbetet ende larg parametrave të një tregu të zhvilluar e konkurrencial. Kështu, transaksionet në këtë treg vazhdojnë të jenë me maturim afatshkurtër, njëditor dhe shtatëditor. Si të tilla, ato mundësojnë vetëm plotësimin e nevojave afatshkurtra për likuiditet dhe i detyrojnë bankat të përdorin ristrukturimin e bilancit të tyre ose huamarrjen nga Banka e Shqipërisë, si një mënyrë për plotësimin e nevojave afatgjata. Gjithashtu, vëllimi i tregtimit dhe pozicionimi i bankave të nivelit të dytë, kufizohen


nga limitet në tregtim që kanë bankat me njëra-tjetrën, limite të cilat vendosen në bazë të rrezikut të vlerësuar të kreditit.

Tregu ndërbankar është karakterizuar nga ngushtimi i diferencës së normave të interesit sipas maturiteteve dhe pozicionimi i tyre pranë normës bazë të interesit. *Spread*-i mesatar midis interesave njëditorë dhe shtatëditorë zbriti në 0.7 pikë përqindjeje në vitin 2006, nga 1.6 pikë përqindjeje në vitin 2005. Krahas stabilitetit të tregut, kjo prirje është ndikuar edhe nga ndryshimi i korridorit të lehtësive mbështetëse të Bankës së Shqipërisë, nga asimetrik në një korridor më të ngushtë simetrik¹⁰. Në fund të vitit 2006, normat e interesit arritën në 4.52 për qind për transaksionet njëditore dhe në 5.24 për qind për transaksionet shtatëditore, krahasuar me 4.13 për qind dhe 5.43 për qind respektivisht në fund të vitit 2005.

Si pasojë e ruajtjes së një ritmi të lartë të kreditimit në lekë dhe të rritjes së huamarrjes së qeverisë, nevojat për likuiditet kanë patur një natyrë afatgjatë, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2006. Ato janë plotësuar me marrëveshje të anasjellta të riblerjes me Bankën e Shqipërisë, ndërsa tregu ndërbankar ka patur likuiditet të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat afatshkurtra, gjë që ka ndikuar në uljen e interesave respektivë në këtë treg.

Në gjysmën e parë të vitit 2006, ka pasur një ulje të vazhdueshme të *yield*-eve të bonove të thesarit dhe të obligacioneve të qeverisë, si pasojë e kërkesës së ulët të qeverisë për financim. Në gjysmën e dytë të vitit 2006, pas sinjaleve shtrënguese të Bankës së Shqipërisë dhe rritjes së kërkesës për likuiditete në sistem, pati një rritje graduale të këtyre *yield*-eve. Në fund të vitit 2006, ato arritën në nivelin 6.45 për qind për afatin 3-mujor, 7.10 për qind për afatin 6-mujor dhe 7.89 për qind për afatin 12-mujor. Krahasuar me një vit më parë, *yield*-et janë rritur përkatësisht me 0.83 pikë përqindjeje, 0.45 pikë përqindjeje dhe 0.98 pikë përqindjeje.

Grafik 20. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë dhe normat e interesit në tregun ndërbankar.




	Dhjetor-04	Dhjetor-05	Qershor-06	Dhjetor-06
Norma bazë e interesit	5.25	5.00	5.00	5.50
Tregu ndërbankar 1-ditor	3.26	4.10	4.21	4.52
Tregu ndërbankar 7-ditor	5.90	5.6	5.15	5.24
Tregu primar				
Yield-i i bonove të thesarit 3- mujore	6.09	5.41	5.23	6.45
Yield-i i bonove të thesarit 6-mujore	7.22	6.73	5.42	7.10
Yield-i i bonove të thesarit 12- mujore	8.11	6.91	5.74	7.89
Tregu i obligacioneve				
Yield-i i obligacioneve 2-vjeçare	9.00	8.00	6.38	8.40
Yield-i i obligacioneve 3-vjeçare			7.50	8.80
Yield-i i obligacioneve 5-vjeçare				9.68

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat tregtare.

Tabelë 8. Normat e interesit në treg ndërbankar dhe në treg primar (në përqindje).

- TREGU I KAPITALEVE

Tregu i kapitaleve është i kufizuar tek investimi në letrat me vlerë afatgjata të qeverisë, të cilat kanë filluar të emetohen në vitin 2002. Rritja e vëllimit të tyre ka siguruar një shtrirje në strukturën kohore të financimit të qeverisë si dhe ka sjellë rritjen e peshës që ato kanë në portofolet e investuesve. Emetimet e obligacioneve të qeverisë janë rritur krahasuar me vitin e kaluar, duke bërë që portofoli i bankave, të vetmet pjesëmarrëse në këtë treg, të rritet me 37.0 miliardë lekë. Pësha që zënë obligacionet kundrejt totalit të letrave me vlerë të qeverisë është rritur në 22 për qind në vitin 2006, nga 12 për qind vitin e kaluar. Struktura e maturiteteve të tyre varion nga dy deri në pesë vjet. Obligacionet pesëvjeçare u emetuan për herë të parë, në muajin nëntor të këtij viti, për shumën 6.3 miliardë lekë. Kërkesa për to rezultoi më e lartë sesa shuma e emetuar.



Megjithë rritjen e aktivitetit dhe të konkurrencës në tregun primar, tregu sekondar i letrave me vlerë të qeverisë mbetet relativisht i pazhvilluar. Veprimet e blerje-shitjeve në tregun ndërbankar janë të kufizuara, ndonëse kanë treguar rritje krahasuar me vitin e kaluar. Në vitin 2006, për tregtimin e bonove të thesarit numërohen 44 transaksione (vëllim 5.6 miliardë lekë) nga 36 transaksione (vëllim 4.2 miliardë lekë) në vitin 2005. Për tregtimin e obligacioneve, numri i transaksioneve është rritur nga dy (për shumën 80 milionë lekë) në tre (për shumën 600 milionë lekë).

Në muajin dhjetor 2006, *yield*-i i obligacioneve 2-vjeçare të qeverisë, arriti në nivelin 8.40 për qind nga 8.00 për qind që ishte një vit më parë. Interesat e obligacioneve 3-vjeçare zbritën në 8.90 për qind, nga 9.50 për qind në fundvitin e kaluar.

- NORMAT E INTERESIT TË DEPOZITAVE DHE KREDIVE

Tregu i depozitave në lekë është karakterizuar nga ulja e interesave, në gjysmën e parë të vitit 2006 dhe rritja e tyre, pas sinjaleve shtrënguese të politikës monetare. Ritmet e rritjes së interesave të depozitave në lekë ishin më të ulëta se ritmet e rritjes së interesave në tregun primar. Normat e interesit janë rritur më shpejt për afatet e gjata të maturimit, duke reflektuar përshtatjen e kohëzgjatjes së tyre me rritjen e borxhit afatgjatë të qeverisë.¹¹

Tabelë 9. Normat e interesit në tregun e depozitave dhe kredive në lekë (në përqindje).

	Dhjetor-04	Dhjetor-05	Qershor -06	Dhjetor-06
Norma bazë e interesit	5.25	5.00	5.00	5.50
Depozita në lekë				
Depozita 1-mujore	3.39	3.35	3.11	3.35
Depozita 3-mujore	4.48	4.07	3.74	3.94
Depozita 6-mujore	5.41	4.77	4.35	4.64

Depozita 12-mujore	5.99	5.57	5.05	5.46
Depozita 24-mujore	6.98	6.82	5.90	5.88
Depozita 36-mujore		6.49	5.94	6.42
Kredi në lekë				
Kredi deri në 6 muaj	10.98	12.90	11.28	12.18
Kredi 6 muaj – 1 vit	13.73	12.16	11.80	11.16
Kredi 1-3 vjet	20.42	18.07	15.89	17.61
Kredi mbi 3 vjet	12.89	12.23	11.42	12.20
Interesi mesatar i ponderuar	13.71	13.50	12.55	12.92

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat tregtare.

Normat e interesit për kreditë në lekë janë ulur në të gjitha afatet, gjatë vitit 2006. Interesi mesatar i ponderuar në muajin dhjetor 2006 zbriti në 12.92 për qind, nga 13.50 për qind që ishte një vit më parë. Ulja më e madhe e interesave të kredive, krahasuar me atë të depozitave në lekë, solli uljen e kostos së ndërmjetësimit¹²; nga 8.13 për qind në muajin dhjetor 2005, në 7.54 për qind në muajin dhjetor 2006, për afatin 6-mujor dhe nga 6.59 për qind në 5.70 për qind, për afatin 12-mujor. Me gjithë uljen e kostos së ndërmjetësimit në krahasim me vitin e kaluar, niveli i *spread*-it mbetet ende relativisht i lartë. Ai ndikohet nga konkurrenca jo e plotë në këtë treg dhe nga natyra me rrezikshmëri më të lartë e kredive të akorduara në lekë.

	Dhjetor-04	Dhjetor-05	Dhjetor-06
Në dollarë amerikanë			
Norma bazë e interesit FED	2.25	4.25	5.25
Depozita 1-mujore	1.48	2.36	3.03
Depozita 3-mujore	1.69	2.81	3.44
Depozita 6-mujore	1.88	2.99	3.87
Depozita 12-mujore	2.27	3.56	4.29
Depozita 24-mujore	2.65	4.15	4.86
Në euro			
Norma bazë e interesit BQE	2.00	2.25	3.50
Depozita 1-mujore	1.65	1.82	2.54
Depozita 3-mujore	1.75	2.01	2.91
Depozita 6-mujore	1.78	2.20	3.29
Depozita 12-mujore	1.97	2.49	3.45
Depozita 24-mujore	2.31	3.27	4.16

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat tregtare.

Tabelë 10. Normat e interesit në tregun e depozitave në valutë (në përqindje).


Në tregun e depozitave në valutë, normat e interesave në dollarë dhe në euro kanë vazhduar trendin e tyre rritës, si rezultat i shtrëngimit të politikës monetare nga Fed-i dhe Banka Qendrore Evropiane, gjatë vitit 2006. Në të njëjtën kohë, janë rritur dhe normat e interesave për kreditë e akorduara në këto monedha. Rritja më e madhe e këtyre interesave ka qenë në kreditë nga 6 muaj në një vit, në euro dhe në kreditë deri në 6 muaj, në dollarë. Në fund të vitit 2006, interesat mesatarë të ponderuar të kredive në dollarë, arritën 9.42 për qind dhe interesat e kredive në euro, arritën në 8.17 për qind; nga 8.47 për qind dhe 7.95 për qind që ishin përkatësisht, në fund të vitit të kaluar.

Tabelë 11. Normat e interesit në tregun e kredive në valutë (në përqindje).

	Dhjetor-04	Dhjetor-05	Dhjetor-06
në dollarë amerikanë			
Kredi deri në 6 muaj	7.47	7.92	9.76
Kredi 6 muaj – 1 vit	7.71	8.92	9.11
Kredi 1-3 vjet	8.22	8.23	10.0
Kredi mbi 3 vjet	8.52	8.97	9.06
Interesi mesatar i ponderuar	7.79	8.47	9.42
në euro			
Kredi deri në 6 muaj	7.57	8.07	7.63
Kredi 6 muaj – 1 vit	8.07	7.31	8.45
Kredi 1-3 vjet	9.02	8.28	8.45
Kredi mbi 3 vjet	8.25	8.22	8.34
Interesi mesatar i ponderuar	8.17	7.95	8.17

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat tregtare.

Grafik 22. Spread-i i interesave të depozitave 12-mujore lekë – valutë, në terma nominalë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ulja e interesave të depozitave në lekë nga njëra anë dhe rritja e interesave të depozitave në valutë nga ana tjetër, kanë çuar në ngushtimin e spread-it midis interesave të depozitave në lekë me ato në valutë, të cilat në disa raste, arritën nivelet më të ulëta historike.

Gjithsesi, pas një periudhe të gjatë rënëse, ky spread filloi të rritet, me rritjen e interesave të depozitave në lekë. Në fund të vitit, ai arriti në 1.17 pikë përqindjeje për dollarin dhe 2.01 pikë përqindjeje për euron (për afatet 12-mujore).

Boks 4. Norma e interesit në tregun ndërbankar.

Euribor (Euro Interbank Offered Rate), Libor (London Interbank Offered Rate), Tibor (Tokyo Interbank Offered Rate) etj., janë terma të cilëve investitorët i referohen, kur bëhet fjalë për nivelet e normave të interesit të tregut ndërbankar për monedhën e euros, dollarit, jenit etj.. Vitet e fundit është vënë re një interesim në rritje i bankave qendrore të ekonomive të zhvilluara, drejt publikimit të normave të interesit të tregut ndërbankar të parasë¹³. Ky fakt, lidhet me synimin e bankave qendrore për nxitjen e pjesëmarrjes në tregun ndërbankar të parasë, me qëllim thellimin dhe zgjerimin e këtij tregu. Kjo ndikon në krijimin e tregjeve ndërbankare të zhvilluara dhe eficiente të parasë, duke e bërë këtë treg transmetues më të mirë të politikës monetare.

Banka e Shqipërisë, gjatë viteve të fundit, ka intensifikuar përpjekjet për krijimin e një strukture financiare më të zhvilluar dhe eficiente, duke synuar dhe harmonizimin e tregjeve financiare me standardet e Eurozonës. Në këtë kuadër dhe duke marrë parasysh të drejtën ligjore të Bankës së Shqipërisë për nxitjen dhe për mbështetjen e tregut financiar, për herë të parë në 07.02.2007, Banka e Shqipërisë publikoi normat fikse të interesave në tregun ndërbankar të parasë, TRIBID-in (Tirana Interbank Bid Rate)¹⁴ dhe TRIBOR-in (Tirana Interbank Ofer Rate)¹⁵. Llogaritja dhe publikimi

i normave fikse të tregut ndërbankar, synon nxitjen e aktivizimit të mëtijshëm të bankave të nivelit të dytë në tregun ndërbankar të parasë. Kjo, pritet të kontribuojë në eficiencën e qarkullimit të likuiditetit të sistemit bankar, në përcaktimin e çmimit të këtij likuiditeti, në mirëfunksionimin dhe zhvillimin e këtij tregu financiar, duke shërbyer në transmetimin më të mirë të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, këto norma mund të shërbejnë dhe për qëllime referuese, vlerësuese, statistikore dhe kontabilizuese.


Përlllogaritja dhe publikimi i këtyre normave bëhet çdo ditë, për transaksionet me maturim njëjavor, 1-mujor, 3-mujor, 6-mujor dhe 12-mujor. Më konkretisht, përlllogaritja bëhet nga ora 12.30 deri në 13.00 e ditës së punës dhe publikohet menjëherë, në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë ëëë.bankofalbania.org dhe në faqen e saj në REUTERS, me kod TRIBOR. Normat e interesit – TRIBID dhe TRIBOR – në përputhje me praktikën ndërkombëtare, llogariten si mesatare e thjeshtë e kuotimeve të bankave të përzgjedhura. Megjithatë, duke qenë se numri i bankave mund të ndryshojë çdo ditë, në varësi të aktivitetit të bankave në tregun ndërbankar, janë përcaktuar mënyra llogaritjeje të tilla që mënjanojnë kuotimet më ekstreme. Mënyrat e zbatuara janë të tilla, që normat fikse të interesit në tregun ndërbankar të jenë përafshueset më të mira të normave të aplikuara nga bankat aktive, në këtë treg.

III.5 KURSI I KËMBIMIT

Leku ka vijuar të ruajë tendencën mbiçmuese ndaj valutave kryesore edhe gjatë vitit 2006. Gjithsesi, zhvillimet në kursin e këmbimit të lekut kanë konfirmuar ngadalësimin e trendit mbiçmues të tij kundrejt monedhave kryesore. Në terma vjetorë nominalë efektivë, leku është mbiçmuar mesatarisht me 1.1 për qind gjatë vitit 2006. Një vit më parë ky mbiçmim ishte 2.8 për qind.


Ecuria e faktorëve bazë ekonomike, i ka dhënë formë sjelljes së kursit të këmbimit të lekut në periudhën afatgjatë. Kushtet makroekonomike kanë siguruar ambient të përshtatshëm për ruajtjen e pozitive forcuese të lekut, në pesë vitet e fundit. Gjatë kësaj periudhe, ekonomia shqiptare ka përjetuar norma të qëndrueshme rritjeje, në një ambient me norma të ulëta inflacioni. Teoria dhe eksperiencia ekonomike, tregojnë që monedhat me inflacion të ulët kanë prirje për t'u forcuar kundrejt monedhave me inflacion më të lartë. Në katër vitet e fundit, diferencat në inflacion të monedhës tonë kundrejt dollarit dhe euros, kanë qenë në një interval të ngushtë rreth zeros. Gjithashtu, ritmet e larta të rritjes ekonomike shoqërohen me forcim të monedhës në atë masë, që kjo rritje ekonomike përmirëson pozicionin konkurrues të vendit dhe reflektohet në ndryshime strukturore të raportit të çmimeve të mallrave të tregtueshëm dhe të patregueshëm.¹⁷

Grafik 23. Ndryshimet vjetore të NEER¹⁶.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 24. Diferenca e inflacioneve të lekut dhe valutave usd e euro (në pikë përqindjeje).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 25. Diferenca e normave të interesit të depozitave me afat (në pp) dhe NEER.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 26. Ecuria e bilancit të pagesave, e bilancit tregtar dhe e transfertave private (në milionë usd)*.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Pjesa e dytë e vitit 2006 përshin vetëm në dhënat e tremujorit të tretë.

Diferenca e normave të interesit lekë-valutë, edhe pse në rënie gjatë tre viteve të fundit, ka vazhduar të jetë në nivele pozitive, duke mbështetur pozitat e lekut. Bankat qendrore në botë, janë karakterizuar nga politika monetare shtrënguese gjatë vitit 2006. Edhe Banka e Shqipërisë ka qenë pjesë e këtij zhvillimi, duke zbutur trendin rënës të diferencës së normave të interesit lekë-valutë.

Nga ana tjetër, deficiti tregtar në rritje, ka nxitur një kërkesë më të lartë për valutë të huaj. Ky efekt është balancuar nga hyrjet e qëndrueshme valutore, kryesisht në formën e transfertave private, duke bërë që bilanci i pagesave të rezultojë pozitiv. Megjithatë, perspektiva afatgjatë e bilancit të pagesave dhe e kursit të këmbimit, do të ndikohet ndjeshëm nga sigurimi i burimeve të qëndrueshme valutore të ekonomisë, në formën e të ardhurave nga eksportet apo të investimeve të huaja direkte.

Zhvillimet ekonomike gjatë vitit 2006, kanë mbështetur një monedhë vendase të fortë. Presionet mbiçmuese për lekun janë përqendruar kryesisht në muajt korrik-gusht dhe dhjetor. Përveç hyrjes sezonale të valutës, që është faktori kryesor i forcimit të lekut në këtë periudhë, në treg janë reflektuar dhe rritjet e normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë. Oferta e lartë e valutës në këtë periudhë është thithur pjesërisht nga ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë, të cilat kanë synuar përmbushjen e objektivit të rezervës ndërkombëtare neto dhe zbutjen e luhatjeve të tregut valutor. Blerjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor gjatë vitit 2006, kanë qenë rreth 138 milionë usd.


Dobësimi i dollarit kundrejt euros në tregun ndërkombëtar valutor, ka vazhduar të favorizojë prirjen mbiçmuese të lekut kundrejt dollarit, gjatë vitit 2006. Nga ana tjetër, leku ka qenë më i qëndrueshëm kundrejt euros, me prirje të lehtë nënçmuese. Në tregun ndërkombëtar, kursi usd/euro e mbylli vitin në nivelin 1.32 kundrejt nivelit 1.18, që tregtohej në fillim të vitit 2006. Në tregun tonë, dollari amerikan u nënçmua me 9.25 për qind kundrejt lekut, ndërkohë që euro e mbylli vitin rreth 0.9 për qind më lart se hapja e tij.

Në përgjithësi, leku ka paraqitur një luhatshmëri më të ulët kundrejt dy valutave kryesore gjatë vitit


2006, duke iu përmbajtur trendit rënës të vrojtuar ndër vite. Stabiliteti i lekut ka ardhur si rezultat i përmirësimit të funksionimit të tregut valutor dhe i zhvillimeve pozitive në një sërë faktorësh makroekonomikë.

Edhe gjatë këtij viti, në tregun valutor është vënë re një tendencë e zhvendosjes së aktivitetit valutor drejt sistemit bankar. Vëllimi i valutës së tregtuar kundrejt lekut, nga sistemi bankar, është rritur me 36 për qind gjatë vitit 2006. Kjo dëshmon për rritjen e rëndësisë së sistemit bankar si partner në transaksionet e tregut valutor. Ky zhvillim, është nxitur dhe është mbështetur nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet përmirësimeve të marrëdhënieve institucionale me bankat tregtare. Nga ana tjetër, rritja e numrit të bankave dhe e degëve të tyre ka nxitur një konkurrencë më të lartë në sistemin bankar, gjë që është shprehur në ngushtimin e diferencës midis çmimit të blerjes dhe shitjes së valutave që ato aplikojnë, një sinjal i rritjes së eficiencës së tregut valutor bankar.

Grafik 27. Ecuria e lekut kundrejt euros dhe dollarit amerikan.



Grafik 28. Luhatjet e kursit të këmbimit në tremujorë¹⁸.



III.6 INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

- MARRËVESHJET E RIBLERJES DHE MARRËVESHJET E ANASJELTA TË RIBLERJES

Sikundër edhe në vitet e kaluara, marrëveshja e riblerjes me maturim njëjavor me çmim fiks, ishte instrumenti kryesor i përdorur gjatë vitit 2006. Në kushtet e tepcës së likuiditetit të sistemit bankar gjatë dhjetë muajve të parë të vitit, Banka e Shqipërisë tërhoqi, nëpërmjet marrëveshjes së riblerjes me

maturim njëjavor, 3.21 miliardë lekë në nivel mesatar ditor. Për të minimizuar presionet për uljen e interesave në kushtet e tepricës së lartë të likuiditetit gjatë pjesës së parë të vitit, Banka e Shqipërisë ndërhyri në tregun e parasë edhe nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes me afat maturimi më të gjatë se një javë. Marrëveshja e riblerjes me afat maturimi njëmuor u përdor në tre raste, duke tërhequr mesatarisht 0.95 miliardë lekë nga sistemi bankar. Përdorim më të gjerë gjeti marrëveshja e riblerjes me afat maturimi tremujor, nëpërmjet së cilës gjatë periudhës shkurt-gusht 2006, u tërhoqën mesatarisht rreth 3.1 miliardë lekë në ditë.

Rritja sezonale e kërkesës për para gjatë periudhës së verës si dhe përqendrimi i kërkesës së qeverisë në pjesën e dytë të vitit, ulën likuiditetin e sistemit bankar, çka bëri të nevojshëm kthimin e kahut të ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë, në drejtim të injektimit të likuiditetit në sistemin bankar, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2006. Banka e Shqipërisë injektoi likuiditet nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim njëjavor, njëmuor dhe tremujor. Sistemi bankar preferoi huamarrjen me afat më të gjatë maturimi, duke përdorur instrumentin e marrëveshjes së anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, vetëm në tre raste, në shumën 0.93 miliardë lekë. Krahas ndërhyrjes me marrëveshje të anasjelltë repo javore, gjatë dy muajve të fundit të vitit 2006, Banka e Shqipërisë nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim tremujor, injektoi mesatarisht 4.20 miliardë lekë në ditë. Ndërkohë që në një rast gjeti përdorim edhe marrëveshja e anasjelltë e riblerjes, me maturim njëmuor në shumën 1.00 miliardë lekë.

- **TRANSAKSIONET E SHITBLERJEVE ME TË DREJTA TË PLOTA (OUTRIGHTS)**

Për të plotësuar nevojat më afatgjata të tregut me likuiditet, gjatë 4 muajve të fundit të vitit 2006 u kryen katër transaksione blerjeje me të drejta të plota të bonove të thesarit, me vlerë nominale totale prej 3.2 miliardë lekësh.

- **DEPOZITA NJËDITORE**

Për investimin e likuiditeteve të lira, bankat e nivelit të dytë përdorën instrumentin e depozitës njëditore pranë Bankës së Shqipërisë. Në këtë instrument, u investuan mesatarisht 1.58 miliardë lekë në ditë ose 0.82 miliardë lekë më shumë se në vitin 2005. Gjatë vitit 2006 u vu re një rritje e nivelit të likuiditetit të painvestuar (rezervave të lira) dhe rritje e likuiditetit të investuar në instrumentin me afat më të shkurtër maturimi – depozitën njëditore.

- **KREDIA NJËDITORE DHE KREDIA LOMBARD**

Zhvillimi dhe funksionimi më i mirë i tregut ndërbankar gjatë vitit 2006, kanë përforcuar rolin e bankës qendrore si huadhënësja e fundit. Vetëm shtatë, janë rastet e përdorimit të instrumentit të kredisë njëditore gjatë vitit 2006. Pavarësisht mungesës së likuiditetit gjatë tremujorit të tretë të vitit, injektimi i tij nëpërmjet këtij instrumenti ishte mesatarisht 4.58 milionë lekë në ditë, në krahasim me 23.96 milionë lekë, që ishte niveli respektiv gjatë vitit 2005.

Për të katërtin vit rradhazi, instrumenti i fundit kreditues i Bankës së Shqipërisë, kredia lombard nuk pati asnjë rast përdorimi.


• REZERVA E DETYRUAR

Instrumentit i rezervës së detyruar, u përdor në vazhdimësi edhe gjatë vitit 2006, për të tërhequr likuiditetin e sistemit bankar. Ritmi mujor i rritjes së rezervës së detyruar në lekë gjatë vitit 2006, ishte mesatarisht më i lartë se gjatë vitit 2005, 0.92 për qind kundrejt 0.76 për qind, duke reflektuar rritjen në kategoritë respektive që përfshihen në llogaritjen e rezervës së detyruar. Norma e remunerimit për rezervën e detyruar në lekë, në muajin korrik reflektoi rritjen e normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë, duke mbetur konstante në pjesën tjetër të vitit. Në fund të vitit, kjo normë ishte 3.68 për qind në krahasim me vlerën respektive prej 3.50 për qind, të një viti më parë.


Gjatë vitit 2006, bankat kanë përdorur mesatarisht rreth 12.85 për qind të nivelit maksimal të lejuar (20 për qind) të përdorimit të rezervës së detyruar për plotësimin e nevojave ditore për likuiditet, shifër kjo e përafërt me një vit më parë. Përdorimi i kufizuar i kësaj lehtësie është rezultat i tendencës për të mbajtur gjendje të lartë të rezervave të lira, nga një numër i kufizuar i bankave të sistemit. Niveli i gjendjes së llogarisë është mirëadministruar nga bankat e sistemit, duke kufizuar në minimum rastet e mosplotësimit të rezervës.

Tendenca në rritje e rezervës së detyruar në euro, rikonfirmoi preferencën e depozituesve për këtë monedhë, ndërkohë që rezerva e detyruar në dollarë, e konvertuar në monedhën vendase, mbeti pothuajse konstante gjatë gjithë vitit, duke patur të njëjtën sjellje si në vitin 2005. Interesi i remunerimit të rezervës së detyruar në valutë, reflektoi rritjen e normave të liborit dhe euriborit. Rritjen më të lartë e pati interesi i remunerimit të rezervës së detyruar në euro, i cili në krahasim me fundvitin 2005 është rritur me 0.69 pikë përqindje, në nivelin 2.36 për qind, ndërsa interesi i remunerimit të rezervës së detyruar në usd është rritur me 0.55 pikë përqindjeje, në nivelin 3.72 për qind.

Grafik 29. Ecuria e rezervës së detyruar në lekë e sistemit bankar dhe norma e remunerimit.



Grafik 30. Ecuria e rezervës së detyruar në valutë e sistemit bankar dhe norma e remunerimit.



III.7 ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

Gjatë vitit 2006 rezerva valutore bruto, e vlerësuar dhe e raportuar në usd, është rritur me 368.06 milionë usd, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor, vlerën 1,793.12 milionë usd. Ndër faktorët që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e rezervës bruto përmendim:

- hyrje nga lëvrimi i huave të dhëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) etj., në masën 120.93 milionë dollarë;
- veprime të blerjes së valutës nga bankat tregtare, nga Ministria e Financave dhe nga institucione të tjera, në shumën 204.79 milionë dollarë:
 - 138.53 milionë usd (sistemi bankar),
 - 63.7 milionë usd (Ministria e Financave),
 - 2.56 milionë usd (institucione të tjera);
- derdhje nga bankat e nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë, për plotësimin e rezervës së detyruar apo dhe për veprime të tjera që lidhen me kapitalin e tyre, 75.39 milionë usd;
- të ardhura të siguruara nga investimi i rezervës valutore deri në fund të muajit dhjetor, në rreth 45.5 milionë usd;
- luhatjet në kursin e këmbimit të monedhave në përbërje të rezervës valutore, kanë ndikuar ndjeshëm vlerën e rezervës bruto, duke regjistruar një efekt pozitiv gjatë vitit 2006, rreth 106.03 milionë usd.

Rezerva bruto është ndikuar negativisht nga daljet, që arrijnë në 214.73 milionë usd. Këto dalje përfaqësohen nga transfertat e kryera me urdhër të Ministrisë së Financave, të bankave tregtare e të tjera (në total rreth 135.86 milionë dollarë) si dhe nga kryerja e pagesave të borxhit të jashtëm për Qeverinë Shqiptare (67.65 milionë usd) apo shlyerja e detyrimeve të Bankës së Shqipërisë ndaj FMN-së (11.22 milionë usd).

Boks 5. Zhvillimet në kuadrin e programit RAMP.

Në vijim të marrëveshjes së nënshkruar me Bankën Botërore në shtator të vitit 2005, gjatë vitit 2006, Banka e Shqipërisë ka vijuar të asistohet nga Banka Botërore, në aktivitetin e kryer për administrimin e rezervës valutore.

Ristrukturimi rrënjësor i bazës rregullative, që lidhet me administrimin e rezervës valutore përbën një ndër zhvillimet kryesore për vitin 2006. Në thelb të këtij restrukturimi qëndron delegimi i kompetencave nga Këshilli Mbikëqyrës drejt strukturave si: Komiteti i Investimit dhe Departamenti i Operacioneve Monetare. Këshilli Mbikëqyrës miraton kriteret e përgjithshme të administrimit të rezervës valutore, duke shprehur në mënyrë të qartë objektivat dhe kufizimet që do të shoqërojnë procesin në përputhje me nevojat afatgjata, afatmesme dhe afatshkurtra për likuiditete, të përcaktuara në ligjin e Bankës së Shqipërisë dhe dokumente të tjera themelore. Mbi bazën e këtyre kriterëve, strukturat e tjera zhvillojnë dhe sigurojnë përdorimin e metodologjive të duhura për caktimin e benchmark-ëve, hartojnë procedura, përzgjedhin institucionet financiare apo realizojnë çdo aktivitet tjetër, të nevojshëm në kuadrin e administrimit të rezervës valutore. Ndarja hierarkike e përgjegjësisë, e ka bërë procesin e administrimit të rezervës valutore mjaft fleksibël dhe pranë standardeve botërore më të mira, të njohura në këtë fushë, si në aspektin e arritjes së objektivave të kthimit ashtu edhe rrezikun që shoqëron investimin.

SHËNIME

¹ Matja e treguesve monetarë për efekt të hartimit të programit, bazohet në standardin e “Statistikave Monetare”, i cili ndryshon lehtësisht nga standardi i Statistikave Financiare Ndërkombetare. Megjithëse ndryshimet në këto standarde janë objekt i standardizimit të të dhënave me vendet e tjera, ato nuk përbëjnë ndryshim thelbësor për efekt të hartimit dhe zbatimit të politikës monetare.

² Ritmi mesatar vjetor i rritjes, llogaritet si mesatare dymbëdhjetë mujore e rritjes vjetore të treguesit.

³ Agregati M2, përbëhet nga para ja jashtë bankave dhe depozitat në lekë, ndërsa M3 përfshin M2 dhe depozitat në valutë.

⁴ Të dhënat në seksionin e zhvillimeve monetare raportohen sipas standardit të “Statistikave Ndërkombetare Financiare”. Kundrejt standardit të “Statistikave Monetare” shifrat mund të pasqyrojnë ndryshime të lehta.

⁵ Reduktimi i ndjeshëm i kredisë për bujqësinë mbas muajit qershor 2006, ka ardhur si rezultat i rishikimit të portofolit të njëjës prej bankave të sistemit.

⁶ Devijimet e ndjeshme gjatë tremujorit të dytë, kanë ardhur kryesisht si pasojë e prezantimit për herë të parë, të formularit sipas rretheve.

⁷ Huamarrja e qeverisë në kushtet e suficitit buxhetor ka rezultuar në rritjen e tepricave të likuiditetit të qeverisë.

⁸ Nga privatizimi i pjesës shtetërore të Bankës Italo-Shqiptare.

⁹ Sipas kriterëve të Mastroiitit, deficiti buxhetor vjetor ndaj PBB-së nuk duhet të kalojë nivelin 3 për qind. Norma e borxhit bruto të qeverisë ndaj PBB-së nuk duhet të kalojë nivelin 60 për qind.

¹⁰ Ky korridor u ndryshua në korrik të vitit 2005, nga një korridor asimetric (+2.50/-3.00 pikë përqindjeje) rreth normës bazë të interesit, në një korridor simetric (+1.75/-1.75 pikë përqindjeje).

¹¹ Në të njëjtën kohë janë rritur dhe interesat për depozitat në lekë për afate 24-mujore, por ky tregues, i llogaritur si mesatare e ponderuar për të gjithë sistemin bankar, rezulton më i ulët se në muajin qershor, për shkak të strukturimit kohor të depozitave nga një bankë.

¹² Kostoja e ndërmjetësimit është llogaritur si ndryshim i normës së interesit të kredisë me atë të depozitave, për të njëjtën monedhë.

¹³ “Tregu ndërbankar i parasë” është tregu ku bankat e nivelit të dytë kryejnë ndërmjet tyre veprime huamarrjeje dhe huadhënieje në monedhën vendase-lek.

¹⁴ Norma fikse e interesit, e llogaritur bazuar në kuotimet e bankave referencë për të pranuar depozita në tregun ndërbankar të parasë.

¹⁵ Norma fikse e interesit, e llogaritur bazuar në kuotimet e bankave referencë për të vendosur depozita në tregun ndërbankar të parasë.

¹⁶ NEER – kursi nominal efektiv i këmbimit, i llogaritur kundrejt dy monedhave sipas një peshe të përafërt që zënë në tregtinë me jashtë, euro (80 për qind) dhe usd (20 për qind). Që nga muaji prill 2004, NEER është mbi nivelin 100. Një rritje e NEER do të thotë mbiçmim i lekut.

¹⁷ Një fenomen i tillë njihet në literaturë si efekti Balassa-Samuelson.

¹⁸ Llogaritur si mesatare tremujore e luhatshmërisë së kursit të këmbimit. Luhatshmëria e kursit të këmbimit është matur si devijim standard $[\sum (x_i - i)^2 / (n - 1)]^{1/2}$, x_i - kursi i këmbimit në periudhën i , i - mesatarja e periudhës i (për shembull, kursi i këmbimit në një ditë të muajit të caktuar në vitin i , minus kursin mesatar të muajit, në vitin i).

	Fq.
FJALA E GUVERNATORIT	11
KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE	1 31
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2 43
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET	3 85
KAPITULLI IV MBIKËQYRJA BANKARE	4 117
KAPITULLI V. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	5 131
KAPITULLI VI. RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2006	6 151

KAPITULLI IV. MBIKËQYRJA BANKARE

IV.1 ECURIA E SISTEMIT BANKAR

Sistemi bankar vijoi zhvillimin e tij të qëndrueshëm edhe gjatë vitit 2006. Gjendja e tij financiare vlerësohet e kënaqshme, me një ecure në nivele të mira dhe të qëndrueshme të treguesve të rentabilitetit; me një mjaftueshmëri të kapitalit mbi nivelin minimal të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë por me një prirje të lehtë në rënie, si shprehje e konsolidimit të tij; me një rritje të thellësisë së ndërmjetësimit bankar, e shprehur në rritjen e raportit të portofolit të huave ndaj totalit të aktiveve të bankave si edhe në rritjen e raportit të totalit të aktiveve të bankave në tërësi ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB); me një zgjerim në vazhdimësi të rrjetit të bankave dhe hyrjen në treg të bankave të reja; me shtimin e produkteve të reja bankare, si ATM dhe e-banking, dhe rritje të përdorimit të tyre¹ si shprehje e rritjes së vëllimit të aktivitetit bankar në tërësi; si edhe me një situatë likuiditeti të kënaqshme, ku Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol aktiv në ofrimin e instrumenteve lehtësuese, për mundësimin e administrimit të likuiditetit të sistemit bankar.

Rezultati neto i sistemit bankar për vitin 2006 ishte me fitim prej rreth 7.45 miliardë lekësh, rreth 12.9 për qind më shumë se viti 2005. Për vitin 2006, kjo shifër është 0.83 për qind e PBB-së, krahasuar me 0.79 për qind një vit më parë.

	Dhjetor '04	Dhjetor '05	Dhjetor '06
Rezultati neto	5.11	6.60	7.45

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Rezultati neto (në miliardë lekë).

Të ardhurat nga aktivitetet kryesore, të cilat përfaqësohen nga të ardhurat neto nga interesi, rezultuan 31.2 për qind më shumë se një vit më parë, duke reflektuar orientimin e sistemit bankar në veprimtari me kthim më të lartë² (dhe nivel rreziku më të lartë); ndryshimin e strukturës së maturimit të aktiveve me rrezik të lartë³; si edhe rritjen e vëllimit të aktiveve në tërësi, në kushtet kur rritja e interesit bazë për të treja monedhat kryesore të bilancit (lekë, euro dhe usd), përgjithësisht pasqyrohet më shpejt në normën e interesit për aktivet, krahasuar me pasivet.

Zhvillimet pozitive në treguesin e të ardhurës neto nga interesat, u reflektuan edhe në ecurinë e treguesit të marzhit neto nga interesat (NIM), i cili është rritur me rreth 0.5 për qind. Në këtë ecure të NIM, kanë kontribuar pothuaj në të njëjtën masë, si rritja e kthimit nga aktivet mesatare që sjellin interes (të ardhura), ashtu edhe rënia e kostos së financimit të aktiveve mesatare që sjellin interes. Gjykojmë që rënia e komponentit të dytë të treguesit të NIM,

kur normat bazë të interesit për monedhat kryesore janë rritur, është e lidhur me rënien e peshës së depozitave ndaj totalit të burimeve në 83.3 për qind (nga 87.2 për qind), si edhe me rritjen e konsiderueshme të burimeve pa kosto⁴, si për shembull, kapitali i paguar.

Tabelë 2. Marzhi neto nga interesi (në përqindje).

	Dhjetor '04	Dhjetor '05	Dhjetor '06
Të ardh. nga int. / aktiv. mes. që sjellin të ardh.(1)	6.96	6.81	7.05
Shpenz. për int. / aktiv. mes. që sjellin të ardh.(2)	3.88	3.08	2.83
Marzhi neto nga interesat (NIM)[(1) – (2)]	3.08	3.73	4.22

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2006, e ardhura neto nga interesat ishte 92.6 për qind e të ardhurave bruto të sistemit bankar⁵, krahasuar me 84 për qind në fund të vitit 2005. Ky tregues, ka shënuar rritje të vazhdueshme, veçanërisht në tre vitet e fundit, duke shprehur qëndrueshmërinë e të ardhurave neto në tërësi për sistemin bankar.

Performanca e treguesve kryesorë të rentabilitetit, përkatësisht kthimi nga aktivet mesatare (RoAA) dhe kthimi nga kapitali mesatar (RoAE), ishte mjaft e mirë edhe për vitin 2006.

Tabelë 3. Treguesit e rentabilitetit (në përqindje).

	Dhjetor '04	Dhjetor '05	Dhjetor '06
RoAA	1.28	1.40	1.36
RoAE	21.10	22.24	20.17

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sistemi bankar shënoi një rënie të lehtë të kthimit nga aktivet mesatare dhe nga kapitali mesatar aksioner. Megjithatë, kahu i kundërt i lëvizjes së RoAA dhe RoAE ndaj treguesit të NIM, flet për ndikimin më të madh që ka dhënë rritja e shpenzimeve të veprimtarisë dhe provigjonet, në të ardhurën neto të sistemit bankar. Gjykojmë që zhvillimet në shpenzimet e veprimtarisë dhe në provigjone, tregojnë përgjithësisht për një rritje të aktivitetit të sistemit bankar dhe për përmirësim të ndërmjetësimit.

Rënia e RoAA me 0.04 për qind, shpjegohet me ritmin më të lartë të rritjes së aktiveve mesatare (16.7 për qind), ndaj të ardhurës neto. Edhe për RoAE, rritja më e shpejtë e kapitalit mesatar aksioner ndaj të ardhurës neto, përbën thelbin e rënies. Në ecurinë e këtyre treguesve, ndikon edhe hyrja në treg e bankave të reja, të cilat në fazën fillestare të veprimtarisë së tyre kontribuojnë më tepër në drejtim të rritjes së aktiveve të sistemit dhe më pak në drejtim të rezultatit të tij financiar.

Nivelet relativisht të larta të kthimit nga kapitali aksioner, nuk i kanë nxitur aksionerët për shpërndarje të fitimeve. Përkundrazi, të ardhurat kanë shërbyer si një mbështetje e mirë e bankave, për zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarisë.

Edhe gjatë vitit të kaluar, kontributin kryesor në rritjen e aktiveve të sistemit bankar e dhanë bankat e mëdha (të grupuara në Grupin 3), ndonëse pesha e tyre në treg, vjen në rënie. Llogaritjet tregojnë që niveli i përqendrimit për aktivitetin e kredidhënies është më i ulët (konkurrenca këtu është më e lartë), krahasuar me nivelin e përqendrimit për aktivet dhe për depozitat.

Tabelë 4. Indeksi H (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve dhe depozitave.

	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Indeksi H (aktivet)	0.37	0.32	0.30	0.27	0.21	0.18
Indeksi H (pasivet)	0.43	0.37	0.35	0.31	0.24	0.20
Indeksi H (kredia)	0.20	0.17	0.15	0.11	0.10	0.11

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2006, aktivet e sistemit bankar shënuan rritje me 127.7 miliardë lekë (ose 25.7 për qind), rreth 57.6 miliardë lekë më shumë se rritja e aktiveve e evidentuar në vitin 2005. Krahas bankave të mëdha, në zgjerimin e bilancit të sistemit kontribuan dhe disa nga bankat e mesme e të vogla.

Tabelë 5. Ecuria në vite e totalit të aktiveve.

	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03	Dhjetor '04	Dhjetor '05	Dhjetor '06
Totali i aktiveve (miliardë lekë)	270.8	318.5	339.3	373.6	426.4	496.6	624.3
Total aktive /PBB	50.2	53.5	51.6	50.2	51.9	59.3	69.4
Total kredi /PBB ⁶	5.3	4.7	5.9	6.8	8.5	15.3	22.0


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Teprica e kredisë së sistemit bankar⁷, gjatë vitit 2006, shënoi rritje me 70.2 miliardë lekë ose 55 për qind, nga 57.6 miliardë lekë për vitin e mëparshëm. Ndërkohë, teprica e kredisë në lekë është rritur me 24.4 miliardë lekë ose 78.2 për qind, ndërsa teprica e kredisë në valutë është rritur me 45.7 miliardë lekë ose 47.4 për qind. Ecuria në rritje e kredidhënies flet për kërkesën e lartë të ekonomisë për financim dhe për mundësitë, gjithnjë në rritje të sektorit bankar, për të përmbushur këtë kërkesë.

Shtirja e konsiderueshme në kredidhënie është shoqëruar me rritjen e madhësisë së portofolit të kredive me probleme, me rreth 3.1 miliardë lekë ose 103 për qind, krahasuar me fundin e vitit 2005. Në fund të 2006-ës, treguesi i cilësisë së portofolit të kredisë, i shprehur si raport i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredive në terma bruto, llogaritet 3.1 për qind ndaj 2.3 për qind, në fund të vitit 2005.

Aftësia e sistemit bankar për të mbuluar me kapital humbjet e rrjedhura nga kreditë⁸ shënon rënie, por mbetet në nivele të mira. Ky tregues është ndikuar nga ritmi më i lartë rritës i tepricës neto të kredisë me probleme⁹ (+120 për qind) kundrejt rritjes së

Grafik 1 Peshat e grupbankave në sistem sipas totalit të aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

kapitalit rregullator (+41.2 për qind). Treguesi “kredi me probleme/tepricës së kredisë (neto)”, i cili vlerëson madhësinë neto të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë, vazhdon të llogaritet në nivele të ulëta, prej 1.4 për qind në fundvitin 2006.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin, në fund të vitit 2006 paraqitet në nivelin 18.1 për qind, duke shënuar një rënie prej 0.5 pikë përqindjeje, krahasuar me fundin e vitit 2005. Rënia e lehtë e këtij raporti, i atribuohet ndryshimeve të përafërta të përbërësve të tij. Konkretisht, kapitali rregullator i sistemit është rritur me rreth 41 për qind, ndërsa totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit, të ponderuara me koeficientët e rrezikut, është rritur me rreth 45 për qind. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për vitin 2006, vazhdon të ruajë prirjen rënëse, të shfaqur gjatë viteve të mëparshme. Vlera e këtij treguesi për bankat individuale, në fund të dhjetorit 2006, varionte nga 12.4 për qind deri në 166.1 për qind. Gjatë vitit, vlera e tij minimale e kërkuar prej 12 për qind, është shkelur përkohësisht vetëm në dy raste. Bankat e mëdha shënojnë një rritje të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, kryesisht si rezultat i rritjes së kapitalit rregullator në fund të vitit, me rreth 62.3 për qind.

Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit vazhdon të shfaqë nivele më të larta në grupin e bankave të vogla (G1) me rreth 41.3 për qind, i ndjekur nga grupi i bankave të mesme (G2) dhe atyre të mëdha (G3), përkatësisht me rreth 15.9 për qind dhe 16 për qind.

Bankat e grupit G1, paraqesin një rritje të konsiderueshme të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit me rreth 6 pikë përqindje, si rrjedhojë e rënies së aktiveve dhe zërave jashtë bilancit, të ponderuar me koeficientët e rrezikut me rreth 6.9 për qind, ndërkohë që kapitali rregullator është rritur me rreth 10.7 për qind. Si shkak kryesor për këtë rritje të treguesit të mjaftueshmërisë për grupin e bankave të vogla, konsiderohet ndryshimi që pësoi përbërja e këtij grupi, gjatë tremujorit të parë të vitit 2006.

Tabelë 6. Mjaftueshmëria e kapitalit (në përqindje).

	Sistemi bankar	G1	G2	G3
Dhjetor 2006	18.1	41.3	15.9	16
Dhjetor 2005	18.6	35.0	19.4	14.4
Dhjetor 2004	21.6	47.3	17.8	17.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2006, raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve të sistemit bankar, shënoi vlerën 57.6 për qind, krahasuar me 62.6 për qind që ishte në fund të dhjetorit 2005. Bankat në përgjithësi, vazhdojnë të shënojnë nivele të kënaqshme likuiditeti, ndërsa sistemi bankar paraqitet me tepriçë likuiditeti. Bazuar në të dhënat operative, bankat e sistemit kanë qenë më aktive në treg krahasuar me vitin 2005, gjë e cila është reflektuar në rritjen prej rreth 7 për qind, të vëllimit mesatar të transaksioneve mujore ndërbankare.

Gjithashtu, depozitat pranë bankave, të cilat përbëjnë peshën kryesore të burimeve të sistemit, kanë patur prirje rritëse gjatë vitit 2006. Politika

monetare e kujdeshme e Bankës së Shqipërisë, për mbajtjen nën kontroll të inflacionit dhe normës reale të kthimit në lekë, rritja e normave të interesit të depozitave në usd dhe euro, si edhe zgjerimi i rrjetit të bankave të sistemit, kanë kontribuar në qëndrueshmërinë e depozitave në sistem.

Edhe dinamika e likuiditetit, vlerësohet normale për vitin 2006. Banka e Shqipërisë, me anë të kombinimit të instrumenteve të operacioneve të tregut të hapur, si marrëveshjet repo dhe të anasjellta repo dhe shitja/blerja e letrave me vlerë me të drejta të plota, ka administruar situatën e likuiditetit në tregun ndërbankar. Bankat kanë përdorur gjithashtu, instrumentet e kredisë njëditore dhe të depozitës njëditore, për përmbushjen e nevojave të tyre ditore për likuiditet.

IV.2 LICENCIMI DHE KUADRI RREGULLATOR

Në fund të vitit 2006, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, që rregullon veprimtarinë e bankave dhe degëve të bankave të huaja, që veprojnë në vend. Ligji ishte fryt i përvojës së zhvillimeve disavjeçare në sistemin bankar shqiptar si edhe i harmonizimit të saj me praktikat dhe përvojat më të mira evropiane. Ai, parashikon në mënyrë më të detajuar kërkesat për licencimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja, për transparencën e bankave me publikun, për standarde më të mira për përgjegjshmërinë në drejtimin e bankave, për procesin e kujdestarisë dhe të likuidimit, për ekspertët kontabël të autorizuar, për nevojat për kapital, për mbikëqyrjen e konsoliduar etj., me qëllim përmbushjen e objektivit për sigurimin e stabilitetit financiar.

Përgatitja e këtij ligji, si edhe e akteve të tjera rregullative, përfaqësoi një zhvillim të rëndësishëm, në fushën e mbikëqyrjes bankare, gjatë vitit 2006.

Mbi bazën e standardeve më të mira për një mbikëqyrje efektive, të përcaktuara nga Komiteti i Bazelit, gjatë vitit 2006 vazhdoi puna për pasurimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullativ mbikëqyrës. Kështu, u miratua një rregullore e re dhe u ndryshuan disa rregullore ekzistuese.

Konkretisht, u hartua dhe u miratua rregullorja “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”. Ajo synon të vendosë disa kritere bazë, të cilat duhen zbatuar nga subjektet e saj, me qëllim minimizimin e rrezikut që mund të vijë nga papërshtatshmëria ose keqfunksionimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Këto kërkesa, parashihen të jenë fleksibël, për vetë nivelin e zhvillimit dhe ndryshimit shumë të shpejtë në këtë fushë.

Në vijim, u ndryshuan dhe u miratuan këto rregullore dhe udhëzime:

- a) rregullorja “Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre”. Ndryshimi saktëson elementet e llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit;

- b) rregullorja “Për administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja”. Ndryshimi lejon që anëtarët e komitetit të kontrollit të bankës, të jenë në të njëjtën kohë edhe anëtarë të këshillit drejtues të saj. Kështu, synohet një integrim më i mirë i informacionit rreth bankës dhe rritja e përgjegjshmërisë së strukturave drejtuese, në kontrollin dhe në administrimin e saj;
- c) udhëzimi “Për kapitalin rregullator të bankës”, ku u shtuan kërkesat për verifikimin më të plotë të burimeve financiare të aksionerëve që ofrohen ndaj bankës, në formën e borxhit të varur;
- d) rregullorja “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”. Ndryshimi, mundëson që në rastin e ndërrimit të aksionerit indirekt, sikurse parashikohet edhe në rastin e ndërrimit të aksionerit direkt, banka është e detyruar të kërkojë miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë dhe të plotësojë dokumentacionin e kërkuar, sipas kësaj rregulloreje;
- e) rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë”. Ndryshimi synoi rritjen e kërkesave për administrimin më të mirë nga sistemi bankar të zhvillimeve në fushën e kredisë dhe ruajtjen e cilësisë së saj. Ndër më kryesoret mund të përmendim: saktësime lidhur me nevojën e përmirësimit të sistemeve të analizës së bankave, për portofolet e kredisë sipas karakteristikave të tyre, me qëllim monitorimin në kohë reale të zhvillimeve të këtyre portofoleve; kërkesa të reja lidhur me:
 - i) transparencën e bankave me klientët e tyre kredimarrës të motivuara nga praktika, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga njëra anë dhe të bankës nga ana tjetër, si edhe për zhvillimin e konkurrencës në tregun bankar;
 - ii) përcaktimin e disa kërkesave lidhur me veprimet që duhet të ndërmerren strukturat drejtuese të bankës, me qëllim që të administrojnë më mirë rrezikun e kredisë dhe të ruajnë cilësinë e portofolit të saj. Kërkesat janë të tilla që sigurojnë në të njëjtën kohë, fleksibilitetin e duhur në zhvillimin e veprimtarisë, si edhe ofrojnë elementet e nevojshme për një vendimmarrje të shpejtë, në drejtim të ruajtjes së cilësisë së kredisë; plotësime lidhur me a) elementin – garanci në procesin e kredimarrjes, me qëllim mirësigurimin e kredisë dhe; (b) përcaktime të ruajtjes së klasifikimit të kredisë, me qëllim kryerjen e këtij procesi në mënyrë të dokumentuar dhe të kujdesshme.

LICENCIMI

Gjatë vitit 2006, sistemi bankar njohu zhvillime të rëndësishme sasiore dhe cilësore. Në fund të vitit, sektori bankar shqiptar përbëhej nga 17 banka, prej të cilave 3 ishin me kapital privat tërësisht shqiptar.

Në fillim të vitit 2006 nisi aktivitetin e saj Banka Union. Në muajin shkurt, iu dha miratimi paraprak për licencë Bankës së Parë të Investimeve sh.a. (në procesin e transformimit të saj nga degë në filial të Bankës së Parë të Investimeve në Bullgari).

Ndryshimet në pronësinë e kapitalit të bankave janë tregues të interesit të grupeve të fuqishme financiare dhe bankare evropiane për investime në sektorin bankar shqiptar. Konkretisht:

- Në maj të vitit 2006 u miratua shitja e 80 për qind të aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Italo-Shqiptare, që i përkisnin Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Capitalia S.A., Itali, tek aksioneri i ri SanPaolo IMI S.p.A., Itali.
- Në të njëjtën periudhë, u miratua transferimi i pronësisë së 60 për qind (plus 2 aksione) të aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Kombëtare Tregtare nga Kent Bank/Bayindir Bank, tek aksioneri i ri institucional turk, Çalik-Seker Konsorsiyum Yatirim Anonim.
- Në gusht të vitit 2006 u miratua transferimi i pronësisë së 11.25 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës ProCredit, nga BERZH tek ProCredit Holding AG (aksioner ekzistues).
- Në tetor të vitit 2006, u miratua transferimi i 71.97 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës Emporiki S.A. të Greqisë, tek aksioneri Credit Agricol S.A., Francë. Ky transferim, ndikon edhe në pjesëmarrjen indirekte të Credit Agricol S.A. tek kapitali aksioner i Bankës Emporiki të Shqipërisë sh.a., në të njëjtën masë.

Ndryshime priten të ndodhin në aksionerët e Bankës Italo-Shqiptare dhe të Bankës Amerikane të Shqipërisë, në kushtet kur aksioneri i tyre SanPaolo IMI S.p.A. është përthithur nga Banka Intesa dhe është krijuar shoqëria e re Intesa-SanPaolo S.p.A.. Këto ndryshime do të shqyrtohen nga Banka e Shqipërisë pas paraqitjes së dokumentacionit, sipas kërkesave të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë".

Zgjerimi i rrjetit të bankave brenda territorit të Shqipërisë, vijoi edhe gjatë vitit 2006. Kështu, u shtuan edhe 62 degë dhe agjenci të reja, me një shtrirje në të gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj. Peshën më të madhe e zë rrethi i Tiranës, me 30 degë dhe agjenci të reja, të hapura. Në këtë mënyrë, mbulohen me shërbime bankare jo vetëm zonat ku janë përqendruar aktivitetet e biznesit të prodhimit, të tregtisë dhe të shërbimit por edhe ato periferike.

Gjatë vitit, u dha miratimi për dy degë të bankave jashtë territorit të Shqipërisë dhe dy degë të tjera janë në proces miratimi.

Tabelë 7. Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2006.

Nr	Bankat	Nr. i degëve brenda vendit	Nr. i agjencive	Nr. i degëve jashtë Shqipërisë
1	Banka Raiffeisen	37 ¹⁰	46	
2	Banka Kombëtare Tregtare	21	10	1 ¹¹
3	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	3	1	
4	Banka Italo-Shqiptare		6	
5	Banka Italiane e Zhvillimit	1 ¹²		
6	Banka Tirana	32	4	
7	Banka Kombëtare e Greqisë Dega Tiranë	4	6 ¹³	
8	Banka Ndërkombëtare Tregtare	5		
9	Dega e Bankës Alfa -Tiranë	9	1	
10	Banka Amerikane e Shqipërisë	8	11	2
11	Banka ProCredit	21	1	
12	Dega në Tiranë e Bankës së Parë të Investimeve	1	2	
13	Banka Emporiki	3	4	
14	Banka e Kreditit të Shqipërisë	2	1	
15	Banka Credins	11	4	
16	Banka Popullore	29		
17	Banka Union	3	4	
	TOTALI	190	101	3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2006, janë paraqitur nga bankat 71 kërkesa për miratim administratorësh të emëruar prej tyre, si kërkesë e ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Nuk ka patur vendime, për refuzimin e miratimit të administratorëve të emëruar nga bankat.

Po kështu, është kërkuar rritja e nivelit të licencës nga niveli i parë në nivelin e dytë, nga Banka Amerikane e Shqipërisë dhe Banka Italo-Shqiptare. Pritet plotësimi i dokumentacionit nga bankat, në zbatim të rregullores përkatëse për dhënien e miratimit nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë është njoftuar për ndryshimet në statutet e bankave, që lidhen me rritjen e kapitalit themeltar, ndryshimin e strukturës së aksionerëve dhe të pronësisë mbi aksionet në masën nën 10 për qind të kapitalit të bankës etj.. Këto ndryshime, pasqyrohen në regjistrin e bankave që mbahet në Bankën e Shqipërisë dhe në degët e saj në rrethe.

Bankat kanë plotësuar nivelin e kapitalit fillestar minimal të kërkuar dhe të regjistruar, në zbatim të vendimeve nr. 3 dhe nr. 4, datë 26.01.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për një ndryshim në rregulloren “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”.”.

Gjatë vitit të kaluar, në Bankën e Shqipërisë u paraqitën 9 kërkesa për licencim të zyrave të këmbimit valutor dhe të gjitha këto u miratuan. Në të njëjtën kohë, për shkak të parregullsive të konstatuara nga inspektimet në vend, iu revokua licenca 7 zyrave të tjera.

U licencuan 4 shoqëri të reja të kursim-kreditit dhe iu revokua licenca 10 shoqërive të tjera. Shoqëritë e kursim-kreditit, të cilave iu është revokuar licenca, janë bashkuar mbi bazën e 6 shoqërive ekzistuese të kursim-kreditit.

Gjatë vitit 2006, filloi procedura e miratimit të produkteve elektronike të përdorura nga bankat e nivelit të dytë në shërbim të klientelës. Ajo që vihet re është vendosja e shërbimeve të ATM-ve dhe emetimi i kartave të debitit dhe të kreditit pothuajse në të gjitha bankat, çka jo vetëm rrit shpejtësinë e shërbimit por edhe cilësinë e tij. Shërbimi i *e-banking* është shtrirë në disa banka.

Në fund të vitit 2006, pas ndryshimeve të ndodhura, lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë sipas viteve paraqitet si më poshtë:

Tabelë 8. Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Nr	Subjektet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
1	Banka dhe degë të bankave të huaja	13	13	14	15	16	17	17
2	Subjekte financiare jobanka	2	4	5	7	7	7	6
3	Zyra të këmbimit valutor	19	38	58	58	54	58	60
4	Shoqëri të kursim-kreditit	- -	- -	113	131	130	131	125
5	Unione të shoqërive të kursim- kreditit	- -	- -	2	2	2	2	2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

IV.3 INSPEKTIMET NË VEND

Gjatë vitit 2006, janë kryer 14 inspektime të plota dhe 13 inspektime të pjesshme pranë bankave tregtare, 5 inspektime të plota në subjektet financiare jobanka, 2 inspektime të plota në shoqëritë e kursim-kreditit dhe 53 inspektime pranë zyrave të këmbimit valutor. Gjithashtu, në kuadër edhe të rritjes së kërkesës për hapje degësh të reja nga bankat, janë realizuar rreth 70 inspektime për sigurinë e mjediseve të punës të këtyre degëve dhe të zyrave të këmbimit valutor.

Inspektimet në vend, kanë synuar verifikimin e përputhshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë bankare sipas kuadrit rregullativ në fuqi, si dhe garantimin e një gjendjeje financiare të shëndoshë të sistemit bankar në tërësi, dhe për çdo bankë në veçanti.

Në analizat periodike, janë evidentuar çështjet më të rëndësishme që kanë rezultuar nga kontrollet individuale, duke mundësuar që një kohë të dytë të bëhen përgjithësime në nivel sistemi.

Ndër këto çështje mund të veçohen: ritmi i rritjes së kredisë për ekonominë dhe përbërjen e saj (sipas valutës, kohëzgjatjes, sektorëve); efektet në mjaftueshmërinë e kapitalit, si rezultat i ndryshimeve të supozuara në normat e interesit, në kursin e këmbimit dhe në përkeqësimin e mundshëm të cilësisë së kredisë (analiza stress-test); domosdoshmëria për përmirësimin e vazhdueshëm të qeverisjes, të transparencës dhe të kontrollit të brendshëm në bankat e nivelit të dytë; përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit; raportimi dhe probleme të tjera.

Reagimi i bankave ndaj rekomandimeve dhe masave të propozuara nga Banka e Shqipërisë, ka qenë i shpejtë dhe përgjithësisht i plotë. Sidoqoftë,

të gjitha bankat duhet të bëjnë kujdesin maksimal për të vepruar në çdo rast brenda kërkesave të kuadrit rregullativ, në mënyrë që të zhvillojnë një veprimtari bankare të qëndrueshme dhe të ekuilibruar.

SHËNIME

¹ Nga të dhënat operative, raportohen 6 banka të cilat kanë prezantuar produktin e ATM-ve dhe 7 të tilla që kanë prezantuar veprimtarinë e e-banking.

² Pesha e huave në totalin e aktiveve të sistemit u rrit në 31.5% në fund të vitit 2006, nga 25.6% në fund të vitit 2005.

³ Pesha e huave afatmesme u rrit në 33.2% ndaj 29.7% një vit më parë, ndërkohë që pesha e huave afatshkurtra u pakësua në 28.8% nga 32.3% në fund të vitit 2005. Theksojmë se interesi mesatar i ponderuar për huatë afatmesme llogaritet më i lartë se për huatë afatshkurtra, veçanërisht për huatë në lekë.

⁴ Përgjithësisht, rastet e shpërndarjes së dividendit nga bankat në Shqipëri, janë mjaft të rralla.

⁵ Totali i rezultatit neto nga interesat dhe veprimtaritë e tjera.

⁶ Totali i kredisë përfshin kredinë dhënë rezidentëve dhe jorezidentëve.

⁷ Kredia e dhënë në total nga sistemi bankar, duke përfshirë dhe kredinë për jorezidentët.

⁸ Raporti "kredi me probleme neto / kapitalit rregullator" llogaritet 6.8 për qind, nga 4.3 për qind në fundin e vitit 2005.

⁹ Teprica neto e kredisë me probleme për sistemin bankar, evidentohet 2.6 miliardë lekë nga 1.2 miliardë lekë në fundvitin 2005.

¹⁰ Është bërë saktësimi i numrit të degëve dhe agjencive të bankës, mbi bazën e informacionit vjetor që dërgon banka në Bankën e Shqipërisë.

¹¹ Dega Prizren dhe dega Prishtinë janë miratuar paraprakisht.

¹² Për degën Durrës dhe degën Vlorë, nuk janë përcakuar vendndodhjet.

¹³ Janë në proces agjencia sheshi "Shtraus", Tiranë, agjencia autostrada "Tiranë – Durrës" dhe agjencia Sarandë.

	Fq.
FJALA E GUVERNATORIT	11
KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE	1 31
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2 43
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET	3 85
KAPITULLI IV MBIKËQYRJA BANKARE	4 117
KAPITULLI V. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	5 131
KAPITULLI VI. RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2006	6 151

KAPITULLI V. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

V.1 ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE

V.1.1 ZHVILLIMI I SISTEMIT TË PAGESAVE NË SHQIPËRI

Sistemi i pagesave në Shqipëri ka krijuar tashmë fizionominë e një sistemi të modernizuar si nga ana rregullative ashtu dhe nga ajo operationale. Viti 2006 shënon plotësimin e infrastrukturës bazë për modernizimin e mëtejshëm të sistemit të pagesave në veçanti dhe të sistemit financiar, në përgjithësi. Numri i transaksioneve të procesuara gjatë vitit 2006 ka një rritje prej 13 për qind, krahasuar me vitin 2005. Ndërkohë, vlera e transaksioneve është rritur me 21 për qind gjatë vitit 2006, duke arritur shifrën 2,664.43 miliardë lekë.


Rezultatet e sistemit për shlyerjet e pagesave me vlerë të madhe (AIPS) dhe të atij për kryqëzimin e pagesave në vlerë të vogël (AECH), tregojnë jo vetëm rritje të numrit të pagesave të kryera por dhe efektivitet më të madh të të dy sistemeve. Banka e Shqipërisë ka ofruar tarifa të ulëta komisionesh, duke synuar uljen e kostove të transaksioneve mes bankave si dhe afrimin e konsumatorit pranë sporteveleve bankare. Gjatë vitit të kaluar, janë bërë përmirësime teknologjike të të dy sistemeve, gjë që ka ndikuar në rritjen e efektivitetit dhe në zhvillimin më me shpejtësi të tregut të shërbimeve, si edhe në rritjen e konkurrencës midis bankave.

V.1.2 STATISTIKA TË SISTEMEVE TË PAGESAVE AECH DHE AIPS

Krahasuar me vitin 2005, numri mesatar ditor i pagesave (në të dyja sistemet) është rritur nga 312, në 352 ose në 40 transaksione më tepër në ditë¹. Në vitin 2006, sistemit të pagesave iu shtua një bankë e re, duke e çuar numrin e pjesëmarrësve në 17 banka.


Rritja e numrit të transaksioneve të kaluara në AECH, në rreth 49 mijë dhe për pasojë edhe e vlerës së tyre në rreth 8 miliardë lekë, duhet konsideruar

Grafik 1. Numri i transaksioneve në sistemet e pagesave AIPS dhe AECH për vitin 2006.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 2. Numri i transaksioneve në sistemin AECH gjatë vitit 2006.




Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 3. Numri i shlyerjeve dhe vlera në miliardë lekë me VISA për vitin 2006.



Grafik 4. Ecuria e numrit të kartave në qarkullim sipas viteve.



Grafik 5. Struktura e kartave, 2006.



si një rritje e kënaqshme, megjithëse duhet patur parasysh se kapaciteti i sistemit ofron mundësi të njëjta me standarde më të zhvilluara.

Në muajin mars 2006, nëpërmjet sistemit AIPS, filloi shlyerja e pagesave elektronike me kartat VISA. Aktualisht, numërohen 6 banka anëtare në këtë skemë, të cilat në total kanë realizuar një vëllim pagesash në vlerën 0.30 miliardë lekë. Grafiku 3, paraqet ecurinë e shlyerjeve nga kartat VISA.

Një instrument tjetër pagese, i cili edhe gjatë vitit 2006 vazhdoi të përdoret në mënyrë manuale është çeku bankar. Duhet theksuar se përdorimi i tij është në nivele modeste dhe më konkretisht, totali i vlerës së çeqeve të kryqëzuara gjatë gjithë vitit, ishte afër 4 miliardë lekëve.

Viti 2006, shoqërohet me rritje dhe shumëllojshmëri në përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave. Numri i kartave në qarkullim është shtuar me 9 herë gjatë vitit 2006, krahasuar me vitin 2004. Shtesa e numrit të kartave krahasuar me vitin 2005 është 127,552 copë, me gati 56 për qind.

Në totalin e kartave të lëshuara, mbizotëron numri i kartave të cash-it. Megjithatë gjatë vitit 2006, numri i kartave të debitit ka ardhur në rritje, duke zënë tashmë 38.75 për qind të totalit të kartave në qarkullim.

Po ashtu, një tregues pozitiv është edhe rritja e numrit të kartave të kreditit me 5,816, duke zënë 2.71 për qind të totalit të kartave. Kjo, dëshmon për një ulje të parasë cash në qarkullim nga viti në vit, si dhe për shtimin e linjave të kredisë konsumatore.

Duket qartë që rritja e numrit të kartave të lëshuara është shoqëruar me rritjen e vëllimit të transaksioneve. Gjatë vitit 2006, numri i transaksioneve u rrit nga 644,987 në muajin janar, në 1,697,301 në muajin dhjetor. Ndërsa vlera totale e transaksioneve me kartë në fund të vitit, arriti në 187.66 miliardë lekë.

Paralelisht me rritjen e numrit të kartave, kemi edhe shtimin e numrit të ATM-ve dhe POS-ve. Si

rrjedhojë, ky vit shoqërohet me zgjerimin e mbulimit me ATM në territorin e Shqipërisë.

Grafiku 8, tregon se rritja nga viti i kaluar është përkatësisht me 130 ATM dhe 404 POS, që do të thotë se bankat, me shtimin e numrit të përdoruesve të kartave, kanë parë të nevojshme rritjen e numrit të terminaleve në pikat e shitjeve si dhe ATM-ve, për të plotësuar sa më mirë kërkesat e klientëve.


Një projekt i nisur gjatë vitit që shkoi është krijimi i një komunikimi elektronik midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, dhe ndërtimi i ndërfaqeve përkatëse midis sistemeve të pagesave dhe sistemit që Ministria e Financave po implementon për administrimin e Thesarit. Përfundimi i këtij projekti në vitin 2007, do të shoqërohet me një shkurtim të kohës së kryerjes së veprimeve të thesarit, me një administrim më të mirë të likuiditetit dhe me një rritje të sigurisë të sistemit.

V.1.3 MBIKËQYRJA E SISTEMIT TË PAGESAVE

Misioni i mbikëqyrjes së sistemit të pagesave në Bankën e Shqipërisë është ulja e rrezikut të sistemit dhe rritja e eficiencës së tij, në përputhje me direktivat e BE dhe standardet e aplikuara nga bankat qendrore të vendeve të BE-së. Zyra e Mbikëqyrjes së Politikave të Sistemit të Pagesave e krijuar për këtë qëllim, po punon për përfaqsimin e bazës rregullative dhe aplikimin e saj në praktikë.


1. Rregulloret dhe manualët e reja, të përfunduara gjatë vitit 2006.
 - a. Manuali "Mbi procedurat e Sektorit të Pagesave për shlyerjen e veprimeve me VISA në sistemin AIPS".
 - b. Rregullorja "Mbi organizimin e kleringut të çeqeve në lekë në Bankën e Shqipërisë", e cila pas konsultimit edhe me bankat e nivelit të dytë, u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në datën 15.11.2006.

Grafik 6. Vlera e transaksioneve me kartë, 2006.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7. Numri i transaksioneve me kartë, 2006.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8. Numri i ATM-ve dhe POS-ve, 2005 - 2006.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2. Rregulloret e reja në punim e sipër.
 - a. Rregullorja "Për pagesat elektronike".
 - b. Projektregullorja për "Debitimin direkt".
3. Rregulloret ekzistuese të rishikuara.

Ka filluar puna për rishikimin e rregulloreve AIPS dhe AECH, që do të finalizohet në vitin 2007.

V.1.4 NISMAT PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË PAGESAVE GJATË VITIT 2007

- a. Ligji për sistemin e pagesave në Shqipëri
Për të plotësuar më tej anën rregullative të një sistemi modern pagesash, ndihet nevoja e hartimit të një ligji shqiptar mbi sistemin e pagesave. Hartimi i këtij ligji, do të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit të Bankës së Shqipërisë, sistemit financiar dhe Qeverisë Shqiptare. Gjatë vitit 2007, synojmë përgatitjen e një platforme për këtë ligj.
- b. IBAN-i
Në vijim të direktivave të BE-së për vendet që aspirojnë aderimin në BE, kushti kryesor në lidhje me sistemet e pagesave është ekzistenca e IBAN-it, në të gjitha transaksionet e pagesave brenda Eurozonës. Në vitin 2007, do të prezantojmë një material informues për bankat tregtare dhe do të hartojmë një bazë rregullative më qëllimin përfundimtar, implementimin e saj nga bankat në të ardhmen.
- c. Hartimi i politikës së mbikëqyrjes së sistemit të pagesave
Gjatë vitit 2007, do të punohet për hartimin e një politike për mbikëqyrjen e sistemit të pagesave, në zbatim të funksionit të Bankës së Shqipërisë si mbikëqyrëse e sistemit të pagesave në Shqipëri dhe me qëllim, rritjen e transparencës me bankat tregtare, si pjesëmarrëse në këtë sistem.
- d. Red Book-u
Në vitin në vazhdim do të synohet përsosja e raportimeve të treguesve të instrumenteve të pagesave nga bankat tregtare, me qëllim kalimin drejt ndërtimit të një modeli paraprak të Red Book-ut e më pas publikimin e tij.

V.2 INTEGRIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

V.2.1 INTEGRIMI EVROPIAN

Më 12 qershor 2006, Republika e Shqipërisë nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me Komunitetin Evropian (BE) dhe Shtetet Anëtare.

Pas ratifikimit të MSA-së nga Kuvendi i Shqipërisë më 27 korrik 2006, pritet që MSA të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga parlamentet e shteteve anëtare të BE-së, duke zëvendësuar kështu Marrëveshjen e Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Tregtar dhe Ekonomik të vitit 1992. Banka e Shqipërisë ka qenë e angazhuar aktivisht në bisedimet zyrtare dhe teknike për nënshkrimin e MSA-së. Kjo marrëveshje parashikon të drejta dhe detyrime reciproke për palët si dhe krijon mekanizma për bashkëpunim në fushat me interes të përbashkët, me qëllim final anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Detyrimet që rrjedhin nga MSA për Bankën e Shqipërisë lidhen me përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit², me garantimin e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime financiare për bankat dhe institucionet e tjera financiare komunitare, liberalizimin e lëvizjeve të kapitalit dhe pagesave rrjedhëse ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së si dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar (*acquis communautaire*) në këto fusha.

Banka e Shqipërisë ka dhënë kontributin e saj edhe në përditësimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, i cili u miratua në korrik 2006. Ky Plan është në përputhje me përparësitë e Dokumentit të fundit të Partneritetit Evropian me Shqipërinë, të miratuar nga BE në janar 2006. Përveç nismave ligjore dhe veprimtarive zbatuese që duhen ndërmarrë nga ana e institucioneve shqiptare brenda afateve të përcaktuara qartë, në Plan janë parashikuar edhe kostot financiare si dhe asistencë e nevojshme teknike për realizimin e këtyre angazhimeve. Prioriteti i Bankës së Shqipërisë në kuadër të këtij Plani, mbetet angazhimi për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik në vend si dhe adoptimi dhe zbatimi në mënyrën e duhur i *acquis-it* në sistemin e brendshëm bankar, si kusht themelor për integrimin e Shqipërisë në Tregun e Brendshëm të BE-së.

Në këtë kuadër, një nga zhvillimet më të rëndësishme gjatë vitit 2006, për sa i përket përafrimit të legjislacionit vendas me atë komunitar ishte hartimi dhe miratimi i ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", bazuar në detyrimet që rrjedhin nga MSA dhe Parimet e Bazelit. Objekti i këtij ligji është vendosja e rregullave për krijimin, licencimin, organizimin, drejtimin, kujdestarinë dhe likuidimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja, për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare si dhe për mbikëqyrjen e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë. Ligji në fjalë ka adoptuar pjesën më të madhe të dispozitave të Direktivës 2000/12/EC, në lidhje me fillimin dhe vazhdimin e veprimtarisë së institucioneve të kreditit.

Më 8 nëntor 2006, Komisioni Evropian publikoi Raportin Vjetor të Progresit për Shqipërinë. Raporti analizoi progresin e realizuar nga Shqipëria për periudhën tetor 2005 - shtator 2006, në drejtim të përmbushjes së kriterëve të Kopenhagenit. Komisioni Evropian vlerësoi politikën e ndjekur nga Banka e Shqipërisë në drejtim të bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare si dhe të mbajtjes së inflacionit nën kontroll, duke kontribuar në ruajtjen e një mjedisi të qëndrueshëm makroekonomik në

vend. Në të njëjtën kohë, Komisioni shprehu vlerësimin edhe për ndjekjen e një politike të besueshme monetare. Ai theksoi veçanërisht, marrjen e masave nga ana e Bankës së Shqipërisë, në drejtim të ndryshimit gradual të strategjisë së politikës monetare drejt regjimit të shënjestrimit të shprehur të inflacionit, me qëllim forcimin e transparencës dhe besueshmërisë së politikës monetare.

Raporti evidentoi gjithashtu zhvillimet pozitive në sektorin bankar në vend si dhe vlerësoi progresin e realizuar në drejtim të ngritjes së regjistrimit të kredive, lëvizjes së lirë të shërbimeve bankare dhe financiare, lirisë së vendosjes së bankave të huaja si dhe liberalizimit të mëtejshëm të lëvizjeve të kapitalit. Nga ana tjetër, Komisioni bëri thirrje për vazhdimin e përpjekjeve për përafrimin e legjislacionit vendas me *acquis-in* edhe pas miratimit të ligjit të ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", për sigurimin e heqjes së kufizimeve në investimet e portofolit dhe lëvizjet e tjera afatshkurtra të kapitalit si dhe kërkoi, ndërmarrjen e reformave të mëtejshme në sektorin e pagesave, për të siguruar ndërveprimin e plotë të infrastrukturës së kartave.

Më 1 dhjetor 2006, Republika e Shqipërisë i paraqiti Komisionit Evropian Programin Ekonomik dhe Fiskal, i cili mbulon periudhën 2006-2008. Ky program mbështetet në modelin e programeve të Procedurës së Mbikëqyrjes Fiskale të Para-Anëtarësimit të vendeve kandidatë, si pjesë e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar dhe paraqitet për herë të parë nga vendet kandidatë potenciale, një prej të cilave është edhe Shqipëria. Raporti përmban objektivat afatmesëm në lidhje me treguesit makroekonomikë, përfshirë edhe objektivat e financave publike si dhe përparësitë e reformave strukturore të nevojshme për anëtarësimin në BE. Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë në përgatitjen e pjesëve të këtij Programi që kanë të bëjnë me politikën monetare dhe kursin e këmbimit, me sektorin e jashtëm të ekonomisë si dhe me zhvillimet në sektorin financiar.

Gjatë vitit 2006, Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë: në Takimin e Shtatë BE-Shqipëri për Çështjet Ekonomike dhe Financiare, ku janë paraqitur zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare dhe në sektorin bankar vendas; në Takimin e Nëntë të Komitetit të Përbashkët BE-Shqipëri, ku është raportuar mbi zhvillimet më të fundit në kuadrin ligjor dhe administrativ bankar në Shqipëri, me një fokus të veçantë në miratimin e ligjit të ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

V.2.2 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Marrëdhëniet me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN)

Kuota e Republikës së Shqipërisë në FMN gjatë vitit 2006 mbeti e pandryshuar, në shumën prej 48.7 milionë sdr³ ashtu si edhe votat e saj (737 vota ose 0.03% e shumës së përgjithshme të votave). Shqipëria ndodhet në të njëjtën konstituencë me Italinë, Greqinë, Portugalinë, Maltën, San Marinon dhe Timorin Lindor. Kjo konstituencë ka një total prej

90.968 votash (4.12% e shumës së përgjithshme të votave) dhe kryesohet nga përfaqësuesi italian z. Arrigo Sadun, i cili shërben si Drejtor Ekzekutiv i konstituencës.

Më 11 janar 2006, autoritetet shqiptare të përfaqësuar nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe Ministri i Financave i paraqitën zyrtarisht FMN-së, Letrën e Mirëkuptimit dhe Memorandumin e Politikave Ekonomike dhe Financiare.

Mbi bazën e këtyre dokumenteve si dhe të vlerësimeve të misionit, i cili vizitoi Shqipërinë në muajin nëntor 2005, Bordi Ekzekutiv i FMN-së miratoi më 27 janar 2006, marrëveshjen e re trevjeçare me Shqipërinë me një vlerë prej 17.045 milionë sdr. Kjo marrëveshje është një përzierje midis programit për Zbutjen e Varfërisë dhe Rritjen Ekonomike (PRGF) dhe programit Lehtësia e Financimit Afatmesëm (EFF - Extended Fund Facility), e cila është një huamarrje më afër termave tregtarë, duke pasqyruar kështu progresin e bërë nga Shqipëria gjatë zbatimit të programit të mëparshëm PRGF 3.

Objektivat kryesorë të programit të ri kanë të bëjnë me ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, si një parakusht për rritjen ekonomike si dhe me përmirësimin e administrimit fiskal, të administrimit të borxhit publik dhe të mbikëqyrjes së institucioneve financiare.

Miratimi i marrëveshjes nga Bordi Ekzekutiv i FMN-së, mundësoi edhe lëvrimin e menjëhershëm të një transhi huaje EFF dhe një transhi huaje PRGF, me nga 1.217.500 sdr secila, përkatësisht në datat 1 dhe 10 shkurt.

Gjatë vitit 2006, në kuadër të konsultimeve për vlerësimin e zbatimit të detyrimeve (Neni IV i Neneve të Marrëveshjes me FMN-në), që rrjedhin nga marrëveshja trevjeçare PRGF/EFF, në muajt prill – maj dhe tetor – nëntor, Shqipërinë e kanë vizituar dy misione rishikuese të FMN-së.

Gjatë qëndrimeve në Shqipëri, misionet patën takime të veçanta me administratorët dhe stafin e Bankës së Shqipërisë. Ato vlerësuan pozitivisht arritjet e institucionit në kuadër të Memorandumit të Politikave Ekonomike dhe Financiare. Në të njëjtën kohë, konstatuan se progresi i arritur në zbatimin e reformave strukturore, ka qenë i kënaqshëm dhe evidentuan rëndësinë e vijimit të këtyre reformave, duke u përqendruar veçanërisht në marrjen e masave të mëtejshme rregullative për ruajtjen e stabilitetit financiar, në kushtet e një rritjeje të shpejtë të kreditimit. Në këtë kuadër, krijimi i Regjistrimit të Kredive u konsiderua si e një rëndësie thelbësore.

Në mbledhjen e tij të datës 24 korrik 2006, Bordi Ekzekutiv i FMN-së, bazuar në përfundimet e misionit rishikues, kreu rishikimin e parë të ecurisë së Shqipërisë nën marrëveshjen PRGF/EFF dhe miratoi lëvrimin (në datat 26 korrik dhe 4 gusht) e një shume të barasvlershme me 2.43 milionë sdr, duke e çuar shumën e përgjithshme të huasë së lëvruar në bazë të marrëveshjes, në 4.86 milionë sdr.

Gjatë vitit 2006, Shqipëria gjithashtu i ka paguar FMN-së rreth 7.9 milionë sdr në kuadër të shlyerjeve të detyrimeve (pagesa principali, interesa, shpenzime periodike etj.), të cilat rrjedhin nga marrëveshjet e kaluara PRGF si dhe ajo ekzistuese PRGF/ EFF.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani ka përfaqësuar rregullisht Republikën e Shqipërisë në vendimmarrjen e Bordit të Guvernatorëve, i cili është organi më i lartë i FMN-së. Një vend të rëndësishëm në marrëdhëniet me FMN-në gjatë këtij viti, kanë zënë dhe mbledhjet vjetore dhe pranverore të FMN-së dhe të Bankës Botërore. Në këto takime është evidentuar ecuria pozitive e treguesve makroekonomikë dhe në veçanti e rritjes ekonomike, stabilitetit të çmimeve dhe konsolidimit të mëtejshëm të treguesve fiskalë si dhe përmbushja e kriterëve të performancës dhe atyre strukturore, të vendosura në kuadër të marrëveshjes me FMN-në. Përfaqësuesit e lartë të FMN-së, kanë shprehur mirëkuptimin për të vazhduar projektet e ndihmës teknike për Bankën e Shqipërisë, në lidhje me të ardhmen e politikës monetare, krijimin e Regjistrisë të Kredive, kontrollin e brendshëm si dhe administrimin e borxhit publik.

Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë ka vijuar të përfitojë nga asistencë teknike e FMN-së, në lidhje me trajnimin e stafit të saj. Gjatë vitit 2006, Bankën e Shqipërisë e kanë vizituar edhe misioni i administrimit të borxhit publik, i cili u fokusua në rolin e bankës qendrore në procesin e administrimit të këtij borxhi si dhe misioni i ROSC-ut (Report on Observance of Standards and Codes - Raporti mbi Zbatimin e Standardeve dhe Kodeve), i cili vlerësoi statistikën monetare e financiare si dhe statistikën e bilancit të pagesave, të hartuara nga ana e Bankës së Shqipërisë. Ky mision la dhe rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të përpilimit të këtyre statistikave.

Marrëdhëniet me Grupin e Bankës Botërore

Në vijim të marrëveshjes "Për administrim dhe konsulencë të investimit të rezervës valutore"⁴, gjatë vitit 2006, Grupi i Bankës Botërore i ka ofruar asistencë teknike Bankës së Shqipërisë në kuadër të programit RAMP (Programi Këshillues për Administrimin e Rezervës Valutore). Kjo asistencë është përqendruar në hartimin e një baze të re rregullatore si dhe në zgjidhjen e disa çështjeve teknike, në lidhje me administrimin e rezervës valutore.

Gjatë mbledhjeve vjetore të FMN-së dhe BB-së, delegacioni i Bankës së Shqipërisë ka zhvilluar takime me përfaqësues të lartë të Bankës Botërore, me të cilët është diskutuar rreth konsolidimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik, veçanërisht për sa i përket mbajtjes së inflacionit brenda intervalit të synuar. Në këto takime është theksuar nevoja e ndërmarrjes së reformave të mëtejshme strukturore në ekonominë shqiptare.

Në 10 janar 2006, Banka Botërore miratoi strategjinë e re trevjeçare të asistencës për Shqipërinë, me një vlerë prej 196 milionë usd. Për herë

të parë që nga fillimi i tranzicionit, Shqipëria do të mund të marrë hua në terma gjysmëregtarë nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), me vlerë 111 milionë usd. Ndërkohë që, huamarrja e butë nga Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA), është parashikuar të jetë 86 milionë usd. Përparësitë e strategjisë së re, përfshijnë nxitjen e rritjes ekonomike përmes mbështetjes së zhvillimit të sektorit privat si dhe përmirësimin e shërbimeve publike të ofruara, veçanërisht në sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë.

Marrëdhëniet me institucionet e tjera financiare ndërkombëtare

Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2006, ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me BERZH-in, kryesisht në drejtim të ofrimit të informacionit dhe statistikave për zhvillimet në ekonominë shqiptare në përgjithësi, dhe për sektorin financiar në veçanti. Në Raportin e Tranzicionit 2006, BERZH vlerësoi pozitivisht mbajtjen e inflacionit brenda objektivave të Bankës së Shqipërisë si dhe miratimin e ligjit të ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Banka për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) është një tjetër institucion me të cilin Banka e Shqipërisë ka mbajtur marrëdhënie të ngushta, gjatë vitit 2006. Guvernatori Fullani ka marrë pjesë në Mbledhjen e 76-të Vjetore të BIS-it. Në takimet e zhvilluara me përfaqësues të këtij institucioni dhe të bankave të tjera anëtare, ka theksuar rëndësinë e thithjes nga ana e Bankës së Shqipërisë të një asistence teknike gjithnjë e më të kualifikuar, veçanërisht në fusha të tilla prioritare si politika monetare dhe mbikëqyrja bankare, gjë që do të ndihmonte në arritjen e standardeve bashkëkohore në këto fusha. BIS ka qenë veçanërisht aktive në ofrimin e asistencës teknike për Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet seminareve dhe trajnimeve të organizuara nga Instituti i Stabilitetit Financiar, i cili promovon stabilitetin financiar ndërkombëtar përmes shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes së sistemit financiar.

Marrëdhëniet me bankat qendrore dhe bashkëpunimi teknik

Në vijim të intensifikimit të marrëdhënieve dypalëshe me bankat qendrore të rajonit dhe më gjerë, Guvernatori Fullani, me ftesë të guvernatorëve të disa bankave qendrore, ka zhvilluar vizita zyrtare pranë Bankës së Italisë, Bankës Kombëtare të Polonisë dhe Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës, ku është takuar me homologët e tij. Këto vizita kanë shënuar një hap të mëtejshëm në procesin e filluar të një bashkëpunimi teknik gjithnjë e në rritje, ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe këtyre bankave qendrore.

Në të njëjtën kohë, Guvernatori ka zhvilluar në muajin prill takime në Ëashington DC me zj. Susan Bies, Guvernatore e Bordit të Rezervës Federale si dhe në Neë York me z. Timothy Geithner, President i Rezervës Federale të Neë York-ut. Në këto takime, është diskutuar mbi zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare si dhe mbi thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit

dypalësh dhe të asistencës teknike që Rezerva Federale mund t'i ofrojë Bankës së Shqipërisë. Ndërsa, në muajin qershor, me ftesë të Guvernatorit Fullani, Guvernatori i Bankës së Greqisë, z. Nicholas C. Garganas ka zhvilluar një vizitë zyrtare dyditore në Shqipëri. Kjo vizitë është zhvilluar në vijim të marrëdhënieve dypalëshe midis dy institucioneve, me një theks të veçantë në shkëmbimin e informacionit dhe të përvojës në fushën e mbikëqyrjes bankare.

Gjatë vitit 2006, janë vendosur marrëdhënie më të ngushta edhe me bankat qendrore të rajonit, të cilat kanë mbështetur nismën e Bankës së Shqipërisë për thellimin e bashkëpunimit rajonal. Bashkëpunimi rajonal, në prizmin e stabilitetit financiar, ka qenë edhe boshti kryesor i tryezës së rrumbullakët, e cila mblodhi guvernatorët e bankave qendrore të Rumanisë, Serbisë, Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës dhe të Kosovës në panelin e gjashtë të Konferencës VI Vjetore, të Bankës së Shqipërisë, të zhvilluar në muajin tetor.

Guvernatori Fullani ka marrë pjesë edhe në takimin XV dhe XVI të Klubit të Guvernatorëve të Detit të Zi, Azisë Qendrore dhe Ballkanit të zhvilluar në Federatën Ruse, përkatësisht në muajt maj dhe shtator.

Bankat qendrore të Italisë, Francës, Gjermanisë, Holandës, Republikës Çeke, Austrisë, Polonisë, SHBA-së dhe Turqisë kanë vazhduar të jenë aktive, në drejtim të ofrimit të asistencës teknike për Bankën së Shqipërisë gjatë vitit 2006. Kjo, kryesisht nëpërmjet organizimit të kurseve dhe seminareve afatshkurtra në fusha të specializuara si edhe organizimit të vizitave studimore pranë këtyre bankave.

Në kuadër të objektivit të Bankës së Shqipërisë për të përfituar nga përvoja e bankave qendrore të Evropës Qendrore dhe Lindore, të anëtarësuara vitet e fundit në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ), gjatë vitit 2006, janë intensifikuar marrëdhëniet e bashkëpunimit me Bankën Kombëtare të Polonisë, Bankën Kombëtare Çeke dhe Bankën Kombëtare Bullgare.

Viti 2006 shënoi edhe thellimin e bashkëpunimit me GTZ-në (Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Teknik) në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit Teknik dhe Financiar midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë. Objektivi kryesor i këtij bashkëpunimi është përafrimi i mëtejshëm institucional dhe operacional i Bankës së Shqipërisë me standardet e SEBQ-së. Disa prej seminareve të organizuara nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me GTZ-në, kanë pasur një karakter rajonal. Në to kanë marrë pjesë ekspertë nga bankat qendrore të Kosovës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Malit të Zi. Kushtet e përafërta dhe sfidat e njëjta, kanë qenë nxitësit kryesorë për organizimin e këtyre seminareve, që kanë ndikuar edhe në zhvillimin e forcimin e bashkëpunimit teknik midis bankave qendrore të rajonit.

Korpusi i Vullnetarëve të Shërbimeve Financiare (FSVC) është një tjetër institucion, i cili gjatë vitit 2006 ka ofruar asistencë për Bankën e Shqipërisë

në disa fusha: si mbikëqyrja bankare, ngritja e regjistrit të kredive, statistikat dhe auditimi i brendshëm.

V.3 EMISIONI I MONEDHËS

Në vitin 2006, në zbatim të detyrimeve kushtetuese dhe të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, u plotësuan kërkesat e ekonomisë për para, në mbështetje dhe në zbatim të politikës monetare dhe të programit monetar, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Gjithashtu, në zbatim të strategjisë të Bankës së Shqipërisë për periudhën afatmesme 2006-2008, dhe në kuadër të planeve të emetimit për plotësimin e kërkesave të ekonomisë për para, u miratuan projekte për rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare dhe shtypjen e një kartëmonedhe të re, me vlerë nominale 2000 lekë.

Viti 2006 shënoi edhe miratimin e ndërtimit të një qendre bashkëkohore të *cash-it*, me objektiv implementimin e standardeve bashkëkohore të bankave qendrore, në fushën e administrimit të parasë.

V.3.1 ECURIA E MONEDHËS NË QARKULLIM


Shtesa e monedhës në qarkullim në vitin 2006 prej 14,7 miliardë lekësh, i është përgjigjur zhvillimit të balancuar makroekonomik të vendit. Në dallim nga viti i mëparshëm, gjatë 11 muajve të vitit 2006, monedha në qarkullim në mënyrë progresive shënoi vetëm pakësim dhe e gjithë shtesa vjetore u vërtetua në muajin dhjetor 2006.

Përqendrimi në nivelin e 14,7 miliardë lekëve, i shtesës së monedhës në qarkullim në muajin e fundit të vitit, krahas tendencës historike është edhe rrjedhojë e përqendrimit më të lartë të pagesave (shpenzimeve), nga subjekte të ndryshme, në fund të vitit.

Arkëtimet e parave të bankave të nivelit të dytë nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2006, u vërtetuan në nivelin e 105 miliardë lekëve, duke mbetur pothuaj në të njëjtin nivel me vitin 2005. Në këtë tregues, ka ndikuar edhe riqarkullimi nga vetë bankat, i parave të arkëtuara nga klientët; para, të cilat pas përpunimit dhe kontrollit, janë ripaguar për të plotësuar kërkesat e klientëve.

Përsa i përket pagesave në *cash* nga arkat e Bankës së Shqipërisë për bankat e nivelit të dytë, furnizimi është realizuar sipas kërkesave të paraqitura prej tyre. Ai ka synuar në të njëjtën kohë, mbajtjen e strukturës së monedhës në qarkullim, në kufijtë e projektuar për fundvitin 2006.

Grafik 9. Monedha në qarkullim në vitin 2006, në mijë lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kartëmonedha dhe monedhat e hyra në arkat e Bankës së Shqipërisë nga bankat e nivelit të dytë, janë përpunuar me makina sortimi të teknologjisë së lartë, të cilat sigurojnë saktësi në numërim dhe kontroll të plotë të autenticitetit të monedhës shqiptare.

V.3.2 SHPEJTËSIA E QARKULLIMIT TË PARASË

Gjatë vitit 2006, Banka e Shqipërisë ka rritur ndjeshëm mbështetjen për bankat e nivelit të dytë, në kuadrin e zgjerimit të veprimtarisë së tyre me klientët për tërheqjen e parave me sisteme automatike (ATM). Numri i ATM-ve të instaluara dhe të vëna në funksionim nga bankat, në fund të vitit 2006, arriti në 335 copë. Zgjerimi i veprimtarisë së pagesave me aparate ATM, krahas lehtësive të shërbimit ndaj klientëve, ka ndikuar edhe në pakësimin e veprimeve në cash.

Tabelë 1. Numri i ATM-ve të instaluara nga sistemi bankar sipas viteve.

	2003	2004	2005	2006
Nr. ATM	15	69	165	335
Rritja vjetore (në herë)	-	3,6	1,39	1,03

Shpejtësia e qarkullimit të parasë në vitin 2006, për ciklin e shkurtuar të qarkullimit (banka të nivelit të dytë - Bankë e Shqipërisë), në total u vërtetua pothuaj në të njëjtin nivel me vitin 2005. Megjithatë, ajo pati ndryshime për prerje të veçanta të kartëmonedhave dhe monedhave metalike.

Kështu, rritje e ndjeshme e shpejtësisë së qarkullimit u vërtetua në kartëmonedhat e prerjeve 5.000 lekë, 1.000 lekë dhe 500 lekë, përkatësisht me 13,3 për qind, 38,9 për qind dhe 8,3 për qind. Këto janë dhe prerjet me të cilat punojnë ATM-të.

Për kartëmonedhat me vlerë nominale 200 lekë dhe 100 lekë, shpejtësia e qarkullimit ka shënuar rënie.

Shpejtësia e qarkullimit të monedhave metalike, përgjithësisht ka shënuar rënie. Kjo, sepse monedhat metalike qëndrojnë gjithnjë në duar të individëve, për kryerjen e pagesave me vlerë të vogël.


Tabelë 2. Struktura e parasë në qarkullim në fund të vitit 2006 (në përqindje).

Prerja	5000	1000	500	200	100	100	50	20	10	5	1
Struktura dt.31.12.2004	25.77	46.13	24.81	2.18	1.11	15.78	35.44	28.25	15.69	4.54	0.30
Struktura dt.31.12.2005	29.86	44.83	22.47	2.03	0.80	12.14	37.07	29.48	16.35	4.65	0.30
Struktura dt.31.12.2006	34.04	43.55	19.96	1.90	0.55	10.99	37.99	29.70	16.38	4.62	0.32

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Monedhat e falsifikuara dhe mbrojtja ndaj tyre

Mbrojtja e kartëmonedhës shqiptare nga falsifikimi dhe ruajtja e autenticitetit të saj, ka vijuar të jetë në vëmendjen e Bankës së Shqipërisë, me qëllim mbrojtjen e publikut dhe rritjen e besimit të tij në monedhën kombëtare.



Numri i kartëmonedhave false të konfiskuara nga viti 1992 e deri në 31.12.2006, përbën vetëm 0.006 për qind të sasisë së përgjithshme të kartëmonedhave të hedhura në qarkullim nga Banka e Shqipërisë; shifër kjo tërësisht e papërfillshme dhe që nuk cënon besimin e publikut në monedhën kombëtare.

V.3.3 VEPRIMTARIA NUMIZMATIKE

Në vitin 2006, përfundoi shtypja e dy monedhave metalike për qëllime numizmatike me tematika “Tirana 85-vjet kryeqytet” dhe “Objekte të trashëgimisë kulturore (Kostumet popullore në Shqipëri)”. Këto monedha u shtypën në Zyrën e Prodhimit dhe të Përpunimit të Monedhës Metalike, të Departamentit të Emisionit.

Prodhimi i monedhave metalike për qëllime numizmatike nga vetë Banka e Shqipërisë, përbën një arritje të suksesshme dhe që krijon bazë, për zhvillime të mëtejshme në këtë fushë.

Gjatë vitit 2006, u punua dhe aktualisht po zbatohen, procedurat për shtypjen e një monedhe tjetër me tematikë “Kodiku i Purpurt i Beratit”, i cili si një objekt unikal i trashëgimisë kulturore shqiptare, është përfshirë në programin e UNESCO-s, Kujtesa e Botës (*Memoire du Monde*), më 25 qershor 2005.

V.4 NDRYSHIME NË LEGJISLACIONIN BANKAR

V.4.1 MIRATIMI I LIGJIT TË RI “PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Legjislacioni bankar gjatë vitit 2006, në vijim edhe të nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në datën 12.06.2006, ndryshoi dhe u

përmirësua në mënyrë thelbësore me hartimin dhe miratimin nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ligj i cili hyn në fuqi në 1 qershor 2007.

Ky ligj, i hartuar nga Banka e Shqipërisë me mbështetjen e FMN-së, është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) në fushën e shërbimeve financiare, në përgjithësi dhe të atyre bankare në veçanti. Këto detyrime, kanë të bëjnë me lirinë e themelimit, lirinë për të ofruar shërbime bankare dhe financiare, dhe përafrimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian.

Në këtë drejtim, ligji i miratuar u mundëson bankave të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian si dhe të gjitha bankave të tjera, të huaja, ofrimin e shërbimeve bankare në Shqipëri nëpërmjet një dege apo filiali të tyre, pa bërë asnjë dallim ndërmjet kushteve për licencimin e këtyre degëve dhe filialeve, dhe kushteve për licencimin e bankave shqiptare. Përveç sa më sipër, në zbatim të dispozitave të MSA – së, ligji i miratuar parashikon trajtimin e tyre në ushtrimin e veprimtarive bankare dhe veprimtarive financiare pas licencimit, në të gjitha aspektet, si bankë shqiptare.

Në ndryshim nga ligji ekzistues në fuqi, ligji i miratuar vendos një regjim më të liberalizuar për kryerjen e shërbimeve financiare. Ai parashikon kushte të tjera për kryerjen e veprimtarive financiare shtesë nga bankat dhe degët e bankave të huaja, duke mos e kushtëzuar këtë me arritjen prej tyre të një niveli të caktuar të kapitalit, siç parashikon ligji në fuqi. Në këtë mënyrë, ligji i miratuar parashikon se Banka e Shqipërisë mund të licencojë subjektin për të ushtruar disa nga veprimtaritë financiare të përcaktuara në ligj që në momentin e licencimit, duke i dhënë të drejtën atij të kërkojë ushtrimin e veprimtarive të tjera shtesë pas licencimit, bazuar në performancën dhe parametrat e tjerë financiarë të tij. Vlerësimi i këtyre parametrave nga Banka e Shqipërisë, do të bazohet në rregulla dhe kritere të qarta, të përcaktuara me ligj, në lidhje me mbikëqyrjen e sistemit bankar, në përputhje me parimet bazë të direktivave përkatëse të Bashkimit Evropian dhe të Bazelit.

Këta rregulla, adresojnë një nga detyrimet e përparësive afatshkurtra të Partneritetit Evropian me Shqipërinë, që është forcimi i kuadrit ligjor dhe mbikëqyrës për sektorin bankar, si dhe përmirësimi i monitorimit të kujdesshëm të sektorit financiar, sipas rekomandimeve të shprehura edhe nga Raporti Vjetor i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2006).

Në dallim nga ligji në fuqi, në bazë të dispozitave të ligjit të miratuar, mbikëqyrja e sistemit bankar do të shtrihet mbi të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja që veprojnë në Shqipëri, si dhe në degët e bankave të licencuara nga Banka e Shqipërisë që veprojnë jashtë vendit. Kjo mbikëqyrje do të realizohet nëpërmjet licencimit, kuadrit rregullator në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe parimet e Bazelit, analizës financiare dhe parashikuese, inspektimeve, veprimeve korigjuese si dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera. Në lidhje

me mbikëqyrjen e degëve të bankave të huaja që veprojnë në Shqipëri, parashikohen dispozita të veçanta për mbikëqyrjen e këtyre degëve, në mbështetje të direktivës përkatëse të Bashkimit Evropian.

Për herë të parë, me këtë ligj trajtohet mbikëqyrja e konsoliduar në zbatim të parimeve të Bazelit dhe të standardeve të përcaktuara në direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian, për një mbikëqyrje të kujdesshme. Ai krijon edhe hapësirat e nevojshme ligjore, për lidhjen e marrëveshjeve me autoritetet e vendeve të tjera, në funksion të rritjes së cilësisë së mbikëqyrjes së konsoliduar të grupeve bankare dhe atyre financiare, që do të veprojnë në Shqipëri.

Për të siguruar dhe forcuar mbrojtjen e depozituesve dhe investitorëve, si dhe për ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar, ligji i ri parashikon rregulla më të qartë për administrimin e rreziqeve, me të cilat mund të përballen bankat gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Duke marrë në konsideratë kushtet aktuale të rritjes me ritme të shpejta të kredihënies në sistemin bankar, ligji i ri trajton në mënyrë më të plotë dhe të detajuar edhe lloje të tjera të rrezikut, të ndryshme nga rreziku i kredisë, me të cilat mund të përballen bankat si dhe ekspozimet e lejuara të këtyre të fundit, kur përballen me këto rreziqe.

V.4.2 KRIJIMI I REGJISTRIT TË KREDIVE DHE HARTIMI I PROCEDURAVE DHE KUADRIT RREGULLATIV TË FUNKSIONIMIT TË TIJ

Ligji parashikon për herë të parë, krijimin dhe mbajtjen nga Banka e Shqipërisë të Regjistrit të Kredive. Qëllimi i ngritjes së këtij regjistri, në kushtet e një zhvillimi të vullshëm të aktivitetit të kredihënies, është të ndihmojë bankat për të marrë vendime të mirinformuara kur u japin kredi klientëve të tyre, si dhe të forcojë mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë mbi sistemin bankar shqiptar.

Aktualisht, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim të ngushtë me bankat e nivelit të dytë, është në përfundim të procesit të hartimit të kuadrit nënligjor. Ky përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Regjistrit të Kredive, llojin e informacionit dhe të të dhënave, mënyrën dhe afatet kohore për raportimin e tyre për qëllimin e funksionimit të tij, si dhe mënyrën dhe kushtet për përdorimin e informacionit dhe të të dhënave të mësipërme, nga përdoruesit e autorizuar të Regjistrit të Kredive.

V.4.3 PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS LIGJORE PËR ZBATIMIN E NJË REGJIMI TË RI TË POLITIKËS MONETARE

Gjatë vitit 2006, Banka e Shqipërisë ka nisur studimin e parakushteve dhe kushteve të zbatimit, në një periudhë afatmesme (viti 2009), të një regjimi të ri të politikës monetare. Në këtë kontekst, janë shqyrtuar mundësitë e përmirësimit të infrastrukturës ligjore për krijimin e këtyre kushteve, në

përputhje me standardet ndërkombëtare në këtë fushë. Gjithashtu, është studiuar mundësia e përmirësimit të ligjit organik të Bankës së Shqipërisë, i cili përkon me parashikimin e ndryshimit të tij si prioritet afatmesëm në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA – së. Këto ndryshime, parashikohet të përcaktojnë kompetenca dhe procedura të qarta, në lidhje me procesin e vendimmarrjes si dhe në lidhje me transparencën e këtij procesi, çfarë përbën dhe një nga parakushtet thelbësore, për hartimin dhe zbatimin e një politike monetare efektive.

V.4.4 HARTIMI I PROPOZIMEVE PËR NDRYSHIMIN E KODIT TË PROCEDURËS CIVILE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në kuadrin e reformës ligjore, të ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë për ndryshimin dhe përmirësimin e Kodit të Procedurës Civile, Banka e Shqipërisë është angazhuar plotësisht në bashkëpunimin me sektorin bankar, për plotësimin dhe saktësimin e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë.

Propozimet e Bankës së Shqipërisë, të cilat janë marrë në konsideratë në pjesën më të madhe të tyre, kanë synuar zgjidhjen e disa problemeve të hasura në aktivitetin bankar, që lidhen me ekzekutimin e titujve ekzekutivë nga ana e organeve të përmbartimit gjyqësor. Propozimet kanë patur për qëllim përmirësimin e bazës ligjore lidhur me zbatimin e procedurave me sa më shumë efektivitet, duke shkurtuar kohën e ekzekutimit të titujve nëpërmjet përcaktimit të afateve konkrete kohore për njoftimin e palëve, gjatë procedurës së ekzekutimit të titujve, rritjes së efektivitetit në zhvillimin e ankandëve, nëpërmjet saktësimin të procedurave për përcaktimin e vlerës së sendit që është vënë si garanci për përmbushjen e detyrimit, si dhe duke parashikuar disa mundësi alternative për debitorin, për ekzekutimin e detyrimit pas marrjes së vendimit nga gjykata. Këto përmirësime, do të krijojnë kushte të favorshme dhe do të rrisin sigurinë në sektorin bankar në zhvillimin e aktivitetit të kredidhënies, duke ulur rrezikun e kredisë me të cilin përballen bankat.

V.4.5 BASHKËPUNIMI ME MINISTRINË E FINANCAVE PËR HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANÇIMIN E TERRORIZMIT”

Në fund të vitit 2006, Banka e Shqipërisë ka bashkëpunuar ngushtësisht me Ministrinë e Financave, gjatë procesit të hartimit të projektligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”. Banka e Shqipërisë, si autoriteti mbikëqyrës i sistemit bankar, e shikon me përparësi përmirësimin e kuadrit ligjor për parandalimin e përdorimit të sistemit bankar, për pastrimin e parave të rrjedhura nga aktivitetet kriminale dhe pasurive prej tij, në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian në këtë fushë dhe me rekomandimet e rishikuara të FATF – it.

Në këtë këndvështrim, ky përmirësim ndër të tjera synon ruajtjen e besueshmërisë së publikut dhe të investitorëve, ndaj sistemit bankar shqiptar.

V.4.6 KRIJIMI I KUADRIT RREGULLATIV PËR ADMINISTRIMIN E REZERVËS VALUTORE

Në këtë vit u përfundua me sukses me asistencën e Bankës Botërore, hartimi dhe plotësimi i kuadrit rregullativ për administrimin e rezervës valutore, duke rishikuar politikën e Bankës së Shqipërisë për administrimin e kësaj rezerve, kriteret dhe kushtet e administrimit si dhe decentralizimin e kompetencave vendimmarrëse, gjatë këtij procesi.

V.5 ZHVILLIME NË FUNKSIONIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Në vitin 2006, janë realizuar 44 audite dhe 3 procedura verifikimi. Një procedurë auditit u realizua duke angazhuar mesatarisht 32 ditë pune-auditor. Nga auditet e ushtruara, inspektorët paraqitën 269 gjetje dhe dhanë 197 rekomandime. Detyrat e auditit u kryen nga 6 inspektorë të kontrollit, prej të cilëve 1 është inspektor i teknologjisë së informacionit. Funkzioni i auditit në Bankën e Shqipërisë, mbulohet me rreth 1.4 inspektorë për çdo 100 punonjës të bankës qendrore, me përvojë mesatare pune në auditin e bankës qendrore, prej 10 vjetësh. Auditet u kryen në Bankën e Shqipërisë, përfshirë 5 degët e saj në rrethe si dhe njësinë e Shtypshkronjës.

Gjatë vitit 2006, për rritjen e rolit të auditit të brendshëm si funksion që mbështet dhe forcon përgjegjshmërinë e drejtimit të bankës qendrore, për të përmirësuar qeverisjen e saj, u mbajtën takimet e rregullta 6-mujore midis Inspektorit të Përgjithshëm dhe anëtarëve joadministratorë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Këto takime, i shërbyen rritjes së shkallës së informimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, për të marrë vendime mbi bazën e një informimi më transparent dhe më të plotë.

Programi i punës së auditit të brendshëm u përshtat, për të përfshirë sugjerimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, me qëllim trajtimin e aspekteve që përbënin çështje me rëndësi dhe për të kryer analiza të pavarura të aspekteve të ndryshme të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë. Ky proces diskutimi dhe informimi i dyanshëm, përmirësoi shkallën e të kuptuarit të pritshmërive të Këshillit Mbikëqyrës nga auditit i brendshëm dhe siguroi një përputhje më të mirë të objektivave të auditit të brendshëm me ato të Bankës së Shqipërisë.

SHËNIME

¹ Gjatë vitit 2006 kanë qenë 247 ditë pune efektive.

² Kriteret e anëtarësimit në BE quhen ndryshe kriteret e Kopenhagenit. Ato janë përcaktuar në Këshillin Evropian, të mbajtur në Kopenhagen në qershor 1993 dhe kërkojnë që vendi kandidat për anëtarësim në BE:

- të ketë ngritur institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut si dhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave (kriteri politik);

- të ketë një ekonomi tregu funksionale, të aftë për t'u përballur me trysnitë konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së (kriteri ekonomik);

- të ketë aftësinë për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi, përfshirë objektivat e bashkimit të politik, ekonomik dhe monetar (përafrimi i legjislacionit dhe zbatimi efektiv i tij).

³ Në datën e mbylljes së raportimit (14 shkurt 2007), kursi zyrtar i sdr-ve me dollarin amerikan ishte $1 \text{ sdr} = 1.49671 \text{ usd}$.

⁴ Marrëveshja "Për administrim dhe konsulencë të investimit të rezervës valutore" është nënshkruar ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, në shtator 2005.

	Fq.
FJALA E GUVERNATORIT	11
KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE	1 31
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2 43
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET	3 85
KAPITULLI IV MBIKËQYRJA BANKARE	4 117
KAPITULLI V. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	5 131
KAPITULLI VI. RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2006	6 151

KAPITULLI VI. RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2006

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR

KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Bankës së Shqipërisë ("Banka"), që përfshijnë bilancin në 31 dhjetor 2006, si dhe pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve, të ndryshimeve në kapitalin e vet dhe të rezervave dhe të rrjedhjes së parasë për vitin ushtrimor të mbyllur, dhe një përmbledhje të politikave kontabël kryesore, dhe shënime të tjera shpjeguese.

PËRGJEGJËSIA E DREJTIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi i Bankës është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare, në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, të paraqitura në Shënimin 2 të pasqyrave financiare. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm, në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme me rrethanat.

PËRGJEGJËSIA E AUDITORËVE

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Përveç sa është paraqitur në paragrafin e parë të opinionit, ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përftojme siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin procedura për të marrë prova auditimi për vlerat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e rrezikut të ekzistencës së gabimeve në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësi. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivititetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

OPINIONI

Siç është diskutuar në Shënimin 10 të pasqyrave financiare, një rivlerësim i godinës qendrore të Bankës është kryer nga një vlerësues i pavarur, i cili ka përdorur metodën e kapitalizimit të qirave dhe të çmimit të shitjes të qendrave të biznesit, në afërsi të godinës qendrore të Bankës. Si rezultat i natyrës së veçantë të godinës dhe në mungesë të një tregu për të përcaktuar vlerën reale të saj, sipas opinionit tonë, kjo metodologji është e papërshtatshme. Si rrjedhojë, ne nuk jemi në gjendje të japim një opinion në lidhje me saktësinë e vlerës së rivlerësuar të godinës qendrore, më 31 dhjetor 2006.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efektit në pasqyrat financiare të çështjes së trajtuar në paragrafin paraardhës, pasqyrat financiare të bashkëngjitura paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2006, dhe rezultatin e aktivitetit të saj, ndryshimeve në kapital dhe rrjedhjes së parasë për fundin e vitit, në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, të paraqitura në Shënimin 2, të pasqyrave financiare.

THEKSIM I ÇËSHTJES

Duke mos kualifikuar më tej opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen në Pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit të vet dhe rezervave dhe Shënimin 18 të pasqyrave financiare. Totali i kapitalit të paguar dhe detyrimeve të Bankës, tejkalon vlerën e mjeteve në një shumë prej 740 milionë lekë, për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2006 dhe Banka ka derdhur në buxhetin e shtetit një shumë prej 4,664 milionë lekësh, si shpërndarje e fitimit të vitit që mbyllet në këtë datë, bazuar në një marrëveshje të nënshkruar në datë 26 mars 2003 me Ministrinë e Financave. Referuar ligjit nr. 8269, neni 11 asnjë transferim, shlyerje ose pagesë sipas neneve 8, 9 e 10 të këtij ligji, nuk duhet të kryhet në qoftë se mjetet e Bankës do të jenë më pak se shumta e detyrimeve të saj dhe e kapitalit të paguar. Gjithashtu, në qoftë se Banka nuk do të kishte regjistruar vlerën e rivlerësimit të godinës qendrore, siç referohet në paragrafin paraardhës, pasqyrat financiare të Bankës më 31 dhjetor 2006, do të paraqitnin një tejkalim të vlerës së detyrimeve dhe kapitalit të paguar mbi mjetet në shumën prej 2,446 milionë lekësh. Në këto kushte, referuar ligjit 8269, neni 7, Ministria e Financave do të duhet t'i transferojë Bankës, letra me vlerë shtetërore të tregtueshme, duke zbatuar përqindjet e interesit të tregut, në atë vlerë, të mjaftueshme për të kompensuar këtë pamjaftueshmëri mjetesh.

Tirana, Shqipëri
23 Shkurt 2007

DELOITTE ALBANIA sh.p.k.

Zagreb, Kroaci
23 Shkurt 2007

DELOITTE d.o.o.

BILANCI MË 31 DHJETOR 2006

(të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe.)

	Shënim nr.	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
AKTIVET			
Aktive në monedhë të huaj			
Ari dhe metale të çmuara	3	797	708
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	4	7,867	8,431
Depozita në bankat e huaja	5	38,157	10,175
Investime të vlefshme për shitje	6.1	117,404	133,464
Investime të mbajtura për tregtim	6.2	9,636	-
Aktive të tjera në monedhë të huaj	7	726	551
Totali i aktiveve në monedhë të huaj		174,587	153,329
Aktive vendase			
Ari dhe metale të çmuara	3	53	50
Kredi tranzite	8.1	139	207
Kredi ndaj bankave vendase	8.2	8,904	-
Investime të vlefshme për shitje	9.1	67,575	66,821
Investime të mbajtura deri në maturim	9.2	-	1,725
Aktive të tjera vendase	10	4,223	2,523
Totali i aktiveve vendase		80,894	71,326
Totali i aktiveve		255,481	224,655
DETYRIMET			
Detyrime në monedhë të huaj			
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	11	15,256	16,145
Detyrime ndaj institucioneve financiare jovendase	12	1,246	1,319
Detyrime të tjera të huaja		186	-
Totali i detyrimeve në monedhë të huaj		16,688	17,464
Detyrime vendase			
Para në qarkullim	13	168,234	153,550
Detyrime ndaj bankave vendase	14	53,575	45,182
Detyrime ndaj qeverisë	15	15,944	6,356
Të ardhura për t'u shpërndarë	16	76	129
Detyrime të tjera vendase	17	954	761
Totali i detyrimeve vendase		238,783	205,978
KAPITALI I VET DHE REZERVAT			
Kapitali themeltar		750	750
Rezerva ligjore		3,750	3,750
Rezerva e rivlerësimit	18	(15,856)	(12,452)
Rezerva e rivlerësimit të mjeteve fikse	10	2,660	983
Rezerva të tjera	19	8,706	8,182
Totali i kapitalit të vet dhe rezervat		10	1,213
Totali i detyrimeve, kapitali i vet dhe rezervat		255,481	224,655

Shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 160 deri në faqen 186, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR VITIN E MBYLLUR
MË 31 DHJETOR 2006
(të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe.)

	Shënim nr	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2006	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005
Veprime me jorezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	20	5,870	4,345
Shpenzime interesi dhe komisioni	21	(494)	(660)
Totali neto nga veprimet me jorezidentë		5,376	3,685
Veprime me rezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	22	4,020	4,328
Shpenzime interesi dhe komisioni	23	(1,731)	(1,393)
Totali neto nga veprime me rezidentë		2,289	2,935
Shpenzime operative të tjera, neto (Humbje)/Fitime neto nga ndryshimet e kurseve të këmbimit valutor	24	(1,367) (3,341)	(360) 3,841
Totali i të ardhurave operative		2,957	10,101
Shpenzime të tjera administrative			
Shpenzime personeli	25	(584)	(528)
Shpenzime amortizimi	10	(122)	(115)
Shpenzime zhvlerësimi të aktiveve të patrupëzuara	10	(114)	(159)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative		(319)	(280)
Totali i shpenzimeve të tjera administrative		(1,139)	(1,082)
Të ardhurat neto nga aktiviteti i Bankës		1,818	9,019
Transferim nga/(në) rezerva të rivlerësimit		3,341	(3,841)
Fitimi neto para shpërndarjes		5,159	5,178
Shpërndarja e fitimit në buxhetin e shtetit		4,664	5,100
Shpërndarja e fitimit në rezerva të tjera		495	78
Totali		5,159	5,178

Shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 160 deri në faqen 186, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT TË VET DHE REZERVAVE PËR
VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2006
(të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe.)

	Kapitali themeltar	Rezerva ligjore	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e rivlerësimit të aktiveve fikse	Rezerva të tjera	Fitim i pashpërndarë	Fitimi neto	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2004	750	3,750	(15,836)	1,012	8,075	-	-	(2,249)
Fitimi neto nga aktiviteti bankar	-	-	-	-	-	-	9,019	9,019
Transferime nga/për në rezervën e rivlerësimit	-	-	3,841	-	-	-	(3,841)	-
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	-	(447)	-	-	-	-	(447)
Rimarrje e tepicës nga rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	-	(29)	-	29	-	-
Të tjera rivlerësime	-	-	(10)	-	-	-	-	(10)
Shpërndarja e fitimit	-	-	-	-	107	(29)	(5,178)	(5,100)
Gjendja më 31 dhjetor 2005	750	3,750	(12,452)	983	8,182	-	-	1,213
Fitimi neto nga aktiviteti bankar	-	-	-	-	-	-	1,818	1,818
Transferime nga/për në rezervën e rivlerësimit	-	-	(3,341)	-	-	-	3,341	-
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	-	(67)	-	-	-	-	(67)
Rritje nga rivlerësimi i aktiveve fikse, neto	-	-	-	1,706	-	-	-	1,706
Rimarrje e tepicës nga rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	-	(29)	-	29	-	-
Të tjera rivlerësime	-	-	4	-	-	-	-	4
Shpërndarja e fitimit	-	-	-	-	524	(29)	(5,159)	(4,664)
Gjendja më 31 dhjetor 2006	750	3,750	(15,856)	2,660	8,706	-	-	10

Shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 160 deri në faqen 186, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË PËR VITIN E MBYLLUR MË 31
DHJETOR 2006

(të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe.)


	Shënim nr.	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2006	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005
Fluksi i parasë nga operacionet			
Fitimi neto i vitit		5,159	5,178
Zëra jomonetarë në pasqyrimin e operacioneve			
Rritje në provigjonet për hua të dyshimta		5	6
Zhvlerësimi dhe amortizimi		237	274
Amortizimi i skontos së letrave me vlerë të vlefshme për shitje		(3,920)	(3,760)
Të ardhura nga interesat		(5,533)	(4,300)
Shpenzime për interesat		1,802	1,457
Humbje nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje		1,503	397
Fitim nga shitja e letrave me vlerë të mbajtura për tregtim		(72)	-
Fitime të porealizuara nga letrat me vlerë të mbajtura për tregtim		(5)	-
Amortizimi i grantit		(53)	(41)
Fluksi i parasë para lëvizjes së kapitalit punues		(877)	(789)
Ndryshime në kapitalin punues			
Ulje në depozita me Fondin Monetar Ndërkombëtar		564	8,359
(Rritje) / Ulje në aktive të tjera në monedhë të huaj		(171)	8
Ulje në kreditë tranzite		68	70
(Rritje) në aktive të tjera vendase		(1,865)	(36)
Rritje / (ulje) në detyrimet ndaj Fondin Monetar Ndërkombëtar		(892)	197
(Ulje) në detyrimet ndaj institucioneve financiare		(73)	(208)
Rritje në detyrime të tjera të huaja		186	-
Rritje në detyrimet ndaj bankave vendase		4,688	7,629
Rritje në detyrimet ndaj qeverisë		9,588	1,054
Rritje në detyrime të tjera në monedhë vendase		193	181
Grant i marrë		-	64
Blerja e letrave me vlerë në monedhë të huaj të mbajtura për tregtim		(25,726)	-
Shitja e letrave me vlerë në monedhë të huaj të mbajtura për tregtim		16,281	-
Fluksi i parasë i gjeneruar nga operacionet		2,841	17,318
Interesa të marrë		5,396	3,993
Interesa të paguar		(1,788)	(1,465)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operacionale		5,572	19,057

	Shënim nr.	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2006	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005
Fluksi nga investimet			
Blerja e aktiveve fikse		(75)	(152)
Blerja e aktiveve fikse të patrupëzuara		(2)	(59)
Blerja e letrave me vlerë në monedhë të huaj të vlefshme për shitje		(289,309)	(234,083)
Blerje e letrave me vlerë në monedhë vendase të vlefshme për shitje		(181,866)	(180,421)
Shitja dhe maturime të letrave me vlerë në monedhë të huaj të vlefshme për shitje		300,050	207,802
Shitja dhe maturime të letrave me vlerë në monedhë vendase të vlefshme për shitje		184,832	181,506
Rritja në marrëveshjet e riblerjes		(5,156)	(1,758)
Axhustime për efekt të kursit të këmbimit		506	158
Fluksi neto i gjeneruar / (përdorur) nga investimet		8,980	(27,007)
Fluksi i parasë prej financimit			
Maturimi i borxheve		1,726	-
Rivlerësimi i godinës qendrore		1,706	-
Rivlerësimi i rezervave të tjera		4	(10)
Rritja në rezerva të tjera		524	107
Rritja (ulja) në emetimin e parasë në qarkullim		9,000	15,000
Fitimi i shpërndarë		(5,188)	(5,207)
Fluksi neto i gjeneruar nga financimet		7,772	9,890
Rritja në para gjatë vitit		22,324	1,940
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	26	24,390	22,450
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	26	46,714	24,390


Shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 160 deri në faqen 186, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në 1 mars 2007.

Ardian Fullani
Guvërnator i Bankës



Marseda Dumani
Drejtor i Departamentit të
Kontabilitetit dhe Pagesave



SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2006

(të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk shprehet ndryshe.)

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Banka e Shqipërisë ("Banka") është Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë, që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr. 8269 datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë". Në zbatim të këtij ligji, detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë janë si vijon:

- arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve;
- nxitja dhe mbështetja e zhvillimit të një regjimi të këmbimeve valutore;
- administrimi i parasë në qarkullim;
- administrimi i normave të interesit;
- hartimi, miratimi dhe zbatimi i politikës monetare të Republikës së Shqipërisë;
- mbikëqyrja e aktiviteteve të bankave të nivelit të dytë, përfshirë dhënien e licencave të të gjitha bankave;
- dhënia e licencave për ushtrimin e aktivitetit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të institucioneve bankare ndërkombëtare.

Banka i nënshtrohet ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Për Bankën e Shqipërisë".

2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

(a) Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin Shqiptar "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe në përputhje me parimet kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Kjo politikë kontabile është gjerësisht në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"). SNRF-të përdoren në përgatitjen e pasqyrave financiare të bashkëngjitura, deri në fazën ku nuk bien në kundërshtim me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë".

Parimet kontabile kryesore që janë përdorur nga Banka në pasqyrat financiare, janë përshkruar si më poshtë:

Pasqyrat financiare të paraqitura përfshijnë llogaritë e Bankës, përgatitur mbi bazën e kostos historike të kontabilitetit, përshtatur për të përfshirë

rivlerësimin e portofolit të letrave me vlerë, monedhave të huaja, të arit, të ndërtesës qendrore, si dhe të aktiveve dhe detyrimeve të tjera financiare.

Pasqyrat financiare paraqiten në monedhën vendase të Republikës së Shqipërisë, lekë Shqiptar "lekë".

Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës, një njësi biznesi e cila merret me shtypshkrimin e materialeve të Qeverisë, që përmbajnë elemente të sigurisë së lartë, si dhe të publikimeve të Bankës së Shqipërisë. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, më datë 1 prill 2003, vendosi që Shtypshkronja të mbetet përkohësisht në varësi administrative të Bankës së Shqipërisë, si pjesë e veçantë e strukturës organizative të saj. Operacionet financiare të Shtypshkronjës, nuk janë konsoliduar me ato të Bankës, për faktin se Shtypshkronja nuk ka kryer rivlerësimin e mjeteve financiare dhe ndërtesave të saj, konform me rivlerësimin e mjeteve financiare dhe ndërtesave të Bankës.

Pozicioni financiar i Shtypshkronjës më 31 dhjetor 2006, është i pasqyruar në Shënimin 27 të këtyre pasqyrave financiare.

(b) Interpretime të reja të miratura, që s'kanë hyrë akoma në fuqi

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, përcakton domosdoshmërinë e përdorimit të disa vlerësimeve kritike kontabël. Gjithashtu kërkohet, që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Bankës. Fushat, ku më së shumti kërkohet një shkallë e lartë gjykimi apo kompleksiteti, apo fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, janë prezantuar në politikat kontabile të raportuara.

Banka ka zgjedhur të mos zbatojë, para datës efektive, standardet dhe interpretimet që janë miratuar, por janë ende joefektive për periudhat kontabël që fillojnë më 1 janar 2006:

- SNRF 7, Instrumentet Financiare: Prezantimi (efektive në 1 janar 2007);
- SNK 1, Amendim – Prezantime shtesë në lidhje me kapitalin (efektive në 1 janar 2007).

Zbatimi i këtyre interpretimeve të reja nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës për periudhën fillestare të zbatimit.

(c) Shmangie nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Devijimet më të rëndësishme nga "SNRF" mund të përmbliidhen si më poshtë:

- SNK 16 "Pasuria, Ndërtesat dhe Pajisjet".

Metoda e rivlerësimit të ndërtesës, siç prezantohet në shënimin 10 nuk është në përputhje me kërkesat për rivlerësimin, të parashikuara nga SNK 16

“Pasuria, ndërtesat dhe pajisjet”, në masën që ky rivlerësim nuk u realizua për të gjithë klasën e ndërtesave.

- SNK 19: “Përfitimet e punonjësve” dhe SNK 26 “Kontabiliteti dhe raportimi i fondit të pensionit”.

Pasqyrimi dhe kontabiliteti i Fondit të Pensionit nuk është bërë në përputhje me SNK 19 dhe 26. Detyrimi ndaj fondit të pensionit është shprehur si vlerë neto, por përlllogaritja e këtij detyrimi nuk i është përmbajtur specifikimeve të standardit, për shkak se nuk është bërë asnjë vlerësim aktuarial.

- SNK 27: “Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe kontabiliteti i investimit në filiale”.

Në pasqyrat financiare të Bankës, nuk është bërë konsolidimi i raporteve financiare në lidhje me aktivitetin e shtypshkronjës, njësi që administrohet nga Banka, siç sqarohet sa më sipër.

(d) Njohja e interesave dhe komisioneve

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa, përfshijnë interesat e fituar nga kuponat si edhe amortizimin e çdo primi apo skontoje, apo çdo diferencë tjetër ndërmjet vlerës fillestare kontabël të instrumentit fitimprurës dhe vlerës së tij në maturim, llogaritur bazuar në metodën lineare.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet lindin nga shërbimet financiare të siguruara nga Banka dhe regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në momentin që shërbimi kryhet. Shpenzime/të ardhura të tjera operative, përfshijnë fitimet dhe humbjet që vijnë nga shitjet dhe ndryshimet në vlerën e tregut të mjeteve dhe detyrimeve financiare, të mbajtura për tregtim apo të vlefshme për shitje.

(e) Konvertimi i monedhave të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, konvertohen në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës, në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj, rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen.

Fitimi ose humbja e porealizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet fillimisht në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe më pas transferohet në llogarinë “Rezerva të rivlerësimit” në bilanc, siç parashikon ligji nr 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”.

Kurset zyrtare të këmbimit, të përdorura nga Banka (njësi e monedhës së huaj përkatëse e shprehur në lekë) për monedhat e huaja më kryesore, më 31 dhjetor 2006 dhe 31 dhjetor 2005 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Dollari amerikan ("Usd")	94.14	103.58
Monedha Evropiane ("EURO")	123.85	122.58
Stërlina angleze ("GBP")	184.65	178.65
Të drejta të veçanta tërheqjeje ("Sdr")	141.51	148.03
Jen japonez (Ypy)	0.7919	0.8826
Ari ("Xau")	1 onz = 59,844.80	1 onz = 53,136.54

(f) Aktivitet financiarë

Të gjitha aktivitetet financiarë shprehen fillimisht me kosto, që konsiderohet çmimi i blerjes përfshirë shpenzimet e lidhura me blerjen e aktivitetit financiar, dhe në vijim maten me vlerën reale.

Aktivitetet financiarë klasifikohen si më poshtë:

Huatë të krijuara nga Banka

Huatë janë aktive financiarë me pagesa fikse ose të paracaktuara, të cilat nuk tregtohen në një treg aktiv por krijohen nga Banka, për t'i siguruar fonde huamarrësit. Huatë e krijuar nga Banka përfshijnë huatë për punonjësit.

Në çdo datë raportimi në vijim ato paraqiten me koston e amortizuar, duke zbritur çdo humbje nga rënia e vlerës për të reflektuar shumat që nuk mund të rekuperohen më.

Të mbajtura deri në maturim.

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim janë aktive financiarë, të cilat mbartin pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturime fikse, për të cilat Banka ka qëllimin pozitiv dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim.

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim njihen në pasqyrat financiarë në datën efektive të shlyerjes dhe fillimisht regjistrohen me kosto. Në çdo datë raportimi në vijim ato paraqiten me vlerën e amortizuar, duke zbritur humbjen nga rënia në vlerë, e cila njihet për të reflektuar shumat e parekuperueshme.

Të vlefshme për shitje.

Investime të vlefshme për shitje njihen në pasqyrat financiarë, në datën efektive të shlyerjes dhe, pas njohjes së parë, ato paraqiten në pasqyrat financiarë me vlerën reale. Ndryshimet në vlerën reale pasqyrohen direkt në kapital në "Rezervën e rivlerësimit të letrave me vlerë", përveç humbjeve nga rënia në vlerë. Kur investimi shitet ose shpreh rënie në vlerën e arkëtueshme, fitimi apo humbja e akumuluar e njohur deri në atë moment në rezervën e rivlerësimit, njihet si e ardhur ose shpenzim për periudhën.

Aktive financiarë të mbajtura me vlerë reale përmes fitim humbjes.

Kjo kategori përfshin instrumente financiarë që Banka i mban për qëllime tregtimi në terma afatshkurtër. Këto investime njihen në pasqyrat financiarë në datën e tregtimit, datë kjo kur blerja apo shitja e investimit është e

përcaktuar në marrëveshje, termat e së cilës kërkojnë shlyerjen e investimit brenda afatit të përcaktuar nga tregu. Letrat me vlerë të mbajtura për tregtim njihen në pasqyrat financiare me vlerën reale. Çdo fitim/humbje e realizuar nga ndryshimi në vlerën reale, njihet direkt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera reale.

Për letrat me vlerë që tregtohen në tregje financiare të organizuara, vlera reale përcaktohet duke iu referuar çmimeve të kuotuar në bursë në momentin e mbylljes së aktivitetit të biznesit në datën e bilancit.

Për letrat me vlerë, për të cilat nuk ekziston një çmim i kuotuar në bursë, një vlerësim i arsyeshëm i vlerës reale përcaktohet duke iu referuar vlerës aktuale të tregut të një letre tjetër me vlerë, e cila është e përafërt në natyrë.

Rënia në vlerë dhe paarkëtueshmëria e aktiveve financiare.

Mjetet financiare, me përjashtim të atyre klasifikuar si "Të mbajtura për tregtim", vlerësohen në çdo datë bilanci, nëse kanë pësuar rënie në vlerë apo kanë humbur aftësinë shlyerëse. Mjetet financiare pësojnë rënie në vlerë kur ka evidencë objektive që, si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të mjetit financiar, janë ndikuar rrjedhat e ardhshme të parave që pritet të merren nga investimi. Në qoftë se një evidencë e tillë ekziston, përcaktohet shuma që vlerësohet të merret nga ai aktiv dhe ndonjë humbje nga rënia në vlerë, duke u bazuar në vlerën neto aktuale të rrjedhjes së ardhshme të parasë që pritet të merret, dhe diferenca midis shumës që vlerësohet të merret dhe vlerës kontabël njihet si më poshtë:

- për huatë e krijuara nga Banka - shuma e recuperueshme e huasë së krijuar llogaritet bazuar mbi vlerësimin në fund të vitit për huatë, duke përfshirë dhe interesin e akumuluar. Në përcaktimin e shumave të recuperueshme nga huatë për personelin, drejtuesit duhet të konsiderojnë shumë faktorë, duke përfshirë dhe historinë e pagesave të ish-punonjësve. Provigjone për rënien në vlerë të huave, raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si një shpenzim dhe zbritet nga kategoria përkatëse e aktiveve në bilanc. Kur vendoset që një hua nuk mund të recuperohet më, të gjitha procedurat e nevojshme ligjore janë përfunduar dhe humbja përfundimtare është përcaktuar, huaja hiqet nga librat.
- për aktivet financiare të mbajtura deri në maturim – vlera e mbartur e aktivitetit deri në shumën që vlerësohet të merret në mënyrë direkte ose nëpërmjet përdorimit të një llogarie provigjone dhe shuma e humbjes përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- për aktivet financiare të vlefshme për shitje – në qoftë se rënia në vlerën e tregut, e një aktivi të disponueshëm për shitje është kaluar direkt në kapital dhe ka një evidencë objektive që aktivi mund të ketë rënie në vlerë, humbja e akumuluar që është njohur direkt në kapital do të hiqet nga kapitali dhe do të njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve edhe nëse aktivi financiar zotërohet përsëri nga Banka.

(g) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë blerë nën marrëveshje për t'i rishitur (marrëveshje riblerjeje e anasjelltë) dhe letrat me vlerë shitur nën marrëveshje për t'i riblerë (marrëveshjet e riblerjes) janë trajtuar përgjithësisht si hua të kolateralizuara dhe regjistrohen me shumën e parave të dhëna/marra, plus interesin e përlogaritur.

Marrëveshjet e riblerjes regjistrohen në bilanc në zërin "Detyrime ndaj bankave vendase". Bazuar mbi rregulloren e Bankës së Shqipërisë mbi marrëveshjet e riblerjes, Bankës nuk i duhet të krijojë kolateral për këto letra me vlerë.

Interesi i fituar mbi marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe interesi i pësuar mbi marrëveshjet e riblerjes, njihen si të ardhura ose shpenzime nga interesi gjatë jetëgjatësisë së çdo marrëveshjeje, duke përdorur normën bazë të interesit të shpallur me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës.

(h) Aktive të qëndrueshme

Aktivet e qëndrueshme shprehen me koston historike zvogëluar me amortizimin e akumuluar, me përjashtim të ndërtesës qendrore të Bankës, e cila shprehet me vlerë të rivlerësuar (Shënimi 10). Çdo rritje që rrjedh nga rivlerësimi i godinës kryesore kreditohet direkt në kapital në zërin, rezerva të rivlerësimit të ndërtesave, përveç rastit kur kjo rritje anulon rënien nga vlerësimi i të njëjtit aktiv, të njohur më përpara në fitim/humbje, rast ky specifik ku rritja nga rivlerësimi njihet direkt në fitim/humbje deri në masën e rënies së njohur paraprakisht. Çdo rënie në vlerën e mbetur të ndërtesave, rezultuar nga procesi i rivlerësimit njihet direkt fitim/humbje, deri në masën e balancës së njohur në rezervat e rivlerësimit, rezultuar nga rivlerësimi i mëparshëm i godinave.

Në qoftë se vlera e tregut e një aktivi të qëndrueshëm është më e vogël sesa vlera kontabël, për shkak të rrethanave të konsideruara jo të përkohshme, aktivi zvogëlohet deri në vlerën e tregut.

Fitimet ose humbjet nga heqja (shitjet ose nxjerrjet jashtë përdorimit) e aktiveve të qëndrueshme, përcaktohen si diferencë midis vlerës neto të daljes nga bilanci dhe vlerës neto kontabël të mjetit, dhe regjistrohen në llogarinë humbje-fitim të vitit në të cilin aktivi është hequr.

Amortizimi llogaritet mbi të gjitha aktivet fikse, bazuar në koston historike ose shumën e rivlerësuar. Amortizimi vjetor llogaritet me metodën lineare, duke përdorur normat specifike të amortizimit për çdo aktiv të amortizueshëm, bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar të aktivit. Jetëgjatësia e zbatuar në vitin 2006 është e njëjtë me atë të vitit 2005:

	2006
Ndërtesa-godina qendrore	40 vjet
Ndërtesat-në degë	25 vjet
Mjete transporti	5-10 vjet
Pajisje zyre	3-20 vjet
Programe kompjuteri	2 vjet

(i) Kosto të shtypjes dhe prerjes së parasë

Kostot e printimit të kartëmonedhave dhe të prerjes së monedhave kapitalizohen si aktive fikse të patrupëzuara dhe amortizohen respektivisht me 2.5 vjet dhe 10 vjet.

(j) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

Banka është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin, në bazë të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" dhe bazuar në këtë ligj 100 përqind e fitimit, kalon direkt në buxhetin e Shtetit, pas plotësimit të niveleve të fondeve rezervë, të kërkuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

(k) Rezerva ligjore

Në përputhje me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", Banka ka krijuar një rezervë ligjore, në të cilën transferohet 25 përqind e fitimit neto të çdo viti, derisa shuma e rezervës arrin 500 përqind të kapitalit themeltar.

(l) Grantet

Grantet regjistrohen fillimisht në bilanc me shumën e marrë. Grantet që lidhen me zëra shpenzimi, kalohen te pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve gjatë periudhës që është bërë shpenzimi. Grantet që lidhen më blerjen e pronave, të pajisjeve dhe programeve kompjuterike kalohen te pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve, përgjatë jetës së aktivitetit përkatës, në shumën që i përket zhvlerësimit/amortizimit që i zbritet aktivitetit.

(m) Paraja dhe ekuivalentet e saj

Për qëllimin e përgatitjes së pasqyrës së rrjedhjes së parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj ndahen në arka në lekë dhe në monedha të huaja, si dhe depozita në monedhë të huaj me maturitet të mbetur më pak se tre muaj.

(n) Përdorimi i parashikimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi i Bankës që të bëjë parashikime dhe supozime, që ndikojnë në shumën e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve dhe paraqitjen e aktiveve dhe detyrimeve kontigjente, llogaritur në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare, dhe shumën e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës të raportuara. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

(o) Krahasueshmëria

Disa shifra krahasuese në pasqyrën e të ardhurave si dhe në pasqyrën e kapitalit dhe rezervës janë riklasifikuar, që të jenë konform prezantimit të pasqyrave financiare të vitit aktual.

3. ARI DHE METALE TË ÇMUARA

Më 31 dhjetor 2006, vlera e arit të vendosur në depozita, mjete të Bankës ishte 797 milionë lekë (2005 – 708 milionë lekë), e cila përbëhet prej 13,319 onz në shufra prej ari (2005 – 13,319 onz ar).

Ari është vlerësuar me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit. Diferenca prej 89 milionë lekësh (2005- 168 milionë lekë), rezulton nga rivlerësimi i arit që është regjistruar në rezervën e rivlerësimit. Më 31 dhjetor 2006, 1 onz ar u vlerësua me 635.7 usd (2005 –513 usd).

Ari dhe metale të tjera të çmuara, të përfshira në aktive në monedhë vendase përfshijn gjendjet e platinit dhe të argjendit në kasafortë, të vlerësuara me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit, me një shumë totale prej 48 milionë lekësh më 31 dhjetor 2006 (2005 – 45 milionë lekë), si edhe ar jomonetar prej 5 milionë lekësh (2005 – 5 milionë lekë).

4. DEPOZITA TEK FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)	7,012	7,128
E drejta speciale e tërheqjes ("SDR")	847	1,295
Interes i përlogaritur	8	8
Totali	7,867	8,431

Kuotat tek Fondi Monetar Ndërkombëtar ("FMN") rezultojnë nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë pranë FMN-së, në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë". Këto depozita kanë si kundërparti huatë e dhëna nga FMN për Republikën e Shqipërisë, siç paraqitet në shënimin 11.

E drejta speciale e tërheqjes, përfaqëson depozitat e vendosura pranë FMN-së. Këto depozita kanë një interes të përcaktuar në bazë javore. Norma e interesit më 31 dhjetor 2006, ishte 4.07 për qind (2005 – 3.03 %).

5. DEPOZITA NË BANKAT E HUAJA

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Llogari rrjedhëse	17,281	7,996
Depozita afatshkurtra	20,803	2,175
Interes i përlogaritur	73	4
Totali	38,157	10,175

Depozitat afatshkurtra dhe llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja, kanë norma interesi që bazohen në monedhën e depozitës apo llogarisë rrjedhëse dhe variojnë nga 0.17 % deri në 5.29 % (2005 – nga 1.25 % deri në 4.53 %).

Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja janë në euro, usd, gbp dhe jpy, të cilat sipas çdo monedhe të huaj u përgjigjen gjendjeve të mëposhtme:

	31 dhjetor 2006 (në milionë)	31 dhjetor 2005 (në milionë)
EURO	197	25
USD	96	28
GBP	7	11
JPY	4,022	2,615

6. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (NË MONEDHË TË HUAJ)

6.1. INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE

Portofoli i letrave me vlerë në monedhë të huaj të vlefshme për shitje, paraqitur në vlerë tregu është si më poshtë:

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Nota thesari të qeverive të huaja	87,190	99,043
Investime afatmesme të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare	18,212	4,577
Investime me kurs fiks të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (FIX BIS)	9,711	24,817
Bono thesari të Qeverisë Franceze	1,818	2,443
Nota thesari të agjencive amerikane	473	2,584
Totali	117,404	133,464

Nota thesarit të qeverive të huaja, përfshijnë nota thesari të Qeverisë Amerikane të shprehura në usd, të Qeverive Franceze dhe Gjermane të shprehura në euro si dhe të Qeverisë Angleze të shprehura në gbp. Notat e thesarit të qeverive të huaja kanë kurse kuponash që variojnë nga 2.5 % në 9 %. Interesi paguhet në baza gjashtëmujore dhe maturimet variojnë nga maj i vitit 2007 në tetor të vitit 2016. Norma e brendshme e kthimit varion nga 2.8 % në 5.66 % (2005 – 1.6 % në 5.82 %).

Investimet afatmesme të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare përbëhen nga letra me vlerë me kupona fikse, të përcaktuara në usd, euro dhe gbp me kurse që variojnë nga 2.95 % në 4.6 %. Interesi është i pagueshëm në baza vjetore, për investimet në euro dhe gjashtëmujore, për investimet në usd dhe në gbp, dhe maturimet variojnë midis shtator 2007 dhe mars të vitit 2014. Norma e brendshme e kthimit varion nga 2.87 % në 5.28 % (2005 – 2.87 % në 5.1 %).

Investimet me kurs fiks të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (FIX BIS) janë të shprehura në usd, euro dhe gbp, me normë të brendshme kthimi që variojnë nga 3.56 % në 5.3 % (2005 – 2.04 % në 4.53 %) dhe me kufij maturiteti nga maj 2007, në dhjetor 2007.

Bonot e thesarit të Qeverisë Franceze janë të shprehura në euro dhe maturohen deri në gusht të vitit 2007. Ato janë blerë me normë të brendshme kthimi prej 3.5 % (2005 – 2.1 %).

Notat e agjencive amerikane janë të shprehura në usd me kurse kuponi deri 2.37 %. Interesi është i pagueshëm në baza gjashtëmujore dhe kufijtë e maturimit janë deri në shkurt 2007. Norma e brendshme e kthimit është 2.4 % (2005 – 2 % në 2.4 %).

Portofoli i letrave me vlerë në monedha të huaja, klasifikuar si “të vlefshme për shitje”, paraqitur në vlerë nominale sipas monedhave është si më poshtë:

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
USD		
Nota të Qeverisë Amerikane	388	388
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	2	77
Nota të agjencive amerikane	5	25
Investime afatmesme të BIS	32	24
Totali	427	514
EURO		
Nota të Qeverisë Franceze	199	442
Nota të Qeverisë Gjermane	169	-
Investime afatmesme të BIS	112	10
Bono thesari të Qeverisë Franceze	15	20
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	60	125
Totali	555	597
GBP		
Nota të Qeverisë Angleze	27	26
Investime afatmesme të BIS	7	4
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	11	9
Totali	45	39

6.2. LETRA ME VLERË TË MBAJTURA PËR TREGTIM

Portofoli i letrave me vlerë në monedhë të huaj, klasifikuar si “të mbajtura për tregtim” paraqitet me vlerë tregu në lekë si më poshtë:

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Nota thesari të Qeverisë Amerikane	6,407	-
Nota thesari të agjencive amerikane	3,229	-
Totali	9,636	-

Notat e Qeverisë Amerikane, të shprehura në usd, kanë kurse kuponi që variojnë ndërmjet 3.37 % dhe 4.87 %. Interesi është i pagueshëm çdo gjashtë muaj dhe maturiteti varion ndërmjet gushtit 2007 dhe prillit 2011.

Notat e agjencive amerikane, të shprehura në usd, kanë kurse kuponi që variojnë ndërmjet 2.37 % dhe 6.62 %. Interesi është i pagueshëm në baza vjetore ose gjashtëmujore, dhe maturiteti varion ndërmjet tetor 2007 dhe nëntor 2009.

Duke filluar nga data 25 korrik 2006, ky portofol administrohet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) në kuadrin e marrëveshjes së Bankës së Shqipërisë me Bankën Botërore "Për administrimin dhe asistencën teknike mbi investimin e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë", e lidhur me datë 23 shtator 2005. Ky portofol njihet në pasqyrat financiare në datën e tregtimit.

7. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË TË HUAJ)

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Kuotizacione në institucionet ndërkombëtare		
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)	358	361
Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA)	12	12
Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA)	6	6
Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)	69	76
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)	55	61
Banka Islamike e Zhvillimit (IDB)	22	24
Totali i kuotizacione	522	540
Arka në valutë	15	11
Të drejta ndaj IBRD	189	-
Totali aktive të tjera në monedhë të huaj	726	551

Më 31 dhjetor 2006, aktive të tjera në monedhë të huaj përbëhen nga kuotizacionet për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në institucionet ndërkombëtare financiare prej 522 milionë lekësh (2005 – 540 milionë lekë), si dhe nga arka në valutë me një vlerë prej 15 milionë lekësh (2005 – 11 milionë lekë).

Të drejta ndaj IBRD, përfaqëson shumën për t'u arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë nga aktiviteti i administruar nga IBRD, gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes së transaksionit (shiko shënimin 6.2).

8. KREDI PËR PALËT E TRETA

8.1. KREDI TRANZITE

Totali prej 139 milionë lekësh (2005 – 207 milionë lekë) përfaqëson kredi për sektorin e shërbimeve, akorduar Bankës Italo-Shqiptare për t'u

shpërndarë huamarrësve, me qëllim mbështetjen e programeve qeveritare (shiko shënimin 12). Për këtë hua nuk është vendosur kolateral.

8.2 KREDI NDAJ BANKAVE VENDASE

Kredia ndaj bankave vendase përfaqëson marrëveshje të anasjellta riblerjeje, të vendosura midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë në vlerën 8,904 milionë lekë (2005 - zero), me afate maturimi një dhe tremujore. Në 31 dhjetor 2006, normat e interesit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes variojnë nga 5.6 % në 6.51 %.

9. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (NË MONEDHË VENDASE)

9.1 INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Bono thesari afatshkurtra të Qeverisë Shqiptare	67,575	66,821
Totali	67,575	66,821

Më 31 dhjetor 2006, bonot e thesarit afatshkurtra përfaqësojnë bono thesari të qeverisë me kupon zero, me afat maturimi 3 dhe 6-muaj, të cilat maturohen në periudhën janar - qershor 2007. Norma e tyre e kthimit në blerje varion nga 5.4 % deri në 7.1 % (2005 – 5.38 % në 8.64 %).

9.2 INVESTIME TË MBAJTURA DERI NË MATURIM

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Obligacione me zero kupon për kapitalizimin e Bankës Kombëtare Tregtare ("BKT")	-	1,725
Totali	-	1,725

Letrat me vlerë për rikapitalizimin e Bankës Kombëtare Tregtare kanë të bëjnë me obligacione zero kupon, të cilat janë emetuar nga Qeveria Shqiptare për të zëvendësuar pjesëmarrjen në kapital në Bankën Kombëtare Tregtare. Letrat me vlerë fitonin një normë kthimi prej 6 % në vit dhe u maturuan në janar të vitit 2006.

10. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Aktive fikse, neto	3,123	1,464
Aktive të patrupëzuara, neto	166	278
Kredi punonjësve	857	707
Debitorë të tjerë	6	5
Numizmatika	39	38
Inventari	25	25
Të tjera	7	6
Totali	4,223	2,523

Ndërtesa qendrore e Bankës, e përfshirë nën kategorinë “Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme”, u rivlerësua në dhjetor 2006, në shumën 2,660 milionë lekë, nga vlera neto kontabël prej 954 milionë lekësh, vlerë kjo e mbetur nga rivlerësimi i kryer në mars të vitit 2000. Rivlerësimi u bë me datë efektive 29 dhjetor 2006, nga një komision i pavarur vlerësuesish. Metodologjia e vlerësimit u bazua në metodën e të ardhurave, bazuar në rikapitalizimin e qirave dhe të çmimit të shitjes të qendrave të reja të biznesit, në afërsi të godinës qendrore të Bankës. Rritja në vlerë prej 1,706 milionë lekësh u kreditua tek rezerva e rivlerësimit të godinave në kapital dhe amortizohet çdo muaj në përputhje me normën e amortizimit përkatëse. Ndërtesat e tjera, pronë e Bankës nuk u rivlerësuan.

Në 31 dhjetor 2006, kreditë e punonjësve përfshijnë provigjone për çështje gjyqësore, në masën 15 milionë lekë (31 dhjetor 2005 – 10 milionë lekë).

Më 31 dhjetor 2006, vlera e regjistruar e kolateralit për kreditë afatgjata dhënë punonjësve të Bankës arrin në shumën 990 milionë lekë (31 dhjetor 2005 ishte 851 milionë lekë).

Vlera neto kontabël e aktiveve fikse për çdo kategori, paraqitet si më poshtë:

	Toka, ndërtesa konstruksione të përgjithshme	Pajisje të përgjithshme	Mjete transporti	Ndërtime në proces	Totali i aktiveve fikse
Kosto/Vlerësimi					
Gjendja më 1 janar 2006	1,443	682	173	17	2,315
Shtesat	4	28	27	16	75
Rivlerësim i godinës	1,706	-	-	-	1,706
Eliminim në rivlerësim	(189)	-	-	-	(189)
Gjendja më 31 dhjetor 2006	2,964	710	200	33	3,907
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2006	220	490	141	-	851
Amortizimi i vitit	38	70	14	-	122
Eliminim në rivlerësim	(189)	-	-	-	(189)
Gjendja më 31 dhjetor 2006	69	560	155	-	784
Vlera kontabël neto					
Gjendja më 31 dhjetor 2006	2,895	150	45	33	3,123
Gjendja më 31 dhjetor 2005	1,223	192	32	17	1,464

Vlera neto kontabël e aktiveve fikse të patrupëzuara për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Bankënota të prera dhe monedha të shtypura	Totali i aktiveve fikse të patrupëzuara
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2006	336	2,454	2,790
Shtesat	2	-	2
Gjendja më 31 dhjetor 2006	338	2,454	2,792
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2006	266	2,246	2,512
Amortizimi i vitit	48	66	114
Gjendja më 31 dhjetor 2006	314	2,312	2,626
Vlera kontabël neto:			
Më 31 dhjetor 2006	24	142	166
Më 31 dhjetor 2005	70	208	278

11. DETYRIME NDAJ FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit (PRGF)	8,364	9,513
Llogaria e letrave me vlerë tek FMN	4,812	4,881
Llogari e FMN-së në lekë	2,077	1,751
Interes i përlllogaritur	3	-
Totali	15,256	16,145

Huatë PRGF janë të lidhura me kuotizacionet për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në FMN dhe janë tërhequr në emër të qeverisë për reformat e mëposhtme:

“Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 2” u miratua me marrëveshjen e datës 13 maj 1998 në shumën 45,040,000 sdr, duke u disbursuar nga viti 1999 deri në vitin 2001. Gjendja më 31 dhjetor 2006 është 28,668,900 sdr (2005 – 36,265,400 sdr). Kjo është një hua e kthyeshme deri në vitin 2011, në 10 këste gjashtëmuajore, duke filluar nga viti 2004. Norma e interesit është 0.5 % dhe është e pagueshme çdo gjashtë muaj.

“Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 3” u miratua me marrëveshjen e datës 21 qershor 2002, në shumën 28,000,000 sdr dhe është disbursuar deri më 20 qershor 2005. Gjendja në fund të vitit 2006 është 28,000,000 sdr (2005 - 28,000,000 sdr) me një interes prej 0.5 %, i pagueshëm çdo gjashtë muaj. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas pesë vjet e gjysmë, me 10 këste të barabarta.

“Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit” (PRGF 4) dhe “Huaja-Lehtësia e Financimit Afatmesëm” (EFF) u miratuan me marrëveshjen trevjeçare të datës 27 janar 2006, në shumën 17,045,000 sdr.

Disbursimi i dy transeve të para të PRGF 4 prej 2,435,000 sdr u bë në vitin 2006, me një interes prej 0.5 %, i pagueshëm çdo gjashtë muaj. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas pesë vjet e gjysmë, në dhjetë këste gjashtëmujore të barabarta.

Llogaria e FMN-së në lekë” është rritur 353 milionë lekë, si rezultat i disbursimit të dy transeve të para të huasë EFF prej 2,435,000 sdr, gjatë vitit 2006. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas katër vjet e gjysmë, brenda 10 vjetëve. Interesi i këtyre kredive është i ndryshueshëm dhe paguhet çdo tre muaj. Më 31 dhjetor 2006 interesi ishte 5.26 %.

12. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOREZIDENTE

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Detyrime tranzite (Shënimi 8)	139	207
Hua e Republikës së Greqisë	1,090	1,079
Detyrime ndaj Bankës Botërore	12	28
Interes i përlogaritur	5	5
Totali	1,246	1,319

Detyrime tranzite prej 139 milionë lekësh përfaqëson huanë e dhënë nga Banka Evropiane e Investimeve dhe përbëhet nga huaja prej 0.1 milion usd dhe 1 milion euro (shënimi 8). Interesi paguhet nga përfituesit e këtyre kredive tranzite (bankat dhe kompanitë vendase) drejtpërsëdrejti tek sigurvehit e financimit.

Huaja e Republikës Greke prej 8.8 milionë eurosh është dhënë me qëllim financimin e bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë. Norma vjetore e interesit është 1.17 për qind, e pagueshme çdo 6 muaj. Huaja maturohet në vitin 2018.

Detyrimi ndaj Bankës Botërore përbëhet nga llogaritë e organizatave ndërkombëtare pranë Bankës së Shqipërisë, si Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA), Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA).

13. PARAJA NË QARKULLIM

Banka ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës kombëtare. Ky zë përfshin kartëmonedha dhe monedha vendase në qarkullim, të emetuara nga Banka.

Më 31 dhjetor 2006 dhe 2005 shuma e kartëmonedhave dhe e monedhave në qarkullim është si më poshtë:

Vlera Nominale LEKË	31 dhjetor 2006		31 dhjetor 2005	
	Copë (në mijë)	Totali lekë (milionë)	Copë (në mijë)	Totali lekë (milionë)
100	9,244	924	12,167	1,217
200	15,799	3,160	15,481	3,096
500	66,541	33,271	68,373	34,187
1,000	72,601	72,601	68,218	68,218
5,000	11,351	56,755	9,087	45,435
Monedha		1,523		1,397
		168,234		153,550

14. DETYRIME NDAJ BANKAVE VENDASE

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Në monedha të huaja		
Rezerva e detyrueshme	18,273	14,683
Llogari të bankave të nivelit të dytë	67	118
	18,340	14,801
Në monedhë vendase		
Rezerva e detyrueshme	30,122	26,980
Llogari të bankave të nivelit të dytë	453	1,800
Marrëveshjet e riblerjes	4,199	505
Depozita njëditore	436	1,082
	35,210	30,367
Interes i përlllogaritur	25	14
Totali	53,575	45,182

Interesi mbi llogarinë e rezervave të detyrueshme llogaritet si më poshtë:

- gjendjet në lekë: 70 % e *yield*-it të marrëveshjeve repo: 3.85 % më 31 dhjetor 2006 (70 % e *yield*-it të marrëveshjeve repo: 3.5 % më 31 dhjetor 2005);
- gjendjet në usd: 70 % e normës së usd libor njëmuajore: 3.75 % më 31 dhjetor 2006 (70 % e normës së usd libor njëmuajore: 3.07 % më 31 dhjetor 2005);
- gjendjet në euro: 70 % e normës së euros njëmuajore: 2.57 % më 31 dhjetor 2006 (70 % e normës së euro libor njëmuajore: 1.7 % më 31 dhjetor 2005).

Në 31 dhjetor 2006, vlera nominale e marrëveshjeve të riblerjes, të vendosura midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë është 4,199 milionë lekë, me afat maturimi njëditor.

Depozitat me afat njëditor kanë normë interesi prej 3.75 % (2005 – 3.25 %).

15. DETYRIMI NDAJ QEVERISË

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Fitim për t'iu derdhur qeverisë	-	547
Depozita në emër të qeverisë	15,922	5,785
Të tjera	22	24
Totali	15,944	6,356

Depozita në emër të qeverisë përfshin llogarinë kryesore prej 13,048 milionë lekësh, fonde të donatorëve ndërkombëtarë, të depozituara në Bankë për transferim të mëtejshëm në projektet e ndihmës në Shqipëri, prej 2,087 milionë lekësh, si dhe 787 milionë lekë janë fonde rezervë të qeverisë për Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH).

Zëri "Të tjera" përfaqëson fonde të marra nga Banka për një hua të dhënë qeverisë nga Banka Islamike e Zhvillimit, prej 22 milionë lekësh (2005 – 24 milionë lekë).

16. TË ARDHURA PËR T'U SHPËRNDARË

	Ndihma nga Banka Boterore	Të tjera	Total
Gjendja më 31 dhjetor, 2005	289	36	325
Pakësime	(157)	-	(157)
Gjendja më 31 dhjetor, 2006	132	36	168
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 31 dhjetor, 2005	196	-	196
Amortizimi i vitit	53	-	53
Pakësime	(157)	-	(157)
Gjendja më 31 dhjetor, 2006	92	-	92
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 dhjetor, 2006	40	36	76
Gjendja më 31 dhjetor, 2005	93	36	129

Ndihma nga Banka Botërore i referohet ndihmave të përfituara nga Banka gjatë viteve 2002-2005, respektivisht për blerjen e programeve kompjuterike dhe të pajisjeve, për zbatimin e projektit AIPS "Sistemi Shqiptar i Pagesave Ndërbankare" prej 68 milionë lekësh, si dhe projektit AECH "Sistemi i Kryqëzimit të Pagesave me vlerë të vogël" prej 64 milionë lekësh. Pakësimi prej 157 milionë

lekësh, në zërin “Ndhima nga Banka Botërore”, rezulton nga amortizimi i plotë i ndihmës dhënë nga Banka Botërore për blerjen e sistemit ATM.

“Të tjera” prej 36 milionë lekësh, përfaqëson vlerën e dy godinave dhuratë në qytetet Korçë dhe Berat.

17. DETYRIME TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Detyrimi ndaj Shtypshkronjës (Shënimi 27)	233	212
Depozita të individëve nga pjesëmarrja në bono thesari	636	469
Detyrimi ndaj fondit të pensionit, neto	6	6
Të tjera	79	74
Totali	954	761

Skema e fondit të pensionit përbëhet nga kontributi i punonjësve, në vlerën 2 % të pagës së tyre bruto si dhe kontributi i punëdhënësit, 15 % mbi totalin e pagave. Në 31 dhjetor 2006, vlera e mjeteve të fondit të pensionit, e investuar në letra me vlerë të qeverisë me afat maturimi 12-mujor, është 366 milionë lekë. Vlera e akumuluar e kontributeve të derdhura nga punonjësit e siguruar në fond, deri në 31 dhjetor 2006 është 24 milionë lekë (31 dhjetor 2005 - 19 milionë lekë), ndërkohë që totali i kontributeve të derdhura nga Banka në Fond, që nga krijimi i Fondit deri në 31 dhjetor 2006, është në vlerën 251 milionë lekë (31 dhjetor 2005 – 203 milionë lekë).

Në zërin “Të tjera”, përfshihen kryesisht shpenzime të llogaritura prej 29 milionë lekësh (2005 – 23 milionë lekë), të cilat lidhen me mirëmbajtjen e sistemit ATM, shërbime për informacione statistikore, komisione për administrimin e rezervës valutore nga IBRD etj.. Në këtë zë është përfshirë edhe provigjoni i pretendimeve për disa çështje ligjore, krijuar në kushte normale biznesi. Në 31 dhjetor 2006, një provigjon prej 22 milionë lekësh është njohur në lidhje me këto pretendime (2005 – 22 milionë lekë). Gjatë vitit 2006, rezulton një shtesë në provigjone prej 19 milionë lekësh dhe janë rimarrë në të ardhura, 19 milionë lekë nga provigjonet e viteve të kaluara (shënimi 24).

18. REZERVA E RIVLERËSIMIT

Përbërësit e rezervës së rivlerësimit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Rivlerësimi i monedhave të huaja dhe arit	(15,505)	(12,164)
Rivlerësimi i letrave me vlerë	(377)	(310)
Rivlerësime të tjera	26	22
Totali	(15,856)	(12,452)

Gjatë vitit 2006, humbja neto nga rivlerësimi i monedhave të huaja dhe arit nga luhatja e kursit të këmbimit është në një vlerë prej 3,341 milionë lekë (gjatë vitit 2005 – fitimi neto 3,841 milionë lekë).

Në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” neni 64, pika (a), fitim/humbja neto e rezultuar nga rivlerësimi i mjeteve dhe detyrimeve në valutë të huaj, transferohet në kapital në një llogari rivlerësimi “Rezerva të rivlerësimit nga kursi i këmbimit”.

Në vijim të po këtij neni, pika (b), gjatë vitit 2006 Ministria e Financave ka emetuar letra me vlerë të qeverisë, me një total prej 12,164 milionë lekë për mbulimin e humbjeve neto nga rivlerësimi i monedhave, krijuar deri në fund të vitit 2005. Këto letra me vlerë mbahen në llogari jashtë bilancit, me një maturitet të rinovueshëm prej gjashtë muajsh. Shuma prej 7,672 milionë lekësh (letra me vlerë të emetuara për mbulimin e diferencave nga rivlerësimi i monedhave, krijuar deri më 2003) u rinovua në 31 korrik 2006, me një normë interesi prej 5.56 për qind. Shuma prej 3,828 milionë lekësh (letra me vlerë të emetuara për mbulimin e diferencave nga rivlerësimi i monedhave, krijuar deri më 2004) u rinovua në 1 shtator 2006, me një normë interesi prej 5.83 për qind, si dhe shuma prej 664 milionë lekësh (për mbulimin e diferencave nga rivlerësimi i monedhave, krijuar më 2005) emetuar 3 korrik 2006, me një normë interesi prej 5.42 për qind.

19. REZERVA TË TJERA

Përbërësit e rezervave të tjera janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Rezervë speciale për bilancin e pagesave	7,209	7,209
Fondi i investimit	301	301
Të tjera	1,196	672
Totali	8,706	8,182

Rezerva speciale për bilancin e pagesave ka të bëjë me grante të dhëna nga Komuniteti Evropian për Shqipërinë, si asistencë financiare për ta mbështetur në procesin e transformimit të ekonomisë, në një ekonomi tregu. Këto grante i përkasin periudhës 1992 – 1993, në mbështetje të qëndrueshmërisë së bilancit të pagesave si dhe për të forcuar pozicionin e rezervave. Kjo rezervë ka mbetur e pandryshuar që nga viti 1995.

Fondi i investimit përbëhet nga një fond i krijuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, me qëllim blerjen e një godine të re për Bankën.

“Të tjera” përfshin rezerva të krijuara në vitet respektive me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, nga shpërndarja e fitimit gjatë viteve 2002-2006.

Më 31 dhjetor 2006, rritja në “Rezerva të tjera” përfshin një shpërndarje të mëtejshme prej 495 milionë lekësh, nga fitimi i vitit 2006 si dhe një transferim prej 29 milionë lekësh nga rimarrja në të ardhura nga rezerva e rivlerësimit të aktiveve fikse, bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.13, datë 1 mars 2007.

20. TË ARDHURA NGA INTERESAT DHE KOMISIONET (JOREZIDENTËT)

	Viti që përfundon 31 dhjetor 2006	Viti që përfundon 31 dhjetor 2005
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	4,811	3,578
Interesa nga depozitat me afat	684	508
Interesa nga depozitat në sdr me FMN	51	170
Të tjera	324	89
Totali	5,870	4,345

21. SHPENZIME PËR INTERESA DHE KOMISIONE (JOREZIDENTËT)

	Viti që përfundon 31 dhjetor 2006	Viti që përfundon 31 dhjetor 2005
Amortizimi i primit të letrave me vlerë	406	594
Shpenzime për interesa nga huatë e institucioneve të huaja	13	13
Shpenzime për interesa nga llogaritë e FMN	59	48
Të tjera	16	5
Totali	494	660

22. TË ARDHURA NGA INTERESA DHE KOMISIONE (REZIDENTËT)

	Viti që përfundon 31 dhjetor 2006	Viti që përfundon 31 dhjetor 2005
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	3,902	4,194
Interesa nga huatë qeveritare	6	30
Të tjera	112	104
Totali	4,020	4,328

23. SHPENZIME PËR INTERESA DHE KOMISIONE (REZIDENTËT)

	Viti që përfundon 31 dhjetor 2006	Viti që përfundon 31 dhjetor 2005
Shpenzime për interesa mbi rezervën e detyrueshme	1,440	1,176
Shpenzime për interesa mbi marrëveshjet repo	233	196
Të tjera	58	21
Totali	1,731	1,393

24. SHPENZIME / (TË ARDHURA) TË TJERA OPERATIVE, NETO

	Viti që përfundon 31 dhjetor 2006	Viti që përfundon 31 dhjetor 2005
Humbje neto nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje	(1,503)	(397)
Fitim neto nga shitja e letrave me vlerë të mbajtura për tregtim	72	-
Amortizimi i grantit	53	42
Provizjone për çështje ligjore dhe të tjera (Shënimet 10 dhe 17)	(25)	(6)
Të tjera	32	1
Fitim i parealizuar nga rivlerësimi i letrave me vlerë të mbajtura për tregtim	4	-
Totali	(1,367)	(360)

25. SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzime të personelit përfshijnë pagat e personelit, kontributet për sigurimet shoqërore, kontributet për planin e pensionit dhe shpenzime të tjera.

Shpenzimet sociale përfaqësojnë kryesisht kontributin e detyrueshëm ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Më 31 dhjetor 2006, Banka ka patur 378 punonjës (2005 – 427 punonjës).

26. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Depozita në bankat e huaja (Shënimi 5)	38,084	10,171
Likuiditete në monedhë vendase	7,765	13,450
Likuiditete në monedhë të huaj (Shënimi 7)	15	11
Ari i mbajtur jashtë vendit (Shënimi 3)	797	708
Ari dhe metalet e tjera të çmuara të mbajtura në vend (Shënimi 3)	53	50
Totali	46,714	24,390

27. SHTYPSHKRONJA

Siç është detajuar në shënimin 2(a), Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës. Pozicioni financiar i Shtypshkronjës më 31 dhjetor 2006 dhe 2005, paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
AKTIVET		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	11	16
Inventari	25	37
Klientë	-	2
Për t'u arkëtuar nga Banka (Shënimi 17)	233	212
Totali i aktiveve	269	267
KAPITALI I VET		
Kapitali themeltar	51	51
Rezerva ligjore	19	19
Rezerva e investimit	24	24
Rezerva të tjera	6	6
Fitimi i mbartur	168	161
Totali i kapitalit të vet	268	261
Detyrime të tjera	1	6
Totali i kapitalit të vet dhe detyrimeve	269	267

	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2006	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2005
Të ardhura	72	99
Shpenzime	(65)	(97)
Fitimi i vitit	7	2

28. ANGAZHIME DHE GARANCI

Banka mban disa llogari në monedhë të huaj, në lidhje me marrëveshjet e lidhura midis Qeverisë së Shqipërisë dhe qeverive ose organizatave financiare të huaja. Meqë këto llogari nuk përbëjnë as aktiv as detyrim për Bankën e Shqipërisë, ato nuk janë përfshirë në bilancin e Bankës.

Në 31 dhjetor 2006, letra me vlerë emetuar nga Ministria e Financave, për mbulimin e humbjeve neto nga rivlerësimi i monedhave të krijuara në periudhën 2003-2005 rezulton të jetë 12,164 milionë lekë, me terma maturimi të rinovueshëm çdo gjashtë muaj.

29. AKTIVE TË ADMINISTRUARA

Më 31 dhjetor 2006, Banka mbante në kujdestari bono thesari afatshkurtra me vlerë nominale 269 miliardë lekë, obligacione afatmesme me vlerë nominale 75 miliardë lekë si dhe bono thesari afatshkurtra të shprehura në euro, me vlerë nominale prej 45 milionë euro. Këto instrumente financiare përfaqësojnë letra me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Më 31 dhjetor 2006, Banka mbante në kujdestari ar dhe metale të tjera të çmuara në emër të Qeverisë me vlerë tregu prej 5,308 milionë lekësh. Në rolin e kujdestarit për këto aktive, Banka nuk mbart asnjë lloj rreziku krediti.

Më 31 dhjetor 2006 dhe 2005 vlera e arit në kujdestari, në emër të Qeverisë përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2006 (në milionë lekë)	31 dhjetor 2005 (në milionë lekë)
Ar monetar i mbajtur në bankat e huaja	2,230	1,980
Ar jomonetar i mbajtur në bankat e huaja	1,115	990
Ar jomonetar i mbajtur brenda vendit	1,761	1,564
Metale të tjera të çmuara	202	160
Totali	5,308	4,694

Interesat e marra nga depozitimi i rezervave të arit të Qeverisë, njihen si të ardhura nga interesat për Qeverinë, duke rritur detyrimin ndaj tyre. Për vitin 2006, interesat e marrë janë rreth 6 onz. Diferenca prej 614 milionë lekësh është rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit. (Shënimi 3.)

Këto llogari nuk pasqyrohen në pozicionin financiar të Bankës.

30. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë të kontrollojë tjetrën apo të ushtrojë një influencë domethënëse mbi palën tjetër, në marrjen e vendimeve financiare apo të tjera.

Duke marrë në konsideratë çdo palë të lidhur të mundshme, vëmendje i kushtohet substancës së marrëdhënies dhe jo formës së mirëfilltë ligjore.

Banka e Shqipërisë nuk ka palë të lidhura përveçse marrëdhënieve me drejtuesit dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës. Më 31 dhjetor 2006 dhe 31 dhjetor 2005, transaksionet e realizuara me palët e lidhura përbëhen nga:

	31 dhjetor 2006	31 dhjetor 2005
Kredi për strehim për stafin - Staf drejtues	84	79
Totali	84	79

Kreditë kanë norma interesash prej 0.5 për qind dhe janë të pagueshme në 30 vjet, duke filluar pas një periudhe prej 2 vjetësh, me këste të barabarta mujore. Këto kredi janë të kolateralizuara.

	Viti që përfundon 31 dhjetor 2006	Viti që përfundon 31 dhjetor 2005
Shpenzime administrative		
-Shpenzime telefoni		
-Drejtorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës	4	4
-Paga dhe bonuse		
-Drejtorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës	78	67
-Kontributi i bankës në skemën e fondit të pensionit		
-Drejtorët	7	6
Totali i shpenzimeve administrative	89	77

31. ADMINISTRIMI I RREZIKUT

Rezerva valutore administrohet nga Banka e Shqipërisë dhe investimi i saj realizohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare, i cili bazohet në rregulloren "Mbi politikën e administrimit të rezervës valutore", që miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Rezerva valutore, në përputhje me nevojat për likuiditet, investohet në instrumente financiare afatshkurtra dhe letra me vlerë me të ardhura konstante.

RREZIKU I LIKUIDITETIT

Politikat e monitorimit dhe të adresimit ndaj rrezikut të likuiditetit, përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës. Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës monitoron rrezikun e likuiditetit në mënyrë të vazhdueshme, duke analizuar treguesit e likuiditetit, boshllëqet dhe skenarët ekonomikë. Banka, administron rrezikun e likuiditetit nëpërmjet investimit në depozita afatshkurtra me bankat e huaja.

Politikat e administrimit të likuiditetit, vendosen për të siguruar që edhe në kushte të vështira, banka të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj.

RREZIKU I KREDITIT

Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës, nën kontrollin e Këshillit Mbikëqyrës, është përgjegjës për përcaktimin e rrezikut të kreditit, që shoqëron operacionet e Bankës. Rreziku i kreditit zbutet nga ana e Bankës, duke kryer transaksione të shumta me institucione qeveritare dhe ndërkombëtare. Kreditë për bankat vendase sigurohen nga bonot e thesarit të Qeverisë.

RREZIKU I ÇMIMEVE

Faktorët kyç të rrezikut të çmimeve që ndikojnë bankën janë:

- rreziku i monedhave, i shoqëruar me ndryshime në vlerën e instrumenteve financiare, për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit; dhe
- rreziku i normave të interesit, i shoqëruar me ndryshime në vlerën e instrumenteve financiare, për shkak të ndryshimeve në normat e interesave të tregut.

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të monedhave, monitorohet vazhdimisht nga Departamenti i Operacioneve Monetare. Aktivet financiare, të mbajtura në monedhë të huaj janë paraqitur në secilën prej shënimeve korresponduese në pasqyrat financiare.

Rreziku i normave të interesit monitorohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës. Banka e zbut këtë rrezik, duke mbajtur një tepricë të konsiderueshme të aktiveve interesprurëse mbi pasivet që paguajnë interes (siç detajohet në shënimin 31 më poshtë). Banka mban një portofol aktivesh dhe pasivesh financiare me interes, të tilla që e ardhura e gjeneruar nga interesi neto është në mënyrë të ndjeshme më e lartë se kërkesat operative, gjë që minimizon efektet e mundshme negative të ndryshimeve në normat e interesit. Normat e interesit që zbatohen mbi aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten në çdo shënim korrespondues të pasqyrave financiare.

32. NDJESHMËRIA E NORMAVE TË INTERESIT (ANALIZA E MATURITETIT TË MBETUR)

	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Jo të ndjeshëm ndaj interesit	Totali
Aktivët								
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	797	797
Depozita tek FMN	-	847	-	-	-	-	7,020	7,867
Depozita në banka të huaja	31,866	6,218	-	-	-	-	73	38,157
Investime të vlefshme për shitje	-	473	664	23,009	90,969	2,289	-	117,404
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	1,253	8,383	-	-	9,636
Aktive të tjera në monedhë të huaj	189	-	-	-	-	-	537	726
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	53	53
Kredi tranzite	-	-	-	-	-	-	139	139
Kredi ndaj bankave	3,350	5,500	-	-	-	-	54	8,904
Investime të vlefshme për shitje	25,013	23,932	18,630	-	-	-	-	67,575
Aktive të tjera vendase	-	-	-	-	-	857	3,366	4,223
Totali i aktiveve	60,418	36,970	19,294	24,262	99,352	3,146	12,039	255,481
Detyrimet dhe kapitali i vet								
Detyrime ndaj FMN	235	150	319	627	4,929	2,458	6,538	15,256
Detyrime ndaj institucioneve financiare jövendase	-	-	-	-	-	1,090	156	1,246
Detyrime të tjera të huaja	186	-	-	-	-	-	-	186
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	168,234	168,234
Detyrime ndaj bankave vendase	53,030	-	-	-	-	-	545	53,575
Detyrime ndaj qeverisë	-	-	-	-	-	-	15,944	15,944
Të ardhura për t'u shpërndarë	-	-	-	-	-	-	76	76
Detyrime të tjera vendase	-	-	-	-	-	-	954	954
Kapitali dhe rezervat	-	-	-	-	-	-	10	10
Totali i detyrimeve, kapitali i vet dhe rezervat	53,451	150	319	627	4,929	3,548	192,457	255,481
Ndryshimi i bilancit më 31 dhjetor 2006	6,967	36,820	18,975	23,635	94,423	(402)	(180,418)	-
Ndryshimi i akumuluar nga ndjeshmëria e normave të interesit - 2006	6,967	43,787	62,762	86,397	180,820	180,418	-	-

	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Jo të ndjeshëm ndaj interesit	Totali
Aktivet								
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	708	708
Depozita tek FMN	-	1,295	-	-	-	-	7,136	8,431
Depozita në banka të huaja	7,868	-	-	-	-	-	2,307	10,175
Investime të vlefshme për shitje	1,747	8,744	4,886	20,877	97,210	-	-	133,464
Aktive të tjera në monedhë të huaj	-	-	-	-	-	-	551	551
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	50	50
Kredi tranzite	-	-	-	-	-	-	207	207
Investime të vlefshme për shitje	23,371	25,038	18,412	-	-	-	-	66,821
Investime të mbajtura deri në maturim	1,725	-	-	-	-	-	-	1,725
Aktive të tjera vendase	-	-	-	-	-	707	1,816	2,523
Totali i aktiveve	34,711	35,077	23,298	20,877	97,210	707	12,775	224,655
Detyrimet dhe kapitali i vet								
Detyrime ndaj FMN	-	263	264	597	5,338	3,051	6,632	16,145
Detyrime ndaj institucioneve financiare jo vendase	-	-	-	5	-	1,079	235	1,319
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	153,550	153,550
Detyrime ndaj bankave vendase	43,264	-	-	-	-	-	1,918	45,182
Detyrime ndaj qeverisë	-	-	-	-	-	-	6,356	6,356
Të ardhura për t'u shpërndarë	-	-	-	-	-	-	129	129
Detyrime të tjera vendase	-	-	-	-	-	-	761	761
Kapitali dhe rezervat	-	-	-	-	-	-	1,213	1,213
Totali i detyrimeve, kapitali i vet dhe rezervat	43,264	263	264	602	5,338	4,130	170,794	224,655
Ndryshimi i bilancit më 31 dhjetor 2005	(8,553)	34,814	23,034	20,275	91,872	(3,423)	(158,019)	-
Ndryshimi i akumuluar nga ndjeshmëria e normave të interesit - 2005	(8,553)	26,261	49,295	69,570	161,442	158,019	-	-

33. POZICIONI NETO I MONEDHËS

	LEKË	USD	EURO	GBP	Të tjera	Totali
Aktivët						
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	797	797
Depozita tek FMN	6,538	-	-	-	1,329	7,867
Depozita në bankat e huaja	-	9,096	24,496	1,380	3,185	38,157
Investime të vlefshme për shitje	-	40,239	68,791	8,374	-	117,404
Investime të mbajtura deri në maturim	-	9,636	-	-	-	9,636
Aktive të tjera në monedhë të huaj	335	379	12	-	-	726
Ari dhe metale të çmuara	53	-	-	-	-	53
Kredi tranzite	-	15	124	-	-	139
Kredi ndaj bankave	8,904	-	-	-	-	8,904
Investime të vlefshme për shitje	67,575	-	-	-	-	67,575
Aktive të tjera vendase	4,219	2	2	-	-	4,223
Totali i aktiveve	87,624	59,367	93,425	9,754	5,311	255,481
Detyrimet						
Detyrime ndaj FMN	6,889	-	-	-	8,367	15,256
Detyrime ndaj institucioneve financiare jovendase	12	15	1,219	-	-	1,246
Detyrime të tjera të huaja	-	186	-	-	-	186
Para në qarkullim	168,234	-	-	-	-	168,234
Detyrime ndaj bankave vendase	35,227	6,472	11,876	-	-	53,575
Detyrime ndaj qeverisë	8,890	338	6,715	1	-	15,944
Të ardhura për t'u shpërndarë	76	-	-	-	-	76
Detyrime të tjera vendase	938	13	3	-	-	954
Totali i detyrimeve	220,266	7,024	19,813	1	8,367	255,471
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2006	(132,642)	52,343	73,612	9,753	(3,056)	10
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2005	(117,926)	49,795	65,013	9,029	(4,698)	1,213

